



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Me Çfarë Çmimi?

Alokimet Buxhetore për
Zbatimin e Kornizës Ligjore
kundër Dhunës në Familje në
Kosovë



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Me Çfarë Çmimi?

Alokimet Buxhetore për
Zbatimin e Kornizës Ligjore
kundër Dhunës në Familje në
Kosovë

Përgatitur nga Nicole Farnsworth, Ariana Qosaj-Mustafa, Milva Ekonomi, Ada Shima dhe
Dua Dauti-Kadriu për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

© United Nations Development Programme, 2012. All rights reserved.

Autore: Nicole Farnsworth, Ariana Qosaj-Mustafa, Milva Ekonomi, Ada Shima dhe Dua Dauti-Kadriu për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

Ky hulumtim është përkrahur nga Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI) e Programit për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës. Qëndrimet e paraqitura në këtë raport nuk përbëjnë domosdoshmërisht qëndrime të UNDP-së.

ISBN 978-9951-498-08-1

Përktheu: Arben Fetahu

Dizajni dhe faqosja: Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës dhe Night Design.

Shtypi: Grafika Reznij



Kingdom of the Netherlands



*Empowered lives.
Resilient nations.*

*Për Diana Kastratin dhe familjen e saj,
të cilët edhe një vit pas vrasjes brutale të saj
ende nuk kanë gjetur drejtësi*

Falënderime

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) u shpreh mirënjohje 181 përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, organizatave joqeveritare dhe donatorëve që kontribuan në realizimin e këtij hulumtimi. Ky hulumtim nuk do të mund të realizohej pa ndihmën e tyre.

Falënderojmë Iniciativën për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI) të Programit për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) për financimin e këtij hulumtimi, për durimin që tregoi deri në finalizimin e tij dhe për ndihmën e vlefshme që UNDP na dha gjatë këtij procesi, në veçanti përmes Departamentit për Politika, Çështje Gjinore, Hulumtime dhe Komunikim (PGRC).

RRGGK i është mirënjohës ekipit hulumtues, të përbërë nga personat në vijim, për përkushtimin e treguar dhe për orët e shumta që i kaluan duke lexuar, diskutuar, shkruar dhe kontrolluar faktet relevante: Nicole Farnsworth, Ariana Qosaj-Mustafa, Milva Ekonomi, Ada Shima dhe Dua Dauti-Kadriu. Dr. Elizabeth Villagómez Morales dha kontribut të vlefshëm në cilësinë e ekspertit ndërkombëtar pranë këtij ekipi. Drejtoresha Ekzekutive e RRGGK-së, Igballe Rogova, i dha këtij ekipi shtytje shtesë përmes përkrahjes së vazhdueshme morale dhe ekspertizës së saj, dhe Elmaze Gashi e rishikoj me kujdes. Sara Nicole Baxley pati mirësinë që ta redaktojë këtë raport. Duam të falënderojmë Itziar Mujin, Donjeta Muratin, Zana Rudin dhe Blerina Kaçikun për ndihmën e ofruar. Fjolla Dukagjini Klisurica, Liridona Dobërdolani, Franziska Güther, Shqipe Gjocaj dhe Amy Hillock punuan vullnetarisht për të ndihmuar në procesin e transkriptimit.

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Përmbledhje Ekzekutive.....	1
Hyrje	3
Përkushtimi i UNDP-së për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave	4
Si Përkufizohet Dhuna në Familje në Kosovë dhe Kush Preket nga Ajo?	4
Çka Është Buxheti nga Perspektiva Gjinore dhe Përse Është i Rëndësishëm për Kosovën?.....	6
Lidhur me Këtë Hulumtim: Shkurtime mbi Metodologjinë.....	8
Kufizimet: Si të Vlerësohen Kostot në Kosovë?	9
Çka Përmban Ky Raport?	9
Kapitulli 1. Korniza Ligjore në Kosovë.....	11
Konventat Ndërkombëtare dhe Krimi i “Padukshëm” në Kosovë.....	11
Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje	13
Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014.....	15
Monitorimi dhe Vlerësimi i Implementimit të Kornizës Ligjore	17
Kapitulli 2. Kush	20
Vendosë Si Ndahen Paratë? Procesi Buxhetor në Kosovë	20
Prioritetet: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve.....	20
Drejt një Procesi Buxhetor me Pjesëmarrje: Cikli Buxhetor i Kosovës	25
Konkluzione: Pengesat Buxhetore Ndikojnë në Shërbimet që Ndërlidhen me Dhunën në Familje ..	30
Arsimimi Formal për Dhunën në Familje.....	31
Ngritja e Vetëdijes.....	32
Matja e Raportimit të Shtuar	35
Konkluzionet	37
Kapitulli 4. Mbrojtja, Siguria dhe Ndjekja Penale	38
Policia: Ofrimi i Mbrojtjes dhe Sigurisë	38
Zyrtarët e Departamentit të Mjekësisë Ligjore: Sigurimi i Provave për Mbrojtje dhe Ndjekje Penale.....	41
Gjykatat: Mbrojtja e Viktimave, Ndjekja e Autorëve të Dhunës, Avancimi i Sigurisë	43
Mbrojtësit e Viktimave: në Mbrojtje të Drejtave	49
Komisioni për Ndihmë Juridike: Mbrojtja e Viktimave, Mundësimi i Ndjekjes Penale.....	51
Shërbimet e Mirëqenies Sociale: Mbrojtja e Viktimave, në Veçanti e Fëmijëve	53
Strehimoret: Mbrojtja e Viktimave	58
Shërbimi Korrektues: Siguri për Viktimat, Rehabilitim për Autorët e Dhunës	62
Konkluzione: Mbrojtja e Viktimave të Dhunës në Familje, Ndjekja Penale e Autorëve.....	63
Kapitulli 5. Rehabilitimi dhe Reintegrimi	64
Kujdesi Shëndetësor Drejt Rehabilitimit	Error! Bookmark not defined.
Kujdesi Shëndetësor Drejt Rehabilitimit	64
MASHT: Arsimimi Drejt Fuqizimit Ekonomik dhe Reintegrimit	69
Fuqizimi ekonomik drejt reintegrimit.....	71
Rehabilitimi dhe Reintegrimi: Strehimoret dhe OJQ-të	73
Rehabilitimi dhe Reintegrimi i Autorëve të Dhunës.....	75
Konkluzione	79
Kapitulli 6. Referimet dhe Koordinimi: Një Qasje e Përqendruar tek Viktimat	80
Kapitulli 7. Në Përmbledhje: Kostoja e Dhunës në Familje.....	85
Rekomandime.....	91
Shtojca 1. Kostot e Gjithmbarshme të Dhunës në Familje në Vitin 2011-2012	100
Shtojca 2. Krahësimi i Buxhetit të Strategjisë me Alokimet Aktuale	116
Shtojca 3. Të Hyrat Buxhetore Komunale për Shërbimet Sociale sipas Madhësisë së Popullsisë ..	121
Shtojca 4. Lista e Participantëve të Hulumtimit.....	122
Shtojca 5. Vlerësimet e Mëhershme lidhur me Buxhetimin Gjinnor dhe Dhunën në Familje	129

Shkurtesat

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AGP	Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
BPGJ	Buxhetimi nga Perspektiva Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Ndaj Grave
CLARD	Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve
QPS	Qendra për Punë Sociale
QSGF	Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve
QRP	Qendra Rajonale për Punësim
QMG	Qendra për mirëqenien e grave
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSHPS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Punë Sociale
DMS	Departamenti për Mirëqenie Sociale
DMNV	Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave
DHF	Dhuna në familje
DHBGJ	Dhuna në baza gjinore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
SDSF	Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve - Kosovë
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnime për Hetime Penale i Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
KDF	Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Thelbësore
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KtK	<i>Kvinna till Kvinna</i>
KE	Komisioni Evropian
KNJ	Komisioni për Ndihmë Juridike
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
Ligji	Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MF	Ministria e Financave
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Marrëveshje e mirëkuptimit
MAP	Ministria e Administratës Publike

MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MV	Mbrojtës i viktimave
MVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit
NHDHF	Njësia e Hetimeve për Dhunë në Familje
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
OJQ	Organizatë joqeveritare
OPDAT	Zyra për Zhvillim, Asistencë dhe Trajnime Prokuroriale Ndërkombëtare (SH.B.)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë
PILPG	Grupi Ndërkombëtar për Drejtën dhe Politikat Ndërkombëtare
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PKKT	Programi i Kosovës Kundër Trafikimit
RRGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
Strategjia	Programi Kundër Dhunës në Familje në Kosovë dhe Plani i Veprimit 2011-2014
UA	Udhëzim Administrativ
UM	Urdhër Mbrojtës
UNDP	Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNKT	Ekipi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara
ZBGJ	Zyrtar për Barazi Gjinore
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave
WSSI	Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas

Përmbledhje Ekzekutive

Në këtë raport është shfrytëzuar qasja e shqyrtimit të kostove të parandalimit të dhunës në familje, mbrojtjes së viktimave, ndjekjes penale të autorëve të saj dhe përkrahjes së rehabilitimit dhe reintegrimit të tyre, të cilat rregullohen me ligjet dhe politikat e zbatueshme në Kosovë në makro-nivel. Për të arritur deri tek përllogaritjet në vijim, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK), i financuar nga UNDP, u konsultua me 184 palë të interesuara. Saktësia e disa prej këtyre përllogaritjeve mund të jetë e kufizuar, për shkak të mangësive në sistemin e grumbullimit të të dhënave dhe linjave buxhetore të zbehta.

Në vitin 2011 shërbimet që ndërlidhen me adresimin e **dhunës në familje kanë kushtuar së paku €3,060,116**, nga të cilat mbi €1,923,124 janë ndarë nga shteti dhe mbi €1,136,992 nga donatorët (37.2%). Vetëm 0.13% të shpenzimeve të gjithmbarshme të Kosovës gjatë vitit 2011 janë ndarë në shërbime shtetërore për adresimin e dhunës në familje. Në përgjithësi, shpenzimet e ndërlidhura me shërbimet për dhunën në familje kanë kushtuar €1.76 për kokë banori, apo €1.11 për person në kuptim të taksave vjetore të paguara. **Qeveria dhe donatorët kanë ndarë bindshëm më shumë resurse për mbrojtje (€2,088,581) se sa për parandalim (€526,264) apo rehabilitim dhe reintegrim (€399,585).** Ka shumë gjasa që këto shifra të mos pasqyrojnë të gjitha shpenzimet që qeveria i ka bërë për adresimin e dhunës në familje.

Më tej, kostoja aktuale e shërbimeve të dhunës në familje, të cilat ofrohen në pajtueshmëri me kornizën e zbatueshme ligjore dhe politike, është mjaft më e lartë. **Në shumë fusha institucionet ose nuk kanë ndarë fare buxhet ose buxheti që kanë ndarë ka qenë i pamjaftueshëm.** Kjo ngjan kryesisht për shkak se shumë institucione nuk kanë njohuri të mjaftueshme për përgjegjësitë që kanë lidhur me adresimin e dhunës në familje, për shkak të indikatorëve të dobët të performansës dhe për shkak të **koordinimit të pamjaftueshëm mes zyrtarëve për buxhet, zyrtarëve programor dhe zyrtarëve për barazi gjinore.** Poashtu, duhet të miratohen edhe shumë akte nënligjore dhe Procedura Standarde Operative, zbatimi i së cilave ka implikacione buxhetore.

Mes mangësive të shumta, vlen të përmenden **disa praktika më të mira.** Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndarë buxhet për psikologët të cilët duhet të këshillojnë nxënësit; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe disa komuna u kanë siguruar strehimoreve financim të pjesshëm të veprimtarive të tyre; dhe disa gjyqtarë të specializuar i kanë dhënë prioritet trajtimit të rasteve të dhunës në familje.

Tani institucionet relevante kanë **përgjegjësi** për të vlerësuar shpenzimet e nevojshme për të ofruar shërbimet që mungojnë apo për të përmirësuar mangësitë në shërbimet ekzistuese. Shtyllat programatike qeveritare të 1) parandalimi dhe 2) mbrojtjes, sigurisë dhe ndjekjes penale mund të implementohen pjesërisht duke i shfrytëzuar buxhetet ekzistuese të institucioneve relevante. Megjithatë, rehabilitimi dhe reintegrimit mbesin të nënfinancuara për shkak se shërbimet e tilla ishin të pakta në kohën e përpilimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KASH) për vitet 2012-2014. Ofrimi i shërbimeve që ndërlidhen me rehabilitimin dhe reintegrimin nuk mund të sigurohet me mjetet që aktualisht sigurohen përmes KASH-it, ndërsa mjete tjera nuk mund të ndahen për këtë qëllim deri në vitin 2014. Për më tepër, përkundër zotimeve në KASH për të përkrahur sundimin e ligjit, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe mirëqenien sociale, qeveria mbetet e fokusuar në investime kapitale (që marrin mbi 60% të shpenzimeve qeveritare). Rrjedhimisht, për shërbime sociale ka pak mjete në dispozicion. Kjo ka ndikim në tërë popullatën, edhe pse mund të thuhet se viktimat e dhunës në familje, si një nga grupet më të cenueshme të shoqërisë, janë mes atyre që më së keqi ndikohen nga mungesa e mjeteve.

RRGGK ua propozon institucioneve disa strategji për të tejkaluar sfidat financiare gjatë implementimit të përgjegjësive ligjore të tyre lidhur me dhunën në familje: 1) rishqyrtimi i linjave buxhetore, identifikimi i mënyrave për **shfrytëzim më efikas të resurseve shtetërore**; 2) sigurimi i fondeve nga donatorët; 3) gjetja e mënyrave inovative për të **shtuar të hyrat**; ose **4) investimi në parandalim**, si mjet për të zvogëluar shpenzimet e përgjithshme që ndërlidhen me dhunën në familje. Këto sugjerime dhe rekomandimet tjera që ofrohen në kapitujt në vijim do duhej t'i shërbejnë Qeverisë së Kosovës gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2013 dhe të KASH-it të radhës.


Hyrje

Këshilli i Evropës vlerëson se dhuna në familje është shkaktari kryesor i vdekjes dhe paaftësisë të grave të moshës mes 16 dhe 44 vjeç në Evropë.¹ Në Kosovë, dhuna në familje përbën formën më të përhapur të dhunës në baza gjinore.² Ekzistojnë një kornizë ligjore e cila është ndryshuar rishtas si dhe institucione e organizata të cilat janë të thirrura që të parandalojnë dhunën në familje, të mbrojnë viktimat, të ndjekin autorët e dhunës dhe të kryejnë rehabilitimin e viktimave, autorëve të dhunës dhe fëmijëve të tyre.³ Shërbime gjegjëse ofrohen nga institucione të ndryshme, përfshirë mes tjerash njësitë e specializuara të policisë, mbrojtësit e viktimave të cilët mbrojnë të drejtat e këtyre të fundit, zyrtarët që ofrojnë ndihmë juridike, qendrat për punë sociale dhe strehimoret. Miratimi para pak kohe i Ligjit për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm "Ligji") dhe i Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm "Strategjia") për periudhën 2011-2014 përbëjnë hapa të rëndësishëm përpara në këtë drejtim. Tani, është i domosdoshëm monitorimi me të cilin sigurohet implementim efektiv dhe efikas i kësaj kornize ligjore.

Implementimi kërkon resurse dhe vlerësim të saktë të kostove që ndërlidhen me dhunën në familje. Ky hulumtim mëton të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të **shpenzimeve të shtetit lidhur me implementimin e Ligjit dhe Strategjisë dhe të kornizës ligjore më të gjerë.** Dhuna në familje ndërthet edhe shpenzime tjera (shih diagramin 1). Do të mund të vlerësohej edhe ndikimi i gjithmbarshëm social dhe ekonomik i dhunës në familje tek individët, familjet dhe kompanitë (shih gjysmërrethin me ngjyrë të çelët). Megjithatë, ky hulumtim është fokusuar në shpenzimet që shteti i ka në bazë të zotimeve dhe obligimeve shtetërore (rrethi me ngjyrë të errët). Këtu përfshihet edhe shtjellimi i resurseve jashtetërore që ia lehtësojnë shtetit realizimin e përgjegjësive të tij (p.sh. fondet e siguruar nga donatorët). Ky studim mëton të përkrahë autoritetet e Kosovës në implementimin e kornizës ekzistuese ligjore, duke u ofruar të gjitha palëve me interes informata më të sakta mbi shpenzimet e ndërlidhura me dhunën në familje dhe me procesin buxhetor në Kosovë.

Në këtë kapitull bëhet ndërlidhja e këtij hulumtimi me mandatin më të gjerë të UNDP-së për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave; më tej në këtë kapitull përkufizohet dhuna në familje, shtjellohet përhapja dhe perceptimet mbi dhunën në familje në Kosovë; përkufizohet Buxhetimi nga Perspektiva Gjinore (BPGJ) dhe rëndësia e tij; si dhe

Diagrami 1. Shpenzimet Matëse kundrejt Ndikimit



¹ Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare "Dhuna ndaj gruas në familje," rekomandimi 1582, 2002.

² Shih publikimin e RRGK-së, *Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për Qëllime të Strategjisë së Parë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) pranë Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, 2008, faqe 2.

³ RRGK nuk përkrahë termin "viktimë"; ky term mund të përforcojë më tej nocionin e viktimizimit dhe të pengojë kapacitetet dhe mundësitë potenciale të personave që kanë pësuar nga dhuna që të kenë ndikim mbi jetët dhe të ardhmet e tyre. Në këtë raport ky term përdoret për shkak se ai shfrytëzohet në kornizën aktuale ligjore të Kosovës dhe nga shumica e institucioneve të vendit.

ofrohet një përmbledhje e metodologjisë hulumtuese dhe një pasqyrë mbi pjesën e mbetur të këtij raporti.

Përkushtimi i UNDP-së për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave

Ky hulumtim i financuar nga UNDP i kontribuon zotimeve më gjithëpërfshirëse të UNDP-së për avancimin e barazisë gjinore në Kosovë. UNDP Kosovë ka përshpejtuar integrimin e dimensioneve gjinore në të gjithë sektorët dhe fuqizimin e tyre si mjet për të siguruar rezultate më të mira për të dy gjinitë. Të gjitha veprimet e ndërmarra bien nën kornizën e Strategjisë së UNDP-së për Barazi Gjinore dhe Agjendës Tetëpikëshe të UNDP-së për Parandalimin e Krizave dhe Rimëkëmbjen drejt Fuqizimit të Grave dhe Barazisë Gjinore, bazuar në Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Avancimi i sigurisë dhe drejtësisë gjinore mbetet prioritet parimor. Theksi vihet edhe në mbrojtjen sociale, ekonomike, politike dhe kulturore të grave në kontekst të sigurimit të kushteve të qëndrueshme të jetesës. Programet në fjalë promovojnë llogaridhënien nga qeveritë dhe institucionet në kuptim të implementimit të ligjeve që i marrin parasysht kontekstet gjinore dhe të sigurimit se mobilizimi i resurseve, koordinimi i ndihmave, alokimet buxhetore dhe shpërndarja e fondeve do të kryhen duke marrë parasysht kanalizimin e çështjeve gjinore. Fundja, qëllimi i UNDP-së në Kosovë është që të avancojë rolin e grave në vendimmarrje.

Përmes WSSI, e cila financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës, UNDP i ka përkrahur institucionet e Kosovës në shtimin e kapaciteteve të shërbimeve parandaluese dhe reaguese, në veçanti sa i përket dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore. UNDP WSSI punon pranë sektorëve të drejtësisë, sigurisë, mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe arsimit me qëllim të sigurimit të adresimit të barabartë të nevojave të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

Ky studim është kërkuar nga UNDP Kosovë, me qëllim të të kuptuarit më të mirë të shpenzimeve që ndërlidhen me dhunën në familje në Kosovë. Përcaktimi i masës deri në të cilën ligjet dhe zotimet që ndërlidhen me dhunën në familje përkrahen me alokime përkatëse buxhetore përfaqëson një hap kyç drejt shtimit të sigurisë së grave në Kosovë.

Si Përkufizohet Dhuna në Familje në Kosovë dhe Kush Preket nga Ajo?

Dhuna në familje përkufizohet si "një apo më shumë veprime të qëllimshme apo neglizhim nga një person ndaj një personi në marrëdhënie familjare, përfshirë mes tjerash përdorimin e forcës fizike apo presionin psikologjik, duke bërë që personi të frikësohet për mirëqenien ekonomike të tij/saj dhe duke u shkaktuar atyre dëme materiale." Një sërë veprash penale të kryera brenda marrëdhënieve familjare mund të konsiderohen dhunë në familje.⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) rregullon ndjekjen penale (automatike) sipas detyrës zyrtare të veprave penale si lëndim i lehtë trupor, lëndim i rëndë trupor, kushte të ngjashme me skllavërinë, puna e dhunshme, dhunimi dhe ngacmimi seksual, në rastet kur këto kryhen brenda një marrëdhënieje familjare.⁵ Lëndimi i lehtë trupor, shkelja e urdhrit mbrojtës, aktet seksuale jokonsensuale, eksploatimi seksual, rrëmbimi dhe dëmtimi i pronës së një personi tjetër konsiderohen vepra penale. Ligji i ri për mbrojtje nga dhuna në familje ofron një përkufizim më të gjerë të dhunës në familje se sa KPRK. Megjithatë, ky ligj është i zbatueshëm vetëm si mjet civil që mund të realizohet përmes procedurës civile.

⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) nuk bën përkufizimin e dhunës në familje si të tillë. Megjithatë, nëse kryhen brenda marrëdhënieve familjare (e cila përkufizohet në nenin 107, paragrafi 24), këto vepra mund të shqyrtohen për ndjekje penale. Këto vepra penale trajtohen në kapituj të ndryshëm, përfshirë veprat penale kundër jetës dhe trupit; lirive dhe të drejtave të njeriut; integritetit seksual; martesës dhe familjes; pronës; dhe të drejtës ndërkombëtare (shih nenet 137, 153, 154, 160-162, 193, 195-197, 210-213, 252, 253, 257, 258, 260, 261).

⁵ Për më shumë informata mbi kornizën ligjore, shih Kapitullin 1.

Edhe pse dhuna në familje prek edhe meshkujt, dëshmitë sugjerojnë që ajo ka tendencë që të ndikojë më shumë tek femrat. Rolet dhe pabarazitë gjinore shpesh i kontribuojnë dhunës në familje.⁶ Termi "gjinor" i referohet roleve sociale të cilat grave dhe burrave u jepen në kohë dhe vende të caktuara. Ato nuk janë biologjike, por të sajura nga shoqëria. Një nëpunës civil i tha RRGK-së "dhuna nuk është aq e pranishme në regjionin tonë, sepse ne gratë i kemi të dëgjueshme." Kjo sugjeron se gratë "duhet" të jenë të dëgjueshme, përndryshe - përdoret dhuna. Normat gjinore poashtu përcaktojnë se meshkujt "duhet të jenë të fortë" dhe të mos flasin për dhunën të cilën e pësojnë në shtëpi. Nëse dhuna në familje shqyrtohet në kontekstin e roleve gjinore të dhëna nga shoqëria, parandalimi i dhunës në familje mund të bëhet vetëm pas ndryshimit të normave dhe roleve që u jepen grave dhe burrave. Kjo mund të arrihet duke shtuar vetëdijen mbi faktin se dhuna në familje nuk është "normale", se ajo është krim dhe mënyrë e sjelljes sociale e cila mund të ndryshohet.

"Ne ende jemi një shoqëri patriarkale. Ne ende nuk besojmë në gratë dhe fëmijët. Prandaj ne i shtypim ato."
- Zyrtare, Drejtorja për Ekonomi dhe Financa

Në anketën e fundit reprezentative të amvisërive për dhunën në shtëpi, të realizuar në nivel të Kosovës e të quajtur *Siguria fillon në shtëpi*, u shtjellua prania e dhunës fizike, psikologjike dhe seksuale nëpër familje. Ky hulumtim i vitit 2008, i financuar nga UNDP dhe i realizuar nga RRGK, mbuloi një mostër të përzgjedhur prej 1,256 qytetarësh të etnive të ndryshme. Në bazë të informatave të grumbulluara nga respondentët, 43% kishin përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje gjatë jetës së tyre (46.4% femra dhe 39.6% meshkuj).⁷ Tetëmbëdhjetë për qind (11% të femrave) kishin pësuar dhunë fizike, ndërsa 3.5% të femrave kishin përjetuar edhe dhunë seksuale. Dhuna fizike kishte prekur 30% të

"Dhuna në Familje nuk i përket vetëm një kulture të caktuar. Ajo ndikon tek të gjithë. Ne mund ta gjejmë Dhunën në Familje në komunitetin [Kosovar] Shqiptar, në komunitetin Serb dhe në komunitete të tjera."
- Prokurori

respondentëve (pothuajse dy herë më shumë femrat se meshkujt). Gati 13.7% të respondentëve të gjinisë femërore kishin përjetuar dhunë ekonomike, që nënkupton shfrytëzimin e financave për të ushtruar ndikim apo autoritet mbi një person tjetër.⁸ Dhuna në familje konsiderohet çështje private dhe shpesh

mbetet pa u raportuar,⁹ kështu që ajo mund të jetë më e pranishme se sa që pretendohet nga respondentët. Edhe pse dhunë në familje kanë përjetuar individë të gjinive, moshave dhe etnive të ndryshme, si dhe persona me statuse të ndryshme ekonomike dhe nga regjione të ndryshme gjeografike, grupet demografike më të prekura nga dhuna në familje ishin gratë, qytetarët nga viset rurale, shqiptarët Kosovar, personat me nivel më të ulët të arsimit,¹⁰ të papunët, të varfrit dhe/ose personat që pranonin ndihmë sociale.¹¹ Banorët e Fushë Kosovës dhe Podujevës kishin më shumë gjasa që të vuajnë nga dhuna në familje se sa banorët e viseve të tjera.

Ky hulumtim ekzaminonte edhe perceptimet mbi dhunën në familje.¹² Shumë respondentë pajtoheshin me deklarata si "dhuna është pjesë normale e çdo marrëdhënieje

⁶ Për më shumë rreth shkaqeve të dhunës në familje, shih RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*.

⁷ RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*. Kjo përfshin dhunën në familje të përjetuar si fëmijë dhe si të rritur.

⁸ Kjo mund të përfshijë "moslejimin që një person të punojë për përfitime ekonomike; refuzimin e punës dhe kontributit për buxhetin familjar; mosfrimin e përkrahjes financiare për familjen; apo refuzimin për të ndarë paratë me partnerin për blerjet që kryhen brenda ekonomisë familjare" (për më shumë informata, shih RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*, f. 35).

⁹ Rreth 40% të respondentëve që kanë përjetuar dhunë në familje këtë nuk ia kanë treguar askujt; 15% thanë se edhe po të përjetonin dhunë, ata kurrë nuk do ta raportonin atë (RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*).

¹⁰ Njëzet për qind të viktimave të anketuara nuk kanë përfunduar fare shkollimin fillor, 17.2 kanë kryer shkollën fillore, 34.4% kanë vijuar shkollën e mesme ndërsa 6.6 studimet universitare.

¹¹ RRGK kishte zbuluar korrelacionin mes këtyre grupeve demografike dhe personave që kanë përjetuar dhunë në familje.

¹² Për më shumë informata, shih RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*.

dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna mund të ndodh ndonjëherë” (40%) apo “marrëdhënia seksuale nuk mund të konsiderohet dhunë në rast se zhvillohet mes dy personave të martuar të moshës madhore” (60%).¹³ Respondentët tregonin tendencë të të besuarit se ishte “normale” apo e pranueshme që burri të jetë i papunë (62.4%) apo të ketë përdorur alkool kohëve të fundit (43%).

Në vitin 2009, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka përpiluar indikatorët anketues për të matur shkallën e dhunës ndaj grave në nivel shteti.¹⁴ Këta indikatorë mëtojnë të shtojnë nivelin e vetëdijes për dhunën në familje, tu shërbejnë si informatë politikave publike, përfshirë organet koordinuese, buxhetet, planet e veprimit, legjislacionin, protokollet, zbatimin e ligjeve, shërbimet, arsimin, trajnimet, përfshirjen e mediave, hulumtimet, grumbullimin e të dhënave dhe praktikën gjyqësore.¹⁵ Ato ofrojnë mundësi për të kryer krahasime në nivel shtetëror dhe në nivel ndërkombëtar. Siç paraqitet në Tabelën 1, përqindja e grave të cilat i janë nënshtruar dhunës fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike gjatë vitit të fundit në Kosovë nuk është në dispozicion, pasi që hulumtimi i fundit reprezentativ është kryer në vitin 2008.¹⁶

Tabela 1. Indikatorët e OKB-së në Kosovë

Indikatorit (NA = Nuk është në dispozicion)	
1. Norma e grave që i janë nënshtruar dhunës fizike gjatë 12 muajve të fundit	NA
2. Norma e grave që i janë nënshtruar dhunës fizike gjatë jetës së tyre	11.0%
3. Norma e grave që i janë nënshtruar dhunës seksuale gjatë 12 muajve të fundit	NA
4. Norma e grave që i janë nënshtruar dhunës seksuale gjatë jetës së tyre	3.5%
5. Norma e grave që i janë nënshtruar dhunës fizike/seksuale nga partneri aktual/i kaluar gjatë 12 muajve të fundit	NA
6. Norma dhe shpeshtësia e përjetimit të dhunës fizike apo seksuale nga gratë prej partnerëve aktual/të kaluar gjatë jetës së tyre	NA
7. Norma e grave që i janë nënshtruar dhunës psikologjike nga partneri i tyre gjatë 12 muajve të fundit	NA
8. Norma e grave që i janë nënshtruar dhunës ekonomike nga partneri i tyre gjatë 12 muajve të fundit	NA
9. Norma e gjithmbarshme e grave që i janë nënshtruar gjymtimit gjenital	NA

Çka Është Buxheti nga Perspektiva Gjinore dhe Përse Është i Rëndësishëm për Kosovën?

Buxhetime është proces politik në të cilin grupe të ndryshme interesi konkurrojnë për të përfituar nga një sasi e kufizuar resursesh. Buxhetet shtetërore pasqyrojnë prioritetet politike, sociale dhe ekonomike të një shteti në një moment të caktuar. Qeveria e Kosovës është zotuar në Qarkoren Buxhetore që ka lëshuar se do të përkrah katër prioritetet kryesore: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, qeverisjen e mirë përmes fuqizimit të sundimit të ligjit, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe shtimin e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët.¹⁷ Të gjitha këto zotime ndërlidhen me minimizimin e dhunës në familje dhe avancimin e mëtejshëm të barazisë gjinore, kësaj të gjitha institucionet duhet të kenë parasysh edhe këtë prioritet gjatë përgatitjes së buxheteve të tyre.

¹³ RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*, f. 16-17.

¹⁴ Shih Këshilli Ekonomik dhe Social i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, *Raport i Miqve të Kryesuesit mbi Rishikimin e Indikatorëve të Dhunës ndaj Grave*, 2009; dhe *Raporti i Seancës së Dyzetë të Komisionit Statistikor të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, 2009. Të dhënat duhet grumbulluar përmes një ankete kombëtare (paragrafët 23-27), e një anketë e tillë nuk është realizuar në Kosovë për të gjithë indikatorët.

¹⁵ Shih Organizata e Kombeve të Bashkuara, *Indikatorët e OKB-së për Matjen e Dhunës Ndaj Grave*, Gjenevë, 2007.

¹⁶ Anketa nuk ka grumbulluar informata mbi religjionin, orientimin seksual apo aftësinë fizike të respondentëve. Megjithatë, *Siguria fillon në shtëpi* ka ofruar informata kualitative mbi dhunën ndaj personave në moshë, fëmijëve, homoseksualëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

¹⁷ Republika e Kosovës, Ministria e Financave, *Qarkorja Buxhetore 2012/01*. Qarkorja buxhetore është dokument që Ministria e Financave e sajton për të udhëzuar organizatat buxhetore në nivel komunal dhe shtetëror se si të përgatisin buxhetet vjetore.

BPGJ mund të përkufizohet si "sigurim i kanalizimit të çështjeve gjinore në procesin buxhetor".¹⁸ Ai synon të sigurojë informata përkatëse për proceset buxhetore, duke integruar nevojat dhe interesat e grave, burrave, vajzave dhe djemve. BGJ është vegël me të cilën shtjellohet se si buxheti ndikon ndryshe tek gratë se sa tek burrat, varësisht nga rolet gjinore të tyre. Ai krahason këto informata me zotimet e qeverisë për të avancuar të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, me qëllim të promovimit të një llogaridhënie të shtuar nga qeveria dhe të sigurimit të informatave për politikën sociale dhe ekonomike të autoriteteve.¹⁹ BGJ ndërlidhet me proceset buxhetore, proceset politike, proceset administrative, veglat teknike, resurset njerëzore dhe të tjera, strukturat ndërsektoriale, strategjitë apo planet qeveritare, proceset e monitorimit dhe rishikimit.²⁰ Për të realizuar synimin e vet, BGJ ekzaminon të hyrat dhe shpenzimet qeveritare për programe dhe projekte të caktuara, si dhe tërë ciklin buxhetor dhe të gjithë komponentët e buxhetit.

Përkundër keqkuptimeve që ekzistojnë, **BGJ nuk ka të bëjë vetëm me gratë dhe zyrtarët për barazi gjinore** (ZBGJ), megjithëse ata luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e buxhetimit. Në fakt, BGJ inkurajon të gjitha agjencitë, ministritë dhe komunat që të sigurojnë ndarje të mjaftueshme buxhetore për të realizuar zotimet e tyre lidhur me barazinë gjinore, siç përcaktohet me kornizën ekzistuese ligjore në Kosovë. BGJ kërkon që të ekzistojnë mjete për të menaxhuar buxhetimin dhe ekzekutimin e buxhetit, me të cilat do duhej përkrahur politikën qeveritare për kanalizimin e çështjeve gjinore. Kjo përfshin dizajnimin dhe implementimin e politikave në sektorë të ndryshëm dhe matjen e rezultateve të tyre. Në Kosovë, kjo mund të sigurohet në nivel kombëtar, pasi që ZBGJ-të do duhej të kryejnë detyrat e tyre lidhur me mbikëqyrjen e procesit buxhetor, në bashkëpunim me zyrtarët tjerë.²¹ Rrjedhimisht, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) do duhej të përpilojë raporte periodike lidhur me këndvështrimin gjinor të praktikave buxhetore. ZBGJ-të nëpër ministri dhe komuna mund të ndihmojnë përmes monitorimit të praktikave buxhetore. Kjo përfshin monitorimin nëse buxhetet mund të adresojnë në mënyrë adekuate obligimet programatike dhe ligjore që ndërlidhen me trajtimin e dhunës në familje. Këto raporte mund të ofrojnë informata sa i përket përshtatshmërisë së buxhetit qeveritar nga këndvështrimi gjinor, të cilat mund të shfrytëzohen nga politikëbërësit dhe nga opinioni publik, e të cilat rrjedhimisht mund të rezultojnë me shtim të ndjeshmërisë ndaj buxhetimit gjinor në projekte publike.

BGJ mund të shfrytëzohet për të kalkuluar koston e dhunës në familje për një ekonomi të caktuar. Ekzistojnë së paku dy qasje ndaj përcaktimit të koston për dhunën në familje. E para njihet si "përcaktim i koston së ndikimit," dhe me të mëtohet përcaktimi i çmimit të përgjithshëm që shoqëria paguan për dhunën në familje. Ajo kërkon intervista të thukëta me një mostër reprezentative të viktimave të dhunës në familje, nga të cilat kërkohet vlerësimi i shërbimeve të cilat i kanë gëzuar dhe i ndikimit që dhuna mund të ketë në shoqëri (p.sh. ditët e mosvijimit të punës, kostoja e shërbimeve shëndetësore). Informatat nga buxheti grumbullohen me qëllim të kalkulimit të koston së këtyre shërbimeve, edhe pse ato nuk konsiderohen shërbime formale. Si rrjedhojë kalkulohen edhe koston e fshehura edhe koston e shërbimeve të shfrytëzuara. Qasja e dytë, e shfrytëzuar me këtë rast, fokusohet në shpenzimet që institucionet dhe ofruesit e shërbimeve i kanë pasur në lidhje me parandalimin, mbrojtjen, rehabilitimin dhe reintegrimin. Këto shtylla përbëjnë një qasje gjithëpërfshirëse për sigurimin e mirëqenies së viktimës dhe rehabilitimit të kryesit të dhunës, në pajtim me kornizën ligjore të Kosovës.

¹⁸ Këshilli i Evropës, *Buxhetimi gjinor, Raporti Final i Grupit të Specialistëve të Buxhetimit Gjinor (EG-S-GB)*, Strasburg: Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, 2005. Shih poashtu UNIFEM, *Buxhetimi gjinor në Evropën Juglindore: Përvojat e UNIFEM-it, Shkup*: UNIFEM, 2010.

¹⁹ Elizabeth Villagómez, *Buxhetimi gjinor: Elemente Praktike*, prezantim, Prishtinë, 2011 dhe R. Sharp dhe R. Broomhill, "Buxhetimi për Barazi: Përvoja australiane," *Ekonomia femine*, 8 (1), Routledge, 2002, faqet 25-47.

²⁰ Villagómez, *Buxhetimi gjinor: Elemente Praktike*.

²¹ Shih Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Qarkorja Buxhetore 2012/01 dhe Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë, Ligji Nr. 2004/2, 2004.

Ky studim i është përmbajtur përcaktimit të kostove në nivel *makro* dhe jo në nivel *mikro*, ngase Kosovës i nevojitet urgjentisht një sqarim sa i përket proceseve të buxhetimit dhe një vlerësim i kostove të ndërlidhura me implementimin e kornizës së re ligjore lidhur me dhunën në familje. Shqyrtimi i të ardhurave me të cilat mbulohen këto shpenzime publike është poashtu i një rëndësie madhore. BGJ mund të ndihmojë në vlerësimin nëse buxheti është i mjaftueshëm për të implementuar Ligjin, Strategjinë dhe kornizën më të gjerë ligjore mbi dhunën në familje. BGJ poashtu mund të ofrojë sugjerime se si të shfrytëzohen resurset ekzistuese në mënyrë më efikase.

Lidhur me Këtë Hulimtim: Shkurtimisht mbi Metodologjinë

Ky hulimtim i kryer mes janarit dhe korrikut të vitit 2012 kishte tri objektiva hulimtuuese: 1) identifikimin e organeve përgjegjëse dhe mekanizmave institucionalë për dhunën në familje, në pajtim me rregullativën aktuale ligjore dhe identifikimin e boshllëqeve të mbetura institucionale; 2) vlerësimin e mekanizmave aktual të buxhetimit brenda institucioneve relevante, me përgjegjësi në lidhje me dhunën në familje, dhe 3) vlerësimin dhe parasupozimin e kostove reale dhe implikimeve buxhetore për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen e kryerësve të dhunës në familje, për secilin institucion përgjegjës sipas kornizës ekzistuese ligjore.²² RRGK gjithashtu i ka ekzaminuar edhe kostot që ndërlidhen me reintegrimin dhe rehabilitimin e viktimave dhe autorëve të dhunës në familje, siç përcaktohet në Strategji.

RRGK filloi punën duke e shqyrtuar kornizën ekzistuese ligjore që ndërlidhet me dhunën në familje dhe duke i përcaktuar përgjegjësitë ligjore të secilit institucion. RRGK poashtu shtjelloi buxhetet qeveritare, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe veglat për përcjelljen e buxhetimit gjinor gjetiu në botë (p.sh. Evropë Juglindore, Spanjë, Afrikë të Jugut, Shtete të Bashkuara të Amerikës). RRGK planifikoi krahasimin e planeve vjetore të punës dhe buxheteve përkatëse për vitin 2012 për të gjitha institucionet me përgjegjësi ligjore në këtë fushë, por vetëm Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ia siguroi të dy këto dokumente.

Më pas, RRGK vizitoi të gjitha institucionet përkatëse për të mësuar më shumë për programet, procedurat e buxhetimit, të hyrat, shpenzimet, monitorimin dhe praktikën e punës së tyre. Kjo punë përfshinte realizimin e intervistave me zyrtarë të programeve dhe zyrtarë për buxhet në të gjitha institucionet përgjegjëse për implementimin e kornizës ligjore, si dhe me donatorët, organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe akterët e tjerë që ofrojnë financim në këtë fushë. Në tërësi, RRGK ka intervistuar 184 palë me interes, përfshirë institucionet qendrore shtetërore, OJQ-të, donatorët dhe zyrtarët në komuna. Mes tjerash, hulimtuesit parashtruan dy pyetje kyçe: 1) sa kishte (nëse kishte të tillë) buxhet institucioni në fjalë për të realizuar përgjegjësitë ligjore që ndërlidhen me dhunën në familje; dhe 2) a është ai buxhet i mjaftueshëm. Të gjitha kostot e identifikuar që ndërlidhen me dhunën në familje janë paraqitur në kapitujt në vijim, në kllapa dhe në fusnota.

Implementimi i programeve të nivelit qendror mund të vlerësohet vetëm në nivel komunal. Shqyrtimi i praktikave në nivel komunal është gjithashtu i rëndësishëm për të kuptuar se si decentralizimi i vazhdueshëm ndikon në ofrimin e shërbimeve. Për këtë arsye, RRGK ka përzgjedhur tri komuna të ndryshme për t'i studiuar: Dragashin, Mitrovicën dhe Gjilanin. Punohej nën hipotezën se Dragashi ka më së paku financa në dispozicion për të adresuar dhunën në familje dhe se ofron më pak shërbime për viktimat për shkak të lokacionit gjeografik, numrit më të vogël të institucioneve lokale dhe mosekzistimit të strehimores brenda komunës. Në Mitrovicë do ofroheshin shërbime deri diku më të mira, por situata politike mund ta limitonte qasjen në shumë institucione dhe të ndikonte në buxhetin komunal. RRGK vlerësonte se Gjilani ka shërbimet më të mira, koordinimin më të mirë ndërinstucional dhe një nga buxhetet më të mëdha komunale të ndarë për adresimin e

²² UNDP i ka përkufizuar objektivat e hulimtit.

dhunës në familje. Sipas logjikës prapa përzgjedhjes së kësaj mostre, studimi i komunave të ndryshme dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe financave në dispozicion, ekipi hulumtues do të mund të kuptonte më shumë mbi mënyrat e ndryshme të reagimit ndaj dhunës në familje në Kosovë. Përveç shqyrtimit të dokumenteve, RRGK intervistoi edhe përfaqësues të institucioneve komunale relevante.

Anëtarët e ekipit hulumtues analizuan të dhënat në mënyrë të pavarur e më pastaj bashkëpunuan në sajimin e të gjeturave preliminare të hulumtimit.²³ Më pas, në prill dhe qershor të vitit 2012, RRGK dhe UNDP organizuan grupe punuese me institucionet relevante. Pjesëmarrësit patën mundësinë që të kontrollojnë edhe një herë të dhënat. Ky kontroll shërbeu për t'i validuar të gjeturat, minimizuar gabimet dhe grumbulluar inpute mbi rekomandimet e tyre. Megjithatë, marrë parasysh detajet e shumta të grumbulluara dhe numrin e madh të palëve me interes të përfshira në këtë hulumtim, mund të jenë përvjedhur gabime për të cilat RRGK kërkon falje.

Kufizimet: Si të Vlerësohen Kostot në Kosovë?

Vlerësimi i kostove reale dhe të planifikuara lidhur me dhunën në familje në Kosovë u dëshmuar të jetë një proces tejte sfidues, për shkak se sistemet ose nuk ekzistojnë fare ose janë të reja, për shkak të sistemeve të dobëta për grumbullimin e të dhënave dhe për shkak të linjave jo të qarta buxhetore. Kjo kryesisht ndikohet nga mënyra se si institucionet ndajnë buxhetet e tyre në pesë kategori: 1) paga dhe mëditje, 2) mallra dhe shërbime, 3) komunali, 4) subvencione dhe transfere, 5) investime kapitale. Buxhetet nuk përfshijnë linja për kosto apo aktivitete individuale. Për këtë arsye, shpenzimet e sakta të institucioneve në këto kategori është e pamundur të përcaktohen. Nëse RRGK do të kishte në dispozicion planet e punës për secilin institucion dhe buxhetet e tyre të ndara sipas linjave buxhetore, atëherë do të mund të vlerësonte shpenzimet e shtetit në lidhje me dhunën në familje. Megjithatë, të pakta ishin institucione që kishin informata të qarta programatike apo që ishin të gatshme t'i ndajnë ato me ne. Institucionet që i siguruan këto informata rrallë i kishin edhe buxhetet e ndara sipas planeve të punës që ndërlidheshin me dhunën në familje.

Duke marrë parasysh këtë kufizim të rëndësishëm, RRGK ka bërë përlogaritje të përafërt të shpenzimeve që ndërlidhen me dhunën në familje, bazuar në intervista dhe në kalkulimet e sqaruara në fusnota. Ajo që është edhe më e rëndësishme është se ky raport identifikon zbrazëtira në shërbimet e ofruara; qoftë në kuptim të resurseve të pamjaftueshme qoftë në formë të nevojës për linja të reja buxhetore për të cilat institucionet duhet të përcaktojnë shpenzimet dhe ndajnë buxhetin në të ardhmen. Tani, ***mbetet përgjegjësi e institucioneve relevante që të vlerësojnë shpenzimet e nevojshme për të nisur ofrimin e shërbimeve që mungojnë apo për të tejkaluar problemet që hasin gjatë ofrimit të shërbimeve aktuale.***

Çka Përmban Ky Raport?

Pjesa e mbetur e këtij raporti është ndarë në tetë kapituj. Në kapitullin e parë është paraqitur korniza ekzistuese ligjore që ndërlidhet me dhunën në familje, ku shtjellohen zbrazëtirat juridike në kornizën aktuale ligjore dhe shqyrtohen sfidat për një reagim të koordinuar institucional kundër dhunës në familje. Kapitulli 2 shtjellon "Kush vendosë si të ndahen paratë?": prioritetet buxhetore të Kosovës, proceset buxhetore dhe mënyra se si ato procese ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet që ndërlidhen me dhunën në familje.

Tre kapitujt vijues ndahen sipas "shtyllave" të përcaktuara në Strategji: Parandalimi (Kapitulli 3); Mbrojtja, Siguria dhe Ndjekja Penale (Kapitulli 4); dhe Rehabilitimi dhe Reintegrimi (Kapitulli 5). Tabela 2 ofron një përmbledhje të institucioneve që kanë përgjegjësi për shtyllat në fjalë, siç përcaktohet në Objektivat Strategjike të Strategjisë dhe

²³ RRGK ka mëtuar ngritjen e vlefshmërisë së tyre përmes shfrytëzimit të trekëndëshit hulumtuesi, burimi i të dhënave dhe metoda.

në kornizën e gjithmbarshme ligjore. Në rreshtin e fundit është dhënë buxheti i paraparë për implementimin e Strategjisë për secilën shtyllë. Ekzistojnë kosto shtesë për implementimin e përgjegjësiave më të gjera ligjore. Këta kapituj shtjellojnë zbrazëtitat në kornizën ligjore, performancën deri tani të institucioneve, koordinimin dhe masën deri në të cilën institucionet relevante kanë buxhetuar sa duhet për realizimin e përgjegjësiave të tyre. Në rastet kur ka qenë e mundur, janë dhënë edhe parashikime mbi alokimet aktuale buxhetore dhe shpenzimet që ndërliken me dhunën në familje. Të gjitha shpenzimet janë të paraqitura në euro.²⁴ Kapitulli 6 flet për nevojën e krijimit të një sistemi të referimit dhe Procedurave Standarde Operative, si parakushte për të siguruar ofrim efikas dhe efektiv të shërbimeve.

Të gjeturat lidhur me shpenzimet e përgjithshme shtetërore lidhur me dhunën në familje janë përmbledhur në Kapitullin 7. Këto të gjetura janë të rëndësishme për dy momente të ciklit buxhetor në Kosovë. Së pari, të gjeturat ndihmojnë në vlerësimin e ndikimit që dhuna në familje ka pasur në buxhet, në veçanti në vitin 2011. Së dyti, të gjeturat mund të shërbejnë gjatë procesit të dizajnit dhe planifikimit të buxhetit të vitit 2013 dhe KASH-it të ardhshëm. Kapitulli i fundit jep rekomandime për të gjitha institucionet. Në shtojca gjenden informata shtesë dhe të dhëna të cilat mund të ndihmojnë dhe lehtësojnë planifikimin buxhetor.

Tabela 2. Shtyllat e Strategjisë dhe institucionet përgjegjëse për to

Parandalimi	Mbrojtja dhe siguria	Rehabilitimi dhe reintegrimi
OS 1: Deri në 2014, të krijohen mekanizma efikas dhe gjithëpërfshirës për të parandaluar dhunën në familje	OS 2: Deri në vitin 2013, të sigurohen mekanizma efikas për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje	OS 3: Të sigurohen shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryerësve të dhunës në familje në Kosovë. OS 4: Rehabilitimi dhe reintegrimi i përhershëm i viktimave të dhunës në familje
MASHT	Policia	MASHT, Drejtoritë komunale për arsim
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Instituti i Kosovës për Administratë Publike	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Zyra e Prokurorit Publik	Prokurori Publik	Ministria e Drejtësisë, MV-të
Ministria e Drejtësisë	Akademia Policore e Kosovës	Policia
Mediat, OJQ-të, strehimoret, donatorët, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës*	OJQ-të, strehimoret, donatorët, operatorët privatë*	OJQ-të, strehimoret, donatorët, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, operatorët privatë, Qendrat Afariste për Informim Profesional, Programi për Fuqizimin e Familjes i Fshatit SOS*
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Qendrat për Punë Sociale (QPS)	MPMS, QPS	MPMS, QPS
Komunat	Komunat	Komunat
Komisioni për Ndihmë Juridike	Komisioni për Ndihmë Juridike	Qendrat Rajonale të Punësimi
Gjykatat	Gjykatat	Gjykatat
ABGJ	ABGJ	ABGJ
Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Drejtësisë
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ministria e Financave	Qendrat e Shëndetit Mendor
Drejtoritë komunale të arsimit, shkollat	Ministria e Administratës Publike	Ministria e Financave
Ministria e Administratës Publike	Mbrojtësit e viktimave (MV)**	
Policia	Shërbimi korrektues**	
Fakulteti i Filozofisë, Universiteti	Ombudspersoni**	
Buxheti/shtyllë:	€342,160	€974,734
		€1,116,000

* Këto nuk janë institucione, por mbajnë përgjegjësi sipas Strategjisë.

** Këto nuk përmenden në Strategji, por RRGK sugjeron se ato do duhej të kenë rol nën shtyllën përkatëse.

²⁴ RRGK ka shfrytëzuar normën evropiane të këmbimit ndërbankar të valutave: \$1 baras me €0.7183 në vitin 2011 dhe €0.7748 në janar të vitit 2012.

Kapitulli 1. Korniza Ligjore në Kosovë

Në këtë kapitull përshkruhet korniza ligjore dhe politikat ekzistuese që rregullon çështjet që ndërlidhen me dhunën në familje në Kosovë, përfshirë këtu Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (Ligji) dhe Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit (Strategjia). Në të identifikohen kundërthëniet dhe zbrazëtirat juridike të kësaj kornize ligjore, në krahasim me të drejtën ndërkombëtare dhe standardet e të drejtave të njeriut. Në këtë kapitull poashtu shtjellohen mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të kornizës ligjore.

Konventat Ndërkombëtare dhe Krimi i “Padukshëm” në Kosovë

Në bazë të Kushtetutës së Kosovës, në Kosovë janë drejtpërdrejt të zbatueshme një sërë konventash ndërkombëtare.¹ Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Gruas (CEDAW), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) dhe Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (CRC) sigurojnë mbrojtje për viktimat e dhunës në familje dhe u japin shteteve udhëzime specifike se si ta ushtrojnë këtë përgjegjësi.² Në rast të çfarëdo kundërthënie, konventat ndërkombëtare kanë prioritet mbi ligjet dhe legjislacionin e Kosovës.³ Sipas kësaj kornize normative, dhuna në familje përbën vepër penale dhe diskriminim në baza gjinore.⁴ Megjithatë, në krahasim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, korniza ligjore për dhunën në familje në Kosovë mbetet më e dobët.

Konventa e re e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Këshillit të Evropës) mund të shërbejë si standard udhëzues për institucionet e Kosovës, të cilat kanë aspirata për integrim në Bashkimin Evropian (BE). Në të përcaktohet se: “dhuna në familje nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike të cilat ndodhin brenda familjes apo në njësisë amvisërore.”⁵ Strategjia jep një definicion të ngjashme, por vetëm në formë të procedurës

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008, neni 22) liston të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me konventat ndërkombëtare që janë drejtpërdrejt të zbatueshme, përfshirë CEDAW, KEDNJ dhe KDF.

² Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i CEDAW përcakton parimet e përgjegjësisë shtetërore për aktet e agjentëve shtetërorë dhe qytetarëve. Më tej, “...shtetet mund të jenë përgjegjëse edhe për akte private nëse ato nuk veprojnë me kujdes të duhur për të parandaluar shkeljen e të drejtave apo për të hetuar dhe ndëshkuar aktet e dhunës, dhe për të ofruar kompensim.” KDF thekson se është e ndaluar çdo formë e dhunës ndaj fëmijëve; ajo kërkon nga shtetet që të miratojnë “tërë legjislacionin e domosdoshëm për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike apo mentale, nga lëndimet apo abuzimi, nga neglizhenca apo trajtimi neglizhent, nga keqtrajtimi apo eksploatimi, përfshirë abuzimin seksual, gjatë kohës kur ata janë nën kujdesin e prindërve, kujdestarëve ligjorë apo personave të tjerë që gëzojnë kujdes mbi fëmijët.” (neni 19).

³ Shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 22.

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimi në rastin *Opuz kundër Turqisë* (9 qershor 2009) gjeti se dhuna në familje përbën diskriminim në baza gjinore dhe se shteti Turk kishte dështuar në ofrimin e mbrojtjes efektive dhe efikase për viktimat e gjinisë femërore, duke shkelur kësaj obligimet që ka sipas Konventës (Këshilli i Evropës (KIE), *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*, 87 UNTS 103, ETS 5, miratuar më 4 nëntor 1950, ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953). Shih poashtu Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Vendimet gjyqësore për kërkesat për Urdhra Mbrojtës në Rastet e Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë; OSCE, 2012, f. 7.

⁵ Këshilli i Evropës, Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Raport Sqarues, 2011, neni 3, paragrafi i përkufizimeve (b).

civile. Edhe pse me KPRK kërkohet ndjekja penale (automatike) sipas detyrës zyrtare e të gjitha veprave penale të kryera në marrëdhënie familjare,⁶ ai vë theks mbi dhunën fizike dhe nuk përfshin dhunën psikologjike apo aktet tjera të dhunës brenda familjes. Konventa e Këshillit të Evropës rekomandon që shtetet të rregullojnë Çështjen e përcaktimit se edhe ngacmimi dhe dhuna psikologjike përbëjnë vepra penale.

Ligji i cili mund të zbatohet vetëm si mjet juridik civil, përcakton se ndjekja e veprave penale që ndërlihen me dhunën në familje do të bëhet sipas detyrës zyrtare vetëm në rast të shkeljes së urdhërave mbrojtës.⁷ KPRK emëron disa vepra penale në marrëdhënie familjare të cilat mund të ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare vetëm pas inicimit të procedurës (p.sh. zhvatja, kërcënimi apo privimi i paligjshëm nga liria).⁸ Megjithatë, nëse pala e dëmtuar vendosë që të tërheqë mocionin para vendimit gjyqësor, atëherë procedura ndërpritet. Në Kosovë, këto dispozita janë të pamjaftueshme për shkak se viktimat, të cilat shpesh gjenden nën presion social dhe/ose ekonomik, shpesh tërhiqen dhe kësisoj këto vepra penale nuk ndiqen. Dhuna në familje duhet të konsiderohet vepër penale, në mënyrë që viktimat të mund të gëzojnë mjete adekuate dhe mbrojtje juridike, duke siguruar kësisoj të drejtën për jetë pa keqtrajtim dhe riparim për vuajtjet e pësuar.⁹

Më tej, implementimi i dobët bën që viktimat të mos kenë mjete efektive juridike në dispozicion.¹⁰ Një respondent tha, "Ligji është ligj i mirë, por është e pamundur që ai të implementohet menjëherë për shkak se traditat janë më të fuqishme se ligji."¹¹

"Dallimi mes legjislacionit në letër dhe implementimit të tij është tepër i madh."
- Një respondent

Vendimi inovativ i nxjerrë kohëve të fundit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, theksonte se dhuna në familje nuk do duhej trajtuar si çështje private "e padukshme".¹² Në fakt, dhuna në familje paraqet një interes publik që kërkon veprim nga shteti. Gjykata vërejt se standardet ndërkombëtare do duhej "të garantojnë jo të drejta teorike apo iluzore, por praktike dhe efektive."¹³ Më tej, në një aktgjykim të Gjykatës Evropiane të vitit 2008 thuhet se autoritetet kanë obligim që të "krijojnë dhe aplikojnë në praktikë një kornizë adekuate ligjore që siguron mbrojtje nga aktet e dhunës nga individë privatë"¹⁴ dhe se shteti do duhej të mbrojë aktivisht viktimat e dhunës, për shkak të cenueshmërinë së tyre. Siç ka theksuar RRGK, ligjet dhe politikat do duhej të jenë "më shumë se sa fjalë në letër."¹⁵ Më tej, mosimplementimi i ligjeve, mosndjekja e veprave penale dhe mosndalimi i krimit ngërthen në vete një çmim: zgjidhjet e improvizuara nga shteti dhe shpenzimet për rehabilitim.

Për më tepër, Ligji nuk adreson pabarazitë kulturore dhe patriarkale në pajtim me Konventën e Këshillit të Evropës. Masat përkatëse duhet të bazohen në të kuptuarit përkatës të dhunës ndaj grave, me theks në të drejtat njerëzore të viktimave, sigurinë dhe

⁶ KPRK (Kodi Nr. 04/L-082, 20 prill 2012, neni 120.23) përkufizon marrëdhënien familjare si marrëdhënie mes dy personave që janë të fejuar, martuar apo që bashkëjetojnë pa martesë; që ndajnë të njëjtin vendbanim primar dhe që kanë lidhje gjaku apo përmes martesës ose adaptimit, përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipërit, vëllezërit e motrat, tezet e hallat, dajat dhe axhët, mbesat, nipat apo kushërinjtë; apo prindërit e një fëmije.

⁷ Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligji nr. 03/L-182, neni 26.

⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 mbi *Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale në Kosovë*, 2003, neni 6. Shih poashtu nenet 55 dhe 59.

⁹ KiE, *Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje*, Raport Sqarues.

¹⁰ Gjetjet e RRGK bazuar në intervista dhe vrojtme, 2012.

¹¹ Intervistë e RRGK me ZBGJ, 2 mars 2012.

¹² Strategjia (Vendimi i Qeverisë Nr. 08/34, 25 gusht 2011, faqe 8) poashtu sugjeron se dhuna në familje nuk do duhej të konsiderohet çështje private. Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *rasti Opuz kundër Turqisë*. Vendimi thekson se ligjet në Turqi dhe gjetiu duhet të implementohen. Gjykata ka vërejtur se "paafësia e përgjithshme e sistemit gjyqësor për të reaguuar dhe mosndëshkimi i agresorëve... dëshmon se ka përkushtim të pamjaftueshëm për të ndërmarrë veprime adekuate për të adresuar dhunën në familje."

¹³ Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *rasti Opuz kundër Turqisë*, paragrafi 165.

¹⁴ Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *rasti Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë*, kërkesa numër. 71127/01, Aktgjykim, Strasburg: 2008. Shih nenet 2, 3 dhe 8 dhe paragrafin 65.

¹⁵ Shih RRGK, Më shumë se "fjalë në letër"?

marrëdhëniet mes viktimës, kryerësit, fëmijës (fëmijëve) dhe mjedisit shoqëror të tyre.¹⁶ Masat në fjalë duhet të fuqizojnë viktimat duke adresuar gjendjen e tyre ekonomike dhe nevojat e veçanta të personave të cenueshëm, përfshirë edhe viktimat e moshës së mitur. Arsimiti, kujdesi shëndetësor dhe trajnimet do duhej t'u kontribuojnë fuqizimit të tyre.

Kosova do duhej tu përmbahet obligimeve të veta që ka sipas standardeve ndërkombëtare dhe regjionale të të drejtave të njeriut, të cilat listohen në Kushtetutën e Kosovës, përfshirë këtu KEDNJ dhe CEDAW, në kuptim të sigurimit të hetimit efikas dhe efektiv, ndjekjes penale dhe kompensimit të viktimave të dhunës në familje. Konventa e Këshillit të Evropës, si standard primar i institucioneve të Kosovës, ofron një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen e viktimave dhe dhënien fund mosdëshkimit të kryerësve të veprave të dhunës në familje.¹⁷ Aktet ligjore apo nënligjore të domosdoshme për të mbrojtur viktimat nga shfaqja apo rishfaqja e dhunës duhet të miratohen. Duhet të krijohen mekanizma të referimit dhe të sigurohet efektiviteti i tyre; duhet siguruar bashkëpunim i koordinuar mes agjencive shtetërore: gjyqësorit, prokurorisë, policisë, autoriteteve lokale dhe qendrore dhe OJQ-ve.¹⁸ Përkrah kësaj, profesionistët duhet të aftësohen në fushën e bashkëpunimit mes agjencive, për të mundësuar funksionimin e një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin dhe referimin e rasteve.

Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje

Në korrik të vitit 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Ligji).¹⁹ Në të dhuna në familje përkufizohet si akt apo neglizhencë që një person kryen ndaj një personi tjetër me të cilin është në lidhje familje, përfshirë mes tjerash dhunën fizike, presionin psikologjik, shkaktimin e frikës për mirëqenien ekonomike të tij/saj dhe shkaktimin e dëmit material.²⁰ Me këtë ligj mëtohet parandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave, trajtimi i autorëve të dhunës dhe lehtësimi i pasojave të dhunës në familje.²¹

Ligji parash tri lloje të urdhrave mbrojtës.²² Personat që jetojnë në të njëjtën ekonomi familjare, që jetojnë në bashkësi martesore, që kanë lidhje gjaku, që janë palë në kontest apo janë në marrëdhënie familjare (edhe kur nuk jetojnë në të njëjtën shtëpi) mund të kërkojnë urdhër mbrojtës. Pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar i tij/saj, mbrojtësi i viktimave, apo punëtori social poashtu mund të kërkojnë urdhër mbrojtës.²³ Masat mund të përfshijnë trajtimin psikosocial të kryerësve (përfshirë ato kundër abuzimit të alkoolit dhe drogave), ndalimi i afrimit të kryerësit më afër se ndonjë distancë e caktuar viktimës, largimi i kryerësit nga vendbanimi i përbashkët, pagimi i qirasë apo alimentacionit për fëmijët e viktimës.²⁴

¹⁶ KiE, Konventa, Neni 18, paragrafi 3.

¹⁷ Kapitulli IV "Mbrojtja dhe Përkrahja, Obligimet e Përgjithshme të Shteteve," neni 18. Këshilli i Evropës, *Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*, CETS nr. 210, hapur për nënshkrime në vitin 2011. Kusht për hyrje në fuqi janë 10 ratifikime, përfshirë tetë nga shtetet anëtare. Deri më 7 korrik 2012, kjo Konventë ishte nënshkruar nga 19 shtete dhe ishte ratifikuar nga një shtet (shih <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=210&CM=1&DF=&CL=ENG>).

¹⁸ Shih gjithashtu nenet 20 dhe 22.

¹⁹ Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nxori në vitin 2003 *Rregulloren për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje* (Rregullorja Nr. 2003/12). Ligji bazohet në atë Rregullore.

²⁰ Sipas Ligjit, neni 2, paragrafi 1.2 veprimet e qëllimshme apo lëshimet përfshijnë: përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik; shkaktimin apo kanosjen e dhembjes fizike apo vuajtjes psikike, shkaktimin e ndjenjës së frikës dhe kërcënimin e dinjitetit; sulmin fizik; ofendimin, sharjen dhe format tjera të fyerjes; përluljen e tjetrit; marrëdhëniet seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimin seksual; kufizimin e kundërligjshëm të lirisë së lëvizjes; dëmtimin apo kërcënimin e pronës; shkaktimin e frikës tek personi tjetër për mirëqenien fizike, emocionale apo ekonomike të tij/saj; hyrja apo largimi me dhunë nga vendbanimi i përbashkët; dhe rrëmbimi.

²¹ Ligji, neni 1 "Qëllimi i Ligjit".


²² Ligji, neni 22. Për më shumë informata, shih Kapitullin 4.

²³ Ligji, neni 13, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4.

²⁴ Ligji, nenet 4 - 12.

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka kritikuar Ligjin për shkak të gjuhës asnjëse që shfrytëzon.²⁵ Tek përcaktimi i qëllimit të Ligjit, ai i jep rëndësi të njëjtë nevojave të viktimave dhe trajtimit të autorëve të dhunës.²⁶

Në të nuk njihet fakti se shumica e viktimave në Kosovë janë gra dhe vajza. Rrjedhimisht, ai injoron pabarazitë sociale, kulturore dhe/ose ekonomike me të cilat përballen shumica e viktimave, përderisa në anën tjetër përkrahë kryerësit e veprave. Ligji do duhej të merr në konsideratë normat sociale që i kontribuojnë dhunës në familje. Për shembull, këshillimi i detyrueshëm i kryerësve të veprave të dhunës në familje do duhej të trajtojë rolet gjinore dhe pabarazitë gjinore (e jo vetëm abuzimin me alkool dhe droga si shkak të dhunës në familje).



Implementimi i Ligjit varet nga nxjerrja e Udhëzimeve Administrative (UA) brenda gjashtë muajsh nga miratimi i tij.²⁷ Deri në korrik të vitit 2012 (dy vite pas miratimit) vetëm Policia e Kosovës i ka miratuar Procedurat Standarde Operative për zbatimin e rolit dhe detyrave që ka sipas Ligjit.²⁸ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) e kanë hartuar UA-në për Përcaktimin e Lokacioneve dhe Mënyrave për Trajtim Psiko-Social (XX/2012), e cila është duke u rishikuar.²⁹ Përveç kësaj, MSH hartoi UA-në për Masat Mbrotjtëse të Trajtit të Detyrueshëm nga Varësi nga Alkooli dhe Abuzimi me Substanca Psikotropike, si një nga masat për zvogëlim të dhunës.³⁰ Megjithatë, derisa këto UA të mos hyjnë në fuqi, në Kosovë nuk ka në dispozicion trajtim në fjalë, gjë që u pamundëson gjyqtarëve urdhërimin e trajtimit të tillë dhe zbatimin e Ligjit.³¹

Edhe pse ndikimi buxhetor duhet të vlerësohet për secilin ligj para miratimit të tyre, RRGK nuk arriti ta gjejë vlerësimin buxhetor të Ligjit. Sipas Strategjisë, MPMS "në bashkëpunim me" MSH, Ministrinë e Drejtësisë (MD), Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe MASHT-in është "përgjegjëse" për krijimin e mekanizmave për "përkrahjen dhe plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje, përfshirë asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtim me ligjin e zbatueshëm."³² Rrjedhimisht, MPMS në bashkëpunim me ministritë tjera e ka për detyrë të sigurojnë mjete të mjaftueshme buxhetore për zbatimin e Ligjit.

Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, ABGJ është gjithashtu përgjegjëse për të kryer analiza politike, këshilluar qeverinë lidhur me arritjen e barazisë gjinore, hartimin e amendamenteve për ligje dhe avancimin e masave për të siguruar implementim të parimeve të barazisë gjinore.³³ Kjo përfshin financimin e pjesëshëm të aktiviteteve relevante. Roli i ABGJ-së për të

²⁵ Shih Misioni i OSBE-së në Kosovë, Gjykimi i kërkesave për urdhra për mbrojtje ne rastet e dhunës në familje në Kosovë, 2012, f. 23.

²⁶ Ligji, neni 1, "Qëllimi i Ligjit".

²⁷ Ligji, neni 28, paragrafi 1.

²⁸ Përkrahur nga Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajtime për Hetime Penale i Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara (ICITAP). Për më shumë informata, shih Kapitullin 4.

²⁹ Intervista e RRGK me ZBGJ, MD, qershor 2012. MPMS dhe MD janë përgjegjëse (Ligji, neni 4, paragrafi 3).

³⁰ Korrespondenca e RRGK me ZBGJ, MD, qershor 2012. UNDP WSSI përkrahu hartimin e legjislacionit sekondar në vitin 2011 (€4,669), dhe takimin e ministrive të linjës për finalizimin e tij në maj të vitit 2012 (€3,354).

³¹ Korrespondenca e RRGK me përfaqësuesin e UNDP WSSI; dhe intervistat me ABGJ, MD dhe MPMS, 2012.

³² Ligji, neni 27.

³³ Ligji për Barazinë Gjinore në Kosovë, Ligji nr. 2004/2, 2004, neni 5.2 (b).

ndikuar ndarjen e buxhetit nuk është përkufizuar shprehimisht në Ligjin për Barazi Gjinore apo në Ligj. Megjithatë, marrë parasysh detyrat e ABGJ-së dhe udhëheqjen që ajo ka pasur në hartimin e Ligjit dhe Strategjisë, ABGJ do të mund të ndërmernte iniciativa për të implementuar Ligjin dhe për të siguruar buxhet të mjaftueshëm për të.³⁴ Si pjesë e mandatit të saj, ABGJ do duhej të "mbikëqyrë" implementimin e politikave për arritjen e barazisë gjinore, siç është Strategjia, në veçanti marrë parasysh faktin se dhuna në familje përbën shkelje të drejtave të barabarta dhe ngërthen në vete diskriminim gjinor.³⁵ Kjo sugjeron se ABGJ do duhej të këshillojë dhe përkrahë ministritë në hartimin UA-ve për implementimin e Ligjit; të propozojë kritere për qeverinë dhe të sigurojë mjetet financiare.³⁶

Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014

Strategjinë e hartoi një grup punues që udhëhiqej nga ABGJ dhe përbëhej nga institucione qeveritare, OJQ dhe akterë ndërkombëtarë. Raportet e RRGK-së, të përkrahura nga UNDP WSSI, i shërbyen këtij procesi në cilësi informative.³⁷ Strategjia u miratua në nëntor të vitit 2011 dhe ka për qëllim përmirësimin e koordinimit aktualisht të pamjaftueshëm mes institucioneve kryesore që trajtojnë dhunën në familje, zbrazëtitat në sistemin e referimit dhe mungesën e infrastrukturës bazike për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje.³⁸ Ky dokument përmban tri objektiva: 1) krijimin e mekanizmave efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje, deri në vitin 2013; 2) sigurimin e mekanizmave efikas mbrojtës për viktimat, deri në vitin 2013; dhe 3) sigurimin e shërbimeve efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryerësve anëmbanë Kosovës.³⁹ Bazuar në këto tri objektiva, Strategjia mund të ndahet në tri shtylla: parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin dhe reintegrimin. Në Strategji nuk përmendet ndjekja penale në mënyrë shprehimore, por sipas diskutimeve që RRGK ka zhvilluar me palët me interes ajo do duhej të bie nën shtyllën e mbrojtjes.

Strategjia përcakton aktivitetet që duhet implementuar mes viteve 2011 dhe 2014. Megjithatë, pasi që u miratua në nëntor të vitit 2011, implementimi nuk nisi deri në vitin 2012. Buxheti i tij nuk është rishikuar për të pasqyruar miratimin e vonuar të Strategjisë apo ndryshimet të cilat ai mund t'i ketë pësuar që nga koha e hartimit të versionit të parë. Strategjia liston ndarjet buxhetore për shumicën e aktiviteteve, duke paraparë përkrahje nga buxheti i Kosovës dhe donatorët. Duke miratuar Strategjinë, qeveria i ka marrë përsipër këto shpenzime. Shpenzimet e gjithëmbarshme të planifikuara arrijnë shumën prej €2,414,560. Siç paraqitet në diagramin 2, qeveria e Kosovës i ka zotuar €1,612,854 (66.8%), 32.3% parashihej të sigurohen nga donatorët dhe më pak se 1% nga burime "tjera" (p.sh. "operatorë privatë"). Mes buxhetit të zotuar (€2,940,294) dhe buxhetit të gjithëmbarshtëm (€2,414,560) ekziston një dallim në vlerë prej €525,734. Ky mund të jetë thjeshtë gabim në kalkulim, por duhet përmirësuar. Gjithashtu edhe buxheti duhet të rishikohet prapë.

Strategjia parasheh se një sërë aktiviteteve nuk ngërthejnë "kurrfarë kosto". Disa kosto mund të jenë përfshirë në buxhetet ekzistuese të institucioneve (p.sh. nëpunësit civilë që ndihmojnë në rastet e dhunës në familje si pjesë e detyrave të tyre). Megjithatë, shumë aktivitete "pa kosto" në fakt kanë kosto shtesë. Për shembull, programet televizive lidhur me dhunën në familje për fëmijë kanë koston e regjisorëve, stacioneve dhe programuesve; edukimi mbi raportimin e dhunës në familje ngërthen kosto për paga dhe materiale; ndërsa edhe sajimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit mes institucioneve që trajtojnë dhunën në

³⁴ Shihni Kapitullin 2 për të gjetur një kaptinë mbi atë se kur ABGJ mund të ndikojë në vendimet buxhetore gjatë procesit të hartimit të buxhetit. Hartimi i Strategjisë i ka kushtuar ABGJ-së rreth €13,319 në vitin 2011.

³⁵ Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë, neni 5.2 (d).

³⁶ Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë, neni 5.2 (j).

³⁷ Shih RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*, 2008 (hulumtim i kërkuar nga ABGJ) dhe *Më shumë se "fjalë në letër"?* Përgjigja e Organeve të Drejtësisë ndaj Dhunës në Familje në Kosovë, Prishtinë: UNDP, 2009.

³⁸ Vendimi i Kryeministrit të Kosovës Nr. 03/62, 29 prill 2009 dhe Strategjia, f. 13.

³⁹ Të gjitha objektivat kërkojnë efikasitet, edhe pse indikatorët e pamjaftueshëm matës të Strategjisë mund ta bëjnë vlerësimin më të vështirë.

familje ka kostot e veta. Strategjia injoron kostot për trajnimin e punëtorëve socialë lidhur me dhunën në familje, zhvillimin e programeve ekonomike, ofrimin e kontrolleve mjekësore pa pagesë dhe shërbimet sociale për viktimat e dhunës, ndërmjetësimin në punësim për viktimat e dhunës në familje dhe lidhjen e shërbimeve sociale me programe për fuqizimin e familjes.

Më tej, shumë aktivitete nuk janë të detajuara sa duhet, gjë që u pamundëson institucioneve kalkulimin e kostove. Për buxhetim të saktë është tejet e rëndësishme që të përcaktohet roli specifik i çdo ministrie dhe të jepet përshkrim i detajuar i aktiviteteve (p.sh. si do të implementohen aktivitetet, nga kush dhe me resurse të cilës ministri). Duke qenë se Strategjia thotë se për një aktivitetet janë përgjegjëse nga disa institucione, është e paqartë se cili institucion bartë përgjegjësitë financiare. Hulumtimet e RRGK-së kanë treguar se vetëm MD dhe MASHT kanë përfshirë në buxhetet e tyre të vitit 2012 vlerat e parapara sipas Strategjisë. 24 institucione tjera lokale, 61 institucione të nivelit komunal dhe 10 OJQ të intervistuar nuk kishin ndarë buxhet shtesë **specifikisht për implementimin e Strategjisë** në vitin 2012.⁴⁰ Kjo është problematike sepse Strategjia delegon përgjegjësi që kërkojnë financim shtesë kundrejt buxheteve veç të miratuara të institucioneve.

Intervistat e RRGK-së kanë provuar se personat kyçë, përgjegjës për planifikim programatik dhe buxhetor, nuk kanë fare dijeni për Strategjinë. Pasi që Strategjia ishte miratuar në nëntor të vitit 2011, informatat mund të mos kenë arritur tek institucionet komunale. Megjithatë, vendimmarrësit në nivel qendror do duhej të kishin njohuri përkatëse, për të siguruar se Strategjia do të pasqyrohet si duhet në planet e tyre vjetore të punës dhe në buxhetet për vitin 2013. Një pretendim që rishfaqej mes respondentëve të intervistuar ishte se ABGJ ishte përgjegjëse për implementimin e Strategjisë. Megjithatë, **secili institucion i listuar ka përgjegjësi ligjore për të implementuar aktivitetet e veta** mes viteve 2011 dhe 2014.

"Ne nuk kemi fare të bëjmë me dhunën në familje."
- Dreitoria Komunale e Arsimit

Strategjia parashikon krijimin e postit të një Koordinatori Kombëtar, që do të koordinonte dhe monitoronte punën e të gjitha institucioneve dhe financimet nga donatorët.⁴¹ Me përkrahje nga *UNDP WSSI*, ABGJ ka përgatitur termat e referencës për këtë pozitë: Koordinatori Kombëtar do të udhëheq procesin e monitorimit të implementimit të Strategjisë; Sekretariati Koordinues do të përkrah administrativisht dhe logjistikisht Koordinatorin Kombëtar; një grup punues ndërminstoror do të përfshijë ministritë relevante, përfshirë Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Prokurorin e Shtetit dhe Policinë e Kosovës. OJQ-të që u ofrojnë shërbime viktimave të dhunës në familje gjithashtu do të jenë anëtare të grupit punues.

ABGJ hezitoi që të emërojë një Koordinator në nivel të Agjencisë.⁴² Koordinatorin bartej nga një institucion në tjetrin,⁴³ derisa përfundimisht u emëruar në MD në mes të vitit 2012. Buxhetet qeveritare për këto pozita dhe trupa ende nuk janë ndarë. *UNDP WSSI* ka ndarë fonde për themelimin e Sekretariatit në vitin 2012 dhe për ofrimin e ekspertizës (një bashkëpunëtor të projektit) dhe përkrahjes teknike pas themelimit të tij, gjatë vitit 2013.⁴⁴

Grupi i Asistencës së Drejtpërdrejtë, i cili do tu ndihmojë viktimave të trafikimit, i cili udhëhiqet nga Koordinatorin Kombëtar Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, në zyrën e Zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, do të mund të shërbente si model për këtë strukturë. Nga ai poashtu duhet nxjerrë mësim të caktuara: takimet e rregullta që fillimisht mbaheshin ndihmonin reagimin e koordinuar ndaj trafikimit. Megjithatë, në momentin kur u tërhoq përkrahja e rregullt nga donatorët dhe kur Koordinatorin i Sekretariatit u largua,

⁴⁰ Ky konkluzion ka të bëjë me Strategjinë dhe jo me Ligjin. Policia dhe mbrojtësit e viktimave i kanë mbuluar kostot operative.

⁴¹ Strategjia, f. 26.

⁴² Grup punues RRGK/UNDP, "Me çfarë çmimi?", Prishtinë, qershor 2012.

⁴³ Intervistat e RRGK, 2012.

⁴⁴ *UNDP WSSI* ka buxhetuar €5,811 respektivisht €12,164.

koordinimi pësoi rënie.⁴⁵ Institucioni që mban Sekretariati dhe Koordinatorin e dhunës në familje duhet të ndajë burime të mjaftueshme për të siguruar koordinim pas zvogëlimit të fondeve nga donatorët.

Përfaqësuesit e MD-së kanë vullnetin politik për të mbajtur Koordinatorin. Megjithatë, Strategjia tejkalon kufijtë e drejtësisë dhe ofron një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj parandalimit të dhunës, mbrojtjes së viktimave dhe rehabilitimit të viktimave dhe kryerësve. Ekspertiza institucionale në parandalim, mbrojtje dhe rehabilitim është kyçe për implementim efektiv të Strategjisë, e në këto fusha MD ka përgjegjësi shumë më të kufizuara ligjore, në krahasim me institucionet tjera.⁴⁶ Më tej, MD rishtas ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Zyrën e Prokurorit të Shtetit, për t'i bartur atij disa obligime lidhur me asistimin e dhunës në familje prej mbrojtësve të viktimave tek Prokurori i Shtetit. Si pjesë e qasjes gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës në familje, drejtësia duhet të jetë hapi i fundit i cili nevojitet vetëm *pasi* që institucionet të kenë dështuar në parandalimin e krimit. Me MD në krye, institucionet tjera do duhej të angazhohen aktivisht në sigurimin e implementimit të aspekteve të parandalimit dhe rehabilitimit nga Strategjia, në të cilat MD ka më pak kompetenca.

Sipas RrGGK Koordinatorin dhe Sekretariati është dashur të vendosen në ABGJ, e cila është një agjenci e nivelit të lartë në Zyrën e Kryeministrit. Për shkak të kompetencave ekzekutive të saj, ABGJ është në pozitë që të ushtrojë ndikim tek ministritë e linjës duke kërkuar nga to që të kryejnë detyrat e tyre dhe të monitorojnë Ligjin dhe Strategjinë. Këto përgjegjësi thjeshtë komplementojnë mandatin e saj ekzistues për monitorimin e barazisë gjinore në Kosovë.

ABGJ obligohet t'i raportojë "rregullisht" qeverisë për implementimin Strategjisë.⁴⁷ Duhet të sajohen indikatorët, proceset e raportimit dhe standardet e analizimit të të dhënave për monitorimin e Strategjisë. Në vitin 2012, ABGJ duket se ka pasur prioritete tjera më të rëndësishme se Strategjinë.⁴⁸ Një sërë kostosh që ndërlidhen me aktivitete specifike nga Strategjia, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi, për të cilat ABGJ mban përgjegjësi ligjore, duket se nuk janë përfshirë fare në buxhet.⁴⁹ Resurset e kufizuara njerëzore dhe financiare ia kanë pamundësuar ABGJ-së realizimin e të gjitha përgjegjësive të monitorimit. Megjithatë, brenga që disa akterë e kanë paraqitur – se ABGJ nuk ka kapacitet për të marrë përsipër përgjegjësi të tilla, do duhej të adresohet duke ia zhvilluar kapacitetet institucionale dhe duke i siguruar financim adekuat.

Monitorimi dhe Vlerësimi i Implementimit të Kornizës Ligjore

Të gjitha institucionet do duhej të monitorojnë se sa implementojnë programet qeveritare. Sipas Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë, Kuvendi i Kosovës është përgjegjës për monitorimin e implementimit të politikave dhe ligjeve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore nga Qeveria.⁵⁰ Komisioni i Kuvendit për Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione është një nga komisionet e përhershme të tij. Mandati i tij përfshin shqyrtimin e çështjeve të barazisë gjinore, vlerësimin e statusit të grave dhe nxjerrjen e rekomandimeve për avancimin e statusit të grave dhe të drejtave të grave. Komisioni

⁴⁵ Intervistat e RRGK me zyrtarë, 2012. UNDP nuk ndan këtë mendim.

⁴⁶ UNDP nuk ndan këtë mendim.

⁴⁷ Strategjia, Kapitulli V, neni 5.2. Strategjia nuk specifikon se sa shpesh do duhej të raportojë ABGJ.

⁴⁸ Intervistat e RRGK, 2012.

⁴⁹ ABGJ ka 18 punonjës (Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, Nr. 04/L-079, 2011). Buxheti i gjithmbarshëm për vitin 2012 është €185,777, përfshirë €92,770 për paga, €60,000 për mallra dhe shërbime dhe €30,000 për transfere dhe subvencione. Të njëjtin buxhet e kishte edhe për vitin 2011. ABGJ duket të jetë më pak e financuar se sa disa agjenci tjera. Për shembull, buxheti i saj përbën 17% të buxhetit të Zyrës së Komuniteteve (€1,084,237 me shtatë punonjës). Megjithëse kanë mandate të ndryshme, barazia gjinore prek shumë më shumë qytetarë se sa etnia apo statusi i komunitetit.

⁵⁰ Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë, neni 4.

poashtu do duhej të ekzaminojë abuzimin fizik, emocional dhe psikologjik të grave; dhe të avancojë pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje.⁵¹

Në vitin 2011, Komisioni ka kryer një shqyrtim të detajuar të implementimit të Ligjit.⁵² Ky shqyrtim ishte pjesë e mandatit të rregullt monitorues të Kuvendit.⁵³ Komisioni ka gjetur se qeveria ka ngecje në implementimin e Ligjit, përfshirë alokimin e përkrahjes së mjaftueshme buxhetore për realizimin e aktiviteteve. Ata gjetën se ministritë janë vonuar në hartimin dhe miratimin e UA-ve të paraparë në Ligj. Vonesat e gjykatave në lëshimin e urdhrave mbrojtës vazhdojnë të paraqesin një çështje aktuale që rezulton me atë që viktimat të mos gëzojnë drejtësi funksionale.⁵⁴

Kuvendi ka një tjetër komision që monitoron implementimin e politikave për zhvillimin efikas të shëndetësisë, punës dhe mirëqenies sociale. Ai obligohet që të hartojë strategjinë e punësimit, mbrojtjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve sociale për qytetarët. Përkundër përpjekjeve të shumta, RRGK nuk ishte në gjendje të sigurojë një intervistë me këtë komision e rrjedhimisht nuk ishte në gjendje të mësojë më shumë mbi aktivitetet dhe buxhetin e tij.

Komisioni për Shpenzime Publike është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së shpenzimit të parave publike, në bazë të raporteve, deklaratave periodike, auditimeve dhe raporteve vjetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Kjo përfshin ligjshmërinë e shpenzimeve që ndërlidhen me dhunën në familje.⁵⁵ Gjatë intervistës me RRGK-në, një anëtar i këtij komisioni sugjeroi se ai ka treguar më shumë interes në buxhetin në përgjithësi, në veçanti në të hyrat buxhetore, se sa në monitorimin se deri në çfarë mase strategjitë qeveritare, siç është ajo kundër dhunës në familje, gëzojnë buxhet të mjaftueshëm.

Në mandatin e legjislativit pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, Grupi i Grave Deputete organizoi debate mbi të drejtat njerëzore të grave dhe barazinë gjinore, të cilat mbrohen nga Kushtetuta.⁵⁶ Megjithatë, duke qenë një grup joformal parlamentar, ai nuk ka mandat ligjor dhe puna e tij nuk udhëhiqet në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit. Për më tepër, ky grup parlamentar nuk është organizatë e regjistruar, kështu që ai nuk mund të posedojë apo menaxhojë fonde. Kjo limiton buxhetin e këtij grupi parlamentar dhe rolin e tij në Kuvend. Pasi që ky grup parlamentar është relativisht i ri, ata ende nuk kanë avokuar strategjikisht për të ndikuar në buxhetin e Kosovës. Grupi i Grave Deputete ka hartuar strategjinë e aktiviteteve të veta sa i përket barazisë gjinore. Ajo përfshin monitorimin dhe rishikimin e legjislacionit nga perspektiva gjinore. Trajnimet për përfshirjen e perspektivës gjinore në legjislacion kanë munguar dhe janë zhvilluar vetëm falë donatorëve. Edhe pse ky grup parlamentar gëzon përkrahjen nga Kryesia e Kuvendit, ai nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të luajtur rolin që ka; ai nuk përfiton nga fondet qeveritare dhe varet fund e krye nga angazhimi vullnetar i anëtarëve të tij dhe përkrahja e donatorëve për nismat e tij.⁵⁷ Mungesa e përkrahjes buxhetore nga Kuvendi e pengon atë në zhvillimin efektiv dhe efikas të aktiviteteve të veta.

⁵¹ Shih Rregullorja e Punës e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2005, Shtojca 2.

⁵² Intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, mars 2012

⁵³ *Po aty*. Kushton rreth €2,000.

⁵⁴ Komisioni për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, *Raport mbi Implementimin e Ligjit për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje*, Prishtinë: 2012.

⁵⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni për Shpenzime Publike, *Rregullore e Punës*, prill 2010.

⁵⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7. Grupi i Grave Deputete është themeluar në vitin 2005 si grup joformal i grave deputete nga parti të ndryshme politike parlamentare. Që nga viti 2010, ky grup ka funksionuar si grup i grave deputete të Kuvendit të Kosovës. Ai ka në anëtarësi të vet 40 gra deputete dhe udhëhiqet nga bordi udhëheqës. Objektivë kryesorë e tij është respektimi i të drejtave njerëzore të grave dhe sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave në shoqëri dhe procese demokratike të shtetndërtimit (*Buletini informativ i Grupit të Grave Deputete*, Nr. 1, janar 2012).

⁵⁷ Mes donatorëve janë UNDP, Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Deri tani, donatorët dhe OJQ-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e implementimit të kornizës ligjore sa i përket dhunës në familje. Për shembull, i financuar nga *UNDP WSSI*, RRGK ka realizuar monitorimin për këtë raport.⁵⁸ Në vitin 2012, UNDP ka vlerësuar nivelin e ofrimit të shërbimeve në Gjilan, Dragash dhe Gjakovë.⁵⁹ Këto studime do të ofrojnë informata të rëndësishme bazike për Strategjinë. Donatorët dhe OJQ-të mund të përpilojnë raporte "në hije", mirëpo institucionet e Kosovës janë zyrtarisht përgjegjëse për të kryer monitorimin dhe do duhej të ndajnë buxhet përkatës për këtë veprimtari dhe njëherit të kenë parasysh leksionet e nxjerra nga monitorimet e mëparshme.

⁵⁸ Ky raport kushton mbi €37,000.

⁵⁹ UNDP ka pranuar €4,650 nga qeveria finlandeze, përmes Programit Kundër Dhunës në Baza Gjinore (GBV) të Ekipit të OKB në Kosovë (UNKT) dhe €13,000 nga Projekti Global Gjinor i UNDP, gjithsej €18,000. Pas themelimit të Sekretariatit në vitin 2012, *UNDP WSSI* planifikon të përkrahë një rrjet monitorimi të shoqërisë civile (€34,866), një sistem të përbashkët për menaxhimi e informatave dhe një raport vjetor të monitorimit (€7,326).

Kapitulli 2. Kush Vendosë Si Ndahen Paratë? Procesi Buxhetor në Kosovë

Për disa, procesi i ndarjes së buxhetit mund të duket i ndërlikuar dhe stafi programatik mund të mendojë (gabimisht) se kjo punë është përgjegjësi vetëm e zyrtarëve të buxhetit. Megjithatë, studimi i ndarjeve buxhetore mund të zbulojë se cilat janë prioritetet e një shteti. Pa përkrahje adekuate financiare, programet kombëtare dhe planet e veprimit nuk mund të jetësohen. Të kuptuarit e procesit të buxhetimit në Kosovë përbën element kyç për të kuptuar se kush i merr vendimet se si të ndahen paratë, motivimin politik për vendimet në fjalë, mënyrën se si të ushtrohet ndikim për ta ndryshuar buxhetin dhe si resurset shtetërore mund të shpenzohen në mënyrë më efikase dhe efektive.

Në këtë kapitull shtjellohen çështjet që mund të kenë ndikim në shtimin e ndjeshmërisë gjinore të mekanizmave aktualë buxhetorë brenda institucioneve që kanë përgjegjësi lidhur me dhunën në familje: caqet buxhetore afatmesme dhe afatgjata të Kosovës; pjesëmarrja në proceset buxhetore; dhe decentralizimi.

Prioritetet: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

Që nga viti 2007 Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) shërben si dokumenti kryesor planifikues për politikën ekonomike qeveritare.¹ KASH-i hartohet në pajtim me vizionin e qeverisë së Kosovës për zhvillim kombëtar, që përfshin: rritjen e qëndrueshme ekonomike; qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit; zhvillimin e kapitalit njerëzor; dhe shtimin e mirëqenies sociale. KASH-i për vitet 2012 deri 2014 nuk ka mundur të përfshijë Strategjinë, e cila u miratua tek në vitin 2011. Ngjashëm, as Buxheti i Kosovës për vitin 2012 nuk ka ndonjë kod specifik për ndonjë nënprogram mbi "Mbrotjtjen nga Dhuna në Familje."

KASH-i 2012-2014 ofron parashikimet e komponentëve kryesorë buxhetorë: të ardhurave dhe shpenzimeve. Shtimi i të ardhurave do t'i siguronte shtetit resurse për të ofruar shërbime që ndërlidhen me dhunën në familje. KASH-i sugjeron se të ardhurat buxhetore për vitet 2013-2015 do të shënojnë rritje. Taksat, kreditë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe të hyrat vetanake të komunave janë disa prej burimeve të rritjes së parashikuar. Ekonomistët parashikojnë se në Kosovë bruto prodhimi vendor (BPV) për kokë banori do të shtohet për 7%

¹ Republika e Kosovës, Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014* (KASH). Njësia e Buxhetit Qendror e Departamentit të Buxhetit është përgjegjës për "përgatitjen e Propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, përgatitjen e Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve, zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, vlerësimin e kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore, dhe ushtrimin e të gjitha përgjegjësiave të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit me këtë ligj" (*Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë*, Ligji nr. 03/L-048, 2008, neni 5).

gjatë tri viteve të ardhshme.² Kjo paraqet një rritje të rëndësishme marrë parasysh ekonominë e vogël të Kosovës, por në vlera absolute gjatë tri viteve të ardhshme rritja e parashikuar nuk do të tejkalojë shumë prej €163 për BPV për kokë banori. Rrjedhimisht, do të jetë e vështirë që të shtohen fondet për të përmirësuar shërbimet sociale në Kosovë.

Një tjetër burim i të hyrave janë ndihmat e jashtme dhe Strategjia i përmend donatorët në mënyrë shprehimore. Ata parashihet të kontribuojnë me €780,106 apo me 32% të të hyrave të gjithëmbarshme për realizimin e tij mes viteve 2011 dhe 2014. Në vitin 2011, grantet e donatorëve përbënin 1.5% të buxhetit të qeverisë së Kosovës. Megjithatë, donatorët kanë tendencë të mos shpenzojnë paratë e tyre në formë të ndihmës së drejtpërdrejtë bilaterale.³ Shuma e gjithëmbarshme e regjistruar e programeve të përkrahura nga donatorët jashtë buxhetit të Kosovës për vitin 2011 arrinte €8,968,000. Ky kontribut kishte shënuar rënie prej 58.4% në krahasim me vitin 2010 (€15,342,000), duke sugjeruar se do të ketë rënie të ndihmës së huaj në Kosovë.⁴ Kjo ndihmë edhe ashtu nuk ishte ndarë për aktivitete që trajtojnë dhunën në familje.

Hulumtimi i RRGK ka vërtetuar se gjatë vitit 2011 donatorët kanë kontribuar me **së paku €1,136,992**, apo kanë mbuluar rreth 37.2% të të gjitha shpenzimeve të identifikuara lidhur me dhunën në familje. Donatorët kanë shpenzuar shumë më shumë se kaq, por disa nuk ishin në gjendje të kalkulojnë apo të ofrojnë shifrat e sakta, në veçanti ato që kishin të bëjnë me stafin apo operacionet.⁵ Donatorët mbulojnë shumë shpenzime të cilat do duhej të financoheshin nga qeveria. "Kjo është një situatë shumë e çuditshme, në të cilën donatorët në fakt paguajnë për ofrim të shërbimeve bazike," një donator tha për RRGK. "Janë bërë shumë përpjekje për të shtyrë qeverinë që të ndajë më shumë fonde për ofrimin e shërbimeve të tilla." Qeveria mund të shfrytëzojë informatat lidhur me financimin nga donatorët gjatë parashikimit të buxhetit për të mbuluar kostot e ndërlidhura me dhunën në familje në të ardhmen.

Edhe pse 26 donatorë të intervistuar nga RRGK nuk kishin "linjë specifike buxhetore" për dhunën në familje, disa prej tyre kontribuonin në zbatimin e kornizës ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje.⁶ Për shembull, Ambasada e Finlandës përkrahte Programin e Dhunës në Baza Gjimore Ekspertit të OKB-së në Kosovë (UNKT) 2012-2013 me €800,000. Ky program fokusohet në përkrahjen e implementimit të Strategjisë në tri pilot-komuna: Dragash, Gjakovë dhe Gjiilan.⁷ Diagrami 3 paraqet donatorët e identifikuar dhe organizatat ndërkombëtare që kanë përkrahur gjatë vitit 2011 aktivitetet që ndërlidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me trajtimin e dhunës në familje në Kosovë.⁸ Shuma e ofruar nga secili donator (nëse dihet) është vendosur në kutinë nën emrin e donatorit. Shigjetat tregojnë sektorin apo llojin e aktiviteteve të financuara. Siç shihet nga ky diagram, duke mos pasur marrëveshje me qeverinë, ambasadat shpesh kanë bashkëpunuar me organizatat ndërkombëtare për të koordinuar dhe implementuar projekte zhvillimore.

² Bruto Prodhimi Vendor (BPV) për kokë banori mat rritjen e një vendi për një kohë të caktuar, dhe është indikator i standardit të jetës së qytetarëve. Si i tillë, ai është kyç për zhvillimin e politikave ekonomike dhe planeve zhvillimore. Megjithatë, BPV për kokë banori nuk mat domosdoshmërisht cilësinë e jetës së popullatës, ku përfshihen përfshirja sociale, pjesëmarrja e barabartë në shoqëri apo jeta pa dhunë.

³ Intervista të RRGK-së me donatorë, 2012.

⁴ Republika e Kosovës, Ministria e Financave (MF), *Raporti vjetor financiar për vitin 2011*, 2012.


⁵ Intervista të RRGK-së me donatorë, 2012.

⁶ Intervista të RRGK-së, 2012. Barazia gjimore dhe të drejtat e grave nga donatorët me të cilët biseduam kryesisht trajtoheshin si "tema që prekin shumë fusha".

⁷ Intervista e RRGK-së me një përfaqësues të Ambasadës së Finlandës, 15 mars 2012. Ai tha se programi poashtu mëton të kontribuojë në implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Ky program është një nga programet e para të përbashkëta të UNKT-së.

⁸ Megjithëse OSBE dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) nuk janë "donatorë" si i tillë, puna e tyre mund të thuhet se i kontribuon implementimit të kornizës ligjore ekzistuese. Për EULEX-in, kjo është drejtpërdrejtë përmes kompetencave të tyre të kufizuara policore dhe gjyqësore, ose përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit të institucioneve të Kosovës. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të EULEX-it do duhej të merren përsipër nga Qeveria e Kosovës dhe institucionet relevante të saj në të ardhmen, gjë që do të kërkojë financim.

Diagrami 3. Donatorët dhe Organizatat Ndërkombëtare Mbështesin Përpjekjet për të Adresuar Dhunën në Familje në Kosovë në Vitin 2011



Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të fondeve të donatorëve në Kosovë nuk ka qenë fokusi i këtij hulumtimi. Megjithatë, disa respondentë janë ankuar për mosefikasitet në shpenzimet e donatorëve. "Ka pasur aq shumë trajnime *ad hoc*," na tha një respondentë. Gjithashtu, "ne kemi shumë doracakë, por megjithatë disa agjenci vinë e na hartojnë disa doracakë të rinj pas pesë vitesh." RRGK ka identifikuar disa fusha në të cilat kishte dyfishim të financimit nga donatorët, përfshirë këtu hulumtimet, ngritjen e vetëdijes dhe trajnimet. Donatorët theksuan synimin e tyre për të koordinuar programet dhe buxhetimin me donatorë të tjerë, për t'iu shmangur dyfishimeve.¹ Megjithatë, donatorët duket se po përballen me pengesa të shumta në këtë koordinim, përfshirë kornizat e ndryshme kohore të cikleve të projekteve të tyre, procedurat e ndryshme për partneritete dhe burimet e kufizuara njerëzore. Pas zbulimit se aktivitetet e tyre ishin të ngjashme me ato të donatorëve të tjerë, disa hezitonin që tu hyjnë procedurave burokratike për t'i ndryshuar planet dhe buxhetet e miratuara. Një nga rolet më të rëndësishme të Koordinatorit Kombëtar për Dhunën në Familje do të mund të ishte sigurimi i koordinimit mes donatorëve.

Marrë parasysh se donatorët japin një kontribut të vlefshëm, analizimi i përkrahjes së tyre në të ardhmen është tejet i rëndësishëm për identifikimin e burimeve shtesë nga qeveria që nevojiten për të financuar aktivitetet dhe shërbimet që aktualisht mbulohej nga donatorët. Donatorët kanë hezituuar që të japin parashikime mbi financimin që do të sigurojnë pas vitit 2012. Disa nuk e dinin se sa do të jenë zotimet buxhetore për të ardhmen, ndërsa të tjerët jepnin grantet në baza vjetore, bazuar në kërkesat e dorëzuara nga OJQ-të individuale. Një përgjigje që na u dha shpesh ishte se financimi në të ardhmen varet nga situata politike në Kosovë. "Çdo gjë është e lidhur me politikën, kështu që gjendja është e paparashikueshme," tha një respondent. Qeveritë e huaja duket se janë duke zvogëluar apo ndalur ndihmat për tërë rajonin. "Ato po i kthehen prapë Afrikës, Azisë dhe vendeve në konflikt apo që kanë kaluar nëpër konflikte," tha një tjetër donator. Respondentët mendonin se financimet nga KE potencialisht do të shtohen dhe do të mund të përbëjnë burimin kryesor të financimit në të ardhmen.

Si përmbledhje, KASH-i parashikon se Kosova do të ketë të hyra të mjaftueshme për të realizuar programet dhe aktivitetet aktuale. Megjithatë, Strategjia nuk mbulohet me KASH-in aktual. Pasi që Kosova nuk do të ketë KASH të ri deri në vitin 2014, nevojiten zgjidhje unike për të siguruar të hyra të mjaftueshme për implementimin e Strategjisë dhe adresimin e financave të pamjaftueshme për institucionet nga të cilat kërkohet t'i zbatojnë mandatet e tyre ligjore lidhur me dhunën në familje. Ndiha nga donatorët mund të bie viteve të ardhshme. Rrjedhimisht mjetet e duhura për të adresuar dhunën në familje do të mund të grumbulloheshin nga të hyrat komunale, taksat, përmirësimi i bilancit tregtar të Kosovës,² shpenzimi më efikas, pronat e konfiskuara dhe gjobat për kryerësit e veprave.

Komponenti tjetër kryesor i buxhetit, shpenzimet, ka pesë kategori: pagat dhe mëditjet; mallrat dhe shërbimet; komunalitë; subvencionet; dhe shpenzimet kapitale. Nga viti 2012 deri në 2014, shpenzimet kapitale do të mbesin më të rëndësishmet, duke përbërë 61% deri në 69% të të gjitha shpenzimeve.³ Pasi që sektori privat kontribuon në mënyrë modeste në gjenerimin e kapitalit, qeveria beson se investimet kapitale mund të kontribuojnë në rritjen ekonomike. Rrjedhimisht, qeveria ka planifikuar të alokojë pjesën më të madhe të fondeve për vitet 2012-2015 në infrastrukturë, ndërsa në vend të dytë gjendet


¹ Intervista të RRGK-së, 2012. Një zyrtar komentoi se buxheti i pamjaftueshëm nuk është përbën problem në Kosovë; në fakt, problemi qëndron në koordinimin e buxheteve të institucioneve (Grupi punues RRGK/UNDP, qershor 2012).

² Kosova është tejet e varur nga importet, që përbëjnë rreth 50% të BPV-së; ndërkohë eksportet e vogla mbulojnë vetëm 20% të importeve (KE, Raporti i Progresit në Kosovë për vitin 2011, f. 24). Kjo kryesisht ndodh për shkak se Kosova ka prodhimtari të vogël dhe jokonkurrese në krahasim me pjesën tjetër të rajonit. Kosova mund të përmirësojë bilancin tregtar të saj përmes amortizimit real të normës së këmbimit, që mund të arrihet përmes çmimeve relativisht më të ulëta me partnerët tregtarë. Përmirësimi i bilancit tregtar mund të shtojë të ardhurat, gjë që do të sigurojë financim, p.sh. për shërbimet sociale që ndërlihen me dhunën në familje.

³ KASH 2012-2014.

shëndetësia dhe mirëqenia sociale (shih diagramin 4). Investimet në infrastrukturë i kanë tejkaluar të ardhurat dy vitet e fundit, duke krijuar kështu deficit në buxhet.⁴

Mes viteve 2013 dhe 2015, shpenzimet për paga dhe mëditje pritet të rriten mesatarisht me 3.3%. Rritja më e lartë pritet në vitin 2013, kur Kosova duhet të implementojë legjislacionin sekondar për administratën publike. Përkundër kundërshtimeve nga FMN dhe KE,



qeveria i ka ngritur pagat e punëtorëve me 30% deri 50% në mars të vitit 2011.⁵ Më pas, në vitin 2012, qeveria ka ngrirë punësimin në administratën qeveritare. Kjo pengon implementimin e Strategjisë dhe kornizës ligjore më të gjerë që ka të bëjë me dhunën në familje; institucionet kanë mungesë stafi, të cilin nuk mund ta punësojnë deri në vitin 2013.⁶

Shpenzimet në mallra dhe shërbime pritet të rriten për 2% (mesatarisht) në vit mes viteve 2013 dhe 2015. Më pak se 20% të buxhetit planifikohet të ndahet për subvencione dhe transfere sociale (pjesa më e madhe në Programin e Kosovës për Asistencë Sociale). Qeveria planifikon të shtojë kategorinë e subvencioneve dhe transfereve me 3% në vit, për të pasqyruar rritjen e pritur të numrit të përfituesve dhe pensionistëve në skemën sociale, në veçanti pas indeksimit të përfitimeve sociale në vitin 2014.⁷ Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht ngritje e standardit të jetës për persona që gëzojnë beneficione, dhe është e pamundur të parashikohet nëse buxheti i dedikuar për viktime të dhunës në familje do të shënojë rritje.

"Nëse sektori i shëndetësisë ka nevojë për më shumë, atëherë diçka duhet të sakrifkohet. Njëra duhet të sakrifkohet për tjetrën për shkak se buxheti është i vogël."
 – Përfaqësues, Drejtorja për Financa

Marrë parasysh resurset e limituara të Kosovës, buxheti pasqyron zgjedhjet politike. Respondentët kanë konfirmuar atë që shifrat e dëshmojnë:⁸ në Kosovë ka zotim të kufizuar politik për financimin e shërbimeve sociale në përgjithësi. **Zyrtarët e buxhetit përgjithësisht janë pajtuar se aktivitetet lidhur me dhunën në familje nuk përbëjnë prioritet shpenzues në buxhetin e Kosovës.**⁹ Zgjedhja për të shpenzuar mbi 60% të Buxhetit të Kosovës në shpenzime kapitale nënkupton se do të ketë më pak fonde në dispozicion për programe dhe shërbime sociale, përfshirë këtu edhe implementimin e kornizës ligjore për dhunën në familje. Duke dështuar në ndarjen e burimeve të mjaftueshme, qeveria është duke dështuar në plotësimin e zotimeve të veta lidhur me

⁴ Raporti financiar vjetor për vitin 2011. Deficiti është shpenzim i qeverisë që tejkalon të ardhurat që ka brenda një periudhe të caktuar kohore. Deficiti me kalimin e kohës kontribuon në akumulimin e borxheve (p.sh. shteteve tjera apo bankave). Borxhi mund të zvogëlohet nga suficiti buxhetor, apo të ardhurat shitesë. Në vitin 2011, qeveria ka paguar €11,491,000 në emër të borxheve, kryesisht për të mbuluar shpenzimet në investime kapitale.

⁵ KE, Raporti i Progresit në Kosovë për vitin 2011.

⁶ Shih kapitujt 4 dhe 5.

⁷ KASH, faqet 27-28.

⁸ Ministria e Financave, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2011.

⁹ Grupi i fokusit me zyrtarë të buxhetit, i organizuar nga RRGK në Prishtinë më 5 prill 2012.

Strategjinë dhe Ligjit. Për më tepër, mund të thuhet se ajo nuk është duke iu përmbajtur të gjitha prioriteteve të përcaktuara në KASH, siç janë zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe mirëqenia sociale.

Drejt një Procesi Buxhetor me Pjesëmarrje: Cikli Buxhetor i Kosovës

Buxheti i shtetit i përket popullit dhe duhet të mbikëqyret nga populli. Qytetarët kanë të drejtë të vlerësojnë dhe monitorojnë planet e punës dhe buxhetet e qeverisë, si dhe të marrin pjesë në procesin buxhetor.¹⁰ Procedurat buxhetore rregullojnë vendimet për shpenzimet shtetërore dhe publike.¹¹ Itinerari i Buxhetit të Kosovës, i cili sajohet në pajtim me prioritetet e KASH-it, fillon në mars të çdo viti kur qeveria dhe Ministria e Financave (MF) ia dërgojnë të gjitha institucioneve KASH-in. Institucionet kanë kohë deri në muajin maj që t'i paraqesin MF-së perspektivat e tyre për KASH-in për vitin në fjalë. Në mes të muajit maj, Ministria i grumbullon sugjerimet e tyre dhe e përpilon versionin e parë të buxhetit për vitin vijues. MF ia dërgon projektbuxhetin organizatave buxhetore, do të thotë të gjitha institucioneve në nivel qendror dhe lokal. Në buxhet përfshihen edhe kontributet e donatorëve. Megjithatë, qarkorja buxhetore për vitin 2012 nuk përmban informata mbi kontributet që donatorët i japin realizimit të Strategjisë.

Organizatave buxhetore më pas sajojnë buxhetet e tyre në bazë të pesë kategorive të shpenzimeve të përmendura më sipër. Planifikimi nuk do duhej të bie ndesh me dispozitat e përcaktuara nga MF lidhur me BPV-në dhe inflacionin. Organizatat buxhetore do duhej të përcaktojnë shpenzimet dhe të ndajnë buxhetin për realizimin e të gjitha përgjegjësisë të tyre ligjore, përfshirë obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore në lidhje me dhunën në familje. Pasi që Strategjia është miratuar në nëntor të vitit 2011, pasi që kishte përfunduar procesi buxhetor, institucionet nuk kanë arritur që ta pasqyrojnë atë në buxhetet e tyre për vitin 2012. Sidoqoftë, është brengosëse se shumë zyrtarë për buxhete nuk e dinin edhe në vitin 2012 se Strategjia ekzistonte fare; si do të mund të ndajnë buxhet për implementimin e tij në vitin 2013 nëse fare nuk janë në dijeni për ekzistimin e tij?

Një zyrtar i informuar i buxhetit (i cili planet i përpilon në koordinim të ngushtë me zyrtarët programatik dhe me zyrtarin për barazi gjinore) do të mund të përpilonte një propozim të saktë dhe adekuat buxhetor. Përderisa nuk ka ndonjë obligim eksplicit ligjor që do të rregullonte pjesëmarrjen e ZBGJ-së në procesin e përgatitjes së buxhetit, zyrtarët e buxhetit do duhej të bashkëpunojnë me ta për të siguruar se buxheti, si politikë qeveritare, i kontribuon barazisë gjinore.

Në qershor organizatat buxhetore ia dorëzojnë projektbuxhetet e para MF-së. Më pas ata grumbullojnë inputet mbi prioritetet lokale përmes konsultimeve me qytetarët dhe me grupe të interesit.¹² Në këtë fazë, ZBGJ-të dhe OJQ-të e grave do të mund të inkurajonin gratë dhe burrat që të marrin pjesë në përgatitje të buxhetit; ato poashtu mund të vlerësojnë nëse institucionet kanë ndarë mjete të mjaftueshme për të trajtuar dhunën në familje. Megjithatë, në të kaluarën OJQ-të e grave dhe ZBGJ-të ose nuk kanë marrë pjesë fare ose kanë marrë pjesë fare pak në procesin e përgatitjes së buxhetit.¹³

Tabela 3. Kalendar i vendimeve buxhetore në Kosovë

Muaji	Veprimi
Mars	MF ia dërgon KASH institucioneve
Maj	Institucionet ia dërgojnë perspektivat MF-së
Maj	MF harton buxhetin dhe ia dërgon org. buxhetore
Qershor	Org. buxhetore hartojnë buxhetet
Gusht-Shtator	Org. buxhetore komunale dhe kombëtare mbajnë dëgjime buxhetore me qytetarë dhe grupe interesi
Tetor	Pas negociatave, finalizohet buxheti
Tetor	Kuvendi debaton dhe miraton buxhetin
Mars	Fillon implementimi i buxhetit

Influenca është këtu!

¹⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji për Qasje në Dokumente Publike*, Nr. 03/L-215, 2010, neni 1.

¹¹ Kosova ka një sistem Thesarit me një llogari që kontrollohet nga Departamenti i Thesarit.

¹² Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, *Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna*, Nr. 2006/03.

¹³ Intervista të RRGK-së, 2012. Shih kaptinën në vijim për më shumë informata lidhur me pjesëmarrjen në nivel komunal.

Projektbuxheti diskutohet në dëgjime buxhetore, të cilat mbahen mes fundit të gushtit dhe fillimit të shtatorit, kur institucionet duhet të deklarojnë kërkesat e tyre për vitin në fjalë. Deklaratat nuk zgjasin më gjatë se 15 minuta, dhe gjatë kësaj kohe ato duhet të ofrojnë indikatorët e performansës për programet dhe projektet e tyre. Kërkesat buxhetore duhet të plotësohen në bazë të KASH-it. Kjo vështirë se mund të realizohet për vetëm 15 minuta.

Korniza ligjore e Kosovës nuk përcakton në mënyrë shprehimore se kur ABGJ do duhej të ndërhyjë në procesin buxhetar. Megjithatë, dëgjimet buxhetore mund të paraqesin kohën ideale për intervenimin e ABGJ-së pranë ministrive relevante për të siguruar se buxhetet e tyre kanë perspektivë gjinore dhe se ato do t'i jetësojnë përgjegjësitë e tyre lidhur me adresimin e diskriminimit gjinor, përfshirë këtu edhe dhunën në familje. ABGJ do duhej të përgatisë paraprakisht rekomandimet me shkrim, gjë që mund të kërkojë ekspertizë të brendshme dhe burime financiare shtesë. ABGJ poashtu do duhej të negociojë me MF-në për të siguruar se ABGJ do të përmendet në mënyrë eksplicite në Qarkore Buxhetore. Ngjashëm, gjatë dëgjimeve parlamentare, zgjedhjet buxhetore mund të ndikohen nga deputetët, përfshirë këtu edhe Grupin e Grave Deputete.

"Problemi është se në dëgjimet buxhetore nuk ka njerëz që punojnë për çështje gjinore, por vetëm njerëz që punojnë me buxhetin."
- Përfaqësues i MF-së

Pas dëgjimeve buxhetore, qeveria përgatitë dhe dorëzon projektbuxhetin e përgjithshëm tek Kuvendi i Republikës së Kosovës për diskutim. Anëtarët e Grupit të Grave Deputete dhe parlamentarët tjerë kanë mundësi që të ndikojnë në ndarjet buxhetore për të siguruar se ato marrin në konsideratë obligimet për adresimin e dhunës në familje. Projektbuxheti duhet të gjendet në agjendën e Kuvendit gjatë muajit tetor dhe duhet të miratohet para fillimit të vitit fiskal në janar.

Disa zyrtarë të buxheteve kanë hezituar që të ndajnë me ne planet e punës dhe buxhetet. Buxhetet e siguruar përfshinin buxhetin e planifikuar total dhe të shpenzuar, sipas kategorive të shpenzimit. Buxhetet nuk përfshinin linja të detajuara për aktivitetet individuale. Për këtë arsye, ishte e vështirë që të identifikohet se sa cili institucion ka shpenzuar në lidhje me përgjegjësitë që ka për dhunën në familje. "Kjo i ngjan kërkimit të një gjilpëre në një hambar me kashtë," i tha RRGK-së një zyrtar i buxhetit.¹⁴

Fakti se Kosova ka vetëm pesë kategori buxhetore i kontribuon rritjes së boshllëkut mes planifikimit financiar programatik dhe shpenzimeve. Inputet financiare të kërkuara për aktivitet të caktuar shumë rrallë ndodhë të janë të qarta.¹⁵ ***Deri sa Kosova të mos fillojë të ndajë kostot sipas aktivitetit dhe jo sipas pesë kategorive të gjera, do të jetë tejet e vështirë të monitorohet implementimi i buxheteve për strategji të caktuara, përfshirë këtu edhe Strategjinë.*** Megjithatë, elaborimi i buxheteve në detaje do të kërkonte më shumë staf, dijeni për fushën e kontabilitetit, monitorim dhe rrjedhimisht më shumë resurse. Për këtë arsye, duket pak e mundshme që në të ardhmen e afërt të vendosen kategori të reja buxhetore. Sidoqoftë, institucionet duhet të konsiderojnë edhe kostot lidhur me implementimin e strategjive, çfarë është edhe Strategjia, dhe duhet të krijojnë mekanizma për planifikim dhe monitorim të kostove të ndërlidhura. Një zgjidhje kosto-efektive në këtë drejtim mund të jetë specifikimi më i detajuar i kostove, linjave buxhetore dhe ministrive përgjegjëse për aktivitetet e programeve siç është Strategjia. MASHT-i ka dhënë një shembull pozitiv të kësaj, duke i elaboruar në detaje shpenzimet për Strategjinë.

Gjatë vitit, organizatat e ndryshme buxhetore mund të rishpërndajnë buxhetin mes kategorive të ndryshme shpenzuese, për t'i përshtatur ato me legjislacionin e miratuar ndërkohë (p.sh. Strategjia), me shpenzimet qeveritare dhe me ndryshimet e mundshme në të ardhura. Në vitin 2011 qeveria nuk ka kryer rishikim buxhetor të mesit të vitit. Koordinimi

¹⁴ Grupi i fokusit me zyrtarë të buxhetit, i organizuar nga RRGK në Prishtinë më 5 prill 2012.

¹⁵ Grupi i fokusit me zyrtarë të buxhetit, i organizuar nga RRGK në Prishtinë më 5 prill 2012.

mes zyrtarëve për financa dhe zyrtarëve programatik do të mund të siguronte se planet dhe alokimet buxhetore përputhen me përgjegjësitë ligjore, por hulumtimi i RRGK ka sugjeruar se bashkëpunimi i tillë mes departamenteve brenda institucioneve ndodh shumë rrallë.

Pas kalimit të tre muajve të parë, Kuvendi miraton raportin financiar vjetor për vitin paraprak. Rishikimi tregoi se në vitin 2011 disa mjete kanë mbetur të pashpenzuara; dallimi më i madh ishte në kategorinë mallra dhe shërbime (90% të buxhetit është shpenzuar). Për shembull, në MPMS ishte shpenzuar 97% e buxhetit total, por në kategorinë e shpenzimeve për "mallra dhe shërbime" ishin shpenzuar vetëm 87% të mjeteve. Ligji i Buxhetit të Kosovës ndalon bartjen e mjeteve të pashpenzuara në vitin vijues, gjë që kontribuon në shpenzimin e buxhetit me kohë, por jo edhe në mënyrë cilësore.

Statistikat e shpenzimeve buxhetore mund të shfrytëzohen gjatë planifikimit buxhetor dhe për të siguruar shpenzim efikas të fondeve në të ardhmen. Nëse një institucion ka shpenzuar 90% të buxhetit, ai do duhej të hulumtojë përse nuk i ka shpenzuar të gjitha mjetet. Megjithatë, edhe nëse institucionet e Kosovës nuk i shpenzojnë të gjitha mjetet e ndara, ato në të shumtën e rasteve prapë marrin të njëjtën shumë vitin e ardhshëm.¹⁶ Kjo paraqet shkëlqje të Qarkores Buxhetore, e cila thotë se indikatorët do duhej të përcjellin efikasitetin e aktiviteteve të propozuara për realizimin e prioritetit qeveritar të qeverisjes së mirë. Kërkesat buxhetore do duhej të bazohen në arsyeshmëri dhe analiza të shpenzimit-përfitimit, jo në shpenzime konstante vjetore. Për shembull, strehimoret marrin të njëjtin buxhet pa marrë parasysh të hyrat e tyre, numrin e klientëve dhe/ose cilësinë e shërbimeve të ofruara. Ngjashëm me këtë, për vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të buxheteve vjetore të këtyre institucioneve nuk vlerësohet as përmes përcaktimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga zyrtarët për shërbime sociale e as përmes numrit të rasteve të zgjidhura përmes gjykatave.¹⁷

Qarkorja Buxhetore kërkon nga të gjitha organizatat që të paraqesin indikatorët e performancës.¹⁸ Megjithatë, RRGK ka gjetur shumë pak dëshmi se organizatat buxhetore kanë shfrytëzuar indikatorët apo menaxhim të bazuar në rezultate gjatë procesit buxhetor.¹⁹ Monitorimi i performancës së buxheteve ka qenë i mangët, ndërsa buxhetet e institucioneve nuk ndërlihen medoemos me aktivitetet që bazohen në kornizën ligjore. ***Indikatorët e performancës duhet të zgjerohen edhe më tej për të matur performancën bazuar në strategji, siç është Strategjia.***²⁰

Ligji dhe Strategjia janë të rinj dhe për këtë arsye institucionet relevante kanë pasur shumë pak përvojë në planifikimin buxhetor në lidhje me të. Procesi i planifikimit të buxhetit për vitin 2013 do të tu ofrojë institucioneve rast që të vlerësojnë performancën programatike dhe buxhetore të deritanishme dhe të përshtatin buxhetet përkitazi. Ky raport ka për qëllim që të lehtësojë këtë proces të rishikimit duke përshkruar aktivitetet e financuara dhe të nënfinancuara dhe duke sugjeruar strategji për financim më efikas. ABGJ, ZBGJ-të, Grupi i Grave Deputete dhe OJQ-të e grave mund të ndikojnë në buxhet, në veçanti në gusht dhe shtator. Ato mund të rishikojnë projektbuxhetet për të siguruar se institucionet relevante janë duke realizuar mandatet e tyre ligjore lidhur me dhunën në familje dhe avancimin e barazisë gjinore. Për të mundësuar këtë, Qarkorja Buxhetore mund të përfshijë konsultimet obligative me ABGJ-në dhe ZBGJ-të gjatë dëgjimeve buxhetore. Megjithatë, përveç avokuesve për barazinë gjinore, ***të gjithë zyrtarët për buxhet, zyrtarët programatik, parlamentarët dhe ministrat kanë përgjegjësi për të siguruar se institucionet i zbatojnë zotimet ligjore të tyre.***

¹⁶ Rishikimi i buxheteve vjetore të institucioneve nga RRGK.

¹⁷ Të gjeturat e bazuara në intervista të RRGK-së me institucione përgjegjëse, 2012.

¹⁸ Çdo program duhet të ketë "(i) Së paku një indikator specifik për rezultat të pritur, (ii) Së paku dy masa për rezultat të pritur, (iii) Një masë të efijencës për çdo rezultat të pritur."

¹⁹ Menaxhimi i bazuar në rezultate përfshin menaxhimin e rezultateve. Gjatë planifikimit, implementimit, monitorimit dhe vlerësimit, përqendrimi vazhdon të mbetet tek rezultatet e kërkuara. Kjo mund të ilustruhet si në vijim: Inputi (financiar dhe njerëzor) → Aktivitetet → Rezultatet → Ndikimi.


²⁰ Grupi punues RRGK/UNDP, 13 qershor 2012.

Decentralizimi dhe Pjesëmarrja Komunale në Përgatitje të Buxhetit

Ligji për Financa Lokale i vitit 2008 ka përcaktuar rregullat dhe ka siguruar financimin e autoriteteve lokale për ofrimin e shërbimeve standarde minimale.²¹ Përmes decentralizimit qeveria i inkurajon komunat që të menaxhojnë dhe rrisin të hyrat e tyre. Komunat mund të nxjerrin fonde për të implementuar Strategjinë dhe për të financuar shërbimet që ndërlidhen me dhunën në familje.

Komunat e Kosovës kanë dy burime financimi: të hyrat vetanake dhe transferet qeveritare. Komunat i pranojnë transferet (grantet operative) nga buxheti qendror. Për këtë arsye, financimi i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore për viktimat e dhunës në familje kryesisht bëhet nga niveli qendror. Granti i përgjithshëm synohet të shpërndahet në mënyrë të barabartë mes komunave, duke e shfrytëzuar një formulë për ndarjen e tij, që përfshin popullatën (89%), sipërfaqen (6%), numrin e banorëve që u përkasin komuniteteve pakicë (3%) dhe faktin nëse komunitetet pakicë përbëjnë shumicën e popullatës brenda komunës (2%).²² Vendimet për ndarjen e buxhetit nuk varen nga të dhënat e ndara sipas gjinisë. Megjithatë, këto të dhëna janë të rëndësishme për të lehtësuar proceset e planifikimit dhe për të siguruar se buxhetet adresojnë nevojat specifike të grave dhe burrave, vajzave dhe çunave.

Qytetarët që jetojnë në vise të ndryshme të Kosovës nuk mund të gëzojnë qasje të barabartë në shërbime. Për shembull, përderisa Mitrovica dhe Gjilani kishin ofruar më shumë shërbime për të adresuar dhunën në familje, Dragashi kishte në dispozicion vetëm Zyrën për



Ndihmë Juridike. Vendndodhja e Dragashit, në një zonë malore larg nga qyteti më i afërt i Prizrenit, kufizonte qasjen e qytetarëve në institucione dhe shërbime. Si komunë e vogël që është, Dragashi nuk mund të financojë shërbimet që ofrohen në komuna më të mëdha. Në anën tjetër, Mitrovica ka resurse financiare më të mëdha (shih diagramin 5),²³ por politika e

pengon qasjen e viktimave në shërbime, në veçanti qasjen në drejtësi (shih diagramin 4). Gjilani paraqet një shembull pozitiv: autoritetet komunale kanë kontribuar mjaft shumë financiarisht në strehimoren e atjeshme.

Komunat kanë raportuar se kanë më shumë kontroll mbi të hyrat vetanake.

Megjithatë, ato përbëjnë vetëm 14.7% të buxheteve komunale për vitin 2011. Për më tepër, KASH-i parashikon se të hyrat vetanake do të shtohen me vetëm 3% gjatë tri viteve në vijim. Varësia nga fondet që vijnë nga qeveria qendrore ndikon në aftësinë e zyrtarëve për të financuar prioritetet lokale. "Kërkesat

"Proceset dhe politikat kryesore vendosen në nivel qendror. Ne i përcjellim këto politika, të cilat i vënë si prioritet investimet kapitale."
- Zyrtar komunal për buxhet

²¹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale (Ligji nr. 03/L-040, 2008) rregullon se komunat do të kenë autoritet për të menaxhuar buxhetet e veta; autoritetin për të përcaktuar normat dhe përjashtimet e taksave lokale, gjokat, tarifave dhe pagesat; dhe se të gjitha shërbimet komunale duhet të financohen përmes buxheteve komunale, të cilët përfshijnë burimet vetanake (neni 24).

²² KASH, p. 64.

²³ Nga këto komuna, Mitrovica ka pranuar më së shumti fonde për kokë banori në vitin 2011: €24.49 për person për shëndetësi dhe €2.29 për shërbime sociale. Pasi që shumë serbë të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, megjithatë, popullata mund të jetë më e madhe dhe shpenzimi për kokë banori më i ulët. Derisa ata i kanë menaxhuar 84% të këtij buxheti, autoritetet komunale thanë se nuk kanë pasur kontroll mbi 16% të buxhetit që është shpenzuar në veri.

tona shpesh nuk merren fare në konsideratë,” tha një zyrtar për buxhet. “Për shembull, Inspektorati i Punës na ka kërkuar më shumë punëtorë, por kufijtë e përcaktuar nga MF nuk na e lejojnë këtë. MF thotë se këta kufij janë të ‘butë’, por në realitet ata janë *shumë të fortë*.”²⁴ Komunitat mund të mos jenë në gjendje të punësojnë staf të mjaftueshëm për të ofruar shërbime që ndërlidhen me dhunën në familje. Për këtë arsye, megjithëse decentralizimi do duhej të sigurojë planifikim të buxheteve me pjesëmarrje në nivel lokal, edhe planifikimi edhe ekzekutimi i buxheteve mbeten mjaft të centralizuar.

Niveli i implementimit të decentralizimit dallon nga institucioni. Policia e Kosovës dhe organet e drejtësisë (p.sh. gjykatat, MV-të dhe Komisioni për Ndihmë Juridike) kryejnë planifikimin buxhetor, menaxhimin, shpenzimin dhe mbikëqyrjen, përfshirë edhe lidhur me dhunën në familje, në nivel qendror. Në anën tjetër, drejtoritë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale²⁵ dhe drejtoritë për arsim kanë buxhetet komunale dhe grantin e përgjithshëm qeveritar. Kjo kontribuon në rritjen e konfuzionit lidhur me atë se kujt duhet t’i raportohet (komunës apo Departamentit për Mirëqenie Sociale), në veçanti mes punëtorëve socialë. Aktualisht, ata i raportojnë të dy palëve dhe të dyja do duhej t’ua monitorojnë performansën. QPS-të poashtu kanë raportuar se kanë më shumë përgjegjësi dhe më pak resurse; granti qeveritar është zbritur ndërsa shtesat e planifikuara nga komuna nuk janë siguruar, gjë që ua ka vështirësuar atyre realizimin e mandateve të tyre.²⁶

Sa i përket mbikëqyrjes së buxheteve nga publiku, komunitat do duhej të konsultohen me qytetarët mes qershorit dhe shtatorit, Megjithatë, të pakta janë komunitat që i informojnë qytetarët me kohë për zhvillimin e konsultimeve, në mënyrë që këta të fundit të mund të marrin pjesë në to.²⁷ Pjesëmarrja e qytetarëve (e në veçanti e femrave) në procesin e buxhetit në përgjithësi mbetet në nivel të ulët.²⁸ Vendimet buxhetore duket se kryesisht merren nga udhëheqësia komunale sipas politikave të nivelit qendror.

Çdo komunë ka një ZBGJ. Sipas Ligjit për Barazi gjinore, ata do duhej të “rishikojnë çdo vendim të marrë nga autoritetet lokale para miratimit të tij,” përfshirë këtu edhe buxhetin komunal.²⁹ **ZBGJ-të duket se nuk luajnë rol shumë aktiv në hartimin e buxhetit.** “Ne nuk marrim pjesë në procesin buxhetor. Të gjitha kërkesat tona [për financim] duhet të kalojnë përmes Drejtorisë së Administratës apo Kryetarit të Komunës,” një ZBGJ i tha RRGK-së. **Qasja e pamjaftueshme në resurse financiare i ka penguar ZBGJ-së në aftësinë e tyre për ta avancuar strategjikisht barazinë gjinore në nivel komunal.** Kjo përfshin parandalimin e dhunës në familje duke adresuar pabarazitë gjinore. ZBGJ-të do duhej të kenë buxhet të pavarur nga Njësia për Drejta të Njeriut apo Zyra e Kryetarit.³⁰

Zyrtarët në fjalë nuk ishin në dijeni për buxhetimin gjinor si vegël, me një përjashtim – ZBGJ në Gjilan.³¹ Zyrtarët komunalë kryesisht kishin bindjen se organizimi i një takimi për të shënuar 8 marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, mjaftonte për të “adresuar barazinë gjinore”. Megjithatë, organizimi i një ahengu apo dreke për gratë mbase nuk kontribuon strategjikisht në avancimin e barazisë gjinore në një komunë të caktuar.

Bazuar në vlerësimin e proceseve ekzistuese buxhetore, *UN Women* planifikon të trajtojë ZBGJ-të dhe akterët komunalë në shfrytëzimin e BGJ si mjet për të ndarë buxhet për trajtimin e dhunës në familje në Gjakovë, Gjilan dhe Dragash (€60,000).³² Ata gjithashtu

²⁴ Intervistë e RRGK-së me një zyrtar nga Departamenti për Buxhet dhe Financa, 2012.

²⁵ Në Mitrovicë drejtorja është shpërbërë. Në vend të kësaj, kjo Komunë ka Drejtorin për Integrim Evropian dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtorin për Shëndetësi.

²⁶ Intervista të RRGK-së me punëtorët socialë në nivel komunal, 2012.

²⁷ Shih Institutin e Kosovës për Hulumtime Politike dhe Zhvillim (KIPRED), *Arkat Publike: Drejt Menaxhimit Efikas dhe Transparent të Buxheteve Komunale*, Prishtinë: KIPRED, 2011, f. 23.

²⁸ *Po aty*, dhe intervistat e RRGK-së me zyrtarë komunalë dhe OJQ, 2012.

²⁹ *Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë*, neni 4.16.

³⁰ *Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë*, neni 4.15. Po ashtu, intervistat e RRGK-së me ZBGJ, korrik 2012.

³¹ Intervistë e RRGK-së me ZBGJ, 2 mars 2012.

³² Kjo është pjesë e Programit GBV të UNKT.

planifikojnë të trajnojnë OJQ-të për planifikim me pjesëmarrje, buxhetim me pjesëmarrje dhe për evokim për integrimin e reagimeve ndaj dhunës në familje në planet dhe buxhetet komunale.³³

Komunat kryesisht nuk kanë pasur linja të veçanta buxhetore për të adresuar dhunën në familje. Disa ZBGJ kanë ndërmarrë aktivitete dhe disa komuna kanë financuar strehimoret dhe/ose raste të caktuara sociale. Kjo përkrahje nuk është institucionalizuar përmes kornizës ligjore, por është varur nga liderët lokal, posaçërisht nga kryetarët e komunave.³⁴ Kryesisht komunat në të cilat gjenden strehimoret financin aktivitetet për të adresuar dhunën në familje, ndërsa komunat tjera nuk ndanin mjete financiare për këtë.³⁵

Konkluzione: Pengesat Buxhetore Ndikojnë në Shërbimet që Ndërlidhen me Dhunën në Familje

Përkundër zotimeve të bëra lidhur me dhunën në familje në kornizën ligjore, Buxheti i Kosovës qartë dëshmon se dhuna në familje nuk paraqet prioritet. Në KASH nuk mund të bëhen ndryshime drastike deri sa të miratohet një plan tjetër afatmesëm në vitin 2014. Gjatë planifikimit të buxhetit në të ardhmen duhet të konsiderohet se si do të mbahen në jetë aktivitetet që aktualisht financohen nga donatorët, në veçanti marrë parasysh se përkrahja nga donatorët potencialisht mund të zvogëlohet. Edhe pse komunat janë në gjendje të gjenerojnë të hyra vetanake, rritja e ulët e këtyre të fundit, me normë prej vetëm 3%, nuk do t'ju sigurojë atyre mjete të mjaftueshme për ta implementuar Strategjinë. Komunat do të vazhdojnë të varen parimisht nga fondet e qeverisë qendrore, kështu që ndikimi i zyrtarëve lokalë në përcaktimin e prioriteteve buxhetore ka gjasa të mbetet fare i vogël. Sigurimi i të hyrave të reja për implementimin e Strategjisë ka pak gjasa të ndodhë.

Strategjia nuk ka linjë të ndarë në Buxhetin e Kosovës, gjë që ndikon negativisht në financimin për implementimin të tij. Për këtë arsye, qeveria ka dhënë indikacione se buxheti për implementimin e tij do të jetë horizontal: çdo institucion që ka përgjegjësi për implementimin e Strategjisë duhet të arrijë ta bëjë këtë përmes buxheteve të tyre ekzistuese. Disa aspekte të Strategjisë ndërlidhen me detyrat e tyre të rregullta institucionale dhe këto veç do duhej të ishin buxhetuar. Megjithatë, ekzaminimi i buxheteve të institucioneve, për të cilin bëhet fjalë në kapitujt në vijim, tregon se atyre nuk u janë ndarë fonde të mjaftueshme për të implementuar mandatet e tyre ligjore. Në kapitullin 7 shtjellohen strategjitë që qeveria do të mund t'i shfrytëzojë për t'i tejkaluar pengesat financiare për implementimin e Strategjisë si dhe kornizës ligjore për adresimin e dhunës në familje.

ABGJ, ZBGJ-të dhe zyrtarët programatik me përgjegjësi që ndërlidhen me dhunën në familje nuk kanë qenë sa duhet të përfshirë në proceset e planifikimit buxhetor. Qarkorja Buxhetore do duhej të kërkojë konsultimin e tyre gjatë këtij procesi. Për më tepër, të gjithë zyrtarët për buxhet, zyrtarët programatik, parlamentarët dhe ministrat kanë përgjegjësi për të siguruar se institucionet do të mbajnë zotimet e tyre lidhur me dhunën në familje. Indikatorët më të mirë të performansës do të duhej të matin performansën e tyre, bazuar në rolet dhe përgjegjësitë përkatëse që kanë.

³³ Intervistë e RRGGK-së me përfaqësuesin e *UN Women*, 23 mars 2012.

³⁴ Strehimoret apo individët shkruan kërkesat. Nëse kjo miratohet, fondet vinin nga kategoria e shpenzimeve të subvencioneve të kryetarit të komunës.

³⁵ Bisedë e RRGGK-së me përfaqësues të komunave, 2012.

Kapitulli 3.

Parandalimi

Ky kapitull dhe kapitujt vijues shtjellojnë shpenzimet e sakta në vitin 2011 për secilën shtyllë të Strategjisë dhe në lidhje me kornizën më të gjerë ligjore dhe politike për adresimin e dhunës në familje. Shtylla e parandalimit mëton të "themelojë mekanizma efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje." Aktivitetet që lidhen me këtë objektivë përfshijnë edukimin e popullatës për të raportuar dhunën në familje; informimin e popullatës se si mund të raportojnë dhunën në familje; ngritjen e vetëdijes publike lidhur me dhunën në familje dhe pasojat që ajo sjell përmes tryezave të rrumbullakëta në komunitet; dhe vendosjen e psikologëve dhe pedagogëve në komuna.

Arsimimi Formal për Dhunën në Familje

MASHT-i do duhej të merr pjesë në hartimin e një Udhëzimi Administrativ (UA) nën udhëheqje e MPMS-së, apo të nxjerrë vetë një UA për ta miratuar Ligjin.¹ Kjo ministri nuk ka planifikuar, buxhetuar apo filluar së hartuari kurrfarë UA lidhur me dhunën në familje. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë parasheh që MASHT-i dhe komunat të përmirësojnë barazinë gjinore dhe të promovojnë shëndetin e studentëve dhe mësimdhënësve, si dhe sigurinë dhe mirëqenien e tyre.² Kjo sugjeron se ata kanë për detyrë parandalimin e dhunës në familje. Mësimdhënësit poashtu duhet t'i raportojnë pranë QPS-ve të gjitha rastet e dyshuara të dhunës fizike, seksuale apo psikologjike kundër fëmijëve.³ Si masë parandaluese, mësimdhënësit poashtu mund (nëse këtë veç nuk e bëjnë) të takohen me prindërit e fëmijëve që potencialisht mund të jetojnë në familje abuzive.⁴

Në pajtim me Strategjinë, MASHT-i do duhej të vendosë psikologë nëpër shkolla; të ofrojë shërbime dhe kualifikime profesionale viktimave të dhunës në familje;⁵ dhe të edukojë popullatën për të raportuar dhunën në familje.⁶ Që nga viti 2009, MASHT-i ka buxhetuar €432,000 për çdo vit, për të mbuluar shpenzimet për 40 psikologë që punojnë nëpër drejtoritë komunale të arsimit.⁷ Megjithatë, një zyrtar i MASHT-it tha se "nuk kishte buxhet të mjaftueshëm" për ta mbajtur këtë program. Më tej, psikologët kanë qenë të vendosur nëpër drejtori komunale për arsim dhe jo në shkolla, siç parashihet në Strategji. Shkollat në zonat rurale nuk ofrojnë qasje tek psikologu. Rrjedhimisht, siç duket MASHT-i nuk ka resurset e nevojshme për të përmbushur të gjitha përgjegjësitë që ka. Pedagogët dhe psikologët do të mund të bashkëpunonin për tu ndihmuar fëmijëve që mund të jenë viktimat të dhunës në familje.⁸ Të dy do të mund të përfitonin nga trajnimet që profesionistët do t'i

¹ Ligji, neni 27 thotë se MPMS duhet të bashkëpunojë me ministritë tjera, përfshirë MASHT-in, në krijimin e strukturave për të përkrahur personat që kanë përjetuar dhunë në familje. Kjo përfshin asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore.

² Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-032, 2011, nenet 3, 5 dhe 7.

³ Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Nr. 02/L-17, 2005, neni 10.6. Dështimi për të vepruar asisoj do të trajtohet në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, UNMIK/REG/2003/25, 2003, neni 156.

⁴ Implikacionet kohore dhe buxhetore nuk mund të vlerësohen pasi që koha e kaluar duke u angazhuar në aktivitete parandaluese nuk është regjistruar.

⁵ MASHT ofron arsim për viktimat e dhunës në familje (shih kapitullin 5). Kjo mund të parandalojë dhunën duke u ofruar viktimave shkathtësi dhe dijeni që u ndihmojnë në sigurimin e të ardhurave dhe pavarësisë ekonomike.

⁶ Strategjia, objektivat strategjike dhe aktivitetet 1.1, 4.1.4 dhe 1.4.

⁷ Psikologët mbase nuk e kalojnë tërë kohën e tyre duke trajtuar raste të dhunës në familje.

⁸ Pjesëmarrës në grupin punues RRGK/UNDP, 13 qershor 2012.

jepnin në lidhje me procesin e referimit, protokollet për rastet e dyshuara të dhunës në familje dhe qasjet adekuate për tu ndihmuar fëmijëve.

Sipas Strategjisë, përmes MASHT-it, autoriteteve komunale dhe ABGJ-së, shkollat do duhej të punojnë për të shtuar vetëdijen e popullatës së përgjithshme lidhur me dhunën në familje. Në klasën e VI, në shkolla jepet lënda e edukatës qytetare në të cilën nxënësit informohen lidhur me konceptet e të drejtave të fëmijëve, të drejtave të njeriut dhe punës së fëmijëve.⁹ Edukata qytetare themelore përfshin një kapitull për dhunën në familje dhe MASHT-i ofron trajnime për të drejtat e fëmijëve dhe dhunën në shkolla. Nëmoshën më të madhe të fëmijëve ofrohen më shumë informata mbi dhunën në familje. MASHT-i ka integruar dy module në klasën e VIII për të paraqitur çështjet gjinore, luftën kundër trafikimit dhe shëndetin, ndërsa një nga këto module zgjedhure përmban një kapitull për dhunën në familje.¹⁰ Pasi që këto kurse janë të integruara në sistemin arsimor, buxheti aktual, do të thotë pagat e mësimitdhënësve, do të mjaftojnë për t'i mbuluar në të ardhmen.

MASHT-i ofron një sërë mundësish trajnimi për mësimitdhënësit. Megjithatë, trajnimet për dhunën në familje nuk ofrohen rregullisht. Mësimitdhënësit që mbajnë dy lëndët e përmendura në klasën e VIII janë njoftuar për planprogramin e ri kur ai filloi të zbatohet, por nuk kanë pasur ndonjë trajnim të mëtejshëm. MASHT-i nuk konsideron se ofrimin i trajnimeve për parandalimin apo reagimin ndaj dhunës në familje përbën pjesë të mandati të tij. Përfaqësues të këtij institucioni thanë se nëse nxënësit dhe mësimitdhënësit do të kërkonin edukim të mëtejshëm në fushën e dhunës në familje, atyre do t'u ofrohej ndihmë. Komenti i tyre duket sikur injoron faktin se në Strategji trajnimet e tilla jo që rekomandohen por kërkojnë medoemos.

Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të programimit është tejet i rëndësishëm. Departamenti i inspektimit vlerëson cilësinë e mësimitdhënies dhe planprogramin e MASHT-it, por nuk kryen ndonjë inspektim të veçantë të cilësisë së mësimitdhënies sa i përket dhunës në familje. Krerët e shkollave kryejnë vlerësime dhe raportojnë tek departamentet komunale në inspektoratet e arsimit. MASHT-i përcakton kostot dhe ndan buxhetet për monitorim dhe vlerësim. Megjithatë, pasi që monitorimi vlerëson performancën e përgjithshme të një shkolle, nuk është e mundur të identifikohen shifrat apo shpenzimet për monitorimin e mësimitdhënies sa i përket dhunës në familje.

MASHT-i rishtas e ka ndryshuar procesin buxhetor të tij, dhe planet e punës brenda çdo departamenti tani përputhen me buxhetet gjegjëse. Në pajtim me këtë, zyrtari i buxhetit i ka identifikuar dy departamente të cilat do të mund të ndërmerrnin aktivitete që ndërlidhen me dhunën në familje: Departamentin e Inspektoratit të Arsimit dhe Njësinë për të Drejtat e Njeriut. Departamenti i Inspektimit nuk identifikon rastet e dhunës në familje në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në fakt, mësimitdhënësit obligohen që t'i referojnë rastet tek ky institucion. Pasi që ende deri sot nuk është referuar asnjë rast, Departamenti nuk ka shpenzuar fare kohë apo resurse lidhje me dhunën në familje; kjo nuk do të thotë se ata nuk do duhej të kenë buxhet për këtë. Njësia për Drejta të Njeriut nuk ka pasur linjë buxhetore specifike për dhunën në familje; dhe drejtoritë e arsimit në komunat e vlerësuara kanë raportuar se nuk kanë kryer dhe nuk kanë ndarë buxhet për aktivitete parandalimi.

Ngritja e Vetëdijes

Strategjia kërkon nga disa institucione të ngritin vetëdijen e shoqërisë lidhur me dhunën në familje; të krijojnë mekanizma për të edukuar dhe ngritur vetëdijen e rinisë për këtë çështje;

⁹ Në klasën e V, nxënësit mësojnë për familjen, shkollën, rolet shoqërore dhe shtëpinë/vendbanimin; dhe rolin, të drejtat dhe detyrat e familjes dhe shkollës. Në klasën e IX, studentët mësojnë mbi llojet e ndryshme të familjes, rolet gjinore dhe marrëdhëniet në familje të gjerë, ndryshimet në familje moderne dhe shkathtësitë e komunikimit mes prindërve dhe fëmijëve.

¹⁰ Të gjitha informatat në këtë kapitull janë nxjerrë nga intervistat apo korrespondenca me institucione relevante gjatë vitit 2012, përveç nëse është potencuar ndryshe. Lëndët janë Edukatë Qytetare (obligative) dhe Shkathtësi Jetësore (zgjedhore).

dhe të shtojnë numrin e rasteve të raportuara të dhunës në familje. Një numër i madh i aktiviteteve vetëdijësuese janë realizuar dhe janë planifikuar të realizohen viteve të ardhshme (shih tabelën 4).

Lidhur me objektivat e Strategjisë, Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Drejtësisë, institucionet qeveritare,¹¹ OJQ-të, donatorët dhe mediat do duhej të organizojnë fushata mediale për dhunën në familje. Njësisia për Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore e MD-së i udhëheq fushatat e tilla. Megjithatë, siç paraqitet në tabelë, donatorët dhe OJQ-të kanë investuar në këtë aktivitet shumë më shumë se sa institucionet e Kosovës.

Tabela 4. Shpenzimet e parashikuara për aktivitete vetëdijësuese lidhur me dhunën në familje

Legjenda: pa buxhet = €0; buxhet më i lartë se i paraqitur = >; buxheti i paditur = ?

Akteri	Veprimtaria	2011	2012
ABGJ	Edukimi i popullatës për ta raportuar DHF (p.sh. punëtori, fletushka)	€13,319	€3,000 ¹²
SHGP	Tryeza të rrumbullakëta me komunitetin dhe entitetet relevante	€0	€0
EULEX	Fushatë publike për DHF (p.sh. pano reklamuese dhe emetime TV)	?	? ¹³
ICITAP ¹⁴	Tryeza të rrumbullakëta, prezantime në shkolla dhe arkiva për DHF	?	>€6,198
ICITAP	Broshura vetëdijësuese, të shpërndara nga Policia e Kosovës	€5,200	?
RRGGK (KtK)	Fushatë vetëdijësuese dhe avokim për DHF	€11,000	€12,500
RRGGK (KtK)	Fushatë 15-ditëshe (dokumentari Crossing Bridges, spot TV, diskutime, teatër)	€10,720	?
Komisioni për Ndhimë Juridike	Informim i popullatës për pikat ku mund të raportohet DHF (broshura)	€0	€0
MKRS	Programe për DHF për fëmijë, në radio dhe TV	€0	€0
MD	Tryeza të rrumbullakëta me komunitetin dhe entitetet relevante	€1,500	€1,500
MD	Kontributi në organizimin e fushatave mediale me fokus në DHF	€0	€0
MAP	Organizimi i fushatave mediale me fokus në DHF	€0	€0
Komunat	ZBGJ në Gjilan ka përgatitur një broshurë me informata për DHF	€160	?
OPDAT	Fushatë në shkolla dhe universitete mbi çështjet tipike për viktimat	€0	? ¹⁵
OPDAT	Broshura për të drejtat e viktimave	€0	€565
OPDAT	Materiale informative për të drejtat e viktimave dhe nevojat psikosociale	€0	?
OSBE ¹⁶	Pjesëmarrja e publikut në hartimin e strategjive për barazi gjinore në Prizren dhe Dragash, me tema që ndërlidhen me DHF	>€872	€0
OSBE	Punëtori për gra rome dhe ashkali me temë DHF	?	?
OSBE dhe ABGJ	Punëtori për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, me fokus DHF	>€5,365	€0
OSBE	Publikimi dhe lansimi i një katalogu informativ për viktimat e DHF ¹⁷	>€8,360	>€4,200

¹¹ Strategjia nuk specifikon cilat institucione, edhe pse shpesh përmend "institucionet qendrore dhe lokale."

¹² Përfaqësuesit e ABGJ-së parashikojnë se 160 ditë dhe dy punëtori në vit i kushtohen aktiviteteve që ndërlidhen me dhunën në familje, që i bie €2,400 në vit për paga dhe mëditje dhe €3,000 për mallra dhe shërbime.

¹³ EULEX-i nuk ka pasur linjë të veçantë buxhetore dhe nuk ka mundur të ndajë shpenzimet.

¹⁴ ICITAP bashkëpunoi me Sektorin për Diplomaci Publike të Ambasadës së SHBA-ve. Takimet e Ekipeve të Veprimit për Siguri në Komunitet të financuara nga ICITAP-i "koinciduan me shtimin e mbulimit medial të çështjeve të dhunës në familje" (korrespondencë, 2012). RRGK e ka shfrytëzuar parashikimin më të lartë të ICITAP-it për shkak se ICITAP-i nuk ishte në gjendje të kalkulojë edhe kohën e saktë që stafi ka kaluar në këtë program. Ata planifikojnë të ofrojnë përkrahje deri në vitin 2014, kur Departamenti i Sigurisë Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme do duhej të merr këtë punë përsipër; nuk është e qartë nëse Ministria do të ndajë buxhetin përkatës.

¹⁵ Buxheti nuk ka qenë i ndarë deri në qershor 2012, ndërsa që edhe korniza kohore për aktivitetet është e panjohur.

¹⁶ OSBE theksoi: "Ndarja e kostove nga tabela nuk është e zbatueshme drejtpërdrejt për Misionin e OSBE-së në Kosovë; ndarja e detajuar e kostove që përcaktojnë çdo aktivitet nuk mund të jetë reprezentative e punës efektive të Misionit, i cili ka një fushëveprim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës. Përveç kësaj, çdo ndarje e kohës/kostos për stafin do të ishte e pasaktë dhe do të mund të rezultonte me të dhëna të paqëndrueshme" (korrespondencë, 28 maj 2012). Përfshirja e stafin dhe shpenzimet operative, këto shifra nuk paraqesin të gjitha shpenzimet që OSBE i mbulon në lidhje me dhunën në familje.

¹⁷ Katalogu në vitin 2011 ka kushtuar përafërsisht €8,360; publikimi i tij në gjuhën rome dhe turke në vitin 2012 do të kushtojë rreth €4,200; ndërsa kostoja e lansimit të tij në vitin 2012 nuk mund të kalkulohet.

OSBE	Shfaqje teatrale për të shënuar ditën ndërkombëtare të barazisë gjinore	€0	>€3,450
OSBE	Shfaqje teatrale dhe vetëdijësim për DHF (Prizren)	€0	>€3,621
OSBE	Fushatë vetëdijësuese në zona rurale të komunës së Podujevës	€0	>€1,755
OSBE	Fushatë vetëdijësuese për DHF dhe linja e hapur kundër trafikimit	€0	€19,195
OSBE	Trajnim për gazetarë dhe shpërblimi për storien më të mirë për DHF	€0	?
PILPG ¹⁸	Punëtori publike edukative për DHF për rininë, në 10 komuna	?	?
PILPG	Pamflete të policisë me informata mbi ndihmën	?	>€300
Policia	Broshurë që informon popullatën për DHF dhe pikat e raportimit të saj	€1,500	€1,500
PVPT (Amb. e Norvegjisë)	Vetëdijësimi mes viktimave potenciale për parandalimin e trafikimit ¹⁹	€5,030	?
Ruka Ruci (Ktk)	Fushatë kundër DHF (tryeza të rrumbullakëta dhe punëtori)	€1,100	€1,100
UNDP ²⁰	Shpallje Publike me linjë të hapur për DHF, që shfaqet në kinema	>€5,760	€0
UNDP WSSI	Me Iniciativën për Kontrollin e Armëve të Vogla në Kosovë (KOSSAC): vetëdijësim për shfrytëzimin e armëve të zjarrit gjatë festimeve dhe në incidente të DHF ²¹	€4,310	?
UNDP WSSI	Materiale promovuese kundër DHF	€2,141	€0
UNDP WSSI	Prodhimi i një filmi dokumentar për DHF dhe trafikimin me qenie njerëzore ²²	> €8,220	€0
UNDP WSSI	Prodhimi i një filmi dokumentar dhe fushatës	€9,200	€0
UNDP WSSI	Fushatë 16-ditore dhe java globale kundër dhunës me armë zjarri ²³	€7,539	€6,979
UNDP WSSI	Shpërblimi për shkrimin më të mirë gazetaresk për dhunën në baza gjinore në Kosovë	€0	€1,162
UNDP WSSI	Tryeza të rrumbullakëta për raportimin e dhunës në baza gjinore, me redaktorë të gazetave dhe SHGP	€0	€ 5,427
UNDP WSSI	Trajnimiti i gazetarëve për raportim efektiv të çështjeve të dhunës në baza gjinore dhe etikës	€0	€ 6,973
UNFPA-GBV ²⁴	Edukimi i rinisë për DHF dhe dhunën në baza gjinore	€0	€7,606
UNFPA-GBV	Ngritja e vetëdijës së liderëve fetarë për të identifikuar dhe përkrahur viktimat e DHF	€0	€4,564
UNICEF-GBV	Programe për DHF në komunitet, me cak rininë; dialogu me meshkuj	?	€16,275
UN Women	Ngritja e vetëdijës së rinisë lidhur me DHF ²⁵	€0	€7,500
<i>Zensko Pravo</i>	Fushatë kundër DHF ²⁶	€0	€10,936

Strategjia gjithashtu parasheh se Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur (AGP), institucionet qeveritare, OJQ-të, donatorët dhe mediat do të organizojnë tryeza të rrumbullakëta lidhur me dhunën në familje nëpër komunitete. AGP nuk ka buxhetuar për këtë qëllim dhe përfaqësuesi i tij nuk ishte në dijeni se AGP përmendej fare në Strategji. Ndërsa ABGJ kishte ndarë disa fonde, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare kishin organizuar apo kishin planifikuar organizimin e shumicës së takimeve në komunitet. OJQ-të, përfshirë strehimoret,

¹⁸ Grupi për të Drejtë dhe Politika Ndërkombëtare Publike, i financuar nga SHBA-të (PILPG).

¹⁹ OJQ-ja *Protecting Victims Preventing Trafficking (PVPT)* fokusohet në trafikim (shih kapitullin 4 për të mësuar më shumë mbi relevancën e saj).

²⁰ Programet tjera të UNDP-së mund të kontribuojnë në parandalimin e dhunës në familje duke i tundur normat gjinore dhe adresuar faktorët që i krijojnë ato. Megjithatë, kostoja e saktë e këtyre aktiviteteve nuk mund të përcaktohet për shkak se dhuna në familje është komplekse ndërsa qasja e UNDP-së është shumështrësore.

²¹ Kjo përfshinte kontributin në hartimin e kornizës ligjore relevante (të financuar nga qeveria).

²² Pagesat për filmin dokumentar janë bërë me rata, ndërsa pagesa e fundit u bë në vitin 2011.

²³ Buxheti vjetor i UNDP-së për këtë fushatë është integruar në projekte tjera.

²⁴ UNFPA dhe UNICEF planifikojnë të bashkëpunojnë në vetëdijësim, si pjesë e programit të UNKT të përkrahur nga finlandezët. Vlerat në tri linjat vijuese janë parashikime të vrazhda; dy herë kaq mjete do të shpenzohen në 2012-2013.

²⁵ UN Women poashtu ka financuar publikimin e një doracaku nga Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) me informatat relevante të institucioneve. Financimi do të bëhet mes 2012 dhe 2013, ndërsa ky është një parashikim i vrazhdë i shpenzimeve për vitin 2012.

²⁶ *Zensko Pravo* (shqip: E drejta e gra) është financuar nga Ambasada e Holandës. Ata kanë përfituar fonde për vetëdijësim nga USAID-i, përmes Mercy Corps, por vlera e saktë nuk ka mundur të përcaktohet.

poashtu kishin organizuar shumë demonstrata, shfaqje dhe fushata informative, në veçanti gjatë fushatës 16-ditore kundër dhunës ndaj gruas.²⁷

MKRS, mediat, OJQ-të, donatorët, teatrot dhe ABGJ do duhej të përfshijnë çështjen e dhunës në familje në programet për fëmijë dhe të rinj në radio dhe televizion.²⁸ Megjithatë, MKRS nuk ka zhvilluar apo buxhetuar kurrfarë aktivitete lidhur me dhunën në familje.²⁹ Strategjia poashtu parasheh trajnimin e gazetarëve për raportimin e dhunës në familje.³⁰ Si UNDP ashtu edhe OSBE kanë planifikuar aktivitete të tilla për vitin 2012 (shih tabelën 4).

Strategjia i bën thirrje Policisë së Kosovës, MD-së, Komisionit për Ndhimë Juridike, ABGJ-së, shkollave (MASHT-it), QPS-ve, komunave, donatorëve dhe mediave që të edukojnë dhe informojnë popullatën lidhur me institucionet tek të cilat mund të raportojnë dhunën në familje. Sipas Strategjisë, me këtë aktivitet nuk parashihet "asnjë kosto", por është e evidente se kosto të tilla ka (shih tabelën 4). Komisioni për Ndhimë Juridike, së paku një komunë dhe Policia e Kosovës kanë ndarë buxhete për materiale informative. Përveç tyre, OSBE, ICITAP dhe PILPG kanë shtypur broshura informative për policinë, ndërsa OPDAT (Programi për Asistencë dhe Trajnim i Zyrës për Zhvillim Prokurorial Ndërkombëtar të Departamentit të Drejtësisë së SHBA-ve), kanë publikuar broshura për të drejtat e viktimave.

Nuk dihet nëse ka pasur ndonjë analizë të ndikimit që do ta kishte vlerësuar efektivitetin e përpjekjeve për parandalim deri sot.³¹ Analiza të tilla janë poashtu të rëndësishme për të vlerësuar nëse buxhetet janë shpenzuar në mënyrë efikase. Një hulumtim në nivel të Kosovës në vitin 2013, me të cilin do të mateshin perceptimet dhe qëndrimet pesë vite pas hulumtimit të RRGK-së të vitit 2008 (të financuar nga UNDP) do të mund të ofronte një krahasim për të vlerësuar ndryshimet përkatëse pas kalimit të kësaj periudhe. Pyetjet shtesë do të mund të ndihmonin në vlerësimin se cilat fushata vetëdijesuese kanë qenë më efektive. Enti Statistikor i Kosovës (ESK) do të mund të parashihte në buxhetin e vet dhe do të mund të zhvillonte anketa të rregullta lidhur me dhunën në familje. ESK do të mund të shfrytëzojë përvojën përmbajtësore të RRGK-së si dhe elementet hulumtuese të tij për të kryer krahasime kohore të përgjigjeve.

Matja e Raportimit të Shtuar

Një objektivë specifike e Strategjisë është shtimi i numrit të rasteve të raportuara.³² Kjo kërkon "azhurnimin" e bazave aktuale të të dhënave nëpër institucione, në mënyrë që të mund të monitorohet dhe vlerësohet nëse është arritur ky objektiv. Informatat e sakta për rastet që kanë përfituar nga asistencë gjithashtu mund të ndihmojnë në menaxhimin e rasteve, planifikimin programatik dhe përcaktimin e kostove nëpër buxhetet përkatëse të institucioneve.

Megjithatë, grumbullimi i të dhënave mbetet i dobët edhe brenda institucioneve edhe mes tyre.³³ Shumica e institucioneve të dhënat i vendosin me dorë, ndonjëherë madje edhe në regjistra me shkrim. Sistemet elektronike rrallë shfrytëzohen në grumbullimin e të dhënave kryesore demografike dhe rrallë mundësojnë ndarjen e të dhënave përkatëse për tu analizuar më me lehtësi. Si rezultat i kësaj, institucionet duhet të kenë më shumë resurse

²⁷ Fushata 16-ditore fillon në Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Grave (26 nëntor) dhe zgjatë deri në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, më 10 dhjetor.

²⁸ Strategjia.

²⁹ *Ligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë* (Ligji Nr. 03/L-145, 2009) nuk përmend dhunën në familje. Në MKRS na u tha se ata nuk kanë resurse të mjaftueshme financiare apo njerëzore për të kryer detyrat ligjore që kanë.

³⁰ Kjo paraqitet nën shtyllën e rehabilitimit dhe reintegrimit (Strategjia), por i kontribuon edhe parandalimit.

³¹ Në vitin 2012, UNICEF-i ka planifikuar të kryejë një studim bazik mbi dhunën në familje në tri pilot-komuna të përcaktuara nga UNKT (€37,185). Kjo anketë do të shërbejë kryesisht për të vlerësuar ndryshimet që rezultojnë nga programi.

³² Strategjia, OS 4.1.

³³ Të gjeturat bazuar në intervistat e RRGK-së dhe vrojtimit pas kërkimit të të dhënave nga institucionet për qëllime të këtij hulumtimi.

njerëzore (rrjedhimisht edhe kosto shumë më të larta) për të analizuar manualisht të dhënat. RRGGK ka gjetur se institucionet shpesh nuk kanë të dhëna të mjaftueshme, por as staf dhe/ose ekspertizë për të ofruar të dhënat kur ato nevojiten. Shumë institucione nuk e kanë regjistruar dhunën në familje si kategori të veçantë (institucionet shëndetësore, gjykatat, prokurorët dhe zyrat e punësimit).³⁴ Disa institucione u desh të raportojnë mbi dhunën në familje në raportet e tyre tremujore apo vjetore, kështu që kanë pak stimul për të grumbulluar informatat në fjalë. Tabela 5 paraqet të dhënat në dispozicion lidhur me numrin e rasteve të dhunës në familje që kanë përfutur nga asistenca.


Tabela 5. Numri i rasteve të dhunës në familje që janë asistuar nga institucionet përkatëse, 2000-11

	2000-1	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	mes.	Total
Policia e Kosovës		1273	1251	1318	1370	1371	1077	1034	1080	944	1046	1176	11,764
Mbrojtësit e viktimave			314	414	592	703	645	610	654	627	739	589	5,298
Strehimor.	138	139	444	523	478	527	550	548	206	526	394 ³⁵	355	3,553
Komisioni për Ndihmë Jur. ³⁶								36	20	76.5	76.5	52	209
Qendrat për Punë Sociale				223	380	438	170	247	92	229	226	251	2,005
Këshilli Gjyqësor i Kosovës ³⁷								2795					2,795

Burimi: Informatat që institucionet ia kanë dhënë RRGGK-së.

Instalimi i një sistemi të menaxhimit të integruar të informatave do të mund ta përmirësonte efikasitetin e grumbullimit të të dhënave, përpunimit të tyre dhe do të ofronte informata për politikat programatike dhe buxhetore.³⁸ Nga të gjitha institucionet do duhej kërkuar që të vendosin në këto sisteme të dhënat lidhur me shërbimet e ofruara. Në këtë sistem, viktimat do të mund të identifikoheshin një herë. Më pas institucionet do të mund të shfrytëzonin të njëjtën dosje të rastit, do të mund të koordinonin, ta përcillnin rastin dhe ta monitoronin atë (shih kapitullin 6). Sistemi i sigurisë i mbrojtur me fjalëkalim do t'u siguronte institucioneve të caktuara qasjen në dosjet e klientëve. Në një sistem të tillë do duhej të sigurohet konfidencialiteti dhe do duhej marrë leje nga klientët në rast të shpërndarjes së të dhënave të tyre. Ky sistem do duhej instaluar në bashkëpunim të ngushtë mes të gjitha institucioneve relevante dhe OJQ-ve, në mënyrë që të sigurohet se ai i plotëson të gjitha nevojat e tyre, gjë që do mundësonte ofrimin e shërbimeve cilësore.

Në fund, vlerësimi nëse objektivi për të shtuar raportimin është arritur duhet bërë me kujdes. Institucionet do duhej të vlerësojnë nëse të dhënat që ato i grumbullojnë pasqyrojnë të gjitha paraqitjet e dhunës në familje, sepse dhuna nuk raportohet gjithmonë. Siç paraqitet në diagramin 6, shtimi i raportimit nuk do të thotë domosdoshmërisht se është shtuar numri i rasteve të dhunës në



³⁴ Vetëm strehimoret, MV-të, Zyrat për Ndihmë Juridike dhe QPS-së i kanë regjistruar rastet e dhunës në familje në mënyrë të veçantë.

³⁵ Kjo përfshin të dhënat deri në tetor 2011.

³⁶ Numrat kursiv janë parashikime të bëra nga RRGGK, bazuar në numrin e gjithmbarshëm të rasteve dhe mesatares për tri vite për të cilën Komisioni nuk kishte të dhëna.

³⁷ RRGGK, *Më shumë se "fjalë në letër"?* f. 43. Kjo përfshin veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, për këtë arsye kishte më shumë raste.

³⁸ UNKT planifikoi instalimin e një baze të të dhënave për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në komunat e parapërcaktuara, si pjesë e programit të dhunës në baza gjinore. Të gjitha institucionet do të jenë në gjendje t'i regjistrojnë të dhënat e tyre ndërsa sistemi do të menaxhohet nga komuna.

familje. Shtimi i kapaciteteve institucionale për të asistuar më shumë raste, apo i përpjekjeve parandaluese që inkurajojnë raportimin do të mund të rezultojnë me rritje të përkohshme të numrit të raporteve. Kjo mund të jep bindje të gabuar se dhuna në familje ka shënuar rritje. Me ofrimin e shërbimeve cilësore dhe përpjekje efektive parandaluese, paraqitja e rasteve të tilla mund të shënojë ulje me kalimin kohës.

Konkluzionet

Pasi që një sërë institucionesh janë të angazhuara në përpjekjet për të parandaluar dhunën në familje, është e pamundshme të identifikohen të gjitha paratë e buxhetuara apo të shpenzuara. Një parashikim i vrazhdë i shpenzimeve në parandalim gjatë vitit 2011 është se janë shpenzuar €526,264, përfshirë €448,479 nga shteti dhe €77,785 nga donatorët.³⁹ Në vitin 2012, për parandalimin janë buxhetuar së paku €596,727. Strategjia parasheh se përpjekjet për parandalim kushtojnë €85,540 për vit (€342,160 gjatë katër viteve). Shpenzimet e parashikuara për vitin 2011 dhe 2012 tejkalojnë shumatat e planifikuara. Kjo sugjeron se mund të ngjajë që për parandalim të shpenzohen **tepër fonde**, posaçërisht në krahasim me shtyllat tjera. **Marrë parasysh aktivitetet e shumta dhe të ngjashme vetëdijësuese sugjerojnë se ka dyfishim të përpjekjeve dhe shfrytëzim joefikas të resurseve.** Me disa përjashtime, aktivitetet vetëdijësuese të akterëve të **ndryshëm nuk janë koordinuar mirë.** Bashkëpunimi mes akterëve në përgatitje të një fushate vetëdijësuese dhe një broshure informative të vetme në nivel të Kosovës do të nënkuptonte



RrGGK ka identifikuar një mori materiale të përsëritura për rritjen e vetëdijes.

shfrytëzim më të mirë të resurseve dhe ndikim më të fuqishëm. ABGJ dhe ministritë relevante të linjës do të mund t'i monitoronin dhe vlerësonin më mirë nismat parandaluese.⁴⁰ Palët me interes do të mund ta përcillnin ndikimin përkatës duke shfrytëzuar një indikator të vetëm, i cili do të mund të matet përmes anketave të rregullta të amvisërive në nivel të Kosovës, siç ishte *Siguria fillon në shtëpi*.

Përderisa efektiviteti do duhej monitoruar, shpenzimet shtesë në parandalim mund të jenë të arsyeshme vetëm në aspekt afatshkurtër. Investimi në edukim dhe ngritje të vetëdijes mund t'i kursejë shtetit mjete që do shpenzonte në mbrojtje dhe rehabilitim nga dhuna në

familje (shih kapitullin 7). Pasiguria mes donatorëve sa i përket financimit afatgjatë dhe zvogëlimi i buxhetit të MASHT-it për psikologë do të mund të shkaktojnë pamundësi tek institucionet për të parandaluar dhunën, gjë që do të shkaktoje shpenzime më të larta për mbrojtje dhe rehabilitim.⁴¹ Për këtë arsye, *qeveria* duhet të sigurojë ndarje të fondeve të mjaftueshme për parandalim në të ardhmen.

³⁹ Shpenzimet shtetërore ka gjasa të jenë më të larta se sa ato reale sepse psikologët e MASHT-it sigurisht nuk e kanë kaluar 100% të kohës së tyre duke parandaluar dhunën në familje. Mosmbajtja e shënimeve përkatëse nënkupton se nuk mund të kalkulohen shpenzimet e sakta. Në anën tjetër, shpenzimet e donatorëve janë sigurisht shumë më të larta sepse ata nuk i kanë mbuluar shumë kosto të ndryshme. Të dhënat e shumta që mungojnë e bëjnë të vështirë parashikimin e saktë të shpenzimeve nga donatorët dhe nga qeveria.

⁴⁰ Ligji, nenet 27 dhe 28.

⁴¹ Buxhetimi për parandalim mund të jetë sfidues sepse nuk ekzistojnë kode buxhetore përkatëse (grupi punues RRGK/UNDP).

Kapitulli 4. Mbrojtja, Siguria dhe Ndjekja Penale

Shtylla e Mbrojtjes dhe Sigurisë në Strategji synon të sigurojë "mekanizma efikas mbrojtës për viktimat e dhunë në familje" deri në vitin 2013. Ky kapitull ekzaminon kornizën relevante ligjore dhe politike, cilësinë e shërbimeve dhe koston e kryerjes së detyrave të policisë, forenzikës, ndjekjes penale, mbrojtësve të viktimave, ndihmës juridike, mirëqenies sociale, strehimoreve dhe shërbimit korrektues.

Policia: Ofrimi i Mbrojtjes dhe Sigurisë

Ligji përcakton masat e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje përmes procedurës civile.¹ Me këtë ligj, Policia e Kosovës autorizohet si pikë e parë kontakti për lëshimin e urdhrave për mbrojtje të përkohshme emergjente (UMPE), jashtë orarit të rregullt të punës së gjykatave.² Përveç gjykatave, asnjë institucion tjetër nuk mund të kryejë këtë punë. UMPE janë të vlefshëm deri në momentin kur gjykata të fillojë orarin e rregullt të punës dhe deri sa të lëshohet një urdhër i mbrojtjes apo urdhër i mbrojtjes emergjente.

Ligji përcakton rolet dhe përgjegjësitë e Policisë së Kosovës: rregullon raportimin e incidenteve potenciale të dhunë në familje; arrestimin e kryerësve nëse ka baza për të besuar se ka ndodhur ndonjë akt i dhunës në familje; ofrimin e një linje të posaçme telefonike për viktimat; informimin e viktimave apo përfaqësuesve të tyre për të drejtën e kërimit të UMPE, apo të shërbimeve juridike, psikologjike ose të tjera; lehtësimin e kontaktit me ofruesit e shërbimeve; transportimin e viktimave dhe vartësve të tyre për ekzaminim mjekësor. Policia poashtu do duhej të identifikojë një zyrtar hetues, të plotësojë një raport të incidentit dhe t'ia sigurojë viktimës një kopje të raportit. Në raste të dhunës ndaj fëmijëve, policia duhet të kontaktojë QPS-në përgjegjëse.³ Policia mund të ofrojë mbrojtje për viktimat në pajtim me legjislacionin që rregullon mbrojtjen e dëshmitarëve. Pas urdhrave të gjykatës, policia largon kryerësit e dhunës nga vendbanimi i përbashkët.⁴ Në rastet kur ka elemente të veprës penale, policia përgatit rastin për prokurorin.⁵ Në tabelën 6 përmbledhen shërbimet dhe referimet që u ofruan nga policia mes viteve 2006 dhe 2010.

¹ Ligji, nenet 4-12 parashohin tri lloje të urdhrave të mbrojtjes. Urdhri i mbrojtjes nuk mund të jetë më i gjatë se 12 muaj, por mund të ekzekutohet brenda 24 muajsh (neni 18, paragrafi 2); urdhri për mbrojtje emergjente skadon në momentin kur gjykata e lëshon urdhrin e mbrojtjes (neni 18, paragrafi 4); dhe i njëjti nuk mund të zgjasë mbi 48 orë, duke humbur fuqinë juridike pasi që gjykata të lëshojë urdhrin e mbrojtjes (neni 22, paragrafi 2).

² Ligji, neni 22.

³ *Po aty*. Kur policia dyshon se ka pasur dhunë në familje, ata duhet ta informojnë viktimës për statusin e hetimeve dhe vendndodhjen e kryesit të dyshuar.

⁴ Ligji, neni 24.

⁵ Policia pohon se i referon pothuajse të gjitha rastet (99%) tek prokurori komunal (intervistë e RRGK-së me një zyrtar të DVIU së Policisë së Kosovës, 18 janar 2012). Megjithatë, në vitin 2011 policia ka pranuar 1,046 raporte të dhunës në familje, ndërsa Zyra e Prokurorit të Shtetit pretendon se i ka pranuar vetëm 629 raste. Kjo sugjeron se policia nuk i ka referuar të gjitha rastet e regjistruara apo se Zyra e Prokurorit të Shtetit nuk i ka regjistruar të gjitha rastet.

Në vitin 2011, Policia e Kosovës i ka azhurnuar Procedurat Standarde Operative (PSO), që përkufizojnë çdo hap që policia duhet të ndërmerr gjatë ofrimit të ndihmës për viktime të dhunës në familje.⁶ Të gjithë pjesëtarët e policisë trajnohen për PSO, implementimi i së cilave duhet të monitorohet dhe vlerësohet. Kjo ngërthen implikacione buxhetore.

Buxhetet planifikohen dhe miratohen nga komanda e përgjithshme, përmes një procesi të centralizuar. Disa nga shpenzimet e DVIU-ve, siç janë pagat dhe mëditjet, përfshihen në mënyrë shprehimore në buxhetin e tyre për vitin 2012. Shpenzimet tjera, si mirëmbajtja e veturave dhe paratë e imta, mbulojnë nga buxhetet e stacioneve të policisë.⁷ Policia ka të angazhuar Koordinatorin Kombëtar, DVIU-të regjionale dhe DVIU-të në nivel të stacionit (€334,800 në vit).⁸ Përveç kësaj, policia ka në dispozicion një linjë telefonike të hapur 24 orë në ditë, në të cilën mund të raportohen krimet përkatëse dhe e cila i kushton €21,600 (për gjashtë punonjës). Shpenzimet e transportit janë €51,600 në vit.⁹ Në përgjithësi, buxheti i gjithmbarshëm që ndërlidhet me veprimtarinë e DVIU-ve është së paku €408,000 në vit. Kjo shifër nuk përfshin kohën që njësitë tjera të policisë e kalojnë në raste të dhunës në familje, furnizimet e zyrave, telefonat dhe pajisjet tjera; këto kosto nuk kanë mundur të ndahen nga linjat buxhetore të tjera të policisë.¹⁰ Donatorët dhe akterët tjerë kanë ofruar financime shtesë për të blerë pajisje të rëndësishme për punën e policisë.¹¹


Buxhetet planifikohen dhe miratohen nga komanda e përgjithshme, përmes një procesi të centralizuar. Disa nga shpenzimet e DVIU-ve, siç janë pagat dhe mëditjet, përfshihen në mënyrë shprehimore në buxhetin e tyre për vitin 2012. Shpenzimet tjera, si mirëmbajtja e veturave dhe paratë e imta, mbulojnë nga buxhetet e stacioneve të policisë.¹² Policia ka të angazhuar Koordinatorin Kombëtar, DVIU-të regjionale dhe DVIU-të në nivel të stacionit (€334,800 në vit).¹³ Përveç kësaj, policia ka në dispozicion një linjë telefonike të hapur 24 orë në ditë, në të cilën mund të raportohen krimet përkatëse dhe e cila i kushton €21,600 (për gjashtë punonjës). Shpenzimet e transportit janë €51,600 në vit.¹⁴ Në përgjithësi, buxheti i gjithmbarshëm që ndërlidhet me veprimtarinë e DVIU-ve është së paku €408,000 në vit. Kjo shifër nuk përfshin

Tabela 6. Shërbimet e ofruara nga Policia e Kosovës, 2006-2010

Shërbimi	2006	2007	2008	2009	2010	Total	%
Raste të raportuara	1442	1105	1056	1130	954	5687	100.0
Arrestimi	393	319	316	261	296	1585	27.9
Referime tek QPS	955	591	501	613	406	3066	53.9
Referime tek MV	1295	867	834	670	701	4367	76.8
Urdhër mbrojtës nga gjykata	183	59	54	154	141	591	10.4
Urdhër mbrojtës nga policia	1	4	95	0	9	109	1.9
Referime në strehimore	81	73	44	52	62	312	5.5

Burimi: Policia e Kosovës. Vërejtje: kjo tabelë tregon një rënie të numrit të rasteve të raportuara në polici. Urdhërat mbrojtës janë lëshuar në vetëm 12% të rasteve, ndërsa 5.5% të tyre janë referuar në strehimore.

Diagrami 7. Hierarkia e Administratës dhe Financave në Polici



⁶ ICITAP përkrahu përpilimin e PSO-ve, në bazë të Protokollit për Dhunë në Familje të Minneapolis (korrespondencë e RRGK-së me ICITAP, 10 maj 2012).

⁷ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

⁸ Paga mesatare mujore është €300, që i bie €3,600 në vit, shumëzuar me 93 punëtorë.

⁹ Gjithsej stacionet policore kanë 43 vetura, në të cilat shpenzohen €100 në muaj.

¹⁰ Policia e Kosovës nuk i ka regjistruar të gjitha rastet e reagimit, kështu që përqindja e rasteve të dhunës në familje nuk mund të kalkulohet. Një marrëveshje mirëkuptimi mes policisë dhe Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK) rregullon financimin e linjës telefonike; rrjedhimisht nuk ka mundur të kalkulohet buxheti përkatës.

¹¹ Në vitin 2011, UNDP WSSI ka siguruar 49 regjistruar digjitalë dhe kamera për DVIU-të (€5,660). OSBE gjithashtu ka siguruar kamera si donacion. Në vitet 2012-2013, UN Women planifikon t'ju sigurojë pajisje tjera teknike DVIU-ve në komunat e përzgjedhura nga UNKT (€20,000).

¹² Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

¹³ Paga mesatare mujore është €300, që i bie €3,600 në vit, shumëzuar me 93 punëtorë.

¹⁴ Gjithsej stacionet policore kanë 43 vetura, në të cilat shpenzohen €100 në muaj.

kohën që njësitë tjera të policisë e kalojnë në raste të dhunës në familje, furnizimet e zyrave, telefonat dhe pajisjet tjera; këto kosto nuk kanë mundur të ndahen nga linjat buxhetore të tjera të policisë.¹⁵ Donatorët dhe akterët tjerë kanë ofruar financime shtesë për të blerë pajisje të rëndësishme për punën e policisë.¹⁶

DVIU-të nuk kanë infrastrukturën e nevojshme për të zbatuar përgjegjësitë ligjore të tyre.¹⁷ "Ka probleme teknike," tha një zyrtar për RRGK. "Hetuesit ankohen se nuk kanë kompjuterë, nuk ka internet." Zakonisht një kompjuter përdoret nga pesë deri në tetë zyrtarë të policisë. Kjo shkakton vonesa në përpunimin e rasteve. Për më tepër, edhe ndalja e rrymës ka shkaktuar ndërprerje të intervistave. Pasi që sistemi kompjuterik nuk kishte arritur që të regjistrojë intervistat deri në fund, ato duhet të përsëriteshin. Kjo bën që resurset njerëzore të mos shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe që viktimat të duhet të rikujtojnë ngjarjet e dhimbshme nga disa herë. Investimet në sisteme përkrahëse (UPS) dhe invertorë të energjisë elektrike do të mund të kursenin kostot për burime njerëzore dhe të kontribuojnë në mirëqenien e viktimave. DVIU-të poashtu duhet të kenë dhoma intervistimi, kompjuterë, printerë me ngjyra, kamera dhe vetura në dispozicion. Përkundër kësaj, policia ka arritur të shpenzojë vetëm afërsisht gjysmën e buxhetit për investime kapitale të parapara për vitin 2011; përmirësimet në shpenzime do të mund tu siguronin zyrtarëve pajisje të mjaftueshme për ta kryer punën e tyre.¹⁸

Për më tepër, policia kishte shumë shpenzime të paparapara. Policia transporton punëtorët social apo MV-të, gjë që bën që ata të kenë shpenzime për punën e zyrtarëve, shfrytëzimin e veturave dhe derivatet. Pas linjë përkatëse buxhetore, policia ka raportuar se ka ndodhur të paguajë "nga xhepi i vet" për ushqim dhe rroba të viktimave. Komuna e Mitrovicës ka gjetur një zgjidhje *ad hoc*: komuna e ka kontraktuar një shitore afër stacionit të policisë për t'i ofruar ushqim dhe pije viktimave, dhe këtë e paguan përmes buxhetit komunal për subvencione. Një linjë buxhetore për asistencë emergjente do duhej të ndahej për ta adresuar këtë çështje në nivel kombëtar.

Trajnimi i zyrtarëve të policisë ofrohet si pjesë e trajnimit bazik të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.¹⁹ Trajnimi trajton rolet dhe përgjegjësitë e policisë lidhur me viktimat. Përveç kësaj zyrtarët e policisë kanë nga tetë orë trajnim mbi Procedurat Standarde Operative (PSO) të brendshme lidhur me dhunën në familje.²⁰ Brenda një viti Akademia ofron deri në gjashtë trajnime mbi dhunën në familje. Ky institucionalizim i trajnimeve do duhej të shërbejë si shembull pozitiv për institucionet tjera. Kostoja e trajnimeve, materialeve dhe fjetjes për njësi është parashikuar të jetë €8. Kostoja vjetore e trajnimeve për dhunën në familje është më e ulët se €22,160.²¹ Pasi që ka edhe shumë zyrtarë pa u trajnuar, kjo shumë duket të mos jetë e mjaftueshme.

¹⁵ Policia e Kosovës nuk i ka regjistruar të gjitha rastet e reagimit, kështu që përqindja e rasteve të dhunës në familje nuk mund të kalkullohet. Një marrëveshje mirëkuptimi mes policisë dhe Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK) rregullon financimin e linjës telefonike; rrjedhimisht nuk ka mundur të kalkullohet buxheti përkatës.

¹⁶ Në vitin 2011, UNDP WSSI ka siguruar 49 regjistruar digjitalë dhe kamera për DVIU-të (€5,660). OSBE gjithashtu ka siguruar kamera si donacion. Në vitet 2012-2013, UN Women planifikon t'ju sigurojë pajisje tjera teknike DVIU-ve në komunat e përzgjedhura nga UNKT (€20,000).

¹⁷ Eksperti i kësaj fushe i EULEX-it kishte bindjen se policia kishte burime të mjaftueshme për t'i përmbushur përgjegjësitë e veta. Megjithatë, rastet nganjëherë nuk ishin proceduar si duhet për shkak të mungesës së përkushtimit personal apo ngarkesës së punës, në veçanti brenda për brenda zyrës së prokurorëve (korrespondencë e RRGK-së, 3 maj 2012).

¹⁸ Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, *Raporti vjetor 2011*, faqet 28-29.

¹⁹ Gjatë trajnimit 20-javësh, 20 orë i kushtohen dhunës në familje.

²⁰ Në vitin 2012, ata kanë trajnuar 165 kandidatë. Megjithatë, parashikimi i kostove për këtë trajnim nuk është vënë në dispozicion (intervistë e RRGK-së me Zyrtarin e Trajnimeve, Policia e Kosovës, 2 shkurt 2012).

²¹ Në vitin 2011, janë trajnuar 70 zyrtarë policorë; trajnimi i tyre ka kushtuar €8 për person, gjithsej €560. Policia i ka paguar gjashtë trajnerë nga €300 në muaj (€21,600 në vit). Përqindja e kohës së kaluar në trajnime për dhunën në familje nuk ka mundur të kalkullohet. (intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e Akademisë së Sigurisë Publike në Kosovë, 23 shkurt 2012).

Edhe pse zyrtarët thanë se policia është e njoftuar me PSO-të dhe se trajnohet rregullisht, disa zyrtarë të DVIU-ve nuk kishin marrë pjesë në trajnimet lidhur me dhunën në familje që nga vitet 2002-2003. Atëbotë ende zbatoheshin Rregullorja e vjetër e UNMIK-ut. Të gjithë zyrtarët duhet të njohin ligjin e ri dhe PSO-të. Për shembull, një hetues kishte pyetur një viktimë të gjinisë femërore: "A mendon se ke gabuar diçka, që e ka shtyrë [burrin tuaj] që t'ju godasë? Ndoshta, nuk je pastruar apo larë si duhet?"²² Pyetjet e tilla demonstronë mungesë të njohurisë së dispozitave ligjore dhe tendencën për të fajësuar viktimat dhe sugjeron se ka nevojë për trajnime të mëtejme.

Përderisa pjesa më e madhe e planprogramit është institucionalizuar, policia ende varet në masë të gjerë nga fondet e donatorëve. Në vitin 2011, ICITAP-i zhvilloi një seancë dyditore për dhunën në familje, dhunimin dhe kundërvajtjet seksuale për 70 hetues dhe inspektorë, me shpenzime prej €359. Krahas kësaj, tri zyrtarë policore morën pjesë në një konferencë dhe trajnim për dhunën në familje, në Karolinën e Veriut, që u kushtoi €8,547. Për vitin 2012 donatorët kanë ndarë fonde edhe për disa programe tjera trajnime.²³

Policia duhet të monitorojë performansën e zyrtarëve në implementimin e PSO-ve, gjë që ndërthet shpenzime të tjera të pakalkuleshme. Gjithashtu, policia e EULEX-it monitoron rreth 450 raste të dhunës në familje për çdo vit.²⁴ Vetëm një monitor i EULEX-it (në nivel qendror) merret me rastet e dhunës në familje, nga rreth 1,400 zyrtarë të policisë ndërkombëtare në Kosovë.²⁵ Ky monitorues ka prioritet në mentorim, monitorim dhe këshillim të Shefit të DVIU-së.²⁶ EULEX-i nuk ka linjë buxhetore të ndarë për dhunën në familje, por e financon postin në fjalë.

Monitorimi nga RRGK sugjeron se policia demonstroi performansë më të mirë në mbrojtjen e viktimave të dhunës. Kjo mund t'i atribuohet disa faktorëve të ndryshëm: Ligji dhe PSO rregullojnë në detaje rolet dhe përgjegjësitë e tyre; ata kanë alokuar resurse njerëzore dhe financiare për adresimin e dhunës në familje; dhe ata kanë një nga sistemet më të kompletuara të ruajtjes së shënimeve.²⁷ Bazuar në shpenzimet e vitit 2011, çmimi për të gjitha shpenzimet policore në lidhje me dhunën në familje ka qenë së paku **€423,126**, përfshirë €408,560 nga qeveria e Kosovës dhe €14,566 nga donatorët.

Zyrtarët e Departamentit të Mjekësisë Ligjore: Sigurimi i Provave për Mbrojtje dhe Ndjekje Penale

MD mbikëqyr Departamentin e Mjekësisë Ligjore, me seli në Prishtinë.²⁸ Sektori i Ekzaminimit Klinik, parimisht përgjegjës për viktimat, do duhej të themelohet si pjesë e

²² Intervistë e RRGK-së me një hetues policor, mars 2012.

²³ Në vitet 2012-2013, *UN Women* planifikon përpilimin e dy planprogrameve për të trajnuar policinë dhe aktorë nga gjyqësori në komunat e përzgjedhura, me fonde të siguruar nga programi i UNKT i financuar nga finlandezët (€10,000). Trajnimi do të bazohet në kurset e mëhershme të ofruara nga UN Women (intervistë e RRGK-së, 23 mars 2012). Bazuar në analizën e nevojave (€5,036), *UNDP WSSI* do të trajnojë 250 zyrtarë të DVIU-ve dhe Njësive të Policisë në Komunitet gjatë vitit 2012 (€15,496). Gjithashtu, gjatë vitit 2012, OSBE do të ofrojë trajnime lidhur me dhunën në familje për punëtorët social, Policinë e Kosovës, MV-të dhe palët me interes.

²⁴ EULEX-i ka dhënë parashikimin mbi numrin e lëndëve në vit; EULEX-i gjendet në Kosovë që nga viti 2008. Rastet përzgjidhen për monitorim në bazë të "përdorimit të dhunës apo armëve, moshës së viktimës, rëndësisë së lëndimeve apo performansës së dobët nga Policia e Kosovës" (korrespondencë e RRGK-së me ekspertin e fushës pranë Policisë së EULEX-it, 3 maj 2012).

²⁵ Faqja e EULEX-it në internet, "Komponenti i Policisë së EULEX-it," në: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/police>.

²⁶ Korrespondencë e RRGK-së me ekspertin e fushës pranë Policisë së EULEX-it, 3 maj 2012.

²⁷ Rastet e raportuara kanë të bëjnë me dhunën në familje ndaj grave shqiptare të Kosovës nga zonat rurale të cilat janë të papunësuar dhe kanë vetëm arsim fillor. Përqindja e rasteve të dhunës në familje në çdo regjion është i ngjashëm proporcionalisht me popullatën në rajon, edhe pse Mitrovica, Prishtina dhe Gjlani kishin më shumë raporte të dhunës në familje (në krahasim me popullatën e tyre).

²⁸ Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, Nr. 03/L-137, 2009.

Divizionit të Mjekësisë Ligjore.²⁹ Ky divizion është përgjegjës për kryerjen e ekzaminimeve klinike të viktimave, dëshmitarëve dhe të dyshuarve për vepra penale kundër integritetit seksual të personave.³⁰ Ky divizion lëshon dokumente mjekësore për viktimat apo të dyshuarit. Ai poashtu grumbullon dhe ekzaminon dëshmitë nga viktimat, dëshmitarët dhe/ose të dyshuarit.

Shërbimi mjekoligjor do duhej të ketë procedura operative në pajtim me Ligjin për Mjekësinë Ligjore dhe rregulloret e brendshme (PSO) të lëshuara nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore.³¹ Megjithatë, këto ende nuk ekzistojnë. Ekzaminimet mjekoligjore mund të kryhen në bazë të kërkesës ligjore nga autoritetet hetuese dhe gjyqësore.³² Ekzaminimet mund të përfshijnë vlerësimin e nivelit të lëndimeve trupore, aftësinë e punës, gjendjen shëndetësore, moshës dhe identitetit. Ekspertët ekzaminojnë viktimat e dhunës seksuale dhe abuzimit të dyshuar të fëmijëve. Në raste të dhunës seksuale, viktimat i nënshtrohen testeve gjinekologjike, e më pas referohen për shërbime këshillimore. Departamenti gjithashtu mund të përcaktojë shkallën e traumës nga përdorimi i alkoolit, narkotikëve dhe lëndimeve të dyshuara joaksidentale.³³ Ekspertët mjekoligjorë duhet të sigurojnë konfidencialitet profesional dhe të përmbahen nga praktikat diskriminuese.³⁴ Pacienti duhet të informohet lidhur me ekzaminimin dhe të japë pëlqim me shkrim para kontrollit.³⁵ Nëse pacienti është i moshës së mitur, shërbimi mjekoligjor duhet të merr pëlqimin nga prindi apo përfaqësuesi ligjor.

Gjykatat mund të urdhërojnë kryerjen e testeve të ADN-së nga shërbimi mjekoligjor. Pasi që testimet e ADN-së nuk mund të kryhen në Kosovë, mostrat e gjakut dërgohen jashtë vendit. Aktualisht, viktimat apo kryerësit paguajnë për këto teste.³⁶ Megjithatë, nëse këto teste kanë të bëjnë me vepra penale, qeveria duhet të paguajë për to.³⁷ Departamenti i Mjekësisë Ligjore vazhdimisht ka kërkuar nga MD përkrahje në themelimin e një laboratorit për testime të ADN-së në Kosovë.

Vetëm Departamenti i Mjekësisë Ligjore dhe qendra spitalore e emergjencës kanë mandat ligjor për tu ofruar dëshmi gjykatave. Viktimat që pranojnë trajtim për lëndime që pretendohet të jenë shkaktuar si pasojë e dhunës në familje në klinika tjera publike apo private nuk mund t'i shfrytëzojnë raportet mjekësore nga to në gjykatë. Por, nuk kanë të gjitha viktimat qasje tek ky institucion. "Nganjëherë gratë thjeshtë nuk mund të shkojnë atje," tha një respondent.³⁸

Janë pesë doktorë të mjekësisë ligjore (katër në Prishtinë dhe një në Prizren) dhe dy infermiere mjekoligjore (€905,117).³⁹ Puna jashtë orarit të punës e ekzaminuesve mjekoligjorë dhe pjesëmarrja e tyre në seanca gjyqësore duhet të kompensohet financiarisht në pajtim me aktet nënligjore.⁴⁰ Megjithatë, ky kompensim nuk po ofrohet; MD duhet të

²⁹ Në vitin 2012 ata përgatisnin dizajnin organizativ dhe përshkrimet e vendeve të punës, të cilat duhet të funksionalizohen në vitin 2013 (korrespondencë e RRGK-së me Departamentin e Mjekësisë Ligjore, qershor 2012).

³⁰ *Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore*, neni 6, paragrafët 1.7, 1.8 dhe 1.9. Kjo parashihet në KPRK.

³¹ *Ligji për Mjekësinë Ligjore* (Nr. 03/L-187, 2010), nenet 1.1 dhe 13.

³² Më herët, kur Departamenti gjendej nën Ministrinë e Drejtësisë, ai pranonte raste të cilat vinin në mënyrë të pavarur nga gjykatat dhe të cilat paguanin në bazë të një çmimoreje të paracaktuar. Teknikisht, ky Departament ende mund të pranojë raste të cilat vijnë pa referim nga gjykata, por çmimet ende nuk janë caktuar me ligj (intervistë e RRGK-së me një zyrtar, korrik 2012).

³³ *Po aty*, neni 11.

³⁴ *Po aty*, neni 1.2.

³⁵ *Po aty*.

³⁶ Intervista të RRGK-së me Zyrtarët për Ndihmë Juridike, 2012.

³⁷ *Ligji për Mjekësinë Ligjore*, neni 11.

³⁸ Intervistë e RRGK-së me ekspertë, 9 mars 2012. Hulumtimi i RRGK-së ka treguar se gratë që përjetojnë dhunë shpesh nuk lejohen të vizitojnë doktorët fare (*Hulumtim eksplorues mbi shtrirjen e dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe ndikimin e saj në shëndetin riprodhues të grave*, Prishtinë: RRGK, 2008).

³⁹ Korrespondencë e RRGK-së me përfaqësuesin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, qershor 2012.

⁴⁰ *Ligji i Kosovës për Mjekësinë Ligjore*, neni 14.2.

ndajë buxhet për këtë. Në vitin 2011, vetëm një nga 73 rastet e trajtuara ka qenë i ndërlidhur me dhunën në familje. Mesatarisht trajtimi i një rasti kishte kushtuar €12,399.

Edhe Policia e Kosovës ka Departamentin Mjekoligjor me Njësi Regjionale Mjekoligjore dhe ekipe mjekoligjore. Njësitë Regjionale Mjekoligjore hetojnë rastet e vrasjeve, vetëvrasjeve, vjedhjeve dhe rastet e dhunës. Ekipet komunale mjekoligjore hetojnë rastet më të lehta. Departamenti ka PSO, me të cilat rastet e dhunës në familje trajtohen si të gjitha rastet tjera. Shpenzimet lidhur me dhunën në familje nuk kanë mundur të ndahen nga buxheti i përgjithshëm.

Gjykatat: Mbrojtja e Viktimave, Ndjekja e Autorëve të Dhunës, Avancimi i Sigurisë

Urdhrat mbrojtës mund të përfshijnë masa për mbrojtjen e viktimave dhe avancimin e sigurisë së tyre. Gjykatat janë autoriteti kryesor përgjegjës për lëshimin e urdhrave mbrojtës kundër autorëve të dhunës në familje. Kërkesat për urdhra mbrojtës kryesisht paraqiten në gjykata komunale në procedurë civile. Edhe gjykatat e qarkut mund të lëshojnë urdhra mbrojtës nëse pranë këtyre gjykatave zhvillohet procedurë për kujdestari.⁴¹

Si një nga masat e lejuara, kompensimi i viktimave do duhej të konsiderohej edhe formë e sigurimit të drejtësisë edhe si masë ndëshkuese.⁴² Shtetet janë përgjegjëse për tu siguruar viktimave masa legjislative dhe të tjera për të kërkuar kompensim nga autorët e dhunës.⁴³ Në rastet kur nuk ofrohen shërbime shëndetësore të financuara nga shteti, nuk duhet limituar kërkesat për kompensim të dëmeve përmes procedurës civile.⁴⁴ Në Kosovë, viktimat kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim dhe kompensim për dëmet e shkaktuara përmes procedurës civile, si dhe shërbime shëndetësore në llogari të shtetit.

Megjithatë, gjykatat nuk kanë ofruar çdo herë mbrojtje adekuate; ato kanë dështuar në lëshimin e Urdhrave të Mbrojtjes Emergjente në pajtime afatet kohore të përcaktuara në Ligj.⁴⁵ Në mars të vitit 2012, Këshilli Gjyqësor i Kosovës u konfrontua me gjykatat komunale për shkak të këtyre vonesave. Ai i inkurajonte këto të fundit që të implementojnë Ligjin në mënyrë rigorozë dhe të nxjerrin aktgjykimet e tyre me kohë, marrë parasysh urgjencën me të cilën këto raste duhet trajtuar.⁴⁶ Vendimi kërkon nga gjykatat që tu japin rasteve që përfshijnë akte të dhunës në familje prioritet, pa marrë parasysh numrin e madh të rasteve të pazgjdhura. Ky veprim paraqet një përmirësim në krahasim me Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Zvogëlimin e Numrit të Lëndëve të Pazgjdhura, e cila nuk i jepte prioritet rasteve të dhunës në familje.⁴⁷

Disa gjyqtarëve u mungon dijenia mbi Ligjin, gjë që viktimave ua mohon qasjen në mjet juridik.⁴⁸ Për shembull, gjykatat rrallë kërkojnë zbatimin e të gjitha masave në dispozicion.⁴⁹ Ligji parasheh se gjykatat mund ta urdhërojnë kryesin

"Ende ka gjyqtarë dhe prokurorë të cilët nuk e njohin mirë Ligjin për Dhunën në Familje. T'ju them të vërtetën, ende ka njerëz që nuk e dinë se çka është Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje."
- Përfaqësuesit UNDP

⁴¹ Ligji, neni 3.

⁴² Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, "Deklaratë mbi Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit të Autoritetit," A/RES/40/34, 29 nëntor 1985, paragrafi 12; dhe Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 2011, neni 30.

⁴³ Konventa e Këshillit të Evropës, 2011, neni 30.

⁴⁴ Konventa e Këshillit të Evropës, 2011, neni 30, paragrafi 2.

⁴⁵ Komiteti për Drejtë të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Raporti për Monitorimin e Implementimit të Ligjit për Mbrojtje Nga Dhuna në Familje të Kuvendit të Kosovës, 2012. Të gjeturat konfirmojnë hulumtimet e mëparshme të RRGK-së (*Më shumë se 'Fjalë në Letër'?*, 2008). Në anën tjetër monitorimi i EULEX-it sugjeron se "shumica e rasteve kryhen brenda kornizës kohore të paraparë me ligj. Disa nuk kryhen me kohë, por kjo më shumë ndodh për shkak të pakujdesisë dhe faktorëve të tjerë, e më pak për shkak të mungesës së resurseve" (korrespondencë me RRGK-në).

⁴⁶ KGJK, Vendimi Nr. 22/2012, vendim nga takimi i 58-të, mars 2012.

⁴⁷ Po aty dhe KGJK, Strategjia e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Zvogëlimin e Numrit të Lëndëve të Pazgjdhura, 11 nëntor 2010

⁴⁸ Intervistë e RRGK-së me gjyqtarë, mars-prill 2012.

⁴⁹ Shih RRGK, *Më shumë se 'fjalë në letër'?*, 2008.

që të paguajë alimentacionin për fëmijët dhe qiranë për viktimën për tërë kohëzgjatjen e urdhrat të mbrojtjes. Pasi që shumica e viktimave janë ekonomikisht të varura nga bashkëshortët e tyre apo nga familjet e ngushta, ato kanë mundësi të kufizuara të largimit nga shtëpitë ku kanë pësuar dhunë. Masat që shqiptohen nga gjykatat janë të rëndësishme për avancimin e sigurisë ekonomike të viktimave dhe aftësisë së tyre për të jetuar në mënyrë të pavarur. Megjithatë, RRGK nuk ka gjetur asnjë rast që këto masa të jenë zbatuar në Kosovë.⁵⁰ QPS-të dhe MV-të poashtu shpesh nuk kërkojnë pagimin e alimentacionit dhe qirasë gjatë paraqitjes së kërkesës për urdhër mbrojtës. Për këtë arsye, urdhrat e mbrojtjes shpesh përmbajnë vetëm masat që janë më të lehta të zbatohen, siç janë urdhrat të lëshuara ndaj kryesit të aktit të dhunës në familje për të mbajtur distancë në punë dhe shtëpi nga viktimat.

Gjykatat kanë urdhëruar edhe ndarjen e vendbanimit mes kryesit të dhunës dhe viktimës. Megjithatë, disa kanë kërkuar këtë masë pa e vlerësuar rrezikun potencial për viktimën. Një respondent nga EULEX-i komentoi:

Në rastet e dhunës në familje, sipas Ligjit, gjykata duhet ta urdhërojë kryesin që të largohet nga shtëpia dhe t'i paguajë alimentacionin fëmijëve. Nëse kjo ndodh, gruaja dhe fëmijët nuk do të kenë mjete për të mbijetuar sepse kryesi nuk paguan. Deri sa të iniciohet dhe kompletetohet procedura e ekzekutimit, viktimat nuk ka para. QPS ofron përkrahje, por këto para janë të pamjaftueshme për të siguruar jetë normale. Shpesh bashkëshortët e viktimave të dhunës në familje kanë edhe nga disa fëmijë nga martesat paraprake dhe largimi i kryesit (bashkëshortit) nga shtëpia nuk është zgjidhje e duhur. Në [një] rast kryesi e rrahu bashkëshorten e tij, duke shkelur kësisoj urdhrin mbrojtës. Gjykatësi lokal e arrestoi atë, por Gjykata e Qarkut duke vendosur pas ankesës e lirojë atë. Ai u kthye në shtëpi, plot mllef ndaj gruas së tij.⁵¹

Urdhrat mbrojtës janë të rëndësishëm për fuqizimin e viktimave të dhunës në familje, duke u ofruar atyre pavarësi ekonomike dhe liri nga dhuna. Gjykatat duhet të shfrytëzojnë këto masa të ofruara sipas Ligjit.⁵²

Një numër i vogël i gjykatave (p.sh. në Pejë dhe Prishtinë) kanë adresuar çështjen e vonesave dhe ekspertizës së pamjaftueshme në gjykimin e rasteve të dhunës në familje duke emëruar gjyqtarë të specializuar. Në Pejë, "niveli i lartë i ekspertizës" së dy gjykatësve ua bëri të mundshme që të nxjerrin aktgjykime me kohë dhe të "nxjerrin aktgjykime më të detajuara për të adresuar kompleksitetin e marrëdhënieve mes palëve, në vend se thjeshtë të thonë 'X nuk guxon t'i afrohet Y një muaj,'" raporton EULEX-i.⁵³ Caktimi i gjyqtarëve me përvojë që të merren ekskluzivisht me këto raste duket se paraqet një praktikë të mirë që vlen të shfrytëzohet edhe në komuna tjera.

Në raste penale, ndjekja efektive e autorëve i kontribuon mbrojtjes dhe sigurisë së personave që kanë pësuar nga dhuna në familje. KPRK shprehimisht parasheh ndjekjen penale

"Ka shumë raste të dhunës në familje të cilat referohen. Çdo ditë ne kemi një apo dy raste të dhunës në familje. Ne i procedojmë rastet e dhunës në familje me prioritet vetëm nëse kryesi ka dosje penale."

- Prokurori

(automatike) sipas detyrës zyrtare të veprave të kryera në marrëdhënie familjare. Ligji poashtu kërkon ndjekjen penale të shkeljes së urdhrave të mbrojtjes sipas detyrës zyrtare. Megjithatë, prokurorët vazhdojnë të përzgjedhin rastet që do t'i ndjekin penalisht në mënyrë selektive.⁵⁴ "Nëse ne prokurorë vlerësojnë se një vepër penale është e papranueshme, atëherë ne vendosim që ta trajtojmë atë rast," tha një prokuror i qarkut për RRGK. Ai tha

⁵⁰ Shih RRGK, *Më shumë se 'fjalë në letër'?*, 2008.

⁵¹ Korrespondencë e RRGK-së me EULEX-in, 4 maj 2012.

⁵² RRGK, *Më shumë se 'fjalë në letër'?*, 2008.

⁵³ Korrespondencë e RRGK-së me EULEX-in, 4 maj 2012.

⁵⁴ RRGK, *Më shumë se 'fjalë në letër'?*, 2008.

se ata i trajtojnë me prioritet rastet me rrezikshmëri të lartë apo rastet kur autorët kanë dosje penale.⁵⁵ Disa prokurorë arsyetonin dështimin e tyre për të ndjekur të gjitha veprat penale duke iu referuar numrit të pamjaftueshëm të prokurorëve dhe numrit të madh të lëndëve të pazgjdhura.

Mes komunave të studiuara nga RRGK, Gjilani kishte rezultatin më të mirë në caktimin e prioritetit për ndjekjen e rasteve të dhunës në familje. Sidoqoftë, edhe kjo komunë përballej me probleme të shumta. Për shembull, në këtë komunë kishte më pak prokurorë se sa gjyqtarë.

Përkundër kërkesës për të ndjekur të gjitha rastet penale sipas detyrës zyrtare, gjyqtarët dhe prokurorët i kishin pezulluar disa raste kur viktimat ishin tërhequr; ata poashtu vazhduan që rolin e tyre në raste të dhunës në familje ta konsiderojnë si pajtues.⁵⁶ Një prokuror komunal i tha RRGK-së:

"[Në] një rast të ndjeshëm, të recidivizmit të dhunës në familje vitin e kaluar, viktimja erdhi në polici dhe tha se atë burri i saj e dogji me ujë të valë. Më vonë, ajo e ndërroi deklaratën dhe tha se ajo u dogj aksidentalisht. Ajo kërkonte shkurorëzim. Ajo insistonte që seanca për shkurorëzim të mbahet në gjykatë menjëherë. Unë bashkëpunova me gjyqtarin për ta caktuar seancën... por, deri në kohën e seancës ajo tërhoqi kërkesën e saj për shkurorëzim."

– Mbrojtës i Viktimave

Ne nuk jemi të interesuar që të shkëpusim martesat për shkak se viktimja paska pësuar një shuplakë. Me një vendim të gabueshëm ne mund të shkatërrojmë një familje. Ne duhet të arsyetojmë përse po ia ndalojmë kryesit qëndrimin në skenën familjare. Nëse ka rrezikshmëri të lartë të rishfaqjes së dhunës në rast se ai qëndron në shtëpi, ne mund të kërkojmë edhe paraburgim për atë deri në 30 ditë. Zakonisht gjatë kësaj periudhe ne vërtetojmë faktet duke thirrur dëshmitarë. Nganjëherë viktimat tërheqin deklaratat e tyre fillestare dhe nuk duan të vazhdojnë ndjekjen penale. Edhe pse çiftet mund të pajtohen, kjo nuk e pengon gjykatën që të vendosë për rastin në fjalë... zakonisht dënimet jepen me kusht [jo me burgim].

Sipas Ligjit për Familjen në Kosovë, gjyqtarët dhe prokurorët shpesh punojnë së bashku për të kryer rastet me marrëveshje ligjore mes bashkëshortëve.⁵⁷ Megjithatë, **Ligji për Familjen shprehimisht rregullon se çdo keqtrajtim apo dhunë ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve duhet të konsiderohet si faktor përjashtues për pajtim.**⁵⁸ Sipas vrojtimeve të EULEX-it, pajtimi "mund të ketë ndikime serioze negative, siç është kthimi i viktimës prapa në mjedise ku mund të jenë në rrezik. Kjo edhe më tej i pakëson gjasat që viktimja të denoncojë dhunën."⁵⁹ Zyra e Prokurorit të

"Një grua ishte rrahur gati deri në vdekje, ndërsa gjyqtari vazhdonte të përpiqej ta bindë që të bashkohet me bashkëshortin e saj. Gjyqtari thoshte "E kemi obligim ligjor që të përpiqemi t'i pajtojmë familjet."

– Ekspert

Shtetit do duhej të kërkojë ndjekje efektive penale të të gjitha rasteve. Pakësimi i pasojave të dhunës në familje duke analizuar dëmet e shkaktuara viktimave përbën shkelje të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.⁶⁰

Gjykatat poashtu vazhdojnë të dështojnë në sigurimin e mbrojtjes në rastet kur dhuna në familje rezulton me veprën penale të lëndimit të lehtë trupor.⁶¹ EULEX raportoi:

⁵⁵ Intervistë e RRGK-së me Prokurorin e Qarkut, 5 mars 2012.

⁵⁶ *Më shumë se 'fjalë në letër'?*, dhe monitorimi i EULEX-it (korrespondencë e RRGK-së, 4 maj 2012). Në lidhje me gjyqtarët, shih gjithashtu, Misioni OSBE-së në Kosovë, *Shqyrtimi i Kërkesave për Urdhra të Mbrojtjes për Raste të Dhunës në Familje në Kosovë*, 2012, f. 20-22

⁵⁷ *Ligji i Kosovës për Familjen*. Nr. 2004/32, 2006, neni 77. Intervista të RRGK-së me gjykatën komunale dhe trajnerin e IGJK-së, 2012.

⁵⁸ *Ligji i Kosovës për Familje*, neni 59, paragrafi. 4.

⁵⁹ Korrespondencë e EULEX-it me RRGK-në, 4 maj 2012.

⁶⁰ Konventa e Këshillit të Evropës kërkon nga shtetet që "të sigurojnë hetim efektiv dhe ndjekje penale të shkeljeve" (kapitulli VI). Shih kapitullin 1 për të kuptuar pse kjo është relevante për Kosovën.

Gjykatat kanë tendencë të shqiptojnë dënime shumë të lehta, shpesh duke mos marrë parasysh rrethanat rënduese – faktin se akti ka ndodhur brenda marrëdhënies familjare. Dëgjimet shpesh shtyhen dhe ekziston një sistem në përgjithësi pasiv i menaxhimit të lëndëve që nuk i përshtatet natyrës urgjente të rasteve të tilla. Për më tepër, probleme janë vërejtur edhe në mënyrën e zhvillimit të procedurës së paraqitjes së provave, e cila shpesh zhvillohet në mënyrë sipërfaqësore. Kjo ndikon negativisht në vendimet për rastin, dhe është tejet brengosëse posaçërisht për rastet e dhunës në familje.⁶²

Gjyqtarët e EULEX-it poashtu kanë vërejtur se gjykatat lokale përballen me një ngarkesë të madhe të lëndëve dhe nuk kanë resurse të mjaftueshme, përfshirë hapësirat adekuate për tu ofruar palëve mbrojtje kur kjo është e domosdoshme. Kjo është në veçanti e vërtetë për Mitrovicën; dy gjykatat përkatëse nuk funksionojnë në atë godinë. Rrjedhimisht, gjykatat komunale të Vushtrrisë dhe Mitrovicës dhe gjykata e qarkut e Mitrovicës punojnë në të njëjtën ndërtesë. Gjyqtarët shfrytëzojnë të njëjtat zyra dhe kryejnë funksionet e tyre si gjyqtarë vetëm në ditë të caktuara të javës. Kjo zvogëlon numrin e rasteve që mund të dëgjohen dhe vendosen, duke ngadalësuar kështu reagimin e nivelit të qarkut në rastet e dhunës në familje. Situata e rëndë e ka shtyrë EULEX-in që të shfrytëzojë kompetencat ekzekutive, për të marrë përsipër pesë raste të dhunës në familje.⁶³

"Ndërtesa ka mbetur në Mitrovicën Veriore. Ne kemi vetëm një zyrë prej 12 metrash katror ku punojnë gjashtë punonjës. Janë vetëm dy prokurorë: kryeprokurori dhe unë. Kjo sfidë logjistike na e pamundëson trajtimin e rasteve. Kur duhet të intervistojmë palët, punëtorët tjerë duhet ta lirojnë zyrën. [Ne poashtu kemi] raste nga para vitit 2008 që janë mbetur në zyrën në Mitrovicën e Veriut."

- Prokuror

Në Dragash poashtu kanë pasur mangësi në qasjen në drejtësi për shkak të lokacionit gjeografik të komunës, e cila gjendet larg prokurorëve dhe gjykatave. Asnjë institucion nuk ka pasur mandat të qartë për të mbuluar koston e transportit të viktimave në komunën më të afërt (në Prizren) për të marrë pjesë në seancat gjyqësore. Edhe Prizreni kishte mungesë të resurseve dhe stabilimenteve përkatëse.⁶⁴

Sigurimi i trajnimeve adekuate mbi legjislacionin për dhunën në familje për prokurorë dhe gjyqtarë, siç parashihet me Strategji, ngërthen edhe shpenzime.⁶⁵ IGJK ofron trajnime *ad hoc* për prokurorë, gjyqtarë dhe MV, por ato nuk janë të obligueshme dhe zakonisht zhvillohen vetëm dy herë në vit.⁶⁶ Në vitin 2011, IGJK ka shpenzuar €180 në trajnime lidhur me dhunën në familje.⁶⁷ CLARD ka organizuar dy trajnime për 28 gjyqtarë dhe dy persona të tjerë mbi standardet ndërkombëtare lidhur me luftën kundër dhunës në familje (€2,500). Përveç kësaj, UN Women ka trajnuar 35 trajnerë në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave njerëzore të grave sipas legjislacionit ndërkombëtar, përfshirë dhunën në familje. Më pas 18 prej tyre mbajtën trajnime në pesë regjione të Kosovës (€17,000).⁶⁸

Në vitet 2012-2013, UN Women planifikon të përkrahë IGJK-në në përgatitjen e trajnimeve të avancuara për gjyqtarë në fushën e dhunës në familje, të drejtave pronësore

⁶¹ Shih RRGK, *Më shumë se "fjalë në letër"? 2008.*

⁶² Korrespondencë e RRGK-së me EULEX-in, 4 maj 2012.

⁶³ Korrespondencë e RRGK-së me EULEX-in, 4 maj 2012.

⁶⁴ *Po aty.*

⁶⁵ Strategjia, O.S. 2.1.

⁶⁶ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të IGJK-së, 7 shkurt 2012.

⁶⁷ Korrespondencë e RRGK-së me përfaqësues të IGJK-së, 3 prill dhe 5 qershor 2012. IGJK i ka trajnuar 20 gjyqtarë, asnjë prokuror dhe gjashtë persona të tjerë (përfshirë MV-të).

⁶⁸ Trajnime u ofruan tetë ditë, katër në vitin 2010 dhe katër në vitin 2011 (intervistë e RRGK-së me UN Women, 16 maj 2012.) Këto përfshijnë koston për publikimin e katalogut të përmendur në kapitullin 3.

dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e grave.⁶⁹ Zakonisht planprogramet që përkrahen nga UN Women inkorporohen në planprogramin e rregullt të IGJK-së për gjyqtarë të rinj, ndërsa këta gjyqtarë më tej trajtojnë gjyqtarë e prokurorë anëmbanë Kosovës (€13,000). Në vitin 2012, UNDP WSSI gjithashtu planifikon trajnimin e 30 gjyqtarëve, 30 prokurorëve dhe 40 MV-ve për Ligjin (€9,685). Krahas kësaj, PILPG ka shqyrtuar ofrimin e inputeve të veta në programin e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për specializim në dhunën në familje.⁷⁰ Në të ardhmen, gjyqtarët dhe prokurorët mund të përfitojnë nga trajnimet specifike mbi procedurat e trajtimit të dhunës në familje mbi fëmijët.⁷¹ IGJK do duhej të institucionalizojë trajnimet e obligueshme dhe të mëtojë të minimizojë varësinë nga fondet e donatorëve.

Zyra e Prokurorit të Shtetit ndau €4,500 për të gjitha trajnimet. Megjithatë në disa zona prokurorët nuk janë trajnuar fare sa i përket dhunë në familje dhe kishin tendencë që këtë ta konsideronin çështje private.⁷² Cilësia e trajnimeve mbase ka nevojë që të rishikohet. Disa trajnerë mund ta konfirmojnë se nuk mund të mohohet se ka tendenca që të fajësohet viktimat. Një trajner i tha RRGK-së:

Nëse burri pi dhe e rreh gruan çdo ditë, është e sigurt se dhunën po e shkakton pirja e alkoolit. Por, nëse gruaja dëshiron ta vizitojë familjen e saj dhe burri e refuzon këtë sepse është i lodhur nga puna, e gruaja vazhdon të insistojë deri sa ky ta godasë... edhe në këtë rast duhet të fajësohet gruaja sepse ajo e ka provokuar dhunën. Unë nuk e fajësoj viktimën, por ndonjëherë viktimat vetë provokon.

Presioni i tepërt mund të konsiderohet dhunë psikologjike, por ai nuk i jep të drejtë burrit që të shfrytëzojë dhunë. Trajnimet e pamjaftueshme mund të jenë një nga faktorët që i kontribuojnë performansës së dobët të prokurorit publik dhe gjyqtarëve, të cilën e ka vërejtur RRGK.

Monitorimi i reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje bie nën përgjegjësinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për të monitoruar performansën e përgjithshme të gjykatave; për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave; dhe për të pasqyruar standardet e barazisë gjinore.⁷³ Ishte e paqartë nëse KGJK ka resurse të mjaftueshme për monitorim, megjithëse cilësia e monitorimit duket të jetë e pamjaftueshme nëse kemi parasysh shkeljet e lartpërmendura ligjore nga gjyqtarët.

Sa i përket grumbullimit të të dhënave, KGJK i regjistron rastet në regjistra sipas kodit penal ose civil. Dhuna në familje nuk listohet si vepër e veçantë penale, por KGJK i regjistron aktet e lëndimit të lehtë trupor të cilat rezultojnë në marrëdhëniet familjare. Krimet tjera që ndodhin brenda marrëdhënies familjare nuk regjistrohen si kështu. Gjykatat individuale i regjistrojnë të dhënat mbi autorët e veprave (jo viktimat) në regjistra të shtypur.⁷⁴ Duke qenë se nuk ekziston një bazë qendrore dhe digjitale e të dhënave, për tu ditur numri i rasteve të dhunës në familje që janë trajtuar në procedura civile do duhej që një punonjës t'i kontrollojë të gjithë regjistrat fizikë. Informata të tilla kurrë nuk janë kërkuar apo regjistruar në raportet e KGJK-së.

KGJK menaxhon buxhetin e të gjitha gjykatave. Kostoja mesatare për lëndë është afërsisht €181, ndërsa shpenzimet e gjykatave që ndërlidhen me dhunën në familje arrijnë afërsisht **€104,618** në vit.⁷⁵ Kjo shifër nuk merr në konsideratë nëse rastet e dhunës në

⁶⁹ Intervistë e RRGK-së me UN Women, 23 mars 2012.

⁷⁰ Intervistë e RRGK-së me PILPG, 12 mars 2012.

⁷¹ Intervistë e RRGK-së me UNICEF, 8 mars 2012.

⁷² Intervista të RRGK-së me prokurorë, 2012.

⁷³ *Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës*, nenet 1 dhe 3.

⁷⁴ Intervista të RRGK-së me gjyqtarë, 2012.

⁷⁵ Buxheti total i KGJK-së për vitin 2011 prej 17 milionë euro, i mbulon të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me gjykatat. Gjykatat për Kundërvajtje, me buxhet prej 2 milionë euro, nuk trajtojnë çështje që lidhen me dhunën në familje. Ato trajtohen në gjykata komunale dhe të qarkut, që ndajnë buxhetin e mbetur prej 15 milionë euro.

familje marrin më shumë apo më pak kohë se sa rastet tjera, apo nëse për to nevojiten më pak apo më shumë resurse. Buxheti duket të jetë i pamjaftueshëm, marrë parasysh se gjykatat kanë mungesë të hapësirave të punës, burimeve njerëzore, ekspertizës dhe pajisjeve për të kryer përgjegjësitë ligjore të tyre.

Ngjashëm me KGJK-në, Zyra e Prokurorit të Shtetit menaxhon buxhetin për të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me prokuroritë nga niveli qendror. Kostoja mesatare për rast është rreth €74, dhe rreth **€38,012** janë shpenzuar në ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje gjatë vitit 2011.⁷⁶ Edhe në këtë rast, lëndët e dhunës në familje do të mund të kushtonin më shumë ose më pak se lëndët tjera. Ndjekja efektive penale kërkon më shumë resurse nga policia, QPS-të, Zyrat për Ndhimë Juridike dhe MV-të, të cilat mund të marrin pjesë në procedurat gjyqësore. Ngjashëm me gjykatat, prokuroritë kishin resurse të pamjaftueshme për të realizuar mandatin e tyre ligjor. Sfidë kyçe është numri i pamjaftueshëm i prokurorëve, gjë që ka bërë të pamundur delegimin e prokurorëve të caktuar për tu marrë vetëm me rastet e dhunës në familje.⁷⁷ Prokurorët gjithashtu kanë kufizime sa i përket pajisjeve teknike dhe hapësirave për zyra.

Edhe institucione tjera shfrytëzojnë resurset e tyre duke punuar në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjes. Institucioni i Ombudspersonit monitoron rastet e dhunës në familje në gjykata dhe mbron të drejtat e viktimave. Këtu përfshihet nxjerrja e urdhrave mbrojtës dhe ndjekja penale sipas detyrës zyrtare. Institucioni i Ombudspersoni kryesisht ka monitoruar rastet kur gjykatat e kanë tejkaluar afatin kohor për lëshimin e urdhrave mbrojtës.⁷⁸ Buxheti i Institucionit të Ombudspersonit vjen direkt nga Buxheti i Kosovës. Atje nuk ka punëtorë që punojnë specifikisht në raste të dhunës në familje; stafi i pamjaftueshëm do të thotë se ata nuk mund të specializojnë në këtë lëmi. "Ne aktualisht jemi të kufizuar sepse kemi vetëm dhjetë punonjës dhe nuk mund ta rrisim këtë numër," një respondent na tha. "Një punëtor i yni ka ngarkesë pune sa për dy apo tre punonjës gjatë." ⁷⁹

OSBE monitoron sistemin gjyqësor të Kosovës për të qenë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Bazuar në monitorimin e kryer, OSBE ka nxjerrë më 29 qershor të vitit 2011 *Raportin Reagues: Urdhrat e Mbrojtjes Emergjente në Raste të Dhunës në Familje*, dhe më 6 mars 2012 *Raportin për Shqyrtimin e Kërkesave për Urdhra Mbrojtës në Rastet e Dhunës në Familje në Kosovë*. Kostoja e këtij monitorimi nuk ka mundur të përcaktohet.

Edhe Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it ka mandat "mentorimin, monitorimin dhe këshillimin" dhe "përmirësimin dhe fuqizimin e gjyqësisë së Kosovës për ta bërë atë tërësisht multietnike, të paanshme, të pandikuar politikisht dhe të aftë për të mbajtur gjykime të drejta, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira evropiane."⁸⁰ Në përgjithësi, EULEX-i ka monitoruar së paku 114 raste lidhur me dhunën në familje, edhe pse

Në vitin 2011, ato kanë zgjidhur 82,802 raste (disa raste kalojnë në vitin vijues dhe ngërthejnë shpenzime shtesë); 15 milionë euro pjesëtuar me 82,802 raste baras me €181 për rast. Në vitin 2011, KGJK ka harruar që t'i regjistrojë rastet e dhunës në familje, kështu që shuma praj €181 u shumëzua me 578 raste të dhunës në familje të vitit 2010 (intervista e RRGK-së me zyrtarin financiar të KGJK-së, 2012) IGJK ka mbuluar shpenzimet tjera që ndërlidhen me trajnimet.

⁷⁶ Buxheti i gjithmbarshëm në vitin 2011 ishte €3,893,926. Prokurorët i kanë zgjidhur 52,757 raste atë vit, përfshirë 515 raste të dhunës në familje. Zyra për Statistika i Shërbimit Prokurorial grumbullon dhe regjistron informatat përkatëse.

⁷⁷ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, 3 prill 2012. Kosova kishte rreth 95 prokurorë, ndërsa pritej që ky numër të arrij në 114 deri në fund të qershorit 2012.

⁷⁸ Intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e Institucionit të Ombudspersonit, 31 janar 2012.

⁷⁹ *Po aty*. Ata nuk ishin në gjendje ta tregojnë numrin e rasteve të asistuara gjatë vitit 2011, kështu që RRGK nuk ishte në gjendje të vlerësojë buxhetin e tyre lidhur me rastet e dhunës në familje.

⁸⁰ Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it ka rreth 420 punonjës, përfshirë rreth 70 që punojnë në sistemin e burgjeve, mbi 50 gjyqtarë dhe rreth 30 prokurorë (faqja e EULEX-it në internet, "Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it," në adresën: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/justice/>, vizituar më 22 korrik 2012).

numri i saktë vështirë se mund të përcaktohet. Buxheti i EULEX-it për të monitoruar rastet e dhunës në familje nuk është bërë i ditur.

Si përmbledhje, vendimet gjyqësore për urdhra mbrojtës në raste civile dhe ndjekje penale sipas detyrës zyrtare duhet të merren në kohë të duhur, sepse ata janë kyçe për t'i mbrojtur viktimat nga krimet e mëtejme. Sidoqoftë, të drejtat e viktimave vazhdojnë të shkelen edhe nga prokurorët edhe nga gjyqtarët. Mungesat e resurseve, do të thotë numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjykatoreve, ka ndikuar në shtimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura. Trajnimet joadekuate, të cilat kanë edhe implikacione financiare, potencialisht kanë mundur t'i kontribuojnë performancës së dobët të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Është i nevojshëm edhe menaxhimi më i mirë i të dhënave elektronike; kjo do të mund të ndihmonte përpjekjet për të përcaktuar koston e veprimtarive të ndryshme dhe do të sillte përmirësime në planifikimin buxhetor.

Mbrojtësit e Viktimave: në Mbrojtje të të Drejtave

Që nga viti 2002 Kosova ka një Njësi për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, në të cilën angazhim gjejnë mbrojtësit e viktimave (MV) dhe e cila fillimisht ka ekzistuar nën strukturat e UNMIK-ut.⁸¹ Në vitin 2003, MV-të janë përfshirë në Kodin e Procedurës Penale në Kosovë, si përfaqësues të autorizuar të palëve të dëmtuara.⁸² Në vitin 2005, MV-të u bartën nën menaxhimin e MD-së dhe u riemëruan si Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (DMNV). Roli i tyre është që të mbrojnë dhe përfaqësojnë të drejtat e viktimave të krimit, përfshirë viktimat e dhunës në baza gjinore, para dhe gjatë gjykimeve. Ata janë poashtu përfaqësues të autorizuar të viktimave në kontaktin e tyre të parë me institucionet si QPS-të apo policia dhe mund të kërkojnë urdhra mbrojtës.⁸³

Në shtator të vitit 2011, MD nënshkroi një marrëveshje mirëkuptimi (MM) për t'i bartur të gjitha përgjegjësitë e MV-ve tek Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe për të themeluar Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV) pranë këtij institucioni.⁸⁴ ZMNV duhet të zbatojë mandatin e MV-ve sipas Kodit të Procedurës Penale. Ky transfer poashtu do të ndihmojë në përmbushjen e mandatit të Prokurorit të Shtetit, të cilin ia jep Ligji i ri për Prokurorin e Shtetit të Kosovës, që do të hyjë në fuqi në janar të vitit 2013.⁸⁵ Ky ligj kërkon nga Prokurori i Shtetit që të sigurohet se të drejtat ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshuarve dhe të pandehurve do të mbrohen gjatë fazës së punës prokuroriale. Megjithatë, MM e re atyre ua bartë vetëm rolet dhe përgjegjësitë që ndërliken me viktimat e trafikimit. Kjo MV-ve ua ndalon përfaqësimin dhe mbrojtjen e viktimave të krimeve tjera, përfshirë këtu dhunën në familje, dhe do duhej të ndryshohet nga MD dhe Prokurori i Shtetit për të siguruar pajtueshmëri me rolet dhe përgjegjësitë që MV-të parashihet të kenë sipas Kodit të Procedurës Penale. Roli i shtuar i Prokurorit të Shtetit në mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe palëve të tjera në procedurë penale do duhej të pasqyrohen në Strategji.⁸⁶

MD vazhdon të mbulojë pagat dhe kostot administrative të tjera të MV-ve.⁸⁷ Në qershor të vitit 2012, Prokurori i Shtetit do duhej të merr përsipër këtë përgjegjësi, dhe kjo

⁸¹ RRGK, *Më shumë se "fjalë në letër"?*, 2008.

⁸² Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, neni 81, paragrafi 4.

⁸³ Sipas Ligjit, neni 24, paragrafi 3.3, policia e informon viktimën për të drejtat ligjore të saj, përfshirë edhe shërbimet e ofruara nga agjencitë qeveritare, siç janë edhe MV-të. Një respondent rekomandoi qartësimin e rolit dhe përgjegjësi të MV-ve përmes akteve nënligjore. PSO-të e rekomanduara për dhunën në familje do të mund të rregullonin rolin, përgjegjësitë dhe koordinimin e tyre.

⁸⁴ MM dhe korrespondencë e RRGK-së, 24 shkurt 2012. MM tjetër ia transferoi MPMS-së strehimoren e vetme të menaxhuar nga shteti, Strehimoren e Përkohshme të Sigurt për viktimat të trafikimit.

⁸⁵ *Ligji i Kosovës për Prokurorin e Shtetit*, Nr. 03/L –225, 2010, neni 7, paragrafi 1.5. Gjithashtu, sipas nenit 8, Prokurori i Shtetit do duhej të ofrojë aktivitete parandaluese në bashkëpunim me institucionet tjera shtetërore dhe organizatat publike e private, për ta edukuar shoqërinë mbi ligjin dhe parandalimin e krimeve.

⁸⁶ Sipas *Ligjit të Kosovës për Prokurorin e Shtetit*, Prokurori i Shtetit duhet të sigurojë mbrojtje të të drejtave ligjore të viktimave dhe palëve tjera (neni 7, paragrafi 1.5).

⁸⁷ Intervistë e RRGK-së me MV, 16 janar 2012.

do duhej të pasqyrohet edhe si një linjë e ndarë buxhetore në Buxhetin e Kosovës.⁸⁸ Konfuzioni që përcolli këtë proces dhe zyrtarët përkatës kanë shprehur frustrim me faktin se "marrëveshjet duket të jenë hartuar në mënyrë të pakuptimtë. Nuk janë specifikuar si duhet as buxheti e as mandati."⁸⁹ Për vitin 2011, buxheti për të gjitha aktivitetet e MV-ve, përfshirë dhunën në familje dhe trafikimin, arrinte përafërsisht shifrën prej **€143,103**, që i bie mesatarisht €161 për rast.⁹⁰

Për momentin ekzistojnë 20 MV.⁹¹ Nuk janë të mbuluara të gjitha komunat; institucioni nuk besonte se ZMNV ka mungesë stafi, megjithëse MV-të ankoheshin se kanë tejngarkesë pune. MV-të poashtu raportuan se janë të rrezikuar nga autorët e veprave: "Unë u sulmova nga një autor i krimit, i cili kishte abuzuar seksualisht bashkëshorten e tij, pasi që u lëshua nga burgu shtatë vite pasi që rasti ishte mbyllur." MV-të përballen me situata të rrezikshme, nga të cilat ata duhet të mbrojnë jo vetëm viktimat por edhe veten e tyre. Megjithatë, as rreziku fizik e as puna jashtë orarit "sipas nevojës" nuk pasqyrohen si duhet në pagën e tyre (€304 në muaj). Kjo paraqet shkelje të Ligjit të Punës në Kosovë, i cili rregullon se puna jashtë orarit duhet të kompensohet.⁹² Më tej, ngjashëm si policia, MV-të kanë raportuar se ndodh të shpenzojnë paratë e tyre për tu ndihmuar viktimat, pasi që nuk ekzistojnë linja buxhetore.

"Ka raste kur iu ofroj viktimave ushqim dhe kafe nga buxheti im personal. Kam pasur një rast kur i kam ofruar zyrën viktimës për të qëndruar me orë të tëra." - MV

MV-të kanë telefona mobilë dhe vetura për tu siguruar viktimave transport tek vendet ku u ofrohet ndihma. Megjithatë, buxheti i limituar nënkupton se ata detyrohen të shfrytëzojnë vetura të vjetruara.⁹³ Gjatë këtij hulumtimi, vetura për regjionin e Mitrovicës ishte në riparim. Kjo ia pamundësonte MV-së pjesëmarrjen në procedura dhe shkaktonte vonesa. Edhe pse MV do të mund të shfrytëzonte transportin publik apo veturën personale, këto lloj shpenzimesh nuk mund të rimbursohen nga institucioni. Transporti ishte poashtu problem në Dragash, kështu që MV komunikimet dhe këshillimet i kryente me telefon, gjë që sigurisht ndikon në cilësinë e shërbimeve të ofruara.⁹⁴

Koordinimi mes institucioneve potencialisht kontribuon në shfrytëzimin efikas të resurseve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, edhe pse koordinimi dallonte shumë nga komuna në komunë. Për shembull, në Mitrovicë MV dhe DVIU gjenden brenda stacionit policor, gjë që u lehtëson komunikimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të resurseve. Në Gjilan, MV gjendet në strehimore, gjë që poashtu kontribuon në koordinim. Në anën tjetër, Dragashi ka probleme me koordinim pasi që MV gjendet larg (në Prizren). Shfrytëzimi i përbashkët i zyrave mund të mundësojë reagim më të shpejtë dhe t'i kursejë shtetit resurse.

Në përgjithësi duket sikur buxheti i MV-ve për t'i realizuar përgjegjësitë e tyre është i pamjaftueshëm. MV-të thanë se kanë mungesë të stafit, hapësirave të punës, shtypësve, resurseve për të plotësuar nevojat emergjente të viktimave, veturave, derivateve dhe shpenzimeve për mirëmbajtje.⁹⁵ Pasiguria nga autorët e krimeve, pagat e ulëta dhe

⁸⁸ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, 3 prill 2012.

⁸⁹ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të MV-ve, 16 janar 2012.

⁹⁰ Kjo përfshin të gjitha shpenzimet për MV-të, por nuk përfshin grantet e ofruara për strehimore. MV-të nuk i kanë ndihmuar vetëm viktimat e dhunës në familje, por ato përbënin numrin më të madh të rasteve të trajtuara nga ta.

⁹¹ Ekzistojnë 14 zyra rajonale të MV-ve dhe një zyrë e linjës së hapur. Mes punonjësve përfshihet edhe menaxheri për hartimin dhe implementimin e politikave të mbrojtjes së viktimave; koordinatori që mbikëqyr punën e MV-ve; një zyrtar operativ që gjithashtu menaxhon buxhetin; një asistent administrativ i menaxherit; dhe 20 MV, përfshirë tre që punojnë në linjën e hapur. Menaxheri mban regjistrin e rasteve të asistuar.

⁹² *Ligji i Punës në Kosovë*, Nr. 3/L – 212, nenet 23 dhe 56.

⁹³ ZMNV ka shtatë vetura dhe ka kërkuar dy vetura tjera, por Departamenti për Buxhet dhe Financa i MD-së e ka refuzuar këtë kërkesë. Veturat aktuale janë blerë në vitin 2003. Sipas rregullave kontabile, ato është dashur të zhvlerësohen tërësisht dhe të hiqen nga përdorimi pas vitit 2010.

⁹⁴ Të gjithë MV-të kanë telefona mobilë dhe marrin mbushje prej €10 në muaj. Nga një tjetër telefon emergjent përdoret në rotacion nga MV-të e secilit regjion, me €10 mbushje shtesë.

⁹⁵ Intervistë e RRGK-së me Udhëheqësin e Trajnimit për MV-të, Zyra e Prokurorit të Shtetit, 3 prill 2012.

mospagimi i punës jashtë orarit bëjnë që stafi të ndërrohet shpesh. Si rezultat i kësaj, nevojiten burime njerëzore dhe financiare shtesë për të trajnuar stafin e ri.

MV-të trajnohen në vend të punës për tre muaj dhe më pas punojnë për gjashtë muaj nën mbikëqyrjen e kolegëve të tyre. MV-të kanë diploma universitare në drejtësi dhe kanë kryer trajnime për dhunën në familje. Megjithatë, MV-të shpesh nuk kanë njohuri dhe/ose tejkalojnë rolin dhe përgjegjësitë e tyre.⁹⁶ EULEX-i ka raportuar se MV-të "nuk demonstrojnë gjithmonë nivel profesional adekuat dhe nuk janë në gjendje t'i mbrojnë të drejtat e viktimave."⁹⁷

Pas kalimit të MV-ve tek Prokurori i Shtetit, nuk janë zhvilluar trajnime për dhunën në familje. MV-të kanë mirëpritur trajnimet shtesë mbi rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Në vitin 2012, OSBE do t'i trajnojë të gjithë MV-të për rolin e tyre në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. OPDAT poashtu ka planifikuar që të ofrojë "ekspertizë dhe trajnime për MV-të lidhur me masat ligjore dhe psikologjike për të përkrahur viktimat e dhunës në baza gjinore," megjithëse afati kohor dhe financimi i këtij aktiviteti ende nuk janë përcaktuar.⁹⁸

Komisioni për Ndhimë Juridike: Mbrojtja e Viktimave, Mundësimi i Ndjekjes Penale

Në shkurt të vitit 2012, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin e ri për Ndhimë Juridike Falas pa Pagesë, i cili kryesisht bazohet në Rregulloren e UNMIK-ut.⁹⁹ Këshilli për Ndhimë Juridike Falas përcakton standardet dhe rregullat dhe procedurat për ofrimin e ndihmës.¹⁰⁰ Ai gjithashtu mbikëqyr punën e Agjencisë për Ndhimë Juridike pa Pagesë.¹⁰¹ Dhjetë Zyra për Ndhimë Juridike (ZNJ) ofrojnë përfaqësim juridik pa pagesë dhe sigurojnë përfaqësim të barabartë për grupet e cenushme.¹⁰² Komisioni ka 21 punonjës të cilët hartojnë dhe shpërndajnë broshura mbi dhunën në familje dhe ndihmën shtetërore për viktimat. Komisioni punëson avokatë nga Oda e Avokatëve e Kosovës dhe i paguan për çdo rast.¹⁰³ Nëse rastet kërkojnë përfaqësim në gjykata, ndihma juridike i mbulon edhe tarifat gjyqësore. Viktimat e dhunës kualifikohen për procedura më të lehta të aplikimit për ndihmë juridike.¹⁰⁴ Për të dëshmuar statusin e viktimës, mjafton një deklaratë me shkrim nga MV-të. ZNJ duket se i jep prioritet rasteve të dhunës në familje.¹⁰⁵

Komisioni nuk ka ofruar trajnim për dhunën në familje, dhe disa punonjës nuk kishin ekspertizën e duhur.¹⁰⁶ Në vitin 2012, UNDP planifikon seminarë për t'i njoftuar përfaqësuesit e ZNJ dhe Odës së Avokatëve të Kosovës në komunat e përzgjedhura nga

⁹⁶ Intervista të RRGK-së me zyrtarë të ndryshëm, 2012.

⁹⁷ Korrespondencë e RRGK-së me EULEX-in, 4 maj 2012.

⁹⁸ Korrespondencë me Menaxherin e Programit të Mbrojtjes së Viktimave/Dëshmitarëve, 14 mars 2012.

⁹⁹ *Ligji për Ndhimë Juridike pa Pagesë*, Ligji Nr. 04/L-017, 2012. UNMIK, *Rregullorja për Ndhimë Juridike*, 2006/36, 2006. Përfaqësues të Komisionit për Ndhimë Juridike u brengosën me faktin se "grupi punues përbëhej nga persona që nuk dinin gjë për ndihmën juridike. Shumë institucione shumë të rëndësishme për ndihmën juridike nuk u ftuan fare. Policia, MV-të, avokatët, prokurorët, QPS-të dhe shoqëria civile nuk ishin fare pjesë e këtij procesi" (intervistë e RRGK-së, 13 janar 2012). Kjo mund të ketë ndikuar cilësinë e ligjit të ri dhe ndjenjën e pronësisë mbi implementimin e tij nga palët me interes. Përfaqësuesit e Komisionit nuk kanë përmendur probleme lidhur me Ligjin e ri.

¹⁰⁰ Ligji për Ndhimë Juridike Falas, kapitulli IV.

¹⁰¹ *Po aty*, kapitulli V.

¹⁰² *Po aty*, neni 22.

¹⁰³ Jo të gjitha rastet përfitojnë nga ndihma nga avokatët e kontraktuar; edhe juristët e punësuar pranë Komisionit marrin përsipër disa raste.

¹⁰⁴ Ligji për Ndhimë Juridike Falas, kapitulli VII.

¹⁰⁵ Intervista të RRGK-së me përfaqësues të ZNJ, 2012. Komisioni ka një bazë të të dhënave të viktimave të dhunës në familje që kanë përfituar nga ndihma juridike. Mes viteve 2008 dhe 2011 ata i kanë asistuar 209 raste, përfshirë 180 gra dhe 29 burra, nga të cilët 177 shqiptarë Kosovar, dy serbë, nëntë boshnjakë, gjashtë ashkali dhe dhjetë romë. ZNJ në Prizren kishte ofruar më shumë ndihmë se sa zyrtat tjera, duke asistuar në 142 raste të dhunës në familje.

¹⁰⁶ Intervista të RRGK-së me zyrtarë të ndryshëm, 2012.

UNKT me Ligjin dhe Strategjinë (€2,790). Komisioni duhet të institucionalizojë trajnimet për zyrtarët dhe avokatët e ardhshëm.

Ndihma juridike financohet nga alokimet buxhetore nga Kuvendi i Kosovës. Informatat e pamjaftueshme lidhur me numrin e avokatëve të kontraktuar, llojin e shërbimeve juridike të ofruara dhe numrin e rasteve në gjykatore bëjnë që Komisioni të mos mund të vlerësojë saktë shpenzimet që ndërlidhen me rastet e dhunës në familje. Marrë parasysh këtë që u tha, supozohet se në vitin 2011 në rastet e dhunës në familje janë shpenzuar **€6,126**.¹⁰⁷

Më tej, Komisioni financon vetëm pesë ZNJ; pesë tjera financohen nga UNDP.¹⁰⁸ Në vitin 2011, rreth **€534** janë shpenzuar në raste që ndërlidhen me dhunën në familje.¹⁰⁹ Në vitet 2012-2013, UNDP ka planifikuar të shpenzojë €50,000 si përkrahje financiare dhe teknike për ZNJ në Gjakovë dhe Dragash, për të siguruar "shërbime juridike pa pagesë për viktimat e dhunës në familje."¹¹⁰ Kjo përkrahje përfshin pagat për nga një jurist dhe juriste në çdo zyrë. UNDP gjithashtu do të përkrah intervenimet paralegale nën mbikëqyrje të ZNJ (€71,610). Juristët dhe Oda e Avokatëve të Kosovës do të ofrojnë informata ligjore për komunitetet e komunave të përzgjedhura.

Buxheti aktual i Komisionit është i pamjaftueshëm. Një përfaqësues i komisionit komentoi:

Rritja e numrit të zyrave e ka rritur numrin e personave që kërkojnë ndihmë juridike dhe përfaqësim në gjykata. Megjithatë, buxheti [shtetëror] ka mbetur i pandryshuar... Ka raste që plotësojnë të gjitha kriteret për të gëzuar ndihmë juridike, por për shkak të kufizimeve buxhetore ne jemi të obliguar që t'i refuzojmë ata. Por, si mund ta bëjmë këtë? Kjo përbën shkelje të të drejtave të njeriut... Ne kemi kërkuar buxhet shtesë, por për fat të keq qeveria na ka refuzuar."

Numri i pamjaftueshëm i ZNJ në tepër pak lokacione është problematik ngase pak njerëz në Kosovë, në veçanti pjesëtarë të grupeve të cënueshme, mund ta përballojnë angazhimin e avokatëve të tyre. Përmirësimet në grumbullimin e të dhënave dhe në praktikën e caktimit të kostove do të ndihmonin në përpilimin e buxheteve më të mira dhe do t'i mundësonin Komisionit që të grumbullojë dëshmi adekuate për të lobuar për fonde të mjaftueshme. Disa OJQ dhe biznese poashtu kanë ofruar ndihmë juridike pa pagesë. Për shembull, Medica Kosova në Gjakovë ofron ndihmë juridike pa pagesë për gra që kanë pësuar dhunë në familje. Ofrimi i kësaj ndihme për çdo rast kushtoi mes €500-1,500, ndërsa Medica ka shpenzuar rreth €25,000 në vit.¹¹¹ Në vitet 2011-2012, PILPG ka kontraktuar firmën private Sejdiu & Qerkimi për të ofruar ndihmë juridike dhe për të kryer përfaqësim strategjik, në bashkëpunim me CLARD, në raste të dhunës në familje.¹¹² Mes viteve 2010 dhe 2012, CLARD poashtu ka asistuar 223 raste të dhunës në familje, me kosto prej rreth €8,000. OJQ tjera, si Norma (€16,000),¹¹³ Ruka Ruci dhe strehimoret poashtu kanë ofruar ndihmë juridike

¹⁰⁷ Kjo u kalkulua si shumë e 1) €142,370, totali i shpenzimeve operative në vitin 2011, minus €60,000 të shpenzuara për angazhimin e avokatëve; 2) €60,000 për angazhimin e avokatëve (mallra dhe shërbime); 3) €122,955, për të gjitha shërbimet juridike dhe administrative (paga dhe medijtje); dhe 4) €22,520 për mallra dhe shërbime. Kjo shumë është pjesëtuar me 3,007 raste të asistuar dhe shumëzuar me 64 raste të dhunës në familje.

¹⁰⁸ ZNJ-të e financuara nga Komisioni gjenden në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjiilan. Ato të financuara nga donatorët gjenden në Prishtinë, Gjakovë, Graçanicë, Ferizaj dhe Dragash.

¹⁰⁹ UNDP ka siguruar rreth €231,660 për pesë ZNJ dhe dy qendra ndërmjetësimi. Kjo pjesëtuar me 1,735 raste të asistuar dhe shumëzuar me katër raste të dhunës në familje jep shumën e shpenzuar.

¹¹⁰ Korrespondencë e RRGK-së me UNDP, 4 prill dhe 9 korrik 2012. Kjo ishte pjesë e Programit GBV të UNKT-së.

¹¹¹ Kjo përfshin tërë stafin, gjykatat, shpenzimet e transportit dhe ushqimit. Shumica e rasteve kishin pasur së paku tetë paraqitje në gjykatë. Medica pati sukses në kërkesën për të zbritur tarifën gjyqësore për rastet sociale, dhe u ndihmoi 33 rasteve në vitin 2011.

¹¹² Intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e PILPG, Prishtinë, 12 mars 2012.

¹¹³ Norma ka ndihmuar 20 raste të dhunës në familje në vitin 2011, nga 125 raste të ndihmuara në të gjitha fushat. Buxheti i tyre i përgjithshëm vjetor ishte rreth €100,000 dhe pritet të rritet në €150,000 në vitin 2012.

pa pagesë, megjithëse shpenzimet e sakta të tyre nuk u bënë të ditura. Nuk është e qartë si do mund të ruhet ky nivel i ndihmës juridike të ofruar nga OJQ-të. Gjithsej, ndihma juridike për rastet e dhunës në familje për vitin 2011 ka kushtuar mbi **€58,452**. Kjo shumë nuk është adekuate për të siguruar drejtësi dhe mbrojtje për viktimat e dhunës në familje, si një kategori e cenueshme.

UNDP është duke financuar edhe qendrat e ndërmjetësimit në Gjakovë dhe Ferizaj, me qëllim të trajtimit të lëndëve të pazgjidhura në gjykata.¹¹⁴ Derisa vetë qendrat nuk kanë mandat ligjor dhe nuk gëzojnë fonde qeveritare, zyrtarët ndërmjetësues mund të paguhen për rastet e trajtuara.¹¹⁵ OJQ-të poashtu ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit. Për shembull, Partners Kosova ka ndërmjetësuar në tri raste të dhunës në familje gjatë vitit 2011, duke shpenzuar rreth €2,791.¹¹⁶


Shërbimet e Mirëqenies Sociale: Mbrojtja e Viktimave, në Veçanti e Fëmijëve

Struktura organizative e sistemit të mirëqenies sociale është paksa komplekse. MPMS koordinon mbrojtjen sociale ndërsa Departamenti i saj për Mirëqenie Sociale (DMS) ofron udhëzime në nivel politik.¹¹⁷ DMS ka një zyrë qendrore, drejtori regjionale dhe QPS në shumicën e komunave.¹¹⁸ Siç paraqitet në diagramin 8, drejtoritë komunale për shëndetësi dhe punë sociale administrojnë financat e QPS-ve, megjithëse QPS-të i raportojnë drejtpërsëdrejti DMS-së.¹¹⁹ Kjo ka shkaktuar konfuzion tek QPS-të, ndërsa përgjegjësitë raportuese të tyre mund të qartësohen përmes kornizës ligjore.

MPMS është përgjegjëse për sigurimin e resurseve dhe standardeve profesionale për shërbime familjare dhe sociale, përfshirë shërbimet që ofrohen nga komunat dhe ofruesit privatë. Ministria mbikëqyr një numër të stafit profesional që angazhohet, duke përcaktuar se kusht dhe si duhet të ofrojnë shërbime.¹²⁰ Ligji për Shërbime Familjare dhe Sociale parashihte se këto funksione do të mund të rregulloheshin me protokolle deri në vitin 2005. Megjithatë, protokollat ende nuk janë miratuar apo implementuar. Kjo ka implikacione për strehimoret si ofruese të shërbimeve, si dhe për asistencën që punëtorët socialë ua japin viktimave të dhunës në familje. MPMS duhet të certifikojë dhe licencojë urgjentisht të gjithë punëtorët socialë. MPMS gjithashtu nuk ka buxhetuar për krijimin e politikave që kanë të bëjnë me Ligjin apo për trajnimin e punëtorëve socialë lidhur me përmbajtjen e tij.¹²¹

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare përcakton përgjegjësi mbrojtëse për MPMS-në. Definicioni i personave dhe familjeve në nevojë përfshin edhe viktimat e dhunës në familje.¹²² Ata kanë të drejtë të gëzojnë mbrojtje sociale që ofrohet nga QPS-të, përfshirë edhe

Diagrami 8. Raportimi dhe Financimi i Shërbimeve Sociale



¹¹⁴ Sistemi për Zbatimin e Marrëveshjeve dhe Vendimeve i USAID-it (SEAD) gjithashtu ka financuar dy qendra të ndërmjetësimit në Gjilan dhe Pejë, por këto nuk kanë trajtuar raste të dhunës në familje (korrespondencë e RRGK-së me një përfaqësues, 29 korrik 2012).

¹¹⁵ *Ligji për Ndërmjetësimin në Kosovë* (Nr. 03/L-057): ndërmjetësuesit paguhen nga palët në procedurë të ndërmjetësimit. Paga e ndërmjetësuesve përcaktohet me një akt nënligjor të MD-së.

¹¹⁶ Korrespondencë e RRGK-së me Partners Kosova, 20 korrik 2012.

¹¹⁷ Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, DMS jep propozime, sugjerime dhe këshilla për Ministrinë dhe Qeverinë mbi zhvillimin e politikave lidhur me shërbimet sociale dhe familjare (neni 3, paragrafi 3.2).

¹¹⁸ Ato janë duke u themeluar në komunat e Graçanicës, Kllokotit dhe Ranillugut.

¹¹⁹ *Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë*, Nr. 03/L-040, neni 17 dhe kaptina 10; dhe *Ligji për Shëndetin në Kosovë*, Nr. 2004/04. Në Mitrovicë, QPS gjendet nën Drejtorinë për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale.

¹²⁰ *Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare*, neni 2.5.

¹²¹ Ligji, nenet 7 dhe 28. Për më shumë informata, shih kapitullin 1.

¹²² *Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare*.

asistencën sociale, këshillimet dhe asistencën materiale, varësisht nga fondet.¹²³ DMS është përgjegjës për transferimin e granteve qeveritare për asistencë sociale (shih kapitullin 5).

QPS-të kanë përgjegjësi primare për të mbrojtur fëmijët, përfshirë ata që kanë përjetuar dhunë.¹⁷⁷ Ato duhet të fokusohen në interesat e fëmijës.¹²⁴ Punëtorët socialë duhet të menaxhojnë dosjet dhe të koordinojnë përkrahjen psikologjike, ushqimin, strehimin, arsimimin, përkrahjen financiare, kujdesin shëndetësor dhe ndihmën juridike. Në pajtim me Ligjin, punëtorët socialë mund të kërkojnë urdhra për mbrojtje apo urdhra për mbrojtje emergjente kur fëmijët janë viktime të dhunës në familje.¹²⁵ Megjithatë, nuk kishte asnjë shënim që punëtorët socialë kishin kërkuar urdhra mbrojtës.¹²⁶

QPS-të duhet të mbrojnë të drejtat e fëmijëve në rast të shkurorëzimit të bashkëshortëve. Para se një çift të kërkojë shkurorëzim, gjykata kërkon nga QPS-të të monitorojnë për tre muaj përpjekjet e tyre për të arritur pajtim.¹²⁷ Në praktikë, kjo kërkesë ligjore shpesh ndërhyr me ofrimin e asistencës dhe mbrojtjes në raste të dhunës në familje.

"Ne gjithmonë kemi pasur probleme me fëmijët. Ata nuk kanë mekanizëm për t'i mbrojtur dhe janë në pozitë 'pingpongu'. Ata barten nga njëri prind tek tjetri. Çiftet i shfrytëzojnë fëmijët si mjet për të ushtruar presion tek njëri-tjetri."

- Prokurori i Qarkut

Ligji për Familjen përcakton se punëtori social duhet të shqyrtojë kushtet e jetesës së fëmijëve "dhe të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar arsimimin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të fëmijës, duke u përpjekur që mes bashkëshortëve të arrihet marrëveshje për t'i mbrojtur interesat e tij."¹²⁸ Ngjashëm me gjyqtarët dhe prokurorët, punëtorët socialë duket se

vlerësojnë se pajtimi i çifteve është më i rëndësishëm se sa mbrojtje dhe ruajtja e të drejtave të viktimave.¹²⁹ QPS-të shpesh konsiderojnë se pozita financiare e meshkujve është më e rëndësishme për fëmijët se sa mungesa e dhunës.¹³⁰

Dëshmitë sugjerojnë se QPS-të shpesh dështojnë në ruajtjen e interesave të fëmijës. Në vitin 2011, Kosovarët u tronditën kur ish-bashkëshorti i një viktime të dhunës në familje e vrau këtë të fundit në Prishtinë.¹³¹ Që nga shkurorëzimi nga bashkëshorti i saj i dhunshëm, ai e kishte kërcënuar pandërprerë. Më 26 prill 2011, ajo kërkoj urdhër për mbrojtje nga gjykata komunale e Prishtinës. Në kërkesën e saj, ajo deklaroi se frikësohej për jetën e saj.¹³² Gjukata nuk ia lëshoi urdhrin e mbrojtjes brenda 24 orëve, ashtu siç parashihet me ligj.¹³³ Madje edhe kur ajo u vra, 24 ditë pas parashtrimit të kërkesës, gjykata ende nuk i ishte përgjigjur kërkesës së saj. Ish-bashkëshorti i saj mbetet i dyshuari kryesor dhe ende është në kërkim nga Policia e Kosovës. Për më tepër, fëmija e viktimës ende mbetet nën kujdesin e familjes së afërt të të dyshuarit për vrasje. Babai i viktimës nuk është lejuar që të takohet me mbesën e tij dhe vazhdon të kërkojë kujdestarinë mbi fëmijën.¹³⁴ QPS ka dështuar që të veprojë si kujdestare ligjore e fëmijës dhe vazhdon të shkel të drejtën e

¹²³ *Po aty*, neni 1.4 dhe 2.10.

¹⁷⁷ Ligji, neni 13, paragrafi 2.5.

¹²⁴ *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve* është e zbatueshme sipas *Kushtetutës së Republikës së Kosovës* (neni 22). Edhe *Ligji për Familjen në Kosovë* (neni 82) parashih se QPS-të duhet të kenë parimisht parasysh interesat e fëmijës gjatë tentimit për të pajtuar çiftet që kërkojnë shkurorëzim.

¹²⁵ Ligji, neni 13, paragrafi 1.4.

¹²⁶ Korrespondencë e RRGK-së me DMS, përmes emailit, prill 2012.

¹²⁷ *Ligji i Kosovës për Familjen*, neni 83.

¹²⁸ *Ligji i Kosovës për Familjen*, neni 82.

¹²⁹ *Po aty*. Gjithashtu, Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Shqyrtimi i Kërkesave për Urdhra Mbrojtës në Raste të Dhunës në Familje në Kosovë*.

¹³⁰ RRGK, *Më shumë se "fjalë në letër"?*, f. 61 dhe *Siguria Fillon në Shtëpi*, f. 86.

¹³¹ RRGK ka organizuar një protestë për të kërkuar drejtësi për familjen e viktimës. Më 20 maj 2011, u grumbulluan 638 nënshkrime dhe RRGK i dërgoi një letër KGJK-së më 1 qershor 2012.

¹³² Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Raport reagues: Urdhrat e Mbrojtjes Emergjente në Raste të Dhunës në Familje*.

¹³³ Ligji, neni 16(1).

¹³⁴ Gazeta ditore *Kosova Sot*, "Mosreagimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë rezultoi me vrasjen mizore të Dianës: prindërit e Diana Kastratit të vrarë apelojnë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës," 17 prill 2012.

babait të viktimës për kujdestari të përkohshme. Në një rast tjetër, një respondent që punon për së afërmi me QPS-të tha për RRGK-në:

Dy vajza shumë të reja u trafikuan nga babai i tyre [dhe] u dhunuan nga miqtë e tij... Prokuroria dhe policia ishin të gatshëm që të hapin dosje, të fillojnë hetimet dhe të çojnë këta kriminelë në burg [por] QPS-ja bllokoi procesin. Ata nuk deshën t'i largojnë fëmijët nga babai i tyre sepse jetojnë në një qytet ku të gjithë njihen mes veti dhe babai i vajzave gëzonte reputacion të mirë si familje... Ne u obliguam ta nënshkruajmë një dokument zyrtar dhe t'ia paraqesim atë prokurorit për të filluar hetimet. Gjykatësi i dënoi të dyshuarit me dy-tri vjet burgim, jo për dhunim po për marrëdhënie seksuale me persona të mitur.¹³⁵

Ruajtja e imazhit familjar të personit në fjalë u konsiderua më e rëndësishme se mbrojtja e fëmijës. Në raste të tilla, QPS-të nuk kanë kryer analiza të kushteve të jetesës dhe mundësive të zhvillimit për fëmijët në shtëpi të tilla të dhunshme, gjë që e kanë përgjegjësi.

Dëshmitë sugjerojnë se menaxhimi i lëndëve nga QPS-të kryesisht ka qenë i dobët.¹³⁶ Për shembull, disa menaxherë të rasteve nuk hapin dosje zyrtarisht për shkak se kjo ndërthen punë administrative shtesë.¹³⁷ EULEX-i ka raportuar se "punëtorët socialë të cilët marrin pjesë në procedurë gjyqësore, sipas detyrës zyrtare, nuk janë aktivë; ata rrallë ua paraqesin gjyqtarëve opinionet e tyre, dhe shpesh ndodh të mos paraqiten fare para gjyqtarëve edhe kur ftohen në seanca në mënyrë të rregullt. Kjo përbën arsye për të shtyrë seancat."¹³⁸ Policia raportonte se QPS-të nuk punojnë natën apo se i fikin telefonat zyrtarë kur janë në detyrë.¹³⁹ Performansa e dobët e ka dëmtuar koordinimin në mbrojtjen e fëmijëve.

Sistemet joefikase të menaxhimit të të dhënave dëmtojnë edhe më tej menaxhimin e lëndëve. Bazat aktuale të të dhënave nuk kanë informata të duhura (p.sh. nëse dhuna ushtrohet për herë të parë apo është përsëritur, kushtet e jetesës së viktimave, statusin social dhe të hyrat familjare të tyre). DMS ka nevojë për një sistem të integruar të grumbullimit të të dhënave dhe planifikon themelimin e tij.¹⁴⁰ Një sistem i tillë do t'i mundësonte QPS-ve vendosjen e të dhënave në mënyrë të drejtpërdrejtë, gjë që do të avanconte koordinimin dhe përmirësonte menaxhimin e lëndëve. Implikacionet buxhetore për këtë ende nuk janë vlerësuar.

Praktikat më të mira të menaxhimit të lëndëve ekzistojnë në komuna ku OJQ *Terre des Hommes* ka krijuar grupe koordinuese për të ndihmuar në raste ku janë të përfshirë fëmijët. Falë fondeve të UNICEF-it dhe BE-së, *Terre des Hommes* ka punuar në fuqizimin e njësive për mbrojtje të fëmijëve (NJMF) përmes punëtorëve të specializuar dhe task forcave, si mekanizma koordinues për rastet e mbrojtjes së fëmijëve.¹⁴¹ Task forcat përfshijnë pjesëmarrës të autoriteteve lokale, QPS-ve, policisë, sistemit arsimor, shërbimit sprovues strehimoreve dhe agjencive kundër trafikimit. Ekzistojnë tetë NJMF funksionale, ndërsa task forca funksionale ka në gjashtë komuna.¹⁴² Task forcat e udhëhequra nga NJMF-të janë

¹³⁵ Intervistë e RRGK-së, mars 2012.

¹³⁶ Intervista të RRGK-së me zyrtarë të ndryshëm.

¹³⁷ Intervistë e RRGK-së me zyrtar të DMS, 2012.

¹³⁸ Korrespondencë e RRGK-së me EULEX-in, 4 maj 2012.

¹³⁹ Intervistë e RRGK-së me DVIU-në e Policisë së Kosovës, 18 janar 2012.

¹⁴⁰ Intervistë e RRGK-së me DMS-në, 26 janar 2012.

¹⁴¹ UNICEF-i përkrahu parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, eksploatimit, abuzimit dhe neglizhencës, si dhe parandalimin e delikucencës së të miturve (€38,020 në vitin 2011 dhe €73,560 në vitin 2012). Përkrahja gjithashtu ishte drejtuar për reintegrimin dhe zhvillimin e shërbimeve gjegjëse (korrespondencë e RRGK-së me UNICEF-in, 13 qershor 2012).

¹⁴² Intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e *Terre des Hommes*, 19 mars 2012. Task forca janë krijuar në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Mitrovicë. Tri NJMF funksionojnë në Prishtinë, dhe nga një në Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Fushë Kosovë.

takuar për çdo muaj (dhe kanë koordinuar me anëtarët e familjeve) për të diskutuar dhe marrë vendime për fëmijët që kishin nevojë për mbrojtje sociale. Bazuar në vendimet që kanë marrë task forcat, punëtori social përgjegjës përgatitë planin e veprimit për çdo fëmijë. Ata mund të kërkojnë zyrtarisht asistencë sociale nga *Terre des Hommes* për realizimin e planeve të tyre.

Në vitin 2011, task forcat kanë ndihmuar 388 fëmijë, përfshirë 96 raste të dhunës në familje, me kosto prej rreth **€63,250** (mesatarisht €648 për rast). Programi ka trajtuar përafërsisht gjysmën e rasteve në Kosovë. Shumë komuna nuk kanë task forca, ndërsa disa të tjera kanë më shumë raste se që mund të trajtojnë. Më tej, programi përfundon në vitin 2012 dhe ende nuk ka siguruar fonde shtetërore për vazhdimin e tij. *Terre des Hommes* është duke avokuar për institucionalizimin e *task forcave* në kornizë ligjore. Sipas UNICEF-it kjo mbetet "një sfidë e vërtetë":

Tek çështjet e ndërlidhura me dhunën në familje dhe trafikimin, do të kishim të bëjmë me njerëzit e njëjtë në të njëjtën task forcë... Do të ishte ideale po të kishim punëtorë socialë të specializuar që punojnë me kategori të ndryshme fëmijësh. Por, kjo ka pak gjasa të ndodhë. Duhet të diskutohet se si do t'ia bëjmë. Unë nuk mendoj se agjencitë tjera janë duke diskutuar këtë çështje nga një perspektivë gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale. Ato i kanë mandatet e tyre përkatëse: "ne duam ta krijojmë këtë task forcë për gratë" apo "këtë task forcë për dhunën në familje." Më pas formohen edhe task forca për punë të fëmijëve dhe task forca për mbrojtje të fëmijëve. Janë të njëjtit profesionistë që gjenden në task forcën për dhunën në familje e që merren edhe me viktimat e moshës madhore.¹⁴³

Duhet të zhvillohen diskutime lidhur me çështjet kryesore mes akterëve kryesorë, në veçanti në drejtim të hartimit të Procedurave Standarde Operative (PSO) (shih kapitullin 6). Edhe pse për trajtimin e kategorive të ndryshme duhet të ketë plane të veçanta, në PSO duhet të njihet fakti se një person mund të zhvillojë disa programe politike, gjë që shton efikasitetin dhe zvogëlon rrezikun e riviktimizimit të njerëzve.¹⁴⁴ UNICEF-i poashtu ka theksuar nevojën për të zhvilluar, fuqizuar dhe specializuar legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve; për të sajuar protokolle të ndara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve që kanë pësuar dhunë në familje; dhe për trajnim dhe përkrahje të mëtejme për NJMF-të, përfshirë këtu fuqizimin e rolit të psikologëve të shkollës si dhe mbajtjen e takimeve të rregullta me prindërit, drejtorët e shkollave dhe pedagogët.

Instituti për Politika Sociale pranë MPMP-së është përgjegjës për trajnimin e punëtorëve socialë, bazuar në kërkesat e tyre. Në vitin 2013, MPMS planifikon të krijojë Këshillin për Shërbime Sociale dhe Familjare, një institucion të pavarur përgjegjës për trajnimin dhe licencimin e punëtorëve socialë dhe ofruesve të shërbimeve përkatëse, siç janë strehimoret-OJQ. Këshilli do të ketë buxhet të pavarur nga ai i Ministrisë. Deri tani, ky institut nuk ka ofruar trajnime në fushën e dhunës në familje. MPMS duhet të përcaktojë koston e trajnimeve dhe të ndajë mjetet buxhetore për t'i realizuar ato.

Organizatrat ndërkombëtare kanë ofruar trajnime të tilla për punëtorët socialë. Në vitin 2006, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka prodhuar një *Doracak për Përgjigje ndaj Incidenteve të Dhunës në Familje* i cili përcakton procedurat të cilat duhet të ndiqen nga MPMS, DMS dhe QPS-të për rastet e dhunës në familje. Trajnime u ofruan vetëm në muajt e parë pas publikimit të këtij doracaku. Në vitin 2011, MPMS nuk kishte trajnuar punëtorët socialë lidhur

¹⁴³ Intervistë e RRGK-së me UNICEF-in, 8 mars 2012. Në vitet 2011-2012, UNICEF-i ka kryer një vlerësim të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të cilin e ka përfshirë në Planin Prioritar të Veprimit për fuqizimin e këtij sistemi. Si rezultat i kësaj, Zyra e Kryeministrit ka krijuar një Këshill ndërsektorial për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe për Drejtësi për Fëmijët. Ky Këshill do të përqendrohet në përkufizimin e prioritetëve dhe masave të domosdoshme për të përmirësuar shërbimet aktuale të mbrojtjes së fëmijëve dhe sigurimit të drejtësisë për ta.

¹⁴⁴ *Po aty*.

me këtë doracak.¹⁴⁵ Organizatat ndërkombëtare planifikojnë të ofrojnë trajnime në vitet 2012-2013.¹⁴⁶ MPMS duhet të ndajë fonde për të institucionalizuar trajnime të qëndrueshme për punëtorët socialë. Ata duhet të trajnohen për të siguruar një qasje të ndjeshme ndaj viktimave të dhunës në familje dhe për të mbrojtur më mirë interesat e fëmijës, jo vetëm ekonomikisht, por edhe sa i përket mirëqenies së përgjithshme dhe sigurimit të një jete pa dhunë.

Sa i përket financimit, një raport i kohëve të fundit sugjeron se kostot administrative lidhur me shërbimet sociale për viktimat e dhunës në familje arrijnë rreth €35.47 për rast.¹⁴⁷ RRGK supozon se ofrimi i asistencës për rastet e dhunës në familje kushton rreth €600 në vit,¹⁴⁸ ndërsa QPS-të shpenzojnë mbi **€135,720** në raste të dhunës në familje çdo vit.¹⁴⁹

MPMS, së bashku me MF-në, vendosin për financimin vjetor të QPS-ve. Komunat i mbulojnë kostot administrative të QPS-ve, ndërsa granti i përgjithshëm nga niveli qendror mbulon kostot programatike. Financimi i drejtorive komunale është limituar për shkak të udhëzimeve ministrore, ndërsa departamentet komunale të financave kishin probleme me sigurimin e resurseve qeveritare shtesë.¹⁵⁰ Si rrjedhojë, QPS-të gjatë ofrimit të përkrahjes për klientët e tyre, përfshirë viktimat e dhunës në familje, përballeshin me resurse të kufizuara financiare.¹⁵¹

QPS-të raportuan se nuk kanë resurse adekuate për të plotësuar nevojat emergjente të viktimave (p.sh. ushqim, rroba), për komunikim, kompjuterë, printerë dhe fotokopjues. QPS-të duket se nuk kanë staf të mjaftueshëm për të kryer përgjegjësitë e tyre ligjore. "Për shembull, në Pejë për dy vite me radhë kanë qenë vetëm tre punëtorë socialë, në vend të pesë sish që ka qenë e planifikuar të jenë," i tha RRGK-së një respondent. "Këta tre punëtorë socialë punojnë me rreth 285 raste në muaj. Ata nuk kanë shumë kohë për të kryer vizita në familje."¹⁵² Burimet e pamjaftueshme njerëzore ndikojnë në aftësinë e QPS-ve për tu siguruar fëmijëve mbrojtje dhe ua bëjnë atyre të vështirë parandalimin e dhunës përmes këshillimeve familjare. Delegimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore duhet të shihet si investim në parandalimin e dhunës në familje dhe rrjedhimisht si veprim që i zvogëlon shpenzimet e shtetit në të ardhmen.

"Në Kosovë jepet pak llogari publike dhe ka pak zotime për financimin e shërbimeve të mirëqenies sociale, në veçanti sa i përket parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga llojet e ndryshme të dhunës, neglizhenca dhe abuzimi, përfshirë edhe dhunën në familje."
- UNICEF

¹⁴⁵ Intervista të RRGK-së me punëtorë socialë, 2012.

¹⁴⁶ OSBE po trajnon punëtorët socialë, përfaqësuesit e OJQ-ve dhe strehimoreve në të gjitha regjionet mbi rolet e tyre në ofrimin e asistencës për viktimat të dhunës në familje. Pas vlerësimit të nevojave, UNICEF-i poashtu planifikon të ofrojë trajnime të avancuara për ofruesit e shërbimeve sociale në QPS-të e komunave të përzgjedhura nga UNKT (€46,500 në vitet 2012-2013) (intervistë e RRGK-së me UNICEF-in, 8 mars 2012).

¹⁴⁷ Shih S. Kutishi dhe L. Joshua, *Vlerësimi ekonomik i shërbimeve sociale në Kosovë: Kostoja për njësi të shërbimeve sociale*, Prishtinë, DFID, 2011. Kur kjo shumë shumëzohet me numrin e rasteve të dhunës në familje të cilat DMS ka raportuar të ketë ndihmuar në vitin 2011 (226), shuma arrin në €8,016 në vit: shumë më pak se sa që RRGK ka vlerësuar se nevojiten vetëm për paga dhe mëditje të stafit.

¹⁴⁸ E kalkuluar si kosto për punë, ndarë me numrin e rasteve (226). Kjo mund të jetë një mbivlerësim, pasi që QPS-të mund të mos i regjistrojnë të gjitha rastet; megjithatë të ngjashme janë edhe shpenzimet e *Terre des Hommes* për rast të trajtuar.

¹⁴⁹ Në zyrën qendrore të DMS-së, një person kalon tërë orarin e punës duke punuar në çështje të dhunës në familje, një tjetër ia kushton 50% të kohës dhe një i tretë 20% të kohës, që do të thotë se në këtë fushë punojnë 1.7 punonjës. Në QPS 36 persona punojnë parimisht në raste të tilla. Mesatarisht, stafi kushton €3,600 në vit. Kjo shumëzuar me 1.7, plus 36 persona japin shumën e gjithmbarshme për paga dhe mëditje për adresimin e dhunës në familje. Këtu nuk përfshihen kostot tjera si shpenzimet operative (intervistë e RRGK-së me përfaqësues të DMS-së, 26 janar 2012).

¹⁵⁰ Për shtjellim të mëtejme të kësaj teme, shih kapitullin 2.

¹⁵¹ Korrespondencë e RRGK-së me UNICEF-in, 16 prill 2012.

¹⁵² Intervistë e RRGK-së, mars 2012.

Strehimoret: Mbrojtja e Viktimave

Hezitimi i gjyqtarëve për të aplikuar masa për të larguar autorët nga vendbanimi i përbashkët shpesh i shtyn viktimat për të ikin nga shtëpitë e tyre apo u lejojnë autorëve që të largojnë viktimat nga shtëpia për shkak të "mosnënshtrimit."¹⁵³ Strehimoret ofrojnë mbrojtje të përkohshme shumë të rëndësishme. Edhe pse qeveria ka përgjegjësi për të mbrojtur viktimat, të gjitha strehimoret (përveç njëjës) operohen nga OJQ-të.¹⁵⁴ Përmes DMS-së, MPMS harton rregullore, udhëzime dhe standarde për ofruesit e shërbimeve sociale, përfshirë strehimoret. Megjithatë, MPMS ende nuk i ka përcaktuar procedurat e licencimit, përfshirë procedurat për monitorimin e shpenzimeve të OJQ-ve, siç parashihet me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare.¹⁵⁵ Zyrtarët e DMS-së thanë se MPMS është duke i hartuar këto procedura dhe se mëtohet edhe licencimi i stafit të OJQ-ve.¹⁵⁶

Kosova ka dhjetë strehimore që u asistojnë viktimave të dhunës në familje në shtatë komuna.¹⁵⁷ Në vitin 2007, shumica e strehimoreve krijuan e më pas edhe regjistruan një koalicion për të avokuar për fonde të mjaftueshme dhe për të koordinuar punën e tyre. Derisa këto strehimore në parim asistojnë gratë, në shumicën prej tyre qëndrojnë edhe viktimat e moshës deri 12-vjeçare për djem dhe deri 18-vjeçare për vajza.¹⁵⁸ Pas referimit nga QPS, fëmijët që janë viktimat të dhunës në familje dhe që nuk mund të vendosen në strehimore tjera për shkak të moshës apo mungesës së hapësirës, mund të vendosen në *Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve - Kosovë* (SDSF) dhe *SOS Kinderdorf*, të cilat pranojnë vetëm fëmijë të moshave 3 deri 18 vjeç.¹⁵⁹

Shërbimet e strehimoreve përfshijnë akomodimin e sigurt, rrobat, ushqimin, kujdesin shëndetësor themelor, këshillimin psikologjik, këshillimin familjar, ndihmën juridike, arsimin, trajnimet profesionale dhe shërbimet themelore të reintegrimit (shih kapitullin 5). Edhe pse strehimoret kanë sisteme të sigurisë, përfaqësuesit e tyre kanë shprehur brengë lidhur me nivelin e sigurisë.¹⁶⁰ Strehimoret do të mund të shtonin shërbimet për fëmijë, në veçanti në kuptim të përmirësimit të qasjes në arsim.¹⁶¹

Në vitet 2009-2010, IOM ka ofruar trajnime në fushën e menaxhimit të rasteve për stafin e strehimoreve, të cilat fokusoheshin në trafikim por u ofronin stafit edhe njohuri të përgjithshme. Strehimoret tani shfrytëzojnë dokumente të ngjashme për menaxhimin e rasteve të trafikimit dhe dhunës në familje. Strehimoret mund të shfrytëzojnë formularët për menaxhimin e rasteve, të cilat MPMS mund t'i kërkoj për të siguruar licencë për ofrim të shërbimeve në të ardhmen.

Në dosjet për klientët, strehimoret mbajnë të dhëna të pastrukturuara mbi gjininë, etninë, moshën, lokacionin gjeografik dhe religjionin e viktimës. Rastet regjistrohen ndaras nëpër strehimore, ndërsa bazat e të dhënave nuk shfrytëzohen bashkërisht. Pasi që disa klientë të kalojnë afatin maksimal të qëndrimit në një strehimore (që zakonisht është gjashtë

¹⁵³ Shih RRGK, *Më shumë se "fjalë në letër"?*

¹⁵⁴ Strehimorja e Përkohshme e Sigurt, vetëm për viktimat të trafikimit, tani udhëhiqet nga MPMS.

¹⁵⁵ *Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare*, neni 8.3. Kuvendi i Kosovës aktualisht është duke e rishikuar këtë ligj (intervistë e RRGK-së me Komisionin e Kuvendit për Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, 23 mars 2012).

¹⁵⁶ Intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e DMS-së, 26 janar 2012.

¹⁵⁷ RRGK përfshiu PVPT-në, si strehimore për viktimat të trafikimit, sepse personat e trafikuar shpesh përjetojnë edhe dhunë në familje. Ligji poashtu definon termin "në familje" në mënyrë të zgjeruar që përfshin edhe bashkëjetesën, ndërsa viktimat e trafikimit mund të thuhet se përjetojnë një formë të dhunës në familje pas trafikimit. Financimi për strehimoret që përkrahin viktimat e trafikimit dhe viktimat potenciale të trafikimit është i përfshirë.

¹⁵⁸ Korrespondencë e RRGK-së me strehimore. Strehimoret mund të jenë fleksibile sa i përket limitit të moshës për çuna, varësisht nga niveli i zhvillimit të tyre.

¹⁵⁹ Intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e SDSF, 24 janar 2012. SDSF nuk pranon fëmijët që vlerësohet se janë në rrezik të madh, për shkak të natyrës së hapur të kësaj strehimoreje. SDSF ka kapacitete më të larta se sa strehimoret tjera dhe merr 75% të fondeve nga MPMS (€21,000). Informatat lidhur me financimin e SOS-it nuk na janë vënë në dispozicion.

¹⁶⁰ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të strehimoreve, 25 korrik 2012. Vlerësimet e rrezikut që kryhen nga policia do të mund të mundësonin strehimoreve planifikim më të mirë të sigurisë së klientëve.

¹⁶¹ Korrespondencë e RRGK-së me UNICEF-in, 16 prill 2012.

muaj), ata dërgohen në strehimore tjetër dhe regjistrohen si raste të reja në atë strehimore. Për këtë arsye, numri i gjithmbarshëm i "rasteve" të asistuar nga strehimoret nuk është i njëjti me numrin e personave që kanë përfituar ndihmë. Marrë këtë parasysh, tabela 7 përfshin klientët e ndihmuar nga çdo strehimore nga viti 2000 deri 2011. Ka pasur iniciativa për vendosjen e një sistemi të përbashkët për grumbullimin e të dhënave për strehimore, por strehimoret kanë vazhduar të shfrytëzojnë sistemet e tyre të pakoordinuara të grumbullimit të të dhënave.¹⁶² Disa punonjës të strehimoreve kanë thënë se sistemet më gjithëpërfshirëse të grumbullimit të të dhënave "merrnin shumë kohë" ose ishin "tepër të ndërlikuar," përkundër faktit se ishin trajnuar për shfrytëzimin e tyre. Resurset dhe kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore përbëjnë pengesë për ruajtjen adekuate të të dhënave.

Shumica e strehimoreve kanë përfituar nga financimi i pjesshëm nga MPMS, përmes DMS-ve, që nga viti 2006 (€15,000 deri €21,000 për strehimore, gjithsej €128,000 në vit). MPMS nuk financon strehimoren e re joformale të menaxhuar nga gratë serbe në Kosovë.¹⁶⁴ Fondet do duhej të mbulonin gjysmën e shpenzimeve për shërbimet themelore. MPMS nuk përkrah pagat e stafit të strehimoreve, gjë që është kyçe për funksionimin e strehimoreve. Përveç kësaj, përmes buxhetit të MV-ve, në vitin 2011 MD u ka siguruar strehimoreve në Mitrovicë, Prishtinë dhe Gjilan nga €4,500 për shpenzime operative (përfshirë pagat dhe mëditjet), duke arritur shumën e gjithmbarshme prej €13,500.

Komunat u ofrojnë përkrahje financiare dhe të natyrave tjera strehimoreve,¹⁶⁵ parimisht bazuar në vendimet (dhe vullnetin) e kryetarit. Në Gjilan, komuna ia ka dhënë strehimores në shërbim një ndërtesë publike për 99 vite dhe ia mbulon asaj shpenzimet si pagesat e energjisë elektrike dhe ujit (€10,000 në vit). Strehimorja në Prishtinë shfrytëzon tokën komunale pa kompensim. Në Gjakovë dhe Prizren, komunat u kanë dhënë strehimoreve €5,000 respektivisht €4,800 për të mbuluar shpenzimet e komunalive për vitin 2011. Me përkrahje nga IOM, strehimorja e Prizrenit ka nënshkruar një kontratë për shfrytëzimin e pronës publike komunale për periudhë të pacaktuar, me fillim në vitin 2011, ndërsa Ambasada e Mbretërisë së Holandës ka financuar renovimin e ndërtesës. Komuna e Mitrovicës i siguroi €3,000 në vitin 2011, për shpenzime të komunalive dhe planifikon t'i sigurojë strehimores një ndërtesë të re në vitin 2012. Në vitin 2011, Komuna e Pejës ia siguroi Qendrës për Mirëqenien e Gruas tokën dhe shumën prej €75,000 për ndërtimin e strehimores së re. Vlen të theksohet, ***se strehimoret financohen vetëm nga komunat ku janë të vendosura strehimoret***, edhe pse shërbimet në to shfrytëzohen nga qytetarët nga të gjitha komunat. Strehimoret varen në masë të gjerë nga përkrahja e donatorëve për mbulimin e pjesës më të madhe të shpenzimeve të tyre (shih tabelën 8).

Tabela 7. Rastet e DHF që kanë përfituar asistencë në strehimore për vitet 2000-2011¹⁶³

Strehimorja	Total
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (Prishtinë dhe Mitrovicë)	838
Qendra për Mirëqenien e Grave (Pejë)	821
Shtëpia e sigurt (Gjakovë)	725
Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren	393
<i>Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve</i> (Prishtinë)	1,173
Liria (Gjilan)	838
Total	4,788

¹⁶² Me financim të UNFPA-së, RRGK ka bashkëpunuar me strehimoret në krijimin e softuerit profesional për menaxhimin e rasteve.

¹⁶³ Strehimoret janë hapur në vite të ndryshme. Këta numra përfshijnë anëtarët e familjes që janë strehuar, përfshirë fëmijët. Tabela nuk përfshin PVPT-në, SOS Kinderbergun apo strehimoren e re të menaxhuar nga serbet e Kosovës.

¹⁶⁴ OPDAT ka planifikuar përkrahjen e krijimit të një strehimoreje në një zonë të pambuluar sa duhet, duke u fokusuar në dhunën në baza gjinore mes pjesëtarëve të pakicave. Megjithatë, buxheti dhe orari kohor i këtij zhvillimi nuk është vendosur ende (korrespondencë e RRGK-së, 14 mars 2012).

¹⁶⁵ Vlerësimi i çmimit të tokës, ndërtesave dhe komunalive ishte i vështirë ngase komunat nuk mbajnë dosje të qarta. Këto kontribute janë më të larta se sa shifrat e ofruara në këtë dokument.


Tabela 8. Burimet e financimit për strehimoret në Kosovë, 2011-2012

Strehimorja	Viti	MPMS	MD	Komuna	UNDP WSSI	KtK	Caritas	Amb. SHBA	Amb. Norvegjeze	ADA	CFD	IOM ¹	Amb. Holand.	Amb. Finland.	Totali
Koalicioni i strehimoreve	2011	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	€59,884	€110,000	-	€169,884
	2012	-	€20,000 ²	-	-	-	-	-	-	-	-	€14,971	-	-	€34,971
CPWC (Prishtinë)	2011	€15,000	€4,500	Strehim	€20,000	-	-	-	-	-	-	€9,478	-	-	€28,978
	2012	€15,000	-	Strehim	€10,002	-	-	-	-	-	-	-	-	-	€25,000
CPWC (Mitrovicë)	2011	€15,000	€4,500	€3,000	-	-	-	-	€10,000	-	-	€9,475	-	-	€41,975
	2012	€15,000	-	Strehim	-	-	-	-	€15,000	-	-	-	-	-	€30,000
Qendra për Mirëqenien e Grave (Pejë)	2011	€15,000	-	€75,000	-	-	-	-	-	-	€83,000	-	-	-	€173,000
	2012	€15,000	-	-	-	-	-	-	-	-	€57,000	-	-	-	€72,000
Shtëpia e Sigurt (Gjakovë)	2011	€15,000	-	€5,000	-	-	€25,000	-	-	-	-	€11,583	€14,000	-	€65,583
	2012	€15,000	-	-	-	-	€25,000	-	-	-	-	-	-	-	€40,000
Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve (Prizren)	2011	€15,000	-	€4,800	-	-	-	-	-	-	-	€34,034	-	-	€53,834
	2012	€15,000	-	€2,000 + strehim	-	-	-	€17,665	-	-	-	€16,542	-	-	€51,207
Liria (Gjilan)	2011	€15,000	€4,500	€10,000	-	€34,899	-	-	-	€115,000	-	€44,588	-	-	€223,987
	2012	€15,000	-	€10,000 + strehim	-	€13,500	-	-	-	€46,000	-	€16,509	-	-	€101,009
SDSF (Prishtinë)	2011	€21,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	€14,943	-	-	€35,943
	2012	€21,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	€16,119	-	-	€37,119
PVPT (Prishtinë)	2011	€17,000	-	-	-	-	-	-	€5,030	-	-	€15,292	-	€86,472	€123,794
	2012	€17,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	€16,495	-	-	€33,495

¹ IOM i ka financuar strehimoret përmes Programit të Kosovës Kundër Trafikimit (KKT), të përkrahur nga USAID. Me financim janë trajtuar viktimat e trafikimit dhe viktimat potenciale të trafikimit, përfshirë personat që kanë pësuar dhunë në familje. Mirëmbajtja e operacioneve të përgjithshme të strehimoreve varet nga IOM-i. Në vitin 2009 USAID/IOM ka përkrahur tri OJQ që operonin me strehimore në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren dhe Gjilan (€129,938). Në vitin 2012, ata përkrahën katër strehimore në Prizren, Gjilan dhe Prishtinë (€131,329). Përkrahja e IOM-it për strehimoret u ndërpre më 31 maj 2012. IOM-i ka vlerësuar qëndrueshmërinë e strehimoreve në vitin 2009 (intervista të RRGK-së me USAID dhe IOM, mars 2012). Në vitet 2011-2012, falë financave të siguruara nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës, IOM-i u përpoq që t'ia zhvillojë kapacitetet e Koalicionit për avokim, mentorim, ofrim të shërbimeve, koordinim dhe rehabilitim (€74,855). Kjo përfshinte planifikimin strategjik, koordinimin, ndërtimin e kapaciteteve, një vizitë studimore në Shqipëri dhe takime me zyrtarë.

² Kjo do të shpërndahet strehimoreve individuale (jo koalicionit), por është e paqartë cilave strehimore.

Si përmbledhje, financat e ndara nga qeveria dhe donatorët për tetë strehimoret për vitin 2011 arrinin shumën prej **€916,978**, nga të cilat **74% u dhanë nga donatorët**. Siç paraqitet në diagramin 9, ekzistojnë dispanca në financim mes strehimoreve dhe në periudha të ndryshme kohore. Financimi i strehimoreve duket se ka rënë për më shumë se përgjysmë në vitin 2012, duke arritur shifrën prej **€424,801**, nga të cilat **62% ende sigurohen nga donatorët**. Rënia e theksuar në financim mund t'i atribuohet pjesërisht investimeve infrastrukturore të cilat u bënë në vitin 2011 (p.sh. ndërtimi i strehimores së re në Pejë), por kryesisht janë rezultat i mosvazhdimt apo tkurrjes së programeve të donatorëve.¹ Kjo vë në spikamë faktin kyç se **financimet nga donatorët në Kosovë nuk janë të qëndrueshme**,² dhe se qeveria urgjentisht duhet të përcaktojë koston dhe të ndajë buxhetin për shpenzimet e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.



Anëtarët e koalicionit të strehimoreve vazhdojnë të avokojnë për financim qeveritar të të gjitha shpenzimeve operative bazike.³ Ata kanë kalkuluar se kushton **€30 për 24 orë** shërbimi për një viktime, në mënyrë që atyre tu ofrohen të gjitha shërbimet e nevojshme, dhe se për financimin e tetë strehimoreve do të nevojiteshin €1,200,000 në vit.⁴ Ministritë i kanë thënë Koalicionit se nuk kanë fonde në dispozicion. Anëtarët e koalicionit janë takuar me DSHMS-të për të parë nëse planet financiare të komunave do të mund të përfshinin grante për të mbuluar kostot operative të strehimoreve. *UNDP WSSI* planifikon të llojë pranë MF-së për të krijuar një sistem për financim të qëndrueshëm të strehimoreve (€3,874).

Përveç financimit të pamjaftueshëm, një tjetër zbrazëti e rëndësishme në mekanizmat mbrojtës është se **nuk ekzistojnë fare shërbime strehuese për meshkujt që vuajnë**

¹ Sipas PKT, në nëntor të vitit 2011, Zyra e BE-së në Kosovë ka filluar një projekt dyvjeçar për të përmirësuar reagimin institucional ndaj trafikimit (€803,500). Strehimoret do të trajnohen sa i përket ofrimit të shërbimeve dhe reintegrimit, por pa financim të drejtpërdrejtë. Vlera e saktë që ndërlidhet me dhunën në familje nuk ka mundur të përcaktohet (korrespondenca e RRGK-së me menaxherin përkatës, 11 maj 2012).

² Shih kapitullin 2.

³ Sipas Ligjit, neni 27: nën udhëheqjen e MPMS-së, ministritë janë përgjegjëse për të "përkrahur dhe zhvilluar strukturat ndihmëse dhe infrastrukturën e domosdoshme" për të mbrojtur personat ndaj të cilëve ushtrohet dhunë në familje

⁴ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të strehimores, 17 janar 2012. Në vitin 2010 ata kanë kalkuluar numrin mester të rasteve të strehuara për muaj, javë dhe ditë dhe të gjitha shërbimet e pranuar nga ta, bazuar në çmimet më të ulëta të tregut të punës (korrespondencë e RRGK-së me përfaqësues të strehimores, 25 korrik 2012). Këto kalkulime nuk përfshijnë SOS Kinderberg apo strehimoren e grave serbe, të cilat aktualisht nuk financohen dhe menaxhohen nga vullnetarë si OJQ.

dhunë në familje. Mesatarisht 240 raste të dhunës ndaj meshkujve/çunave i raportohen policisë çdo vit,⁵ por ata kanë fare pak shërbime në dispozicion. Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (KRCT), OJQ që ofron terapi psikologjike për meshkuj, raporton se nga meshkujt në aspektin kulturor pritet që "ta tejkalojnë atë":

Legjislacioni për dhunën në familje parasheh shërbime edhe për meshkuj. KRCT ka ofruar shërbime dhe terapi për meshkujt që kanë qenë viktimë të torturës dhe dhunës në familje. Megjithatë, për të ofruar shërbime për meshkujt, fillimisht duhet të ngritet vetëdija dhe të krijohen mekanizma përmes të cilëve meshkujt lejohen ta ngrisin zërin e tyre dhe të kërkojnë ndihmë. Është më e vështirë për meshkujt ngase ata frikësohen nga stigmatizimi. Të shprehurit në mënyrë të hapur do ta shkatërrojë egon e tyre dhe [ata frikësohen se] do të trajtohen si dështakë. Këto stereotipe do të mund të hiqeshin duke punuar me komunitetin.⁶

Normat gjinore sociale, sipas të cilave nga meshkujt kërkohet të jenë të fortë, nuk i lejojnë meshkujt që të flasin për dhunën që mund ta përjetojnë.

Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve nëpër strehimore, përfshirë shpenzimin efektiv dhe efikas të fondeve publike, është kyç për sigurimin e shërbimeve cilësore. Pasi që strehimoret përfitojnë nga fondet publike, të cilat grumbullohen nga taksapaguesit, MPMS do duhej të monitorojë rregullisht performansën programatike dhe financiare të tyre. MPMS kërkon nga strehimoret që t'ua dorëzojnë asaj të gjitha faturat për shpenzimet e bëra për klientët që janë viktimë të dhunës në familje, përfshirë shpenzimet e mbuluara nga donatorët.⁷ Megjithatë, nuk kryhen inspektime të rregullta; ato varen pjesërisht nga kompletimi i procedurave të licencimit për strehimoret. MPMS duhet të ndajë resurse të mjaftueshme për të monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë adekuate shërbimet e ofruara (p.sh. staf, trajnime, automjete, mjete të komunikimit).

Disa donatorë kanë komentuar se disa strehimore nuk kanë kapacitet për të menaxhuar fondet në mënyrë efikase dhe efektive. Për shembull, një strehimore pretendohet se ka shpenzuar tepër fonde për automjetet dhe staf. Të tjerat dukej se nuk kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e planifikimit ekzekutiv të buxheteve. Shumica e strehimoreve mund të përmirësojnë shkathësitë e tyre në fushën e kontabilitetit, dhe të përgatisin deklarata më të mira vjetore në të cilat skicohen qartë të gjitha burimet e përkrahjes financiare nga qeveria dhe donatorët.

Shërbimi Korrektues: Siguri për Viktimat, Rehabilitim për Autorët e Dhunës

Burgimi i autorëve të dhunës mund të shtojë nivelin e sigurisë së viktimave përkohësisht, por është jetësore që shërbimet korrektuese dhe sprovuese të rehabilitojnë autorët e veprave, në mënyrë që të parandalohet dhuna në të ardhmen.⁸ Shërbimi Korrektues mbikëqyrjet dhe financohet nga MD ndërsa ka për mandat organizimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të sanksioneve me burgim.⁹ Punëtorët e burgjeve trajnohen në Akademinë për Sigurinë Publike.

Shërbimi Korrektues ka kalkuluar se ofrimi i shërbimeve për një të burgosur kushton rreth **€28 për 24 orë**.¹⁰ Mbajtja në burg e një të burgosuri kushton €10,220 në vit. Për

⁵ Hulumtimi i RRGK-së ka dëshmuar se 39.6% të meshkujve kanë përjetuar dhunë në familje (*Siguria fillon në shtëpi*).

⁶ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të KRCT-së, 20 mars 2012.

⁷ *Po aty*.

⁸ Shih kapitullin 5 për më shumë informata mbi Shërbimin Sprovues.

⁹ *Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale*, Nr 03/L-191, neni 203, paragrafi 1.1.

¹⁰ Kjo përfshin ushqimin, akomodimin, trajnimin profesional dhe pagat e punëtorëve (intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e Shërbimit Korrektues, 6 shkurt 2012). Zyrtarët e Shërbimit korrektues kanë kërkuar paga më të mira dhe kompensim të punës së natës dhe kompensim për rrezikshmëri në detyrë (RTK, 1 gusht 2012).

veprën e lëndimeve të lehta trupore, autorët zakonisht dënohen me burgim për tre muaj,¹¹ ndërsa që numri i të burgosurve që vuajnë dënime për krime të ndërlidhura me dhunën në familje mbetet i panjohur. Rrjedhimisht, mund të supozohet se kostoja e burgimit të autorëve të dhunës në familje kushton së paku **€131,040 në vit**.¹²

Konkluzione: Mbrojtja e Viktimave të Dhunës në Familje, Ndjekja Penale e Autorëve Gjithsej shteti (€1,240,658) dhe donatorët (€847,923) kanë shpenzuar së paku **€2,088,581** në mbrojtje dhe ndjekje penale gjatë vitit 2011. Këto parashikime nuk përfshijnë shumë kosto tjera të paidentifikueshme. Në vitin 2012 shpenzimet për aktivitete që ndërlidhen me mbrojtjen pritet të zvogëlohen në rreth €1,760,929, përfshirë €1,160,768 nga shteti dhe €600,161 nga donatorët.¹³ Në vitin 2013, institucionet planifikojnë të rrisin alokimet buxhetore për ndihmë ligjore dhe MV-të, duke kontribuar në shpenzimet e rritura për mbrojtje (€1,619,508 në total).

Disa aktivitete të ndërlidhura me mbrojtjen, që parashihen sipas Strategjisë të realizohen mes viteve 2011 dhe 2014, ende nuk janë zhvilluar dhe nuk janë buxhetuar: një studim mbi mbulueshmërinë me shërbime për viktimat e dhunës në familje; zhvillimin e vendbanimeve sociale;¹⁴ krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit mes komunave për të strehuar viktimat; pajisjet e domosdoshme; hapësirën e domosdoshme për të trajtuar rastet; marrëveshjet e bashkëpunimit mes institucioneve të përfshira në trajtimin e rasteve të dhunës në familje; dhe PSO-të për trajtimin e viktimave.

Për më tepër, në këtë kapitull janë detajuar mungesat në resurse njerëzore dhe financiare të cilat i pengojnë institucionet në përmbushjen e roleve dhe përgjegjësisë të tyre. Çdo institut ka për obligim identifikimin e mënyrës se si do të ndajnë burime të mjaftueshme për t'i mbrojtur viktimat dhe ndjekur autorët e krimit. Kjo përfshin sigurimin e të ardhurave apo menaxhimin e buxheteve ekzistuese në mënyrë më efikase, për të mbuluar edhe shërbimet që aktualisht financohen nga donatorët. "Investimet" e hershme në mbrojtje mund të ndihmojnë në shkurtimin e shpenzimeve të mëvonshme për mbrojtje, ndjekje penale dhe rehabilitim.

¹¹ Në bazë të të dhënave në dispozicion, në vitin 2008 gjykatat kanë burgosur 52 autorë të krimeve kundër jetës dhe trupit. (RRGGK, *Më shumë se "fjalë në letër"?*, faqet 41-43). Krimet tjera mund të ngërthejnë dënime më të gjata.

¹² Kjo është kalkuluar si €28 në ditë, për 90 ditë, shumëzuar me 52 të burgosur të ditur për vitin 2008.

¹³ Një pjesë e fondeve të Programit GBV të UNKT nuk mund të ndaheshin mes viteve 2012 dhe 2013. Për këtë arsye, janë bërë disa parashikime të vrazhda të cilat mund të mos korrespondojnë saktësisht me aktivitetet.

¹⁴ MF dhe komunat nënshkruan një marrëveshje mirëkuptimi për të ndarë tokën për ndërtimin e shtëpive kolektive. Një komision me përbërje të përfaqësuesve të ministrisë dhe komunave i përzgjedh përfituesit bazuar në kriteret e parapërcaktuara (korrespondencë e RRGK-së me zyrtarë, korrik 2012). "Rasteve sociale" trajtohen me prioritet, por nuk është e qartë nëse këtu përfshihen viktimat e dhunës në familje. Për shembull, Rregullorja për "ndarjen e banesave në Komunën e Prishtinës, të cilat do të shfrytëzohen me qira nga rastet sociale," i vitit 2010, nuk përmend specifikisht viktimat e dhunës në familje.

Kapitulli 5.

Rehabilitimi dhe Reintegrimit

Rehabilitimi nga dhuna në familje dhe reintegrimit në shoqëri kërkon një qasje afatgjatë, shumëdimensionale në kuptim të fuqizimit social, fizik, ekonomik dhe politik. Shtylla e Rehabilitimit dhe Reintegrimit në Strategji mëton të sigurojë "shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe autorëve të dhunës në familje"; dhe "rehabilitimin dhe integrimin permanent të viktimave të dhunës në familje." Strategjia identifikon disa veprime me të cilat do të shtohet cilësia e shërbimeve për viktimat të dhunës në familje dhe do të ofrohet trajtim profesional për autorët e dhunës së tillë, gjë që përshpejton integrimin e tyre në shoqëri. Ky kapitull shtjellon kornizën ligjore dhe politike, reagimin institucional dhe ndarjet buxhetore lidhur me aspekte të ndryshme të rehabilitimit dhe reintegrimit, përfshirë këtu shëndetësinë, arsimin, fuqizimin ekonomik dhe përkrahjen e komunitetit. Ngjashëm me Ligjin dhe Strategjinë, ky kapitull poashtu shtjellon programet për rehabilitimin dhe reintegrimit të autorëve të dhunës në familje.

"Kur viktimat raportojnë rastin, ajo duhet të ballafaqohet me policinë, strehimoren, mbrojtësin e viktimës, Qendrën për Punë Sociale, prokurorin, gjykatën ... Në fund çfarë ndodh? Ajo kthehet në shtëpi. Pse? Ajo nuk mund të integrohet në shoqëri. Ajo nuk ka arsimim profesional, nuk mund të gjejë punë dhe nuk ka një vend për jetesë."

– Zyrtar i Policisë së Kosovës

Kujdesi Shëndetësor Drejt Rehabilitimit

Për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje janë të rëndësishme edhe kujdesi i shëndetit fizik edhe ai i shëndetit psikik. Viktimat ndodh që duhet trajtuar me muaj, madje edhe vite të tëra pas incidentit të dhunshëm.¹ Trajtimi i tillë ndërthet shpenzime substanciale që vështirë mund të përcillen me kalimin e kohës.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) ofron kujdesin shëndetësor primar, sekondar dhe terciar. Institucionet e shëndetit primar përfshijnë qendrat e mjekësisë familjare, klinikat, qendrat emergjente, farmacitë dhe qendrat e rehabilitimit. 36 komunat e Kosovës kanë Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) të cilat ofrojnë shërbime të shëndetit primar.² Këto qendra komunale kanë doktorë të mjekësisë së përgjithshme, mjekësisë familjare dhe gjinekologjisë.³ Institucionet e mjekësisë sekondare përfshijnë spitalet,

¹ RRGK, *Hulumtim Mbi Shtrirjen e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe Ndikimin e saj në Shëndetësinë Riprodhues të Grave*.


² Ato ofrojnë shërbime shëndetësore për pacientë që vuajnë nga sëmundje, çrregullime dhe lëndime që mund të kenë ndikim serioz në jetën e tyre (neni 22.2). Duhet të hartohet një akt nënligjor i veçantë për asistimin dhe ofrimin e shërbimeve që ndërliken me rehabilitimin e tyre nga disa sëmundje dhe lëndime të caktuara. Ende nuk është nxjerrë ndonjë akt i tillë nënligjor.

³ Aktet nënligjore të ministrisë përkufizojnë standardet organizative dhe funksionimin e qendrave mjekësore. Qendrat dhe pikat e mjekësisë familjare (QMF) gjithashtu ofrojnë shërbime të shëndetësisë primare. QKMF-të në

qendrat e shëndetit mjekësor, shërbimet e diagnostifikimit, arsimit, qendrat e komunitetit dhe qendrat speciale integruese. Ato ofrojnë kujdes diagnostik, terapeutik dhe rehabilitues. Kosova ka shtatë spitale me qendra emergjente. Në nivelin terciar gjendet Qendra Klinike Universitare.⁴

Shërbimet cilësore shëndetësore do duhej t'i shërbejnë zvogëlimit të mungesave nga puna për shkak të sëmundjeve apo lëndimeve dhe të zvogëlojnë normën e mortalitetit infantil apo maternal.⁵ Dhuna në familje mund të ndikojë negativisht në shëndetin e nënave dhe fëmijëve.⁶ Për këtë arsye, identifikimi sa më i hershëm i shenjave të dhunës në familje dhe intervenimi me qëllim të parandalimit të dhunës mund të rezultojë me zvogëlim të shpenzimeve të duhura për shërbime shëndetësore në aspekt afatgjatë. Zvogëlimi i numrit të ditëve që mungohet nga puna (p.sh. për shkak të dhunës në familje) përmes shërbimeve cilësore shëndetësore poashtu ka implikacione ekonomike. Viktimat e dhunës në familje kërkojnë trajtim të posaçëm, dhe një qasje që merr parasysh pozitën e tyre shpesh të cenueshme dhe nevojat e tyre për privatësi. MSH duhet të hartojë aktet nënligjore për të përmbushur këto përgjegjësi.

Diagrami 10. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor në Kosovë: Strukturat dhe Burimet e Fondeve



MSH ka hartuar një protokoll për tu ndihmuar viktimave të dhunës në familje, por finalizimi i tij është vonuar për shkak të resurseve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore.⁷ Më pastaj, në vitin 2012, një protokoll u hartua me përkrahje financiare dhe teknike nga UNFPA, në bashkëpunim me RRGK-në. Në vitin 2012, MSH ndau €3,000 për përpilimin e protokolleve për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe €10,000 për

komuna të cilat nuk kanë qasje të lehtë në spitale kanë edhe qendra të maternitetit dhe qendra të mirëqenies sociale (*Ligji për Shëndetësinë*, neni 29.3).

⁴ *Ligji për Shëndetësinë*, neni 74.

⁵ *Po aty*, neni 25.

⁶ RRGK, *Hulumtim Mbi Shtrirjen e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe Ndikimin e saj në Shëndetësinë Riprodhues të Grave*.

⁷ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të MSH-së, 25 janar 2012.

trajnimin e 150,000 punonjësve shëndetësorë në trajtimin e viktimave. Përmes RRGK-së, UNFPA po përkrahë dizajnimin e planprogramit dhe trajnimeve deri në fund të vitit 2013.⁸ MSH duhet të alokojë fonde tjera për të institucionalizuar trajnimet për të gjithë punonjësit në shërbime shëndetësore. Duke qenë se potencialisht mund të jenë pikat e para të kontaktit me viktimat e dhunës në familje, personeli i shërbimit emergjent, gjinekologët dhe mjekët e praktikës së përgjithshme duhet të trajnohen për të pasur një qasje adekuate psikopatike ndaj trajtimit të viktimave dhe mekanizmave referues përkatës. MSH poashtu duhet të ndajë buxhet për monitorimin dhe vlerësimin e këtyre mekanizmave.

Në tërë sistemin e kujdesit shëndetësor, MSH do duhej të mbulojë shpenzimet e trajtimit, transportit dhe menaxhimit të të dhënave. Siç paraqitet në diagramin 10, drejtoritë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale (DSHMS) financojnë shëndetësinë primare, pasi që fondet i marrin nga MSH, buxheti komunal dhe granti qeveritar për shëndetësi që merret nga Buxheti i Kosovës. Shëndetësia sekondare dhe terciare financohen drejtpërdrejt nga MSH. Donatorët potencialisht i kontribuojnë këtij buxheti përmes ndihmës bilaterale, por qeveria i grumbullon këto të ardhura brenda buxhetit të Kosovës, kështu që kontributi i saktë i donatorët në shëndetësi nuk mund të kalkulohet.

Përveç kujdesit shëndetësor fizik, MSH është përgjegjëse edhe për ofrimin e trajnimeve psikologjike, si shërbim shëndetësor sekondar.⁹ Ligji nuk jep ende ndonjë përkufizim të shëndetit mendor. Megjithatë, në Kosovë ekzistojnë gjashtë qendra të shëndetit mendor, të cilët administrohen nga Departamenti për Shërbime Shëndetësore dhe MSH.¹⁰ Ato diagnostikojnë dhe trajtojnë pacientët me të meta mendore, por edhe ofrojnë këshillime psikologjike për të gjithë ata që kërkojnë shërbime të tilla.¹¹ Ato u ofrojnë pacientëve trajtim nëpër shtëpitë e tyre apo në qendrat përkatëse. Qendrat kanë edhe punëtorët socialë që monitorojnë rastet dhe angazhojnë familjet e pacientëve. Departamenti për Shërbime Shëndetësore nuk ka marrëveshje mirëkuptimi apo procedura standarde operative për trajtimin e dhunës në familje. Përfaqësuesit e qendrave për shëndet mendor thanë se dhuna në familje është e pranishme në pothuajse të gjitha rastet që i trajtojnë, por ata nuk i regjistrojnë rastet si të tilla. As MSH nuk u ka kërkuar ndonjë raport mbi paraqitjen e dhunës në familje mes pacientëve. Sfidat kryesore të këtij departamenti është numri i kufizuar i punëtorëve: "Ne kemi vetëm dy doktorë për 1,000 pacientë," tha për RRGK një përfaqësues. Përfaqësuesit e strehimoreve poashtu kishin probleme në identifikimin e psikologëve të trajnuar dhe me përvojë që do të punonin me klientët e tyre.¹² Jashtë sistemit shëndetësor publik disa OJQ, përfshirë edhe strehimoret, ofrojnë këshillime psikologjike, me çmim prej përafërsisht €30 për seancë.¹³

Përfaqësuesit të institucioneve shëndetësore kanë thënë se përballen me sfida të shumta, përfshirë, mungesën e një sistemi të udhëzimeve, mungesën "enorme" të infermiereve, hapësirat e pamjaftueshme të punës, infrastrukturën e dobët dhe pajisjet joadekuate.¹⁴ Për më tepër, punonjësit shëndetësorë nuk ruajnë gjithmonë konfidencialitetin e informatave personale të pacientëve.

MSH nuk duket se është tepër aktive në monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara. "Ata nuk e ushtrojnë këtë detyrë," tha një respondent për RRGK, "ose e ushtrojnë atë nga zyrat e tyre në Ministri. Shërbyesit civilë kurrë nuk dalin në terren për t'i kontrolluar fizikisht shërbimet." Janë të shumtë faktorët që kanë kontribuar në monitorimin joadekuat,

"Ne kemi kërkuar shtimin e numrit shumë herë, por kjo ka qenë e pamundshme të realizohet përmes Buxhetit të Kosovës."
– Përfaqësuesi i Qendrës Emergjente

⁸ Kjo përfshin €5,933 për staf dhe €3,195 shpenzime operative për UNFPA, €4,183 për stafin e RRGK-së dhe €3,803 për shpenzime indirekte të RRGK-së.

⁹ *Ligji për Shëndetësinë.*

¹⁰ Komunikim i RRGK-së me përfaqësues të Qendrës për Shëndet Mendor, 27 korrik 2012.

¹¹ *Po aty.* Asnjë ligj nuk i rregullon këto shërbime në detaje.

¹² Grupi punues RRGK/UNDP, "Me çfarë çmimi?"

¹³ Korrespondencë e RRGK-së me tri OJQ, qershor-korrik 2012.

¹⁴ Intervista dhe vrojtime të RRGK-së, 2012.

përfshirë derivatet e pamjaftueshme, veturat e pakta dhe mungesën e shkathtësive menaxhuese. Klinikat private nuk mbikëqyren as aq. Kjo ka bërë që punëtorët shëndetësorë edhe në sektorin privat edhe në atë publik t'ua shkelin të drejtat pacientëve.¹⁵ **MSH duhet të ndërmerret një rol më aktiv dhe të monitorojë cilësinë e shërbimeve shëndetësore të ofruara**, gjë që mund të kërkojë më shumë resurse.

Monitorimi i pamjaftueshëm e ka penguar zhvillimin e ndonjë praktike cilësore të grumbullimit të të dhënave.¹⁶ Edhe pse institucionet shëndetësore i regjistrojnë rastet në regjistrat e tyre, aty nuk përfshihen informata mbi incidentet potenciale apo të vërtetuara të dhunës në familje. Doktorët mund ta kontaktojnë policinë nëse dyshojnë se lëndimet e pacientit janë shkaktuar nga dhuna në familje, por udhëzimet e tilla nuk regjistrohen.¹⁷ Për më tepër, dokumentimi në tërë sistemin shëndetësor është mjaft i dobët, tha një respondent:

Nuk ka llogaridhënie. Askush nuk përpiqet që të klasifikojë të dhënat dhe t'i raportojë ato të dhëna në Qendrën për Mjekësi Familjare. Para luftës, në kohën e Jugosllavisë, institucionet ishin të obliguara me ligj që të raportojnë. Nëse nuk raportonin në Institutin për Shëndet Publik, ato paguanin gjoka. Edhe tani ekziston ligji, por nuk funksionon. Ligjërisht, ata janë të obliguar që të raportojnë, por pasi që asnjë institucion nuk i zbaton këto obligime, ato thjeshtë nuk e bëjnë këtë.¹⁸

Një tjetër respondent vazhdoi:

Ata kanë investuar shumë para në krijimin e një sistemi informativ, por pastaj nuk patën më para për ta mirëmbajtur atë sistem; rrjedhimisht, sistemi i shkatërrua para nja katër vitesh. Kësisoj, ata nuk raportojnë mbi ngarkesat në punë dhe nuk e shfrytëzojnë sistemin e OBSH-së për klasifikimin e sëmundjeve. Situata është vërtetë dramatike.

Doktorët dhe infermieret nuk kanë përshkrime të qarta të vendeve të punës, të cilat do të mund t'i detyrojnë që të grumbullojnë dhe raportojnë të dhënat përkatëse.

MSH urgjentisht duhet të alokojë buxhet të mjaftueshëm për të tejkaluar çështjet që ndërliken me sistemin informativ; për të trajnuar punëtorët shëndetësorë në grumbullimin e të dhënave dhe praktikat konfidenciale; për të qartësuar mandatin e profesionistëve shëndetësorë, në mënyrë që ta përshijë edhe grumbullimin e të dhënave dhe raportimin e rregullt të tyre; dhe për të monitoruar aktivisht implementimin e politikave adekuate të grumbullimit të të dhënave. Edhe pse këto janë të rëndësishme për sistemin shëndetësor në përgjithësi, ato gjithashtu do t'u mundësonin punëtorëve shëndetësorë që të identifikojë dhunën dhe t'i udhëzojnë viktimat për asistencë, gjë që do të parandalonte shfaqjen e dhunës në të ardhmen (dhe shpenzimet tjera të mëvonshme në sistemin shëndetësor). Grumbullimi i të dhënave gjithashtu ndihmon në përcjelljen e numrit të rasteve të dhunës në familje, gjë që mund të lehtësojë planifikimin buxhetor.

Strategjia parasheh ofrimin e medikamenteve dhe ekzaminimeve pa pagesë për viktimat e dhunës në familje që akomodohen në strehimore.¹⁹ Ligji për Shëndetësinë më pastaj thekson se kujdesi shëndetësor duhet të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët dhe se

¹⁵ Intervista të RRGK-së me OJQ të grave dhe strehimore, 2012.

¹⁶ Të dhënat mbi indikatorët shëndetësorë duhet t'i raportohen MSH-së, e cila menaxhon Sistemin Informativ Shëndetësor (që rregullohet me *Ligjin për Shëndetësinë, Ligjin për të Drejtat dhe Obligimet e Qytetarëve në Kujdes Shëndetësor* dhe UA 18/2006 për *Bazën e të Dhënave të Sistemit Informativ Shëndetësor dhe Rregullimin e Brendshëm të Punës në Institucione*).

¹⁷ Intervista të RRGK-së me Qendrën Mjekësore Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, 15 janar 2012.

¹⁸ Intervistë e RRGK-së, mars 2012.

¹⁹ Strategjia, f. 61, O.S. 1, 3.3.

duhet të krijohet sistemi i sigurimit themelor shëndetësor të obligueshëm.²⁰ Realizimi i kësaj kërkon shumë mjete buxhetore, të cilat parashihet të vijnë nga Buxheti i Kosovës, buxhetet komunale dhe bashkëfinancimi i punëtorëve dhe qytetarëve.²¹ Pasi që Kosova ende nuk ka ligjin për sigurimin shëndetësor, ende kanë mbetur pa u specifikuar lloji i kujdesit që duhet ofruar, kujt i duhet ofruar dhe për sa gjatë. Ndryshimet mund të shfaqen pas fillimit të zbatimit të Ligjit për Shëndetësinë.

Pjesërisht për shkak të praktikave të dobëta në grumbullimin e të dhënave, ***kostoja e saktë e kujdesit shëndetësor për viktimat e dhunës në familje nuk mund të kalkulohet*** pasi që sëmundjet, lëndimet dhe trajtimet dallojnë shumë nga rasti në rast. Problemet shëndetësore të rishfaqura duhet të trajtohen në periudha të gjata kohore, gjë që e bën të vështirë përcjelljen e shpenzimeve.²² Përveç shpenzimeve të institucioneve shëndetësore, viktimat kanë edhe shpenzime 'nga xhepi' të cilat nuk janë shtjelluar me këtë rast.

Në praktikë, shërbimet primare shëndetësore mund të kushtojnë mes katër euro për një kontroll të thjeshtë deri në €500 për trajtim më të thuktë.²⁴ Ofruesit individualë të kujdesit shëndetësor publik duket se përcaktojnë koston e kujdesit shëndetësor për viktimat të dhunës në familje. Në Mitrovicë, drejtori i strehimores poashtu shërben si zëvendësshef i QKMF-së. Për këtë arsye shërbimet shëndetësore ofrohen në strehimore apo në spital për çmime të ulëta apo pa pagesë fare. Në Gjilan. Strehimorja ka nënshkruar MM me DSHMS, spitalin rajonal dhe klinikën e mjekësisë familjare, gjë që u mundëson klientëve trajtim me prioritet dhe pa pagesë. Në anën tjetër, në Gjakovë, përfaqësuesit e strehimores kanë raportuar se paguajnë për të gjitha shërbimet shëndetësore. Edhe pse kanë marrëveshje për ofrim të shërbimeve shëndetësore primare, spitali refuzon ofrimin e shërbimeve pa pagesë për shkak se viktimat e dhunës në familje nuk gjenden në listën e kategorive që gëzojnë shërbime pa pagesë. Për më tepër, përfaqësuesit e strehimores thanë se shumë shërbime të rëndësishme nuk ofrohen fare nga klinikat publike (p.sh. ultrazëri, shërbimet stomatologjike). Ata janë dashur të paguajnë për këto shërbime në klinika private, gjë që një strehimoreje i ka kushtuar €4,800 në vit. Strehimoret gjithashtu kanë raportuar të kenë paguar për medikamente.²⁵

Tabela 9. Çmimet e shërbimeve shëndetësore publike²³

Trajtimi	Kosto
Kontroll i përgjithshëm	€4
Analiza laboratorike	-
Ekzaminim i stomakut	-
Ekzaminim ortopedik	€4
Vizitë emergjente	-
Trajtim për abort spontan	-
Lindje	-
PAP test	-
Test vaginal	-
Mamografi	€6-€7
Trajtim i dhunës seksuale	-
Trajtim i shtypjes së gjakut	-
Mjekim për pacientë të shtrirë	-
Rëntgen	€20

²⁰ Ligji për Shëndetësinë, nenet 7.1 dhe 7.2.

²¹ Ligji për Shëndetësinë, neni 7.2.

²² RRGK, *Hulumtim Mbi Shtrirjen e Dhunës në Baza Gjimore në Kosovë dhe Ndikimin e saj në Shëndetësinë Riprodhues të Grave*. Përfaqësuesit e strehimoreve kanë vlerësuar se klientët mesatarisht kanë pranuar mes katër dhe pesë shërbime mjekësore gjatë qëndrimit të tyre në strehimore (Korrespondencë e RRGK-së, 2012).

²³ Korrespondencë e RRGK-së me zyrtarin e MSH-së, korrik 2012. Ata po krijojnë një çmimore të re sepse çmimet aktuale janë tepër të ulëta. Personat që marrin asistencë sociale nga shteti i gëzojnë të gjitha shërbimet pa pagesë.

²⁴ Intervistë e RRGK-së me një punëtor shëndetësor, mars 2012. Përveç shërbimeve të zakonshme, në vitin 2012 MSH zotoi €14,500 specifikisht për aktivitete që ndërlihen me dhunën në familje. MSH trajnon punonjësit e strehimores në ofrimin e ndihmës së parë, kuptimin e rasteve klinike dhe mbrojtjen nga sëmundjet seksuale dhe HIV-i, siç parashihet në Strategji (€1,000) (korrespondencë e RRGK-së me përfaqësuesin e Departamentit për Buxhet dhe Financa, 17 prill 2012).

²⁵ Intervistë e RRGK-së me një përfaqësues të strehimores, 1 shkurt 2012.

Në rastet kur viktimat e dhunës në familje kanë nevojë për shërbime shëndetësore dytësore, edhe ato edhe strehimoret kanë probleme me pagesën. "Shërbimet shëndetësore sekondare janë të shtrenjta," tha një përfaqësues i QKMF-së. "Ne do duhej të kemi një MM mes Ministrisë dhe strehimores për këto shërbime, të cilat do duhej të na ofrohen pa pagesë, ngjashëm me shërbimet shëndetësore primare."²⁶

"Institucionet duhet të kenë një qasje më pozitive kundrejt viktimave të dhunës në familje. Do duhej të nënshkruhej një vendim nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, përmes së cilit viktimat e dhunës në familje do të mund të gëzonin shërbime pa pagesë... Ne duhet t'i mbulojmë këto gjëra me ligj."
- Përfaqësues i QKMF

Ajo që brengosë është fakti se Strategjia pretendon se shërbimet shëndetësore nuk ngërthejnë "kosto". Disa aktivitete të tilla janë përfshirë në aktivitetet ekzistuese institucionale. Megjithatë, përshkrimi i këtyre shpenzimeve si shpenzime pa pagesë do të thotë injorim i shpenzimeve që ndërlidhen me personelin, monitorimin, trajtimin dhe medikamentet që i jepen viktimave; RRGK vlerëson se të gjitha këto kategori janë të nënfinancuara. Strategjia do duhej të merr parasysh kostot e mëdha që sistemi shëndetësor ka në kuptim të rehabilitimit të viktimave të dhunës në familje. Edhe Ligji do të mund të amendamentohet, për tu mundësuar gjykatave që të shqiptojnë masa me të cilat autorët e krimeve do të ishin përgjegjës për mbulimin e shpenzimeve të viktimave sa i përket shërbimeve shëndetësore. Viktimat do duhej të kenë mundësi që të kërkojnë kompensim përmes procedurave civile.

MASHT: Arsimimi Drejt Fuqizimit Ekonomik dhe Reintegrimit

Pasi që arsimit dhe punësimi janë gjithësi të ndërlidhura mes veti, ofrimi i arsimit cilësor është kyç për fuqizimin e viktimave në procesin e reintegrimit. Kjo gjë përmendet edhe në Strategji, sipas së cilës MASHT-i do duhej të ofrojë trajnime profesionale, shërbime dhe kualifikime profesionale për viktimat e dhunës në familje, për të lehtësuar rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre. Përfitimet financiare për qeverinë e Kosovës, në rast të financimit të arsimit të tyre, do të ishin marramendëse: duke arsimuar personat që kanë pësuar dhunë në familje, MASHT-i investon në fuqizimin e tyre ekonomik dhe pavarësimin e tyre financiar. Kjo u mundëson integrim në shoqëri dhe i largon ata nga varësia prej asistencës shtetërore.

Komunat financojnë shkollat fillore dhe të mesme përmes drejtorive të arsimit. Qeveria ia siguron grantin e arsimit drejtpërdrejt komunave. Strategjia thotë se drejtoritë komunale të arsimit duhet të marrin pjesë në hartimin e politikave në nivel lokal, me qëllim të parandalimit të dhunës në familje dhe mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimeve për viktimat dhe autorët e saj. MASHT-i nuk duket se ka ndarë resurset për të përpiluar një UA që do të rregullonte se si viktimave të dhunës në familje do t'ju ofrohen "orë plotësuese" gjatë qëndrimit apo pas largimit nga strehimoret. Aktualisht, viktimat që pranojnë asistencë sociale mund të regjistrohen për arsimim joformal pa pagesë.²⁷ Viktimat e moshës madhore kryesisht marrin pjesë në orë plotësues pa pagesë, por duhet të paguajnë për provimet përfundimtare që kërkohen për të marrë certifikatat përkatëse.²⁸

Sa i përket fëmijëve që kanë pësuar nga dhuna në familje dhe fëmijëve të viktimave të dhunës në familje, strehimoret thanë se siguri i qasjes në arsim për ta mund të jetë sfiduese. Megjithëse mes strehimoreve dhe shkollave ka bashkëpunim, ato ende nuk kanë protokolle referimi.²⁹ Duke qenë se nuk ka ndonjë UA që këtë çështje do ta rregullonte në nivel shtetëror, arsimimi për viktimat e dhunës në familje varet në masë të gjerë nga vullneti autoriteteve komunale dhe drejtorëve të shkollave. Në disa raste, strehimoret kanë pasur marrëdhënie të mira me drejtorë të shkollave dhe kjo u ka siguruar qasje. Megjithatë,

²⁶ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të QKMF-së, 21 mars 2012.

²⁷ Intervistë e RRGK-së me Intervistë e RRGK-së me Zyrtarin për Çështje Gjinore, MASHT, 12 janar 2012.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ Intervistë e RRGK-së me SDSF, 24 janar 2012.

drejtorët nuk i miratojnë çdo herë kërkesat e strehimoreve. Për shembull, në Gjilan një shkollë nuk i ka pranuar dy fëmijë në shkollë për shkak se ka vlerësuar se kjo do t'i rrezikonte fëmijët tjerë.³⁰ Disa fëmijë që banojnë në strehimore nuk ishin në gjendje të vijnë në mësimin ngase frikësoheshin se autorët e dhunës do të mund të vinin në shkollë, ndërsa edhe shkollat hezituan të dërgojnë mësimdhënësit në strehimore.³¹ Moslejimi i vijimit të shkollimit për fëmijët paraqet shkelje të së drejtës së tyre për arsimim.³² MASHT-i, në bashkëpunim të ngushtë me akterët relevantë, duhet të identifikojë procedurat përmes së cilave të gjithë fëmijëve do tu sigurohet qasje në arsimim, duke marrë parasysh brengat që ndërlidhen me sigurinë.

Në disa raste, MASHT-i ka ofruar përkrahje dhe asistencë të kufizuar financiare për arsimimin e fëmijëve që janë viktimat të dhunës në familje. Në një rast, një vajzë dhe një çun në shkollë të mesme nuk mund të qëndronin më në strehimore për shkak të moshës së tyre.³³ Njësia për të Drejtat e Njeriut në MASHT koordinoi me Universitetin e Prishtinës dhe Komunën e Prishtinës sigurimin e akomodimit të tyre në konviktet e studentëve si dhe mbulimin e shpenzimeve për ushqim dhe arsimim për ta. Pas regjistrimit në universitet, çunitiu dha një bursë njëvjeçare nga Komuna e Prishtinës, e cila ia mbulonte akomodimin dhe ushqimin. Megjithatë, në përgjithësi as MASHT-i e as universitetet private nuk kanë për obligim përkrahjen e viktimave të dhunës në familje apo familjeve të tyre. Kësisoj, asistencat që ofrohet në raste të caktuara varet nga vullneti i mirë i përfaqësuesve institucionalë.³⁴

MASHT-i do duhej të hartojë një UA për të përkrahur implementimin e Ligjit dhe Strategjisë, duke u mundësuar komunave reagim më të mirë në rastet kur fëmijët udhëzohen në sistemin arsimor. Kjo UA do të mund të rregullonte bashkëpunimin me strehimoret dhe QPS-të, bazuar në obligimin e tyre ligjor për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve. Kjo UA do duhej të përfshijë subvencionet arsimore për fëmijët e viktimave, në rastet kur QPS-të beson se fëmijët do të gjendeshin në rrezik në rast të kthimit në shtëpitë e tyre të dhunshme. Sigurisë së fëmijëve duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë, posaçërisht nëse ata vijnë në shkollat publike në të cilat mund të kontaktohen nga autorët e veprave të dhunës. UA do duhej të hartohet në kontekst të PSO-ve në nivel shtetëror për fëmijët dhe viktimat e dhunës në familje, duke marrë parasysh koordinimin me ministritë tjera, si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse, shumësektoriale ndaj rehabilitimit dhe reintegrimit të fëmijëve.

Në bazë të kësaj UA-je, MASHT-i do duhej të vë në sistem procedura më të mira për grumbullimin e të dhënave lidhur me të gjitha masat speciale të ndërmarra nga shkollat me qëllim të arsimimit të viktimave të dhunës në familje dhe të gjitha kostot e ndërlidhura me to. Aktualisht, natyra *ad hoc* e shërbimeve arsimore për viktimat e dhunës në familje ka bërë përcjelljen e tyre të pamundur. Shërbimet e tilla të përcjelljes së shpenzimeve do t'ia lehtësonin MASHT-it parashikimin e kostove dhe buxhetit për shpenzime shtesë që ndërlidhen me sigurimin e qasjes në arsim për të gjitha viktimat e dhunës në familje, në pajtim me Strategjinë, Ligjin dhe obligimet për të siguruar të drejtën e arsimit. Kjo mund të përfshijë edhe shpenzimet për trajnimin e mësimdhënësve, të cilët duhet të dëshmojnë qasje më të ndjeshme gjatë edukimit të viktimave të dhunës në familje. MASHT-i poashtu do duhej të shqyrtojë subvencionimin apo moskërkimin e pagesës së zakonit në shumë prej €60 për leksionet profesionale për viktimat e dhunës në familje.³⁵

³⁰ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të shkollës fillore, 28 shkurt 2012.

³¹ Korrespondencë e RRGK-së me UNICEF-in dhe strehimoret, 2012.

³² Kushtetuta e Kosovës, neni 47.

³³ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të MASHT-it, 12 janar 2012.

³⁴ Intervistë e RRGK-së me SDSF, 24 janar 2012.

³⁵ Përfaqësuesi i MASHT-it, grupi punues RRGK/UNDP, "Me çfarë çmimi?".

Fuqizimi ekonomik drejt reintegrimin

Pavarësia ekonomike është kyçe për reintegrim. "Ju e nxirrni një viktimë të dhunës në familje nga shtëpia dhe e vendosni atë në strehimore," komentoi një respondent. "Por strehimorja nuk do ta mbajë atë përjetë dhe nuk i siguron mjete të ekzistencës, nuk e punëson atë dhe nuk e bën të pavarur."³⁶ Pa pasur mundësi që ta mbajnë veten, viktimat e dhunës në familje detyrohen që të mbesin në strehimore apo të kthehen në shtëpitë ku është kryer dhuna. Por, fuqizimi ekonomik është sfidues; edukimi dobët dhe përvoja e pamjaftueshme e punës nënkuptojnë se viktimat e dhunës në familje bëjnë pjesë në grupin e personave që është më së vështiri të punësohen. Për më tepër, derisa institucionet dhe donatorët ofrojnë mjete për parandalim dhe mbrojtje, ato rrallë financojnë fuqizimin ekonomik të *viktimave të dhunës në familje*.³⁷

Disa komuna të caktuara kanë ofruar asistencë të drejtpërdrejtë për viktimat e dhunës në familje, përmes kategorisë së subvencioneve në buxhetet e kryetarëve të komunave.³⁸ Përfituesit zgjedhen në mënyrë arbitrare si "raste sociale;" ngase nuk ka kriteret që specifikojnë se kush kualifikohet për këtë titull. Personat që gëzojnë përkrahje shpesh kanë kaluar në strehimore periudha më të gjata se sa gjashtë muajt maksimal që lejohen. Individët dorëzojnë kërkesat e tyre tek kryetari, i cili vendosë nëse do t'u ofrojë financim apo jo. Kjo asistencë mund të përfshijë transfere direkte të parave të gatshme, sigurim të akomodimit dhe/ose përjashtim nga pagimi i komunalive. Pasi që zyrat e kryetarëve nuk kanë mbajtur shënime nëse viktimat e dhunës kanë përfituar nga asistenca e tillë, vlera e saktë e shpenzimeve të tilla nuk mund të përcaktohet.

Skema e asistencës sociale shtetërore ofron të hyra modeste për personat që kanë pësuar dhunë në familje. Programi i asistencës sociale në Kosovë u siguron prindërve pa bashkëshortë €40 në muaj, nëse kanë së paku një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare; prindërit marrin edhe €5 për çdo fëmijë në muaj.³⁹ QPS-të i identifikojnë përfituesit, ndërsa Divizioni për Asistencë Sociale i DMS të MPMS-së ndan grantin qeveritar për shërbime sociale drejtpërsëdrejti tek pranuesit individualë. Megjithatë, asistenca sociale nuk u mundëson familjeve të kalojnë pragun e varfërisë që është €46.50 në muaj, dhe familjet që pranojnë asistencë sociale shtetërore i kanë gjasat më të mëdha që të jetojnë në varfëri se sa ato që nuk përfitojnë asistencë të tillë.⁴⁰ Pas hyrjes në skemë të asistencës sociale, familjet e varfra e zbusin nivelin e varfërisë por nuk mund t'i ikin asaj.

Në këtë kontekst, grupet demografike të cilat më së shumti eksponohen ndaj dhunës në familje janë gratë nga zonat rurale me nivel më të ulët të arsimit, të papunësuarit dhe të varurit nga asistenca sociale.⁴¹ Personat që jetojnë në familje të udhëhequra nga kryefamiljarë të gjinisë femërore kanë më shumë gjasa të jetojnë në varfëri se sa personat që jetojnë në familje të udhëhequra nga kryefamiljarë të gjinisë mashkullore.⁴² Rrjedhimisht, viktimat e dhunës në familje kanë gjasa më të mëdha të gjenden brenda një të tretës së popullatës së Kosovës që jeton në varfëri. QPS-të nuk e kanë përcjellë numrin e viktimave të dhunës në familje që pranon asistencë sociale, kështu që kostoja e saktë e kësaj asistencë nuk ka mundur të përcaktohet. Jo të gjitha viktimat e dhunës në familje pranojnë asistencë sociale, dhe jo të gjithë personat që pranojnë asistencë sociale e që përjetojnë dhunë ia

³⁶ Intervistë e RRGK-së me përfaqësuesin e MD-së, 12 janar 2012.

³⁷ Intervista të RRGK-së me donatorë dhe organizatat anëtare të RRGK-së, 2012. UNDP ka planifikuar programe të tilla për vitin 2012.

³⁸ Intervista të RRGK-së me autoritete komunale dhe strehimore, 2012.

³⁹ *Ligji i Kosovës për Skemën e Asistencës Sociale*, Nr. 2003/15, 2003, neni 2.

⁴⁰ Banka Botërore, *Konsumi i varfërisë në Kosovë në vitin 2009*, Maj 2011. Në vitin 2009, rreth 34% të popullatës jetonte nën vijën e varfërisë (absolute) dhe 12% nën vijën e varfërisë ekstreme.

⁴¹ Shih kapitullin 1 dhe RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*.

⁴² ESK, *Anketë e Buxheteve Familjare 2009* (HBS), Prishtinë: ESK, 2010.

raportojnë atë QPS-së. Marrë parasysh këta dy faktorë, në vitin 2011 DMS i ka shpenzuar së paku **€183,467** për asistencë sociale për persona që kanë përjetuar dhunë në familje.⁴³

Qeveria e Kosovës është zotuar se do të "shtojë mirëqenien sociale për qytetarët e saj," përfshirë edhe metodën e ofrimit të asistencës sociale.⁴⁴ Megjithatë, transferet sociale dhe rrjedhimisht asistencë sociale kanë pak gjasa të shtohen në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve në vijim.⁴⁵ Rrjedhimisht, asistencë sociale nuk mund t'ua mundësojë personave që kanë pësuar dhunë në familje integrimin e lehtë në shoqëri. Mënyra më e mirë për të siguruar këtë është që tu ndihmohet në kalimin e kufirit të varfërisë.

Qendrat Regjionale të Punësimit (QRP-të) janë përgjegjëse për ofrimin e "shërbimeve dhe këshillimeve juridike pa pagesë" për viktimat e dhunës në familje.⁴⁶ Përveç ofrimit të asistencës për gjetjen e vendeve të punës, qendrat e punësimit poashtu do duhej të vlerësojnë standardin e jetesës së personave të papunë, të ofrojnë trajnime dhe të identifikojnë mundësi të punës praktike. Nën mbikëqyrjen e MPMS-së, Departamenti i Punës dhe Punësimit (DPP) koordinon dhe mbikëqyr buxhetin dhe burimet njerëzore në dispozicion të këtyre qendrave. MPMS financon këto qendra drejtpërdrejt nga buxheti qendror, edhe pse Kuvendi i Kosovës e ka miratuar para pak kohësh ligjin për funksionimin e qendrave në fjalë.⁴⁷ Financimi rrjedh nga MPMS tek DPP e më pas tek shtatë QRP-të dhe 23 zyrat e punësimit. Edhe donatorët ndihmojnë në financimin e programeve të DPP-së dhe QRP-ve. Megjithatë, kostoja e asistimit të viktimave të dhunës në familje për të gjetur punësim nuk ka mundur të vlerësohet për shkak se në bazat e të dhënave të DPP-së dhe QRP-ve viktimat e dhunës në familje nuk ndahen si kategori e veçantë që kërkon punësim apo përfiton nga asistencë. Për më tepër, pothuajse gjysma e fuqisë punëtore të Kosovës është e papunësuar⁴⁸ dhe QRP-të kanë mijëra raste në bazat e tyre të të dhënave, të cilave ato do duhej t'ju ndihmojnë në gjetjen e vendeve të punës. Është e pamundur që 201 punëtorët e këtyre qendrave tu ndihmojnë të gjithë punëkërkuessve. Për po të njëjtën arsye, QRP-të nuk dokumentojnë shërbimet që ua ofrojnë individëve.

"Ne nëpër biznese private arrijmë të punësojmë kryesisht gratë që kërkojnë punë si pastruese dhe enëlarëse. Kur një grua intelektuale fillon këtë punë, ajo gjen veten në një atmosferë të dhunshme. Ato i kthehen keqtrajtimit në familje duke ikur nga keqtrajtimi që iu bëhet në biznese private."

- Përfaqësues i QRP-së

Në ato pak raste të asistuar nga QRP-të, disavantazhi që viktimat kanë për shkak të mungesës së arsimit, për to paraqiste pengesë për punësim.⁴⁹ Kur QRP-të arrijnë të gjejnë punësim për to, zakonisht kemi të bëjmë me vende të punës që nuk kërkojnë kualifikim dhe që paguhen pak. Këto pozita nuk i ofrojnë atyre burime të mjaftueshme për të pasur pavarësi ekonomike.⁵⁰ Diskriminimi dhe ngacmimi edhe më tej ndikojnë në statusin e punësimit të viktimave, na tha një drejtor i QRP-së:

Diskriminimi ndaj grave është i përhapur në përgjithësi, e ndaj viktimave të gjinisë femërore ky fenomen është edhe më i përhapur. Ne i kemi punësuar vetëm tri viktima që kanë pasur të kryer shkollën fillore. Ne u kemi dhënë prioritet këtyre rasteve, por ne nuk mund t'ua zgjidhim problemet atyre. Ka edhe gra të tjera më të reja, më të

⁴³ Kjo është kalkuluar duke pjesëtuar transferet sociale (€28,305,000) me numrin e familjeve që kanë përfituar asistencë sociale (34,867) shumëzuar me numrin e rasteve të dhunës në familje që janë asistuar nga QPS-së (226).

⁴⁴ KASH 2012-2014.

⁴⁵ KASH 2012-2014. Shih kapitullin 2.

⁴⁶ Strategjia.

⁴⁷ Ligji për Regjistrimin dhe Regjistrat e të Papunëve dhe Punëkërkuessve, Nr. 04/L-083, 2012.

⁴⁸ ESK, *Hulumtim i Fuqisë Punëtore 2009*, Prishtinë: ESK, 2010.

⁴⁹ Intervista të RRGK-së me përfaqësues të QRP-ve, 2012.

⁵⁰ Shih Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), *Historia i përket edhe asaj: Historia e Grave në Shoqërinë Civile në Kosovë, 1980-2004*, Prishtinë: QKSGJ, 2008, faqet 270-271; dhe Rebecca Surtees për UNIFEM, *Gratë në punë: Gjendja ekonomike dhe mundësitë për gratë në Kosovë*, Prishtinë, shtator 2000.

bukura që ngacmohen seksualisht. [gjithashtu] duhet të respektohet konfidencialiteti. Ne nuk mund t'ua themi punëdhënësve "ju lutemi ta punësoni këtë grua sepse ajo është keqtrajtuar nga bashkëshorti i saj." Nëse e kuptojnë se gruaja ka pasur probleme në familje, ata nuk do ta punësojnë fare.⁵¹

Kjo QRP në Mitrovicë ka ofruar një shembull pozitiv se si qendrat e punësimit mund t'ju ndihmojnë viktimave të dhunës në familje. Falë vullnetit të mirë të punonjësve të tyre, ata kanë mbajtur një listë të viktimave të dhunës në familje, të cilave u kanë ofruar asistencë me prioritet.

Zyrtarët në QRP-të tjera thanë se personat që kanë pësuar dhunë në familje nuk u janë qasur kurrë qendrave të tyre.⁵² Asnjë nga QRP-të e intervistuar nuk kishte pasur klientë të udhëzuar nga strehimoret apo institucionet tjera. Qendrat e punësimit dhe QPS-të duket se nuk koordinojnë si duhet asistencën për viktimat e dhunës në familje si një nga kategoritë e cenueshme, përkundër faktit se edhe DPP edhe DMS janë nën ombrellën e MPMP-së.

MPMS do duhej të udhëheqë, mbikëqyrë dhe bashkëpunojë me institucionet e punësimit, komunat dhe institucionet tjera të përfshira në implementimin e politikave të punësimit.⁵³ Si pjesë e sistemit të referimeve, strehimoret dhe QPS-të do të mund t'i udhëzojnë klientët në qendra të punësimit, ku do tu jepej ndihmë në punësim e rrjedhimisht edhe në reintegrimit të tyre. Këto institucione do të mund të koordinonin punën në nivel komunal, të udhëzuara nga një UA qendrore e cila rregullon procesin e menaxhimit të rasteve. MPMS gjithashtu do duhej të ndajë resurse të mjaftueshme për trajnimin e stafit të QRP-ve sa i përket qasjes së ndjeshme gjatë trajtimit të viktimave të dhunës në familje dhe sigurimit të konfidencialitetit; për koordinimin me institucione tjera (që kërkon resurse njerëzore); për menaxhim më të mirë të të dhënave, me qëllim të përcjelljes së cilat shërbime janë ofruar. Koordinimi mes QPS-ve dhe QRP-ve do të mund të rezultonte me largimin e viktimave të dhunës në familje, si një nga grupet e cenueshme të shoqërisë, nga varfëria dhe varësia nga asistencë sociale shtetërore.

Përveç asistencës shtetërore, edhe programet e financuara nga donatorët ofrojnë trajnime të përgjithshme profesionale dhe shërbime për gjetje të vendeve të punës. Megjithatë, të dhënat mbi përfituesit e këtyre programeve zakonisht nuk tregojnë nëse ata kanë pësuar dhunë në familje.⁵⁴ Donatorët ka ndodhur t'ua mbulojnë pagat viktimave të punësuar në kompani private. Megjithatë "tek këto raste ekziston një dozë rreziku," tha një përfaqësues i strehimores. "Zakonisht pas skadimit të donacionit, ato largohen nga puna."⁵⁵ Është propozuar si zgjidhje potencialisht e qëndrueshme lirimi nga taksat për bizneset që punësojnë persona që kanë pësuar dhunë në familje (duke marrë parasysh konfidencialitetin).⁵⁶ Në vitet 2012-2013, UNDP planifikon të sajë një listë të mundësive ekonomike për viktimat e dhunës në familje në tri komuna (€4,650) dhe më pas të zhvillojë iniciativë për reintegrimit ekonomik (€50,000).⁵⁷

Rehabilitimi dhe Reintegrimit: Strehimoret dhe OJQ-të

Strategjia parasheh se MPMS do të ofrojë përmes strehimoreve shërbime rehabilituese dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje. Përveç financimit të shërbimeve të

⁵¹ Intervistë e RRGK-së drejtorin e QRP-së, 14 mars 2012.

⁵² Intervista të RRGK-së, 2012.

⁵³ *Rregullorja Nr. 02/2011 mbi Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive*, Kaptina VI.

⁵⁴ Intervista të RRGK-së me donatorë, 2012. Biseda me të gjithë donatorët që zhvillojnë programe të tilla tejkalojnë fushëveprimin e këtij hulumtimi.

⁵⁵ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të strehimores, 17 janar 2012

⁵⁶ Grupi punues RRGK/UNDP, "Me çfarë çmimi," 13 qershor 2012.

⁵⁷ Korrespondencë e RRGK-së me UNDP, 4 prill 2012. Kjo është financuar nga qeveria finlandeze përmes Programit GBV të UNKT.

strehimoreve që ndërlidhen me mbrojtjen (shih kapitullin 4), duhet të ndahen resurse edhe për rehabilitim dhe reintegrimit. Para vitit 2011 pothuajse nuk kanë ekzistuar fare programe të reintegrimit të viktimave të dhunës në familje.⁵⁸ Strehimoret përqeshin të koordinojnë reintegrimit të viktimave të dhunës në familje, por nuk kishin resurset e duhura për ta bërë këtë.

Në vitin 2011, përmes IOM-it, USAID përkrahu strehimoret në zhvillimin e programeve të reintegrimit për viktimat e trafikimit.⁵⁹ Edhe pse përkrahja në fjalë ishte e përqendruar tek viktimat e trafikimit, edhe viktimat potenciale të trafikimit edhe viktimat e dhunës në familje kanë përfituar nga to. Të gjitha strehimoret janë trajnuar për zhvillimin e planeve të biznesit në vitin 2010 (€2,100), ndërsa dy prej tyre kanë marrë grante për të zhvilluar aktivitete për gjenerimin e të hyrave (gjithsej €23,166). Në Gjakovë, strehimorja i ka shfrytëzuar këto mjete për të zgjeruar edhe më tej projektin për gjenerimin e të hyrave, përmes të cilit gratë prodhojnë produkte të bukurosisë. Komuna ua ka ofruar hapësirën të cilën e shfrytëzojnë si dyqan për t'i shitur produktet e tyre, ndërsa IOM-i e ka financuar ndërtimin e dyqanit. Megjithatë, të hyrat shkojnë në strehimore dhe rrallë u shërbejnë fuqizimit të viktimave të dhunës në familje. Në Gjilan, strehimorja u ofronte grave viktimat të dhunës në familje grante të vogla, të cilat ato i shfrytëzonin për të hapur mikrobiznese (p.sh. dyqan për fotokopjim). Masa deri në të cilën puna e tillë në pozita me pagesa të ulëta i kontribuon fuqizimit të qëndrueshëm ekonomik vlen të diskutohet.⁶⁰

IOM-i gjithashtu ka nënshkruar marrëveshje dhe i ka trajnuar tri OJQ të grave nga 15 komuna të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë brenda komuniteteve përkatëse të tyre, lidhur me asistimin dhe reintegrimit të viktimave të trafikimit dhe viktimave potenciale të trafikimit, përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës në familje.⁶¹ Kur një person kërkonte integrim në komunitet, OJQ-ja lokale do t'ia ofronte një pako asistuese, në konsultim me QPS-në relevante dhe IOM-in. Çdo klient përfitonte si grant shumë prej €774, në formë asistence për deri në gjashtë muaj. Planet ishin që përfituesve tu ofrohet asistencë varësisht prej nevojave të tyre, përfshirë këtu banimin, rindërtimin e shtëpisë, qiranë e përkohshme, ushqimin, higjienën, kujdesin shëndetësor dhe trajtimin psikologjik. Përmes këtyre fondeve mëtohej mbulimi i boshllëqeve në rastet kur nuk kishte në dispozicion asistencë shtetërore. Pas gjashtë muajsh, QPS lokale duhej të sigurohet se klientët kanë bërë zgjidhje të qëndrueshme për mbijetesë. Në vitin 2011, nga përkrahja për reintegrimit kanë përfituar 11 klientë (€7,901), ndërsa në vitin 2012 edhe shtatë të tjerë (€5,424).⁶²

OJQ-të e grave që ishin përgjegjëse për administrimin e këtyre fondeve poashtu identifikojnë strukturën e përkrahjes dhe resurset brenda komunitetit (p.sh. trajnimet profesionale, grupet e përkrahjes, punësimin). Për koordinimin e reintegrimit të klientëve, OJQ-të merrnin nga €31 në muaj për pajisje për zyrë, derivate dhe shpenzime tjera (gjithsej €316 në vitin 2011). Menaxherët e rasteve në OJQ merrnin nga €46 në muaj (gjithsej €474 për vitin 2011). Kjo shumë është tejet simbolike marrë parasysh se sa kohë kanë kaluar duke vizituar rastet e tyre, si dhe në takime dhe koordinim, u tha nga IOM. Në gusht të vitit 2012 programi i USAID/IOM mbaroi. Edhe pse OJQ-të dhe QPS-të kanë përmirësuar koordinimin dhe shërbimet e referimit, programi vështirë do të mund të mbahet pa financim të shpenzimeve të reintegrimit për klientët.

⁵⁸ Shih RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*, f. 86.

⁵⁹ Intervista të RRGK-së me USAID dhe IOM, mars 2012. Kjo ishte pjesë e Programit Kundër Trafikimit në Kosovë (KAP) të USAID. Në vitin 2009, IOM ekzaminoi mundësitë e mikrobizneseve, punësimit dhe vetëpunësimit në sektorë të ndryshëm ekonomik për gratë që banojnë në strehimore dhe për stafin e strehimoreve.

⁶⁰ Shih Surtees për UNIFEM, *Gratë në punë* dhe QKSGJ, *Historia i përket edhe asaj*.

⁶¹ Këto organizata të shoqërisë civile përfshijnë *Healthy Mind* në Prizren, *Girls Today* në Suharekë, *Norma* në Prishtinë, *SZO* në Fushë Kosovë, *Help to Poverty RAE Group* në Gjakovë, *Women's Network SHE* në Ferizaj, *Violeta* në Podujevë, *Fortesa* në Kamenicë, *CPWC* në Mitrovicë dhe *Alma* në Pejë.

⁶² Nuk është e qartë se sa përfitues kanë pësuar nga dhuna në familje, edhe pse trafikimi mund të konsiderohet lloj i dhunës në familje, siç thuhet më lart.

Leksionet e mësuar nga ky program mund të jenë të dobishme për zhvillimin e një programi të qëndrueshëm shtetëror të rehabilitimit dhe reintegrimit të viktimave të dhunës në familje. Komunitet dhe DSHMS mund t'i kontraktojnë OJQ-të për ofrimin e shërbimeve të specializuara shoqërore dhe familjare, përfshirë këshillimin dhe përkrahjen e përgjithshme për reintegrimit.⁶³ Disa OJQ, përfshirë edhe disa strehimore, veç ofrojnë këshillime për viktimat e dhunës në familje. Për shembull, *Medica Kosova* ofron këshillime individuale dhe grupe (€12,260); *Open Door* (€9,600) dhe *Ruka Ruci* (€7,000) ofrojnë përkrahje psikologjike, të financuara nga KTK; ndërsa *Zensko Pravo* i këshillon gratë (€10,000), falë financave të USAID/Mercy Corps.⁶⁴ Megjithatë, qëndrueshmëria e këtyre shërbimeve varet nga financat e donatorëve. Në vitet 2012-2013 donatorët planifikojnë të përkrahin programet e reintegrimit.⁶⁵ Sidoqoftë, zgjidhjet afatgjata kërkojnë veprim nga qeveria për përmbushjen e zotimeve të bëra në Strategji.

Në përmbledhje, ***ende nuk ekziston ndonjë sistem gjithëpërfshirës për rehabilitimin dhe reintegrimin e viktimave të dhunës në familje në Kosovë.*** Në vitin 2011 në aktivitete të ndërlidhur me këtë janë shpenzuar vetëm €357,465, 48% të të cilave janë ndarë nga donatorët. Në fakt, fondet nga shteti dhe donatorët janë përqendruar joproporcionalisht në mbrojtje.⁶⁶ Shteti, e në veçanti MPMS, duhet të parashehë kostot dhe të ndajë buxhetin në mënyrë më të saktë dhe adekuate për zhvillimin e një programi të qëndrueshëm, shumështrësor dhe ndërsektorial për rehabilitim dhe reintegrimit.

"Nëse tërë kohën flitet për gratë si viktime, atëherë mënyra se si njerëzit i shikojnë gratë nuk do të ndryshojë. Shumë donatorë po fokusohen në mbrojtje dhe po i trajtojnë gratë si viktime, por gratë janë gjithashtu bartëse për ndryshim. Ato shpesh janë në gjendje të gjejnë zgjidhje të mira, por thjeshtë nuk kanë mundësi ekonomike për këtë. Duhet të ketë fokus të shtuar në rolin e grave si aktorë të rëndësishëm të këtij procesi dhe në rehabilitim. Kjo nënkupton iniciimin e programeve speciale për fuqizimin ekonomik të grave dhe punësimin e tyre."

- Përfaqësues i KTK

Rehabilitimi dhe Reintegrimi i Autorëve të Dhunës

Rehabilitimi dhe reintegrimi i autorëve të dhunës gjithashtu kërkon një qasje ndërsektoriale, e cila mund të përfshijë këshillimin individual dhe familjar, trajnimet profesionale dhe asistencën në sigurim të punësimit. Korniza ligjore e Kosovës parashehë përfshirjen e institucioneve të ndryshme në rehabilitimin dhe reintegrimin e autorëve të dhunës.⁶⁷

Strategjia parashehë se MSH duhet të ofrojë trajtime të obligueshme mjekësore për abuzim me alkool dhe droga, edhe pse trajtime të tilla ende nuk ka në dispozicion.⁶⁸ MSH është duke e hartuar një UA për përkrahjen e personave për të cilët sipas urdhrorit të mbrojtjes kërkohet trajtimi i obligueshëm dhe përkrahja psikologjike.⁶⁹ Kjo UA nuk është finalizuar dhe nuk është miratuar. Në vitin 2012, MH hartoi një tjetër UA (€1,500) me të cilin parashihej trajtimi i obligueshëm për autorët e dhunës në qendra të mjekësisë familjare, në spitale apo në klinika psikiatrike. MSH ende nuk i ka vlerësuar implikacionet buxhetore për implementimin e kësaj UA-je. Më tej, fokusimi në Strategji në drogë dhe alkool i injoron praktikën më të gjera sociale dhe kulturore të cilat "lejojnë" dhunën në familje.⁷⁰ Për të

⁶³ *Ligji për Vetëqeverisje Lokale*, neni 6.3 përkatësisht *Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare*, neni 6.7.

⁶⁴ Korrespondencë e RRGK-së me përfaqësuesin e *Mercy Corps*, 22 mars 2012.

⁶⁵ Në vitin 2012, *UNDP WSSI* planifikon të përfshijë akterë të ndryshëm në krijimin e strategjisë për shërbime të rehabilitimit (€3,874) dhe tu sigurojë strehimoreve €10,021, me qëllim të shtimit të kapaciteteve të tyre për të ofruar shërbime reintegruese. OPDAT gjithashtu ka planifikuar të zhvillojë një program për reintegrimit pas largimit nga strehimoret, edhe pse buxheti dhe korniza kohore për ekzekutimin e tij nuk janë vendosur ende (korrespondencë e RRGK-së, maj 2012).

⁶⁶ Shih kapitujt 4 dhe 7.

⁶⁷ *Ligji*, nenet 4, 9 dhe 28.

⁶⁸ *Ligji*, nenet 4 dhe 9. Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të MSH, 25 janar 2012.

⁶⁹ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të MSH, 25 janar 2012.

⁷⁰ Shih kapitullin 1 dhe RRGK, *Siguria fillon në shtëpi*, f. 16.

adresuar këto praktika që mund të kontribuojnë në dhunë do duhej të ofrohen këshillime individuale dhe familjare.

Shërbimi Korrektues u ofron autorëve të dhunës mundësi të ndryshme të rehabilitimit dhe reintegrimit. Tri qendra korrektuese ofrojnë trajnime profesionale, ndërsa disa të burgosur vijnë trajnime të ngjashme edhe në qendrat e trajnimit në afërsi të tyre. Pas kalimit të provimeve, ata mund të pajisen me certifikata përkatëse nga MPMS.⁷¹ Akademia për Siguri Publike gjithashtu u ofron të burgosurve trajnime profesionale dhe shërbime psikologjike.

Nga stabilimentet korrektuese mund të kërkohej që tu ofrojnë të burgosurve trajtim psikologjik, nëse urdhërohet nga gjykata. Megjithatë, një përfaqësues i shërbimit korrektues tha se ata nuk kanë numër të mjaftueshëm të psikologëve për të ofruar këshillime të tilla. Komunitetet varen nga shërbimet këshillimore që ofrohen në Prishtinë dhe autorët duhej të transportoheshin nga policia.⁷² Megjithatë, respondentët u ankuan se institucionet shëndetësore ndonjëherë thjeshtë u jepnin autorëve të dhunës nga një injeksion dhe nuk u ofronin trajtim adekuat dhe këshillim. Kjo nënvizon rëndësinë e qartësimit të masave të urdhëruara nga gjykata dhe të monitorimit të performancës së punëtorëve shëndetësorë.⁷³

Edhe Shërbimi Sprovues duhet të mbikëqyrë dhe përkrahë të dënuarit që janë të varur nga alkooli dhe droga, e të cilët sipas urdhrave gjyqësor duhet të kenë trajtim rehabilitues jashtë stabilimenteve korrektuese.⁷⁴ Shërbimi Sprovues ekzekuton aktgjykimet që parashohin sanksione alternative, mbikëqyr ndëshkimet e të miturve dhe personat e lëshuar me kusht. Pesë zyrtarë regjionale të këtij shërbimi mëtojnë të integrojnë të dënuarit e mitur dhe madhorë në shoqëri, përmes mbikëqyrjes dhe monitorimit.⁷⁵ Shërbimi Sprovues bashkëpunon me QPS-të, pasi që rasteve të tyre shpesh u nevojiten edhe shërbimet sociale. Ata bashkëpunojnë edhe me QRP-të për tu mundësuar klientëve të tyre trajnime profesionale apo për të ndërmjetësuar në punësim. Megjithatë, mungesa e dijenisë për ekzistimin e qendrave sprovuese në mesin e institucioneve ka shkakuar shumë kokëçarje. Institucionet shpesh kanë refuzuar ofrimin e shërbimeve për rastet e udhëzuara nga qendrat sprovuese, pasi që nuk kishte ndonjë marrëveshje që do t'i obligonte për këtë.⁷⁶ Në vitin 2012, Shërbimi Sprovues po hartonte pesë marrëveshje të mirëkuptimit me pesë institucione të ndryshme për të adresuar këtë çështje. Përfaqësuesit e këtij shërbimi shpresonin se me këtë do ta sigurojnë bashkëpunim më të mirë.

*"Ne kemi kërkuar që Qendra e Shëndetit Mendor të ofroj trajtim psikologjik për të miturit por ata nuk kanë pranuar. 'Nuk është pjesë e mandatit tonë', thanë ata."
- Përfaqësues i Shërbimeve Provuese*

Qendrat sprovuese poashtu ishin duke e krijuar një bazë elektronike të të dhënave në vitin 2012, por nuk ishin në gjendje të ofrojnë informata lidhur me rastet e dhunës në familje të cilat ato i kanë asistuar. Zyrtarët mund tu kenë ndihmuar disa rasteve të caktuara apo të kenë monitoruar të miturit që jetojnë në mjedise familjare abuzive. Edhe pse zyrtarët në fjalë nuk janë trajnuar për dhunën në familje, ata theksuan se këto raste "kanë nevojë për trajtim të veçantë."⁷⁷

Buxhetet e Shërbimeve Sprovuese vijnë drejtpërdrejtë nga MD. Këto shërbime parashihen se kushtojnë rreth €2 në ditë.⁷⁸ Megjithatë, shërbimet e ofruara dhe kohëzgjatja e tyre dallojnë nga rasti në rast. RRGK ka kalkuluar se **së paku €42,120** shpenzohen çdo

⁷¹ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të Qendrës Korrektuese, 6 shkurt 2012.

⁷² Policia e Kosovës i ka mbuluar shpenzimet e transportit, edhe pse nuk ka ndonjë rregullore që përcakton këtë (Intervista të RRGK-së, 2012).

⁷³ Shih kapitujt 1 dhe 4.

⁷⁴ *Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale*, neni 217, paragrafi 5.3.

⁷⁵ Pesë drejtori regjionale menaxhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Sprovues në Prishtinë. Shërbimi sprovues ka 66 punëtorë, nga të cilët 33 janë femra e 33 meshkuj (korrespondencë e RRGK-së, korrik 2012).

⁷⁶ Intervista të RRGK-së me përfaqësues të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues, shkurt dhe maj 2012.

⁷⁷ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të Shërbimit Sprovues, 4 maj 2012.

⁷⁸ *Po aty*. Kalkulimi u krye nga EULEX-i.

vit nga shërbimet sprovuese për raste që ndërlidhen me dhunën në familje.⁷⁹ OJQ-të, përfshirë strehimoret dhe KRCT-në, poashtu ofrojnë këshillime për autorët e dhunës. Megjithatë, kostoja e këtyre shërbimeve nuk ka mundur të kalkulohet.⁸⁰

Diagrami 11 ilustron kostot e njohura që ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve për një autor të pretenduar të dhunës në familje. Pas identifikimit dhe mbase hetimit policor, i dyshuari mund të dërgohet në gjyq. Nëse ka dëshmi të pamjaftueshme për shqyrtim

"Unë ndërmora iniciativë për t'i vizituar familjet e viktimave të dhunës në familje pas kalimit të një kohe të caktuar pas incidentit dhe pasi që rasti ishte mbyllur. Kjo praktikë ka pasur ndikim pozitiv dhe ka parandaluar përsëritjen e dhunës në familje."

- Zyrtar i Policisë


gjyqësor si dhe gjatë kohës mes aktit dhe gjykimit, policia monitoron amvisëritë ku mund të ketë pasur rast dhune. Vizitat në shtëpi mund të parandalojnë rishfaqjen e dhunës. QPS-të poashtu mund ta parandalojnë rishfaqjen e dhunës përmes monitorimit të rregullt dhe këshillimit me familjet, duke mbajtur parasysh interesat e fëmijës. Gjatë vizitave QPS-të mund

të informojnë autorët dhe autorët potencialë të dhunës lidhur me mundësitë që kanë për të avancuar në aspektin arsimor, për të vijuar trajnime profesionale dhe për të përfituar asistencë në punësim përmes QRP-ve. Përfundimisht, gjykatat mund të vlerësojnë se autorët duhet të kalojnë kohë në Shërbim Korrektues, Shërbim Sprovues dhe/apo të kenë këshillim profesional nga MSH, e të gjitha këto kanë shpenzime.

Diagrami 11. Përshkrimi i Qasjes: Kostoja e Shërbimeve për Një Kryes të Pretenduar

⁷⁹ Kjo shumë është bazuar në të dhënat e KGJK-së për vitin 2008: nëse të gjithë personat e burgosur (52) dhe ata me dënime me kusht (182) kanë pranuar shërbime sprovuese për mesatarisht tre muaj. Kjo nuk i përfshin personat që jetojnë në mjedise familjare ku ka dhunë apo personat që marrin asistencë mbi tre muaj. Për këtë arsye, RRGK konsideron se ky parashikim është në pragun minimal.

⁸⁰ Janë mbajtur regjistra të seancave këshillimore, por të dhënat nuk kanë mundur të renditen sipas këtyre kriterëve. Njëjtë nuk ka mundur të ndahet përçindja e kohës që stafi ka kaluar duke ofruar këshillime përkatëse nga pagat e tyre të përgjithshme.



Në përgjithësi, **shërbimet për rehabilitim dhe reintegrim të autorëve të dhunës nuk janë të mjaftueshme për të implementuar kornizën ligjore**. Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë se shërbimet e parapara për autorët e dhunës janë funksionale. Kjo mund të parandalojë dhunën në të ardhmen dhe tu sigurojë viktimave mbrojtje, gjë që zvogëlon shpenzimet e shtetit. Disa respondentë gjithashtu kanë avokuar që të ketë qasje inovative, siç janë vendosja e autorëve nëpër strehimore. “E si t’ia ndërrojmë sjelljet meshkujve?” Një respondent tha “Vijimi i seancave këshillimore shihet si të qenit i dobët. Nëse dikush e kupton këtë fakt, ai do të konsiderohet si dështak që nuk mund ta kontrollojë familjen e vet.” Rolet gjinore sipas së cilave nga meshkujt pritet të jenë të fortë dhe të kontrollojnë familjet e tyre do të bëjnë që meshkujt të mos kërkojnë asistencë dhe të mos vijojnë seancat këshillimore. Për të siguruar funksionalitet të shërbimeve të rehabilitimit dhe reintegrimit, duhet të përpiqemi edhe t’i ndryshojmë rolet gjinore. “[Asistenca] do të ketë rol sipërfaqësor derisa e tërë shoqëria të mos shkojë përpara,” tha si përfundim respondentit.

"Ne duhet të gjejmë një qasje inovative për të trajtuar autorët e dhunës. Ne duhet të kemi strehimore jo për viktimat po për viktimizuesit. Ne duhet t'i vëmë në strehimore ata që shkaktojnë probleme, duhet t'i trajtojmë ata e më pas t'i kthejmë në shtëpi. Është më pak e kushtueshme dhe më lehtë të trajtohet një person se sa pesë sish (p.sh. gratë dhe fëmijët e tyre)."
 - Respondent

Konkluzione

Ky kapitull ka ilustruar se institucionet relevante duhet të ndajnë resurse të mjaftueshme për të krijuar legjislacion adekuat sekondar për ta implementuar ligjin në tërësi.⁸¹ Kosova nuk ka programe adekuate për rehabilitimin dhe reintegrimin e viktimave dhe autorëve të dhunës në familje. ***Qeveria nuk u ofron zyrtarisht viktimave të dhunës në familje kurrfarë përkrahje si kategori e veçantë, sa i përket arsimimit, punësimit apo asistencës sociale. Madje as që diskutohet ofrimi i këshillimeve afatgjata apo siguromi i mirëqenies ekonomike për viktimat, si pjesë e një pakoje gjithëpërfshirëse të reintegrimin. Ende nuk janë krijuar shërbime të këshillimit për autorë të dhunës.*** Shteti dhe institucionet relevante të tij duhet të ndërmarrin hapat e shumtë të përmendur më sipër dhe të ritheksuar mes rekomandimeve, në mënyrë që të përmbushin obligimet e tyre ligjore për rehabilitimin dhe reintegrimin e viktimave dhe autorëve të dhunës në familje.

⁸¹ Përveç Ligjit, edhe *Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë* trajton të drejtat civile, politike dhe ekonomike të cilat duhej të krijojnë kushte për sigurim të barazisë gjinore; ato përfshijnë politikat që përkrahin përmirësimin e statusit të grave, rolit dhe autoritetit të tyre në familje dhe shoqëri (neni 1.2).

Kapitulli 6. Referimet dhe Koordinimi: Një Qasje e Përqendruar tek Viktimat

Ky kapitull sugjeron krijimin e një sistemi të referimit (udhëzimit) dhe përpilimin e Procedurave Standarde Operative (PSO) të cilat do të siguronin një qasje ku viktimat është në qendër të vëmendjes, me qëllim të sigurimit të ofrimit të shërbimeve më efikase dhe efektive.

Siç u dëshmuar edhe në kapitujt e mësipërm, referimi dhe koordinimi mes institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, rehabilitimin dhe integrimin e viktimave vazhdon të bëhet në baza *ad hoc*. Për shembull, policia i transporton mbrojtësit e viktimave, punëtorët socialë dhe prokurorët nëpër seanca gjyqësore dhe në takime me klientët. Kjo policisë i krijon shpenzime të transportit dhe ju kushton me kohë pune të policëve, pasi që gjatë kësaj kohe ata nuk mund të kryejnë detyra të tjera policore. Fakti se nuk ka ndonjë sistem të mirëfilltë të mbajtjes së shënimeve bën të pamundur kalkulimin e kostove për resurset që institucionet e ndryshme i shfrytëzojnë bashkërisht. Megjithatë, respondentët na kanë thënë se kjo ka pasur ndikim negativ në buxhetet dhe mënyrën se si institucionet kanë reaguar ndaj situatave gjegjëse. Paqartësia në ndarjen e roleve dhe përgjegjësisë dhe mungesa e një sistemi të referimit (udhëzimit) që do të përdorej nga agjenci të ndryshme i kontribuon përdorimit joefikas të resurseve në dispozicion.

Edhe pse ligji i definon përgjegjësitë e institucioneve, procedurat do duhej të sistematizojnë itinerarin e viktimave, duke ua përcaktuar institucioneve shtetërore hapat që duhet ndërmarrë. Procedurat Standarde Operative (PSO) në nivel kombëtar do duhej të definojnë qartë përgjegjësitë e secilit institucion, bazuar në ligjet dhe politikat e miratuara. Në komuna ku veç ekzistojnë sisteme të referimit, marrëveshjet aktuale duhet të zyrtarizohen.

Gjatë hartimit të PSO-ve dhe krijimit të sistemit të referimit të viktimave, itinerari i viktimës duhet përcaktuar me shumë kujdes. Për të caktuar atë, duhet përcjellë hapat të cilët viktimat i përcjell gjatë trajtimit, në mënyrë që ata t'i kemi parasysh gjatë monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve që i ofrohen asaj.¹ Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e boshllëqeve në politikat ekzistuese, në parandalimin e dhunës në të ardhmen dhe në identifikimin e kostove të secilit shërbim. Qasja në ofrimin e shërbimeve që viktimën e vë në qendër të vëmendjes, siç ilustron në diagramin 12, përqendron kujdesin në nevojat e viktimës dhe në përgjegjësitë ligjore të secilit institucion. Vlen të theksohet se shigjetat janë të drejtuara tek viktimat, gjë që bën me dije se institucionet do duhej të përbushin

¹ Elizabeth Villagómez, "Trajnimi për caktimin e kostos së dhunës ndaj grave: Qasja e buxhetimit gjinor" prezantim, 2011.

obligimet e tyre ligjore në mënyrë aktive dhe nuk duhet të presin që viktimat t'u drejtohet për të kërkuar ndihmë.

Diagrami 12. Qasja e Drejtuar kah Viktimat për të Ndhimuar Viktimat e Dhunës Familjare



Çdo sistem i referimit duhet fillimisht të identifikojë pikën fillestare të kontaktit: pikën ku viktimat mund të gjejnë ndihmë. Të parët janë policia, miqtë, familja, fqinjët, mësimdhënësit, doktorët, infermieret, gjinekologët, punëtorët socialë, mbrojtësit e viktimave dhe strehimoret.² Edhe ashtu të gjitha institucionet duhet trajnuar në zbulimin e shenjave të dhunës në familje, ndërveprimin me persona që kanë pësuar dhunë në familje dhe në referimin (udhëzimin) e rasteve të tilla.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës i obligon entitetet publike që të raportojnë veprat penale që ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare.³ Nëse punëtorët socialë apo ata shëndetësorë dyshojnë në abuzim të fëmijëve, në veçanti në abuzim seksual të tyre, ata duhet t'i raportojnë menjëherë rastet e tilla.⁴ Edhe pse mjekët, punëtorët socialë dhe mbrojtësit e viktimave nuk përfshihen si dëshmitarë në procedurë penale, ata kanë

² Intervista të RRGK-së, shkurt 2012. Kjo ilustron edhe me faktin se policia merr më shumë raporte për dhunën në familje se sa institucionet tjera (shih tabelën 5).

³ Kodi i Procedurës Penale në Kosovë, neni 197.

⁴ Kodi i Procedurës Penale në Kosovë, neni 198, paragrafi 2.

përgjegjësi që t'i raportojnë veprat e tilla penale.⁵ Mosraportimi i krimeve të tilla rezulton me procedura disiplinore apo marrje të licencës profesionale.⁶

Aktualisht, një numër i vogël i zyrtarëve dhe nëpunësve civilë dinë se ku duhet referuar apo si duhet raportuar rastet e dhunës në familje.⁷ Për shembull, mësimdhënësit mund të jenë në mesin e a tyre që të parët mund ta identifikojnë dhunën ndaj fëmijëve, por MASHT duket se nuk ka kurrfarë UA, procedure apo politike për të bërë referimin e këtyre rasteve. Një mësimdhënësi tha për RRGK: "Kur identifikojmë raste të dhunës në familje, ne nuk i referojmë ato tek ndonjë institucion tjetër. Në fakt, ne mundohemi t'i zgjidhim vetë rastet e tilla. Ne bisedojmë me prindërit dhe me drejtorin e shkollës, por nuk mund të bëjmë më shumë se kaq."⁸ MASHT-i do të mund t'i obligonte mësimdhënësit që t'i raportojnë dhe referojnë rastet e dyshuara të dhunës në familje ndaj fëmijëve apo prindërve tek policia dhe QPS-të. MASHT-i do duhej të miratojë procedurat dhe të institucionalizojë trajnimet përkatëse.⁹

MSH po harton një protokoll dhe një planprogram trajnues për punëtorët shëndetësorë, nga të cilët kërkohet referimi përkatës i rasteve të dhunës në familje. Duke qenë se kjo punë fillimisht është financuar nga UNFPA,¹⁰ MSH nuk ka ende ndonjë plan se si t'i institucionalizojë trajnimet për protokollin e ri; kjo do të kërkojë resurse shtesë.

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) është përgjegjës për trajnimin e nëpunësve civilë në lëmin e dhunës në familje, por ai nuk ka organizuar trajnime në këtë temë pasi që trajnime të tilla nuk janë kërkuar.¹¹ Pasi që RRGK u parashtrori nëpunësve civilë pyetje të ndërlidhura me dhunën në familje, trajnime të tilla filluan të kërkohen gjatë vitit 2012 (€464).¹² IKAP duhet të shtjellojë koston e trajnimeve shtesë për nëpunës civilë. Përmirësimi i njohurive të tyre mbi dhunën në familje, sistemet e referimit dhe përgjegjësitë përkatëse do të mund të siguronte buxhetim adekuat për shërbimet që ofrohen nga të gjitha institucionet

Edhe linjat e hapura telefonike mund të përbëjnë mekanizma të rëndësishëm të referimit. Në vitin 2011, DMNV (tani ZMNV) krijoi një linjë telefonike pa pagesë për dhunë në familje dhe trafikim (€15,492),¹³ me përkrahje nga OSBE (€26,276).¹⁴ Policia ka linjën e vet të hapur 24 orë në ditë. *Ruka Ruci* po bashkëpunon me dy organizata tjera të grave serbe nga Kosova për të krijuar një tjetër linjë të hapur (€10,300, financuar nga *Ktk*).¹⁵ *Safe House* Gjakovë poashtu ka linjë të hapur telefonike, falë përkrahjes prej (€1,600).¹⁶ Shumica e strehimoreve kanë linja të hapura përkrahëse, edhe pse nuk janë të gjitha pa pagesë.

⁵ Kodi i Procedurës Penale në Kosovë, neni 160.

⁶ Punëtorët socialë ende nuk kanë licenca për zhvillim të kësaj veprimtarie, por pasi që të përcaktohet ky obligim, e njëjta duhet të aplikohet edhe për ta.

⁷ Intervista të RRGK-së me institucione të ndryshme, 2012

⁸ Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të shkollave fillore, 28 shkurt 2012

⁹ Ligji thotë se qeveria (përfshirë MASHT-i) harton UA-të për zbatim të atij ligji.

¹⁰ Shih kapitullin 5, "Kujdesi shëndetësor drejt rehabilitimit."

¹¹ Korrespondencë e RRGK-së me përfaqësues të përfaqësues të IKAP-it, 20 mars 2012.

¹² *Po aty*. Kostoja e trajnimit për njësi është €11.60 për person për ditë, shumëzuar me dy ditë për njëzet persona (që do të thotë se i ofrohet një numri të vogël të shërbyesve civilë). Kjo nuk përfshin koston e trajnuesve, ngase kjo është detyrë e rregullt e shërbyesve civilë.

¹³ Pagat e katër operatorëve arrinin shumën totale prej €4,958 ndërsa shpenzimet për linja telefonike €252 për vitin 2011. Mes tetorit 2011 dhe prillit 2012, linja e hapur telefonike pranoi 369 thirrje, përfshirë 34 që ndërlidheshin me dhunën në familje. Operatorët i referuan 16 raste në polici, ndërsa rasteve tjera u ofroi informata mbi ligjet e aplikueshme, strehimoret, urdhrat mbrojtës dhe shërbimet tjera këshillimore juridike (intervistë e RRGK-së me përfaqësues të ZMNV, 11 maj 2012).

¹⁴ OSBE ka financuar pajisjet, trajnimin e operatorëve dhe fushatën vetëdijesuese me spote televizive, posterë dhe fletushka. Në vitin 2012, OSBE ka ndarë €19,195 për promovimin e mëturësishëm të linjës së hapur në radio dhe TV.

¹⁵ Pagat për operatorë me gjysmë orari ishin €7,300, ndërsa €3,000 janë shpenzuar në trajnimin e tyre.

¹⁶ Operatorët janë punonjës të strehimores të cilët me ndërrime përgjigjen në linjën e hapur. Përfaqësuesit gjegjësupozonin se kjo shumë shpenzohet çdo vit për linjën telefonike, edhe pse ajo përfshihet në buxhetin e tyre të gjithmbarshëm (shih kapitullin 4).

Mbase do të ishte më efikase që të krijohet një sistem shtetëror i referimit se sa të mbahen një sërë linjash të hapur telefonike. Nëse viktimat preferojnë të thërrasin linjën ndihmës që nuk menaxhohet nga shteti, disa OJQ mund të mbajnë linjat e hapura në të cilat mund të punësohen psikologë me ekspertizë gjegjëse.


Si pjesë e procedurave të referimit, institucionet dhe organizatat e lartpërmendura do duhej t'i referojnë (udhëzojnë) viktimat e dhunës në familje tek autoritetet përkatëse, do të thotë tek policia, QPS-të dhe/ose mbrojtësit e viktimave. Më pas, propozohet të ndiqet një procedurë e referimit e cila është adaptuar nga PSO-të për viktimat e trafikimit, ku akterët relevantë për secilin hap janë përcaktuar me shkronja të hijezuara (diagrami 13). Nëse kemi të bëjmë me viktimitë që dëshiron ta raportojë dhunën (qoftë ajo e moshës së mitur apo jo), atëherë viktima duhet të dërgohet në stacion policor. Për t'i ikur zhvillimit të më shumë intervistave, gjë që mund të jetë traumatizuese për to, QPS-të (me mandat për të mbrojtur të drejtat e fëmijës)¹⁷ dhe Mbrojtësit e Viktimave (me mandat për t'i përfaqësuar interesat e viktimave) do duhej të jenë të pranishëm gjatë intervistës policore.¹⁸ Deklarata policore duhet të dëshmohej nga këto palë, ndërsa të gjitha palët e përfshira duhet të nënshkruajnë Formularin e Mbrojtjes dhe Asistencës, përmes së cilës viktima hyn në programin e asistencës shtetërore. Një kopje e këtij formulari shpërndahet tek çdo institucion, në mënyrë që atyre tu shërbejë për menaxhim të lëndës. Nëse viktimat e moshës madhore nuk duan të flasin me policinë, atëherë QPS-të (në raste të fëmijëve) dhe/ose MV-të mund të nënshkruajnë Formularin e Mbrojtjes dhe Asistencës. Nëse ato besojnë se është kryer ndonjë vepër penale, ato mund ta referojnë rastin në polici, e cila fillon ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare. Më pas, viktima duhet të ketë shërbime shëndetësore fizike dhe psikologjike, si dhe të ekzaminohet në aspektin mjekoligjor, nëse kjo është e domosdoshme. Në raste emergjente apo nëse kjo është në interes të viktimës, ekzaminimet mjekoligjore mund të kryhen edhe para marrjes së deklaratës. Bazuar në dëshirën e viktimave të moshës madhore apo në vlerësimin e QPS-ve (në raste të fëmijëve), viktima mund të dërgohet në strehimore.

Në rastet kur viktima është psikologjikisht dhe fizikisht e aftë që të diskutojë për të ardhmen e vet, QPS-të (për fëmijë), MV-të (për të rritur) dhe strehimorja (sipas nevojës) diskutojnë me klientin Planin për Rehabilitim dhe Reintegrimit. Menaxheri i rastit më pas bashkëpunon me institucionet tjera për t'i ndihmuar klientit me implementimin e këtij plani. Varësisht nga nevojat e klientit, ky plan mund të përfshijë arsimim; trajnim dhe ndihmë në punësim nga QRP-të, subvencionim në banim; asistencë sociale; kujdes shëndetësor; këshillim psikologjik, këshillim familjar; ndihmë juridike dhe/ose përkrahje në reintegrimit nga OJQ-të. Menaxheri i rastit kryen vizita të rregullta monitoruese deri në realizimin përfundimtar të planit dhe i ndihmon klientit në rishikimin e këtij Plani, nëse kjo është e domosdoshme.

¹⁷ Ligji kërkon nga QPS-të të jenë të pranishme për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve. QPS-të mund të kërkojnë urdhër për mbrojtje.

¹⁸ KPRK parashihet se mbrojtësit e viktimave duhet të mbrojnë të drejtat e viktimave të dhunës në familjet (nenet 81 dhe 82).

Diagrami 13. Procedura e propozuar për referim të viktimave të dhunës në familje



Bazuar në rolet dhe përgjegjësitë e tyre, ZMNV-të do duhej të udhëheqin procesin e hartimit të PSO-ve, në bashkëpunim të ngushtë me akterët relevantë.¹⁹ ZBGJ do duhej të ndihmojë dhe shtyjë këtë proces përpara.²⁰ Sistemi i referimit duhet t'i përmbahet Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës në Familje ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të Këshillit të Evropës, e cila specifikon se financimi i çdo institucioni duhet të bëhet në pajtim me mandatin e vet.

UNDP WSSI (€3,874), OSBE dhe OPDAT kanë shprehur interes për të përkrahur zhvillimin e PSO-ve për vitin 2012.²¹ Si pjesë e Programit GBV të UNKT, në vitin 2012-2013 UN Women planifikon të fuqizojë mekanizmat koordinues në Gjilan dhe Gjakovë dhe të krijojë një mekanizëm të tillë në Dragash. Kjo përfshin edhe përkrahjen e komunës në planifikimin dhe përcaktimin e linjave buxhetore për dhunën në familje (€15,000 për dy vite).²² Do të varet nga komuna nëse grupet e koordinimit do të trajtojnë edhe politikat apo menaxhimin e rasteve. Leksionet e nxjerra nga kjo punë mund të përbëjnë model për komunitat tjera. Të gjithë donatorët do duhej të koordinojnë aktivitetet e tyre për zhvillimin e njëkohshëm të një sistemi të referimit dhe PSO-ve për mbarë Kosovën, duke u siguruar përputhje të plotë mes sistemeve komunale dhe atij në nivel kombëtar.

¹⁹ Kodi i Procedurës Penale në Kosovë i bën mbrojtësit e viktimave përfaqësues të autorizuar të viktимës (neni 82).


²⁰ Kjo do të ishte në pajtueshmëri me përgjegjësitë që i jepen me Ligjin për Barazi Gjinore në Kosovë, neni 5.2.

²¹ Korrespondencë dhe intervista të RRGK-së, 2012. Buxheti i OPDAT nuk është miratuar deri në qershor të vitit 2012.

²² Intervistë e RRGK-së me përfaqësues të UN Women, 23 mars 2012. UN Women gjithashtu do të financojë një vizitë studimore për akterët në nivel komunal, të cilët duhet të mësojnë praktikatat më të mira në Shqipëri (€4,000 nga Fondi Rajonal i UN Women).

Kapitulli 7. Në Përmbledhje: Kostoja e Dhunës në Familje

Duke pasur parasysh mangësitë që mund t'i ketë një përlogaritje e tillë dhe duke konsideruar shpenzimet dhe ndarjet buxhetore të ditura (të cilat i përshkruam më sipër), RRGK u përpoq që ta bëjë një parashikim të koston së gjithmbarshme të parandalimit të dhunës në familje, mbrojtjes së viktimave, ndjekjes penale të autorëve të saj dhe përkrahjes së rehabilitimit dhe reintegrimit të tyre. Në vitin shërbimet që ndërlidhen me adresimin e **dhunës në familje kanë kushtuar së paku €3,060,116**, nga të cilat mbi €1,923,124 janë ndarë nga shteti dhe mbi €1,136,992 nga donatorët (37%). Bazuar në këtë supozim fillestar, së paku 0.13% të shpenzimeve të gjithmbarshme të Kosovës gjatë vitit 2011 janë ndarë në shërbime shtetërore për adresimin e dhunës në familje. Në përgjithësi, shërbimet e ndërlidhura me shërbimet për dhunën në familje kanë kushtuar €1.76 për kokë banore, apo €1.11 për person në kuptim të taksave vjetore.¹ Sa për krahasim, në vitin 2011 qeveria shpenzoi €51 për kokë banori në shërbime shëndetësore, €20 për kokë banori për arsim dhe €8 për kokë banori për ndërtimin e autostradës Morinë-Merdarë.²



¹ Supozimet janë bërë duke pjesëtuar shpenzimet që lidhen me dhunën në familje me numrin e popullatës, duke shfrytëzuar të dhënat nga regjistrimi i popullatës (1,733,872).


² KASH 2012-2014.

Duke iu referuar Strategjisë, diagrami 14 ilustron shpenzimet për secilën shtyllë ndaras. Bëhet e qartë se qeveria dhe donatorët kanë ndarë bindshëm më shumë resurse për mbrojtje (€2,088,581) se sa për parandalim (€526,264) apo rehabilitim dhe reintegrim (€399,585). Mbrojtja ka konsumuar 68% të shpenzimeve të gjithmbarshme të supozuara. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të faktit se disa aktivitete që ndërlidhen me mbrojtjen janë përfshirë në buxhetet e institucioneve para miratimit të Ligjit apo Strategjisë (p.sh. shërbimet policore, prokuroriale, gjyqësore, QPS-të dhe MV-të). Në anën tjetër, parandalimi ka filluar të institucionalizohet tek vonë (p.sh. brenda MASHT-it), ndërsa për rehabilitim dhe reintegrim ekzistojnë fare pak shërbime.

Vlen të theksohet se këto tri shtylla janë të ndërlidhura dhe ndikojnë në kostot e njëra-tjetrës. Parandalimi efektiv mund të zvogëlojë kërkesën për shërbime të mbrojtjes, ndjekjes penale, rehabilitimit dhe reintegrimit (shih diagramin 15).³ Hulumtimet tjera mbi ndikimin e përgjithshëm të dhunës në familje tregojnë se dhuna ka ndikim negativ në buxhetet shtetërore dhe se shpesh zvogëlon kapacitetet e viktimës për t'ï kontribuar në mënyrë produktive familjes, ekonomisë dhe jetës publike.⁴ Ajo shterë resurset që ndahen për shërbime sociale, sistem të drejtësisë, kujdes shëndetësor dhe punësim. Dhuna në familje ka ndikim të fuqishëm në zhvillimin ekonomik dhe njerëzor, përfshirë këtu produktivitetin e zvogëluar, pagat e humbura, zvogëlimin e shpenzimeve ekonomike, rritjen e mortalitetit, peshën e ulët të porsalindurve, dhe nivelin më të ulët të arsimimit për fëmijët që rriten në mjedise të dhunshme, gjë që ndikon në kontributin e tyre të mëpasmë në fuqinë punëtore.⁵ Hulumtimi i RRGK-së konfirmon se fondet publike të shpenzuara për dhunën në familje janë minimale në krahasim me koston më të gjerë ekonomike që dhuna shkakton në rast se nuk parandalohet. Siç paraqitet në diagramin 17, investimi në përpjekje efektive parandaluese, që për vitin 2011 ka qenë më i ulët se €526,264, do të mund t'ï kursente shtetit dhe donatorëve mbi €2,533,852 në shpenzimet për mbrojtje, rehabilitim dhe reintegrim.⁶

Sa u përket shërbimeve specifike të ofruara për viktimat e dhunës në familje, duket se strehimoret kanë shpenzuar shumicën e resurseve (shih diagramin 16). Këshillimet kanë zënë vendin e dytë sa i përket resurseve të nevojshme, ndoshta për shkak të mbivlerësimit të shpenzimeve nga MASHT-i sa i përket këshillimeve nga psikologët në komuna (të cilët nuk e kalojnë tërë kohën e tyre duke këshilluar raste të dhunës në familje). Edhe për policinë, shërbimet sociale dhe MV-të janë bërë mjaft shpenzime. Në anën tjetër, ndihma shëndetësore dhe në punësim duket se janë tërësisht të nënfinancuara. Kjo për shkak të

Diagrami 15. Ndikimi i Parandalimit të Ndërhyrjes së Hershme në Shpenzimet për Dhunën në Familje



Nëse është ushtruar dhunë dhe vazhdon të ushtrohet, shpenzimet rriten me kohë. Shigjeta "ndërhyrje" ilustron se si parandalimi dhe/ose ndërhyrja e hershme mund të parandalojnë shpenzimet në të ardhmen lidhur me mbrojtjen, rehabilitimin dhe reintegrimin.


³ Elizabeth Villagómez, *Elemente Themelore të Buxhetimit Gjnor për Përcaktimin e Kostos së Shërbimeve që u Shërbejnë Vajzave dhe Grave që i Nënshtrohen Dhunës*, 2012; dhe për *Almenara Estudios Económicos y Sociales, Kostot Ekonomike dhe Sociale të Dhunës në Familje Ndaj Grave në Andaluzia*, për Komisionin Ekonomik të OKB-së për Evropën, Konferenca e Statisticientëve të Evropës, Dokument Pune 8, Gjenevë, 2010.

⁴ Këshilli i Evropës, *Luftimi i Dhunës Ndaj Grave, Studim Vlerësues i Masave dhe Veprimeve të Ndërmarra në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës*, Strasburg: Drejtoria e Përgjithshme e Këshillit të Evropës për Drejta të Njeriut, 2006.

⁵ Shih Elisabeth Shrader, *Zhvillimi Ekonomik dhe Dhuna në Baza Gjnore*, Banka Botërore, 2000.


⁶ Për më shumë detaje lidhur me kalkulimet, shih kapitujt paraprak dhe aneksin 1.

dobësie në mbajtje të dosjeve, gjë që ia pamundësoi RRGK-së identifikimin e shpenzimeve për asistim të viktimave të dhunës në familje.



Një tjetër mënyrë e shqyrtimit të shpenzimeve që ndërlidhen me dhunën në familje është që t'i vëhet një çmim secilit shërbim që viktimat mund të pranojnë (shih diagramin 17). Natyrisht, shpenzimet mund të dallojnë shumë varësisht nga vepra penale e kryer, lëndimet e pësura dhe resurset e vetë viktimës (p.sh. akomodimi alternativ, përkrahja nga familja, niveli i arsimimit, statusi i punësimit). Nevojat e ndryshme të viktimave të ndryshme dhe mosmbajtja e mirëfilltë e të regjistrave nga institucioneve bëjnë që të mos mund të kalkulohet saktësisht kostoja "mesatare" e asistencës për viktimë.

Diagrami 17. Vlerësimi i Kostos Vjetore të Dhunës Familjare Përgjatë Rrugëtimit të Viktimës



Në përgjithësi, **përlogaritjet e RRGGK-së mund të nënvlerësojnë dukshëm mjetet që qeveria në të vërtetë i ka shpenzuar në adresimin e dhunës në familje.** Fakti që nuk kishte të dhëna në dispozicion nënkuptonte se RRGGK arrinte thjeshtë të gërvishte sipërfaqen e këtyre shpenzimeve. Për më tepër, megjithëse këto diagrame ilustronë disa supozime mbi shpenzimet në vitin 2011, **kostoja e vërtetë e shërbimeve të cilat do duhej ofruar në pajtim me kornizën ligjore është shumë më e lartë.** Në shumë fusha institucionet nuk kanë ndarë buxhet apo kanë ndarë buxhet të pamjaftueshëm (shih anekset 1 dhe 2). Për shembull, policia, MV-të dhe QPS-të kanë raportuar se kanë mbuluar shpenzime të caktuara “nga xhepi”; disa prej këtyre institucioneve mes tjerash nuk kishin sa duhet vetura, derivate, kompjuterë dhe mjete komunikimi për të përmbushur detyrat e tyre. Shumë entitete nuk kishin ndarë buxhet për shpenzime të ndërlidhura me dhunën në familje, kështu që ato nuk i kishin paraparë në mënyrë të saktë shpenzimet e domosdoshme për këtë veprimtari. Institucionet që nuk ishin në dijeni të përgjegjësive të tyre sa i përket dhunës në familje sigurojnë se nuk kanë paraparë shpenzime për të kryer ato përgjegjësi. Shumica e institucioneve nuk ishin në dijeni për alokimet financiare të domosdoshme për të përmbushur obligimet e tyre ligjore dhe në disa raste nuk kishin as dijeni themelore se si duhet përlogaritur kostot dhe ndarë buxhetet (shih kapitullin 2).

"Dhuna në Familje nuk është prioritet në Komunën e Dragashit, pasi që nuk ka dhunë në familje në Dragash. Prandaj ne nuk buxhetojmë asgjë speciale në këtë fushë."
- Drejtor i Departamentit të Financave

Sa i përket financimit për adresimin e dhunës në familje në të ardhmen, dy shtyllat e para – 1) parandalimi dhe 2) mbrojtja, siguria dhe ndjekja penale, do të mund të implementohen pjesërisht duke shfrytëzuar buxhetet ekzistuese të institucioneve relevante. Megjithëse shpesh ato janë të pamjaftueshme, institucionet kanë ndarë buxhete përkatëse (sipas KASH-it) për policinë, gjykatat, prokurorët, MV-të, QPS-të dhe palët tjera me interes; rolet dhe përgjegjësitë e tyre janë përcaktuar para miratimit të Strategjisë. Megjithatë, shtylla e rehabilitimit dhe reintegrimit mbetet dukshëm e nënfinancuar, për shkak se shumë prej këtyre shërbimeve nuk ekzistojnë në kohën e hartimit të KASH-it. Nevojiten resurse më të mëdha se sa që parashihen në KASH-in ekzistues, por ato nuk mund të ndahen deri në vitin 2014.

Përkundër zotimeve për sundim të ligjit, zhvillim të kapitalit njerëzor dhe mirëqenie sociale në KASH, përcjellja e mënyrës së shpenzimit të parave dëshmon se qeveria mbetet e fokusuar në investime infrastrukturore (shih kapitullin 2). Si rezultat i kësaj, për shumicën e shërbimeve sociale fondet janë shumë të kufizuara. Ky fakt ndikon në tërë popullatën, jo

vetëm tek viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, mund të thuhet se viktimat e dhunës në familje, si një nga grupet më të cenueshme mes qytetarëve të Kosovës, janë mes atyre që më së shumti ndikohen nga shpenzimet joproporcionale në infrastrukturë. Nëse qeveria zotohet të sigurojë mirëqenie sociale, e kjo përbën një nga rolet dhe përgjegjësitë që ka sipas kornizës ligjore ekzistuese, edhe buxheti do duhej të rishikohet dhe të sigurojë më shumë investime në strukturën sociale. Financimi më i mirë i shërbimeve sociale në përgjithësi do të nënkuptonte shërbime më të mira edhe për viktimat e dhunës në familje.

Si do të mund t'i tejkalonin institucionet e vendit sfidat serioze që i hasin gjatë implementimit të përgjegjësiave të tyre sa i përket dhunës në familje? RRGK propozon katër strategji: **1) rishqyrtimi i linjave buxhetore, identifikimi i mënyrave për shfrytëzim më efikas të resurseve shtetërore; 2) sigurimi i fondeve nga donatorët; 3) gjetja e mënyrave inovative për shtimin e të hyrave; ose 4) investimi në parandalim, si mjet për të zvogëluar shpenzimet e përgjithshme që ndërlidhen me dhunën në familje.**

Së pari, sa i përket efikasitetit, shteti mund të shtojë performansën buxhetore duke koordinuar më mirë programet me financat. Koordinimi duhet të zhvillohet në shumë nivele: mes programeve shtetërore dhe njësive të kostos; mes zyrtarëve të buxhetit dhe avokuesve gjinorë;⁷ mes institucioneve, në kuptim të kursimit; dhe gjatë procesit të planifikimit të buxhetit dhe përpilimit të raporteve tremujore. Institucionet poashtu duhet të koordinojnë raportimin e rasteve të dhunës në familje, në mënyrë që zyrtarët e buxhetit të mund të planifikojnë shërbimet relevante efikase.⁸

Qeveria mund të shtojë efikasitetin edhe më tej përmes monitorimit dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të veta. Aktualisht institucionet janë mjaft të dobëta sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të programeve dhe buxheteve të tyre. Donatorët do duhej të bashkëpunojnë me institucione, t'u ofrojnë atyre ekspertizë dhe të zhvillojnë metodologji, vegla dhe kapacitete për të përmirësuar monitorimin dhe vlerësimin. Do duhej përgatitur një set indikatorësh si përkrahje e procesit të implementimit të buxhetit, përfshirë edhe implementimin nga perspektiva gjinore. Indikatorët e performansës duhet të shfrytëzohen si vegël për negociim gjatë planifikimit dhe monitorimit të buxheteve nga perspektiva gjinore në përgjithësi dhe të Strategjisë në veçanti. Leksionet e nxjerra gjatë këtij monitorimi dhe vlerësimi duhet të shfrytëzohen gjatë përpilimit të buxheteve të vijuese vjetore, si mjet për arritjen e synimit të qeverisjes së mirë, i cili përcaktohet në KASH dhe është në pajtim me Qarkoren Buxhetore.

Një tjetër mënyrë për të shtuar efikasitetin është shmangia e dyfishimit të mundshëm të punës, e në veçanti të financimit nga donatorët. Për shembull, para pak kohe tri palë hulumtuesish të përkrahur nga tre donatorë u takuan me të njëjtët akterë komunalë brenda vetëm disa javësh. Të gjitha këto ekipe parashtruan pyetje të ngjashme që kishin të bënin me performansën institucionale kundrejt përgjegjësiave që kanë lidhur me dhunën në familje dhe me proceset buxhetore. Ka pasur mundësi që të grumbullohen resurset në një vend dhe të shfrytëzohet një set pyetjesh, përgjigjet e të cilave do të merreshin nga një ekip i vetëm hulumtues. Kësisoj, do të kishte kursime në kuptim të grumbullimit të të dhënave dhe do të kursehej koha e përfaqësuesve institucionalë.⁹ Edhe duplikimi i shërbimeve nga qeveria, siç është ekzistenca e disa linjave të hapura telefonike, do duhej të shmanget. Në vend se të financohen linja të ngjashme buxhetore (p.sh. vetëdijesimi, trajnimet dhe hulumtimet), shteti do duhej të inkurajojë donatorët që të koordinohen më mirë për të siguruar financim për programet të cilat janë dukshëm më të nënfinancuara, siç është programi i rehabilitimit. Qeveria duhet të ketë parasysh se përkrahja e donatorëve për Kosovën duket të jetë në

"Nganjëherë kam përshtypjen që ekziston një garë e madhe ndërmjet donatorëve."

- Një Respondent

⁷ Në këtë kuptim, ABGJ do të mund të krijonte një vegël përcjellëse për buxhetimin gjinor.

⁸ Grupi punues RRGK/UNDP, "Me çfarë çmimi?", qershor 2012.

⁹ Vrojtime të RRGK-së gjatë zhvillimit të intervistave me institucione.

rënie dhe se fondet e huaja nuk përbëjnë një zgjidhje të qëndrueshme përmes së cilës qeveria do të mund t'i përmbushte obligimet e veta lidhur me adresimin e dhunës në familje.

Mënyra e tretë për të siguruar resurse për adresimin e dhunës në familje është shtimi i të hyrave. Sektori privat nuk mund të kontribuojë shumë për shkak se është i vogël dhe ka pak fuqi investuese. Megjithatë, shteti mund të shtojë të ardhurat duke u bërë presion gjykatave që të ushtrojnë detyrat e tyre që kanë të bëjnë me grumbullimin e gjobave, përfshirë edhe konfiskimin e pasurive të autorëve të dhunës. ***Gjobat gjyqësore për autorët e dhunës në familje dhe pasuria e konfiskuar e kriminelëve do të mund t'i alokohej shërbimeve përkrahëse të ndërlidhura me rehabilitimin dhe reintegrimin.***¹⁰

Së katërti, mund të thuhet se shpenzimet në parandalim janë shumë më të ulëta se sa ato për mbrojtje, rehabilitim dhe reintegrim. ***Investimet në parandalim efektiv dhe moslejimi i shfaqjes së dhunës do të rezultojnë me kursime të mëdha qeveritare në të ardhmen.*** Përveç ngritjes së vetëdijes dhe arsimimit, kjo nënkupton të siguruarit se QPS-të dhe policia kanë resurset e duhura dhe ekspertizën e domosdoshme për të parandaluar aktivisht shfaqjen apo rishfaqjen e dhunës në familje në nivel të komunitetit. Intervenimi i hershëm është shumë më i përballueshëm për shtetin se sa përballja me rezultatet dhe pasojat afatgjata të dhunës në familje.

¹⁰ Grupi punues RRGK/UNDP, "Me çfarë çmimi?", qershor 2012.

Rekomandime

Rekomandimet në vijim janë në përputhje me provat dhe konkluzionet e paraqitura më sipër.

Për të gjitha institucionet

- T'i jepet prioritet dhe të kërkohet financim adekuat nga MF për implementimin e Ligjit dhe Strategjisë. Gjatë përgatitjes së planeve buxhetore duhet të kihet parasysh procedurat e referimit dhe trajnimet e obligueshme.
- Të bashkëpunohet në hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar, përfshirë PSO-të ndërinstitucionale. Çdo institucion duhet të listojë rolin dhe përgjegjësinë e vet në PSO, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjitha institucionet dhe të pasqyrohen në planet e punës dhe buxhetet e tyre. Sistemi i referimit do duhet të përcaktojë qartë alokimet buxhetore të cilat çdo institucion duhet t'i ndajë për ta përmbushur mandatin e vet. Koordinimi më i mirë mund të shtojë efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.
- Të sigurohet koordinim mes ZBGJ-ve, stafit programatik dhe zyrtarëve për buxhete në përgatitjen e buxheteve vjetore dhe trajnimi i adekuat i tyre për t'u kontribuar në mënyrë efektive. Të azhurnohen përshkrimet e vendeve të tyre të punës, për të përcaktuar qartë përgjegjësinë për tu koordinuar gjatë procesit të hartimit të buxhetit.
- Të përpilohen plane të detajuara të punës për aktivitete që adresojnë dhunën në familje, sipas pesë kategorive të caktuara të shpenzimit. Të caktohen dhe zbatohen njësitë e kostos për secilin departament të buxhetit. Ky departament duhet të planifikojë dhe raportojë shpenzimet buxhetore për implementimin e Ligjit dhe Strategjisë, në pajtim me kategoritë e parapërcaktuara.
- Të krijohen indikatorë të performansës për monitorimin e implementimit të buxhetit strategjik.
- Të shfrytëzohen informatat mbi kostot për të monitoruar dhe implementuar Strategjinë.
- Të rishqyrtohen linjat ekzistuese buxhetore, për të siguruar shfrytëzim më efikas të resurseve shtetërore.
- Të shfrytëzohen të dhëna të ndara sipas gjinive gjatë planifikimit buxhetor, për të identifikuar fushat në të cilat alokimet buxhetore duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë nevojave të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.
- Të rishikohen përshkrimet e vendeve të punës për stafin përgjegjës, duke sqaruar rolet dhe përgjegjësitë përkatëse, si mjet për të siguruar implementim të kornizës gjinore që ndërlidhet me dhunën në familje.

Për ligjvënësit e Kosovës, përfshirë Grupin e Grave Deputete

- Të iniciohet hartimi i amendamenteve të KPRK-së, për të përkufizuar dhunën në familje si vepër penale, sipas udhëzimeve të Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje të Këshillit të Evropës. Kjo konventë kërkon nga shtetet që të kenë kujdes dhe të ndërmarrin të gjitha masat legjislative për të "siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive të veprave".
- Të sigurohet hetim, ndjekje penale dhe kompensim efektiv dhe efikas për viktimat e dhunës në familje, duke përmbushur kështu obligimet e Kosovës sipas standardeve ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut të listuara në Kushtetutën e Kosovës, përfshirë KEDNJ dhe CEDAW.
- Të amendamentohet Ligji për të përkufizuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë akterëve të përfshirë në parandalim, mbrojtje, ndjekje penale dhe rehabilitim. Të

shqyrtohen si masa të mundshme këshillimi i obligueshëm për autorët e veprave të dhunës mbi rolet gjinore dhe pabarazinë gjinore (dhe jo vetëm mbi abuzimin me alkool dhe drogë); dhe pagimi i shpenzimeve për shërbime shëndetësore të viktimës.

- Të shtohen alokimet buxhetore dhe të monitorohet implementimi i Ligjit.
- Të sigurohet se Strategjia merr parasysh të gjitha shpenzimet e ndërlidhura me ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe identifikon qartë institucionet përgjegjëse.

Për agjencinë për barazi gjinore

- Të kërkohet implementimi i Ligjit dhe të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për këtë qëllim. Tu ofrohen këshilla dhe përkrahje ministrive në hartimin e UA-ve për implementimin e Ligjit.
- Të instalohen mekanizma për monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi implementimin e Ligjit. Të kërkohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të realizuar monitorimin relevant dhe për të implementuar përgjegjësitë përkatëse.
- Të kërkohet nga MF që të përfshijë konsultimet e obligueshme me ABGJ-në (në nivel kombëtar) dhe ZBGJ-të (brenda ministrive dhe komunave) në Qarkore Buxhetore, si pjesë të procesit të rregullt të hartimit të buxhetit.
- Të sigurohet, përmes trajnimeve, mentorimit dhe monitorimit, që ZBGJ-të në të gjitha nivelet të monitorojnë nëse buxhetet e institucioneve përkatëse të tyre adresojnë në mënyrë adekuate të gjitha obligimet ligjore lidhur me dhunën në familje.
- Të përkrahet koordinimi dhe të shmanget duplikimi mes të gjithë akterëve relevantë, në veçanti mes donatorëve dhe institucioneve, me qëllim të implementimit të kornizës ekzistuese ligjore dhe politike.

Për Ministrinë e Financave

- Të përfshihen konsultime të obligueshme me ABGJ-në dhe ZBGJ-të lidhur me buxhetet ministrore dhe komunale në Qarkore Buxhetore, si pjesë e dëgjimeve të rregullta buxhetore.
- Të specifikohen kategoritë e shpenzimit, për të mundësuar përcjelljen e shpenzimeve në aspekt afatgjatë, gjë që i shërben arritjes së caqeve specifike programatike, përfshirë adresimin e dhunës në familje.
- Të sigurohet se aktivitetet e parapara në Ligj dhe Strategji do të kenë linjat përkatëse buxhetore të përcaktuara në buxhetet vjetore të Kosovës.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të ndryshojë, së bashku me **Zyrën e Prokurorit të Shtetit**, marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar para pak kohe mbi rolin dhe përgjegjësitë e MV-ve, në pajtim me KPRK-në dhe Ligjin. Kjo marrëveshje mirëkuptimi do duhej të pasqyrojë përgjegjësitë e MV-ve lidhur me viktimat e krimit dhe jo vetëm viktimat e trafikimit.
- Të krijohen PSO për Departamentin e Mjekësisë Ligjore lidhur me viktimat e dhunës në familje.
- Të lehtësohet koordinimi dhe të shmanget duplikimi mes akterëve përkatës, përfshirë donatorët, përmes Koordinatorit Kombëtar për Dhunën në Familje, me qëllim të implementimit të kornizës ekzistuese ligjore dhe kornizës politike. Të koordinohet rregullisht me të gjitha institucionet relevante.
- Të sajohet një plan i detajuar i punës (përmes Koordinatorit Kombëtar) për monitorimin dhe implementimin e Ligjit dhe Strategjisë, që përfshin aktivitetet specifike dhe burimet e financimit.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

- Të shtohen të ardhurat: të bëhet presion mbi gjykatat që të grumbullojnë mjete ga gjobat. Gjobat dhe pronat e konfiskuara të autorëve të dhunës do të mund të ndaheshin për ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit dhe reintegrimit.

- Të alokohen resurse njerëzore dhe financiare të mjaftueshme për të monitoruar rregullisht performancën e gjykatës, që të sigurohen përgjigje të shpejta në kërkesat për urdhëresa për mbrojtje dhe vendimet në krimet e kryera në kuadër të marrëdhënieve të brendshme në përputhje me KPRK.

Për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave

- Të iniciohet krijimi i një sistemi të referimit, me të cilin ndihmohen dhe mbrohen viktimat e dhunës në familje, në pajtim me rolet dhe përgjegjësitë ligjore të institucioneve të ndryshme. Ky sistem do duhej krijuar në nivel kombëtar, përmes procedurave standarde të operimit që përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve, në pajtim me ligjet dhe politikat e zbatueshme në Kosovë. Në komunat ku veç ekziston një sistem i referimit, do duhej të miratohen marrëveshje të reja mirëkuptimi në pajtim me procedurat e reja standarde operative.

Për Policinë e Kosovës

- Të vazhdohet me ofrimin e trajnimeve të rregulla mbi dhunën në familje për hetuesit e policisë. Të azhurnohet doracaku aktual me dispozitat që parashihen në Ligj (neni 22). Të parët që duhet përfitur nga ky trajnim janë DVIU-të.
- Të sigurohet se zyrtarët të trajtojnë dhunën në familje si çështje publike dhe jo private, në pajtim me kornizën ligjore e cila parasheh ndjekjen e krimeve të kryera brenda marrëdhënies familjare sipas detyrës zyrtare. Të monitorohet rregullisht performansa e zyrtarëve dhe të ndërmerren masa disiplinore për zyrtarët që dështojnë në kryerjen e detyrave të tyre.

Për Departamentin e Mirëqenies Sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenien Sociale

